

KISHA E JEZU KRISHTIT E SHENJTORËVE TË DITËVE TË MËVONSHME • NËNTOR 2011

Liahona



**Fjalime në
Konferencën e
Përgjithshme**

**U Njoftuan Gjashtë
Tempuj të Rinj**



Mësimi nga Shkrimet e Shenjta, nga Nancy Crookston

Shpëtimtari dha mësim: “Ju hetoni Shkrimet sepse mendoni të keni nëpërmjet tyre jetë të përjetshme; dhe ato janë këto që dëshmojnë për mua” (Gjoni 5:39).

SESIONI I PARADITES TË SË SHTUNËS

- 4 Ndërsa Prapë Takohemi
Presidenti Tomas S. Monson
- 6 Fuqia e Shkrimeve të Shenjta
Plaku Riçard G. Skot
- 9 Zbulesa Personale dhe Dëshmia
Barbara Tompson
- 11 Koha Do Të Vijë
Plaku L. Uitni Klejton
- 14 Bërja e Gjësë së Duhur në Kohën e Duhur, pa Vonesë
Plaku Hoze L. Alonzo
- 16 Këshillë për Rininë
Presidenti Boyd K. Paker
- 19 Ju Keni Rëndësi për Të
Presidenti Diter F. Uhtdorf

SESIONI I PASDITES TË SË SHTUNËS

- 23 Mbështetja e Drejtuesve të Kishës
Presidenti Henri B. Ajring
- 24 Zemrat e Fëmijëve Do të Kthehen
Plaku Dejvid A. Bednar
- 28 Fëmijët
Plaku Nil L. Andersen
- 31 Një Kohë për t'u Përgatitur
Plaku Jan S. Ardern
- 33 Është më Mirë të Shohim Lart
Plaku Karl B. Kuk
- 35 Shëlbimi
Plaku LeGrand R. Kurtis i Riu
- 38 Dhurata Hyjnore e Pendimit
Plaku D. Tod Kristoferson
- 41 Dashuria e Përsosur e Nxjerr Jashtë Frikën
Plaku L. Tom Peri

SESIONI I PRIFTËRISË

- 44 Ne Jemi të Gjithë të Rekrutuar
Plaku Xhefri R. Holland
- 47 Fuqia e Priftërisë Aarone
Peshkopi Keith B. Mek-Mullin
- 50 Mundësia Unike në Jetë
Plaku W. Kristofer Uadell
- 53 Ndhima sipas Mënyrës së Zotit
Presidenti Diter F. Uhtdorf
- 56 Përgatitja në Priftëri: "Unë Kam Nevojë për Ndhimën Tuaj"
Presidenti Henri B. Ajring
- 60 Kini Guxim të Qëndroni Vetëm
Presidenti Tomas S. Monson

SESIONI I PARADITES TË SË DIELËS

- 68 Një Dëshmi
Presidenti Henri B. Ajring
- 71 Të Presësh Nga Zoti: U Bëftë Vullneti Yt
Plaku Robert D. Hejls
- 74 Libri i Mormonit – një Libër nga Perëndia
Plaku Ted R. Kelister
- 77 Duaqe Nënë e Saj
Elen S. Dalton
- 79 Rëndësia e një Emri
Plaku M. Rasëll Ballard
- 82 Qëndroni në Vende të Shenjta
Presidenti Tomas S. Monson

SESIONI I PASDITES TË SË DIELËS

- 86 Besëlidhjet
Plaku Rasëll M. Nelson
- 90 Mësimet e Jezusit
Plaku Dallin H. Ouks
- 94 Mësimdhënia sipas Mënyrës së Shpirtit
Methju O. Riçardson
- 96 Misionarët Janë një Thesar i Kishës
Plaku Kazuhiko Jamashita
- 98 Zgjidhni Jetën e Përjetshme
Plaku Randall K. Benet
- 101 Privilegji i Lutjes
Plaku J. Devn Kornish
- 104 Këngët që Ata Nuk Mundën t'i Këndonin
Plaku Kuentin L. Kuk
- 108 Kur Prapë të Takohemi
Presidenti Tomas S. Monson

MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E SHOQATËS SË NDIHMËS

- 109 Ajo Ç'Ka Unë Shpresoj se Mbesat e Mia (dhe Nipërit e Mi) do të Kuptojnë rreth Shoqatës së Ndhimës
Xhuli B. Bek
- 114 Dashuria Hyjnore Nuk Ligështohet Kurrë
Silvia H. Ollred
- 117 Qëndrojeni Besnike Besëlidhjeve
Barbara Tompson
- 120 Mosmëharro
Presidenti Diter F. Uhtdorf
- 64 Autoritetet e Përgjithshme të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme
- 124 Treguesi i Ngjarjeve në Konferencë
- 125 Mësime për Kohën Tonë
- 125 Presidencat e Përgjithshme të Organizatave Ndhimëse
- 126 Lajme të Kishës



Përmbledhje për Konferencën e Përgjithshme Gjysmëvjetoare të 181-të

SESIONI I PËRGJITHSHËM I PARADITES TË SË SHTUNËS, 1 TETOR 2011

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson. Drejtimi: Presidenti Henri B. Ajring. Lutja e hapjes: Plaku Geri J. Koleman. Lutja e mbylljes: Plaku Louell M. Snou. Muzika nga Kori i Tabernakullit; Mak Uilberg dhe Rajën Mërfi, drejtues; Riçard Eliot dhe Endriu Ansuorth, në organo: "The Morning Breaks" ["Shkrep Mëngjesi"], *Hymns*, nr. 1; "With Songs of Praise" ["Me Këngë Lëvdimi"], *Hymns*, nr. 71; "We Ever Pray for Thee" ["Ne Lutemi Gjithmonë për Ty"], *Hymns*, nr. 23, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar; "Shëlbuës i Izraelit", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 5; "Fëmi i Per'ndis' Jam", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 58, përshtatur nga Murphy, i pabotuar; "Press Forward, Saints" ["Shkoni Përpara Shenjtorë"], *Hymns*, nr. 81, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar.

SESIONI I PËRGJITHSHËM I PASDITES TË SË SHTUNËS, 1 TETOR 2011

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson. Drejtimi: Presidenti Diter F. Uhtdorf. Lutja e hapjes: Plaku Von Jong Ko. Lutja e mbylljes: Plaku Bredli D. Foster. Muzika nga një kor i Fillores nga Plezënt Vju dhe North Ogden në Juta; Vania Y. Uotkins, drejtuese; Linda Margets, në organo: "God's Daily Care" ["Kujdesi i Përditshëm i Perëndisë"], *Hymns*, nr. 306 dhe "Të Falënderoj, At' i Dashur", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 61, potpuri përshtatur nga Watkins, i pabotuar; "Families Can Be Together Forever" ["Familjet Mund të Jenë së Bashku Përgjithmonë"], *Hymns*, nr. 300, përshtatur nga Watkins, i pabotuar; "Lavdi Njeriut", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 50; "My Heavenly Father Loves Me" ["Ati Im Qiejllor më Do"], *Children's Songbook*, f. 228–229 dhe "E Di se Rron Ati Im", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 59, botuar nga Jackman, potpuri përshtatur nga Watkins, i pabotuar.

SESIONI I PRIFTËRISË I MBRËMJES TË SË SHTUNËS, 1 TETOR 2011

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson. Drejtimi: Presidenti Diter F. Uhtdorf. Lutja e hapjes: Plaku Riçard G. Hinkli. Lutja e mbylljes: Plaku Koiçi Aojagi. Muzika nga një kor i Priftërisë Melkizedeke nga Plezënt Grouv në Juta; Xhastin Bills, drejtues; Klej Kristiansen, organist: "Rise Up, O Men of God" ["Ngrihuni, Burra të Perëndisë"], *Hymns*, nr. 324, përshtatur nga Staheli, botuar nga Jackman; "Çdo Or' Më Duhesh Ti", *Himne dhe Këngë*

të Fëmijëve, f. 12, përshtatur nga Bills, i pabotuar; "Rejoice, the Lord Is King!" ["Gëzohuni, Zoti Është Mbret!"] *Hymns*, nr. 66; "Eni F'mij' të Zotit", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 4, përshtatur nga Bills, i pabotuar.

SESIONI I PËRGJITHSHËM I PARADITES TË SË DIELËS, 2 TETOR 2011

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson. Drejtimi: Presidenti Diter F. Uhtdorf. Lutja e hapjes: Plaku Pol K. Sibrovski. Lutja e mbylljes: Plaku Xhejms B. Martino. Muzika nga Kori i Tabernakullit; Mak Uilberg, drejtues; Endriu Ansuorth dhe Klei Kristiansen, në organo: "Lead Me into Life Eternal" ["Më Udhëhiq tek Jeta e Përzetshme"], *Hymns*, nr. 45; "Guide Us, O Thou Great Jehovah" ["Na Udhëhiq, O Jehova i Madh"], *Hymns*, nr. 83, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar; "Consider the Lilies" ["Vini Re Zambakët"], Hoffman, përshtatur nga Lyon, botuar nga Jackman; "Të Falemi, Zot, për Profetin", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 36; "Do të Shkoj ku Ti Do që të Shkoj", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 46, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar; "I Believe in Christ" ["Të Besoj Ty Krisht"], *Hymns*, nr. 134, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar.

SESIONI I PËRGJITHSHËM I PASDITES TË SË DIELËS, 2 TETOR 2011

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson. Drejtimi: Presidenti Henri B. Ajring. Lutja e hapjes: Plaku F. Majkëll Uatson. Lutja e mbylljes: Plaku Gregori A. Shvicer. Muzika nga Kori i Tabernakullit; Mak Uilberg dhe Rajën Mërfi, drejtues; Boni Gudlajf dhe Linda Margets, në organo: "Arise, O God, and Shine" ["Ngrihu, O Perëndi, e Shkëlqej"], *Hymns*, nr. 265, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar; "I Feel My Savior's Love" ["Dashurinë e Shpëtimtarit Tim e Ndiej"], *Children's Songbook*, f. 74–75, përshtatur nga Cardon, i pabotuar; "Tani Le të Gëzojmë", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 32; "Lord, We Ask Thee Ere We Part" ["Zot, Të Kërkojmë Ty Përpara se të Ndahemi"], *Hymns*, nr. 153, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar.

MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E SHOQATËS SË NDIHMËS, E MBRËMJES TË SË SHTUNËS, 24 SHTATOR 2011

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson. Drejtimi: Xhuli B. Bek. Lutja e hapjes: Barbara C. Bredsha. Lutja e mbylljes: Sandra Roxhers. Muzika nga një kor i Shoqatës së Ndhmës

prej Igëll Mauntin dhe Saratoga Springs në Juta; Emili Uadli, drejtuese; Boni Gudlajf dhe Linda Margets, organiste: "The Morning Breaks" ["Shkrep Mëngjesi"], *Hymns*, nr. 1, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar; "E Ëmbël Është Puna", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 13, përshtatur nga Manookin, botuar nga Jackman; "Hark, All Ye Nations!" ["Dëgjoni, të Gjithë Ju Kombe!"] *Hymns*, nr. 264; "Tani Le të Gëzojmë", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 32.

MUNDËSOHEN BISEDAT E KONFERENCËS

Për të gjetur biseda të konferencës së përgjithshme në shumë gjuhë, vizitoni faqen conference.lds.org. Pastaj zgjidhni një nga gjuhët. Përgjithësisht, brenda dy muajve pas konferencës, regjistrime zanore mundësohen edhe në qendrat e shpërndarjes.

MESAZHET E MËSIMIT TË SHTËPISË DHE TË VIZITËS MËSIMORE

Për mesazhet e mësimit të shtëpisë dhe të vizitës mësimore, ju lutemi zgjidhni atë fjalim që u përgjigjet më mirë nevojave të atyre që vizitoni.

NË KOPERTINË

Përpara: Fotografia nga John Luke. Prapa: Fotografia nga Les Nilsson.

FOTOGRAFIMI I KONFERENCËS

Pamjet nga konferenca e përgjithshme në Solt-Lejck-Siti u morën nga Craig Dimond, Welden C. Andersen, John Luke, Christina Smith, Cody Bell, Les Nilsson, Weston Colton, Sarah Jensen, Derek Israelsen, Danny La, Scott Davis, Kristy Jordan dhe Cara Call; në Brazil nga Barbara Alves, David McNamee dhe Sandra Rozados; në Kanada nga Laurent Lucuix; në Salvador nga Josué Peña; në Angli nga Simon Jones; në Japoni nga Jun Aono; në Meksikë nga Monica Mora; në Filipine nga Wilmor LaTorre dhe Ann Rosas; në Afrikën e Jugut nga Rob Milne; në Suedi nga Anna Peterson; dhe në Uruguaj nga Manuel Peña.



NËNTOR 2011 VËLLIMI 13 NR. 4
LIAHONA 09691 101

Revista ndërkombëtare zyrtare e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Presidenca e Parë: Tomas S. Monson, Henri B. Ajring, Diter F. Uhtdorf

Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve: Bojd K. Paker, L. Tom Perri, Rasëll M. Nelson, Dallin H. Ouks, M. Rasëll Ballard, Riçard G. Skot, Robert D. Hejls, Xhefri R. Holland, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk, D. Tod Kristoferson

Botues: Paul B. Pieper

Këshilltarë: Keith R. Edwards, Christoffel Golden Jr., Per G. Malm

Drejtor Administrues: David L. Frischknecht

Drejtor i Artikujve: Vincent A. Vaughn

Drejtor i Grafikës: Allan R. Loyborg

Redaktor Administrimi: R. Val Johnson

Ndihmësredaktorë Administrimi: Jenifer L. Greenwood, Adam C. Olson

Zëvendësredaktorë: Susan Barrett, Ryan Carr

Personeli i Redaksisë: Brittany Beattie, David A. Edwards, Matthew D. Flitton, LaRene Porter Gaunt, Carrie Kasten, Jennifer Maddy, Lia McClanahan, Melissa Merrill, Michael R. Morris, Sally J. Odekirk, Joshua J. Perkey, Chad E. Phares, Jan Pinborough, Paul VanDenBerge, Marissa A. Widdison, Melissa Zenteno

Drejtor Administrues i Artit: J. Scott Knudsen

Drejtor Arti: Scott Van Kampen

Administruese e Prodhimit: Jane Ann Peters

Kryedizenjtorë: C. Kimball Bott, Colleen Hinkley, Eric P. Johnsen, Scott M. Mooy

Personeli i Prodhimit: Collette Nebeker Aune, Howard G. Brown, Julie Burdett, Reginald J. Christensen, Kim Fenstermaker, Bryan W. Gygi, Kathleen Howard, Denise Kirby, Ginny J. Nilson

Përgatitja për Shtyp: Jeff L. Martin

Drejtor i Prodhimit: Craig K. Sedgwick

Drejtor i Shpërndarjes: Evan Larsen

Mbikëqyrës i Përkthimit Shqip: Attila Böröcz

Për pajtimet dhe për çmimet jashtë Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë, ju lutemi të lidheni me qendrën tuaj vendore të shpërndarjes të Kishës ose me udhëheqësin e lagjes apo degës.

Dërgoni dorëshkrime dhe pyetje në Liahona,
Room 2420, 50 East North Temple Street,
Salt Lake City, UT 84150-0024, USA; ose e-mail:
liahona@ldschurch.org.

Liahona (një term nga Libri i Mormonit, që do të thotë "busull" apo "drejtues") botohet në anglisht, armenisht, bislamisht, bullgarisht, çekisht, danisht, estonisht, fihisht, finlandisht, frëngjisht, greqisht, gjermanisht, holandisht, hungarisht, indonezish, islandisht, italisht, japonisht, kamboxhisht, kinezisht, kiribatish, koreanisht, kroatish, letonisht, lituanisht, malagasish, marshallisht, mongolisht, norvegjisht, polonisht, portugalisht, rumanisht, rusisht, samoaisht, sebuanisht, silovenisht, spanjisht, suedisht, shqip, tagalogisht, tahitisht, taisht, tongaisht, ukrainisht, urduisht dhe vietnamisht. (Periodiciteti ndryshon sipas gjuhës.)

© 2011 nga Intellectual Reserve, Inc. I rezervohet të gjitha të drejtat. Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Lënda e shkruar dhe ajo figurative e *Liahonës* mund të kopjohet për ta përdorur me raste në kishë ose në shtëpi, jo për tregti. Lënda figurative nuk mund të kopjohet nëse ajo shoqërohet me kufizime të shënimi i meritave për punën artistike. Çështjet e së drejtës së autorit duhet të adresohen te: Intellectual Property Office, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150, USA; adresa elektronike: cor-intellectualproperty@ldschurch.org.

For Readers in the United States and Canada:

November 2011 Vol. 13 No. 4. LIAHONA (USPS 311-480) Albanian (ISSN 1521-4753), is published four times a year (April, May, October and November) by The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150. USA subscription price is \$3.00 per year; Canada, \$3.60 plus applicable taxes. Periodicals Postage Paid at Salt Lake City, Utah. Sixty days' notice required for change of address. Include address label from a recent issue; old and new address *must* be included. Send USA and Canadian subscriptions to Salt Lake Distribution Center at address below. Subscription help line: 1-800-537-5971. Credit card orders (Visa, MasterCard, American Express) may be taken by phone. (Canada Poste Information: Publication Agreement #40017431)

POSTMASTER: Send address changes to Salt Lake Distribution Center, Church Magazines, PO Box 26368, Salt Lake City, UT 84126-0368.



FOLËSIT SIPAS RENDIT ALFABETIK

Ajring, Henri B., 23, 56, 68
Alonso, Hoze L., 14
Andersen, Nil L., 28
Arderne, Jan S., 31
Ballard, M. Rasëll, 79
Bednar, Dejvid A., 24
Bek, Xhuli B., 109
Benet, Randall K., 98
Dalton, Elen S., 77
Hejls, Robert D., 71
Holland, Xhefri R., 44
Jamashita, Kazuhiko, 96
Kelister, Ted R., 74
Klejton, L. Uitni, 11
Kornish, J. Devn, 101
Kristoferson, D. Tod, 38
Kuk, Karl B., 33
Kuk, Kuentin L., 104
Kurtis, LeGrand R., i Riu, 35
Mek-Mullin, Keith B., 47
Monson, Tomas S., 4, 60, 82, 108
Nelson, Rasëll M., 86
Ollred, Silvia H., 114
Ouks, Dallin H., 90
Paker, Bojd K., 16
Peri, L. Tom, 41
Riçardson, Methju O., 94
Skot, Riçard G., 6
Tompson, Barbara, 9, 117
Uadell, W. Kristofer, 50
Uhtdorf, Diter F., 19, 53, 120

TREGUESI TEMATIK

Administrimi i kohës, 31
Aktivizimi, 14, 35, 50
Ati Qiellor, 108
Besëlidhjet, 86, 117
Besimi, 28, 33, 71, 101, 104
Bibla, 74, 90
Bindja, 33, 38, 86, 90
Benet, Randall K., 44
Dashuria, 53, 77, 96, 120
Dashuria hyjnore, 68, 109, 114
Dëshmia, 9, 60, 68, 74, 82
Detyra, 47, 56
Dishepullimi, 109
Durimi, 68, 71
Durimi, 71
Emri, Kisha, 79
Etërit, 77
Familja, 28, 77
Fatkeqësia, 71, 104
Fëmijët, 28
Fryma e Shenjtë, 6, 9, 16, 33, 47, 82, 94
Gëzimi, 38, 120
Historia familjare, 24
Jezu Krishti, 35, 41, 74, 79, 90, 101
Karakter hyjnor, 19
Konferenca e përgjithshme, 4, 23, 108
Kthimi në besim, 68, 96
Kuraja, 33, 60
Libri i Mormonit, 6, 50, 68, 74
Liria e Zgjedhjes, 98
Lutja, 82, 101
Martesa, 28
Mbështetja tek vetja, 53
Mësimdhënia, 94
Mësimi, 94
Mirëqenia, 53

Moraliteti, 16
Pendimi, 16, 35, 38, 44
Përgatitja, 50, 56, 96
Përgjegjshmëria, 98
Përparësitë, 28, 31
Priftëria, 24, 47, 56, 60, 86, 109
Priftëria Aarone, 47
Prindërimi, 28, 77
Profecia, 11
Puna misionare, 11, 41, 44, 50, 79, 96
Rinia, 16, 24, 44, 47, 50, 77
Rivendosja, 11
Rritja, Kisha, 11, 41
Sakrifica, 50, 120
Shëlbimi, 35
Shembulli, 41, 60, 77, 90, 96
Shërbimi, 14, 47, 50, 53, 56, 68
Shkrimet e Shenjta, 6, 74
Shlyerja, 33, 35, 38, 90
Shoqata e Ndihmës, 109, 114
Shpresa, 19, 71
Standardet, 44, 60, 77, 82
Teknologjia, 24, 31
Tempujt dhe puna në tempull, 4, 24, 41, 109, 117
Të Rejat, 77
Vizitat mësimore, 109, 114
Vlera individuale, 19, 120
Vlera vetjake, 19, 120
Zbulesa, 6, 9, 16, 82



Nga Presidenti Tomas S. Monson

Ndërsa Prapë Takohemi

Është lutja ime që të mund të mbushemi me Shpirtin e Zotit ndërsa dëgjojmë mesazhet sot e nesër dhe mësojmë ato gjëra që Zoti dëshiron që ne t'i dimë.

Është mirë, vëllezër dhe motra, t'ju urojmë mirëseardhjen në Konferencën e Përgjithshme Gjysmëvjetore të 181-të të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Kjo konferencë shënon 48 vite – mendoni për këtë, 48 vite – që kur u thirra në Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve nga Presidenti Devid O. Mek-Kei. Kjo ndodhi në tetorin e vitit 1963. Duket e pamundur që kaq shumë vite kanë ardhur e kanë shkuar që atëherë.

Kur jemi të zënë me punë, duket sikur koha kalon tepër shpejt dhe gjashtë muajt e shkuar nuk kanë bërë përjashtim për mua. Një nga pikat kulmore gjatë kësaj periudhe ka qenë mundësia që pata për të ripërkushtuar Tempullin e Atlantës në Xhorxhia më 1 maj. Unë shoqërohesha nga Plaku e Motra M. Rasëll Ballard, Plaku e Motra Uolter F. Gonzáles, si dhe nga Plaku e Motra Uilliam R. Uolker.

Gjatë festimit kulturor me titull “Aurora nga Jugu”, të mbajtur mbrëmjen përpara ripërkushtimit, ne

vështruam kur dhanë shfaqje 2.700 të rinj dhe të reja nga i gjithë distrikti i tempullit. Ishte një nga programet më të jashtëzakonshme që kam parë dhe publiku u ngrit disa herë në këmbë për të brohoritur.

Ditën në vijim, tempulli u



ripërkushtua në dy sesione, ku Shpirti i Zotit qe me ne me bollëk të madh.

Gjatë pjesës së mëvonshme të gushtit, Presidenti Henri B. Ajring përkushtoi Tempullin e San-Salvadorit në Salvador. Ai u shoqërua nga Motra Ajring dhe nga Plaku e Motra D. Tod Kristoferson, Plaku e Motra Uilliam R. Uolker, si dhe Motra Silvia H. Ollred e presidencës së përgjithshme të Shoqatës së Ndhmës e bashkëshorti i saj, Xhefri. Presidenti Ajring raportoi se ishte një ngjarje jashtëzakonisht shpirtërore.

Në pjesën e mëtejshme të këtij viti, Presidenti Diter F. Uhtdorf dhe Motra Uhtdorf do të shkojnë bashkë me Autoritete të tjera të Përgjithshme në Kuecaltenango të Guatemalës ku ai do të përkushtojë tempullin tonë.

Ndërtimi i tempujve vazhdon i pandërprerë, vëllezër e motra. Sot është privilegji im të njoftoj disa tempuj të rinj.



Së pari, më lejoni të përmend se asnjë godinë e ndërtuar nga Kisha nuk është më e rëndësishme sesa tempulli. Tempujt janë vendet ku marrëdhëniet vulosen së bashku që të zgjasin nëpër përjetësitë. Ne jemi mirënjohës për të gjithë tempujt e shumtë nëpër botë dhe për bekimin që ata janë në jetën e anëtarëve tanë.

Nga fundi i vitit të kaluar Tabernakulli i Provos në Kontenë e Jutas u dëmtua seriozisht nga një zjarr i tmerrshëm. Kësaj ndërtese të mrekullueshme, shumë të dashur nga breza të shenjtoreve të ditëve të mëvonshme, i ngelën në këmbë vetëm muret e jashtme. Pas një studimi të kujdesshëm, kemi vendosur ta rindërtojmë atë duke ruajtur dhe restauruar plotësisht pjesën e jashtme, për t'u bërë tempulli i dytë i Kishës në qytetin e Provos. Tempulli ekzistues në Provo është një nga më të angazhuarit me punë në Kishë dhe një tempull i dytë

atje do të sjellë lehtësi për numrin në rritje të anëtarëve besnikë të Kishës që frekuentojnë tempullin nga Provo dhe komunitetet aty pranë.

Kam kënaqësinë gjithashtu, që të njoftoj tempujt të rinj në vendet në vijim: Barrankila në Kolumbi; Durban në Afrikën e Jugut; Kinshasa në Republikën Demokratike të Kongos; dhe në Star Valej në Uajoming. Përveç kësaj, ne po përparojmë në planet tona për të ndërtuar një tempull në Paris të Francës.

Hollësitë e këtyre tempujve do të jepen në të ardhmen, ndërsa sigurohen vendet e ndërtimit dhe miratimet e domosdoshme.

Kam përmendur në konferencat e mëparshme përparimin që po bëjmë duke i vënë tempujt më pranë anëtarëve tanë. Edhe pse ata janë lehtësisht të arritshëm për shumë anëtarë në Kishë, ka ende zona të botës ku tempujt janë kaq larg nga anëtarët tanë sa që ata

nuk mund ta sigurojnë udhëtimin e kërkuar për të shkuar atje. Kështu që ata nuk janë në gjendje të marrin bekimet e shenjta e të përjetshme që sigurojnë tempujt. Për të ndihmuar në lidhje me këtë, ne kemi në dispozicion atë që quhet Fondi i Përgjithshëm i Ndhmës për Përkrahjen për Tempujt. Ky fond siguron vetëm një vizitë për në tempull për ata që ndryshe nuk do të ishin në gjendje që të shkonin në tempull, por që ende e dëshirojnë skajshëm atë mundësi atë mundësi. Kushdo që mund të dëshirojë të kontribuojë në këtë fond, thjesht mund të shkruajë në informacionin e fletës së zakonshme të kontributit që i jepet peshkopit çdo muaj.

Tani, vëllezër e motra, është lutja ime që të mund të mbushemi me Shpirtin e Zotit ndërsa dëgjojmë mesazhet sot e nesër dhe mësojmë ato gjëra që Zoti dëshiron që ne t'i dimë. Për këtë lutem unë, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Plaku Riçard G. Skot,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Fuqia e Shkrimeve të Shenjta

Shkrimet e shenjta janë si sasi të vogla të dritës që ndriçojnë mendjet tona dhe na përgatisin për drejtim dhe frymëzim nga lart.

Ata prej nesh që vijnë në këtë foltore gjatë konferencës, ndiejnë fuqinë e lutjeve tuaja. Ne kemi nevojë për to dhe ju falënderojmë për to.

Ati ynë në Qiell e kuptoi se, që ne të bëjmë përparimin e dëshiruar gjatë provës sonë në vdekshmëri, do të na duhet të përballemi me sfida të vështira. Disa nga këto sfida do të jenë thuajse mposhtëse. Ai siguroi mjete që të na ndihmojë që të jemi të suksesshëm në provën tonë në vdekshmëri. Një komplet i atyre mjeteve janë shkrimet e shenjta.

Nëpër të gjitha kohët, Ati në Qiell ka frymëzuar burra dhe gra të zgjedhura që të gjejnë zgjidhje, me anë të drejtimit nga Fryma e Shenjtë, për problemet më të ndërlikuara të jetës. Ai i ka frymëzuar ata shërbëtorë të autorizuar që t'i shënojnë ato zgjidhje si një lloj manuali për ata nga fëmijët e Tij që kanë besim në planin e Tij të lumturisë dhe në Birin e Tij të Dashur Jezu Krishtin. Ne mund t'i qasemi kësaj udhëheqjeje në çdo kohë nëpërmjet thesarit që ne e quajmë vepra standarde – që janë, Dhiata e Vjetër dhe e Re, Libri i Mormonit, Doktrina

e Besëlidhje dhe Perla me Vlerë të Madhe.

Ngaqë shkrimet e shenjta janë nxjerrë nga një komunikim i frymëzuar nëpërmjet Frymës së Shenjtë, ato janë e vërteta e pastër. Ne nuk kemi nevojë të shqetësohemi rreth vlefshmërisë së koncepteve që përmbajnë veprat standarde, pasi Fryma e Shenjtë ka qenë instrumenti që i ka nxitur dhe frymëzuar ata individë që kanë regjistruar shkrimet e shenjta.

Shkrimet e shenjta janë si sasi të vogla të dritës që ndriçojnë mendjet tona dhe na përgatisin për drejtim dhe frymëzim nga lart. Ato mund të bëhen çelësi për të hapur kanalën për të lidhja shpirtërore me Atin tonë në Qiell dhe Birin e Tij të Dashur, Jezu Krishtin.

Shkrimet e shenjta, kur citohen saktësisht, u japin forcën e autoritetit deklarimeve tona. Ato mund të bëhen miq besnikë që mund të gjenden kudo dhe në çdo kohë. Ato janë gjithmonë të gjendshme kur nevojiten. Përdorimi i tyre siguron një themel të vërteta që mund ta përftojë nëpërmjet Frymës së Shenjtë. Mësimi, mendimi thellë, kërkimi dhe mbajtja

mend e shkrimeve të shenjta është si të mbushësh një skedar me miq, vlera dhe të vërteta që mund t'i ftosh në çdo kohë, kudo në botë.

Fuqi e madhe mund të vijë nga futja në kujtesë e shkrimeve të shenjta. Futja në kujtesë e shkrimeve të shenjta është si të krijosh miqësi të re. Ajo është si të zbulosh një individ të ri që mund të të ndihmojë në kohë nevojë, të japë frymëzim e ngushëllim dhe të jetë një burim nxitjeje për ndryshimin e nevojshëm. Për shembull, mbajtja mend e këtij psalmi ka qenë për mua një burim fuqie dhe kuptimi:

“Zotit i përket toka dhe të gjitha gjërat që janë mbi të, bota dhe banorët e saj.

Sepse ai e ka themeluar mbi detet dhe e ka vendosur mbi lumenjtë.

Kush do t'i ngjitet malit të Zotit? Kush do të qëndrojë në vendin e tij të shenjtë?

Njeriu i pafajshëm nga duart dhe i pastër nga zemra, që nuk e ngre shpirtin për t'u dukur dhe nuk betohet në mënyrë të rreme.

Ai do të marrë bekimet e Zotit dhe drejtësinë nga Perëndia e shpëtimit të tij” (Psalmi 24:1–5).

Mendimi thellë mbi një shkrim të shenjtë si ky jep një drejtim të shkëlqyer në jetë. Shkrimet e shenjta mund të formojnë një themel mbështetjeje. Ato mund të sigurojnë një burim të jashtëzakonshëm miqsh që duan të na ndihmojnë. Një shkrim i shenjtë që futet në kujtesë, bëhet një mik i përhershëm që nuk dobësohet me kalimin e kohës.

Meditimi mbi një varg të shkrimeve të shenjta mund të jetë kyçi për të hapur zbulesën dhe drejtimin e frymëzimit nga Fryma e Shenjtë. Shkrimet e shenjta mund të qetësojnë një shpirt të trazuar, duke i dhënë paqe, shpresë dhe rivendosje të besimit në aftësinë e njeriut për të kapërcyer sfidat e jetës.



Ato kanë fuqinë e madhe të shërojnë sfidat emocionale kur ka besim te Shpëtimtari. Ato mund të përshpejtojnë shërimin fizik.

Shkrimet e shenjta mund të komunicojnë domethënie të ndryshme në kohë të ndryshme në jetën tonë, sipas nevojave tona. Një shkrim i shenjtë që mund ta kemi lexuar shumë herë, mund të marrë kuptime të reja dhe të holla, që janë rifreskuese dhe tejshikuese kur përballemi me një sfidë të re në jetë.

Si i përdorni ju personalisht shkrimet e shenjta? A bëni shënime në kopjen tuaj? A vendosni shënime anës faqes për të kujtuar një çast drejtimi shpirtëror apo një përjetim që ju ka dhënë një mësim të thellë? A i përdorni të gjitha veprat standarde, përfshirë Dhiatën e Vjetër? Unë kam gjetur të vërteta të çmuara në faqet e Dhiatës së Vjetër që janë pjesë të rëndësishme të themelit të së vërtetës që drejton

jetën time dhe është një burim kur përpiqem të ndaj një mesazh ungjilli me të tjerët. Prandaj unë e dua Dhiatën e Vjetër. Unë gjej perla të çmuara të së vërtetës të shtrira në të gjitha faqet e saj. Për shembull:

“Samueli i tha: ‘Ndoshta i pëlqejnë Zotit olokaustet dhe flijimet si bindje ndaj zërit të Zotit? Ja, bindja është më e mirë se flijimi; dhe të dëgjosh me kujdes është më mirë se dhjami i deshve.’” (1 Samuelit 15:22).

“Ki besim tek Zoti me gjithë zemër dhe mos u mbështet në gjykimin tënd; pranoje në të gjitha rrugët e tua, dhe ai do të drejtojë shtigjet e tua.

Mos e mbaj veten të ditur në sytë e tu, ki frikë nga Zoti dhe hiq dorë nga e keqja . . .

Biri im, mos e përçmo ndëshkimin e Zotit dhe mos urre qortimin e tij, sepse Zoti qorton atë që do, si një baba djalin që atij i pëlqen.

Lum ai njeri që ka gjetur diturinë dhe njeriun që ka përfutur arsyen” (Fjalët e Urta 3:5–7, 11–13).

Dhiata e Re është gjithashtu një burim të vërtete të çmuar:

“Dhe Jezusi i tha: ‘Duaje Zotin, Perëndinë tënde me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde.

Ky është urdhërimi i parë dhe i madhi.

Dhe i dyti, i ngjashëm me këtë, është: Duaje të afërmin tënd porsivetveten.

Nga këto dy urdhërime varet i tërë ligji dhe profetët” (Mateu 22:37–40).

“Edhe Zoti tha: ‘Simon, Simon, ja, Satani ka kërkuar t’ju shoshë ashtu siç shoshet gruri.

Por unë jam lutur për ty, që besimi yt të mos mpaket; dhe ti, kur të jesh kthyer, forco vëllezërit e tu.’

Por ai tha: ‘Zot, unë jam gati të shkoj bashkë me ty edhe në burg edhe në vdekje’.

Por Jezusi tha: ‘Pjetër, unë të them se sot gjeli nuk do të këndojë, para se ti të kesh mohuar tri herë se më njeh’ . . .

Një shërbëtoare e pa ulur pranë zjarrit, e shikoi me vëmendje dhe tha: ‘Edhe ky ishte me të’.

Por ai e mohoi duke thënë: ‘O grua, nuk e njoh’.

Pak më vonë e pa një tjetër dhe tha: ‘Edhe ti je nga ata’. Por Pjetri tha: ‘O njeri, nuk jam’.

Mbasi kaloi rreth një orë, një tjetër pohoi me këmbëngulje duke thënë: ‘Në të vërtetë edhe ky ishte bashkë me të, sepse është Galileas’.

Por Pjetri tha: ‘O njeri, s’di ç’po thua’. Dhe menjëherë, ndërsa ai ende po fliste, këndoi gjeli.

Dhe Zoti u kthye, dhe e shikoi Pjetrin. Dhe Pjetrit iu kujtua fjala që i kishte thënë Zoti: ‘Para se të këndojë gjeli, ti do të më mohosh tri herë’.

Atëherë Pjetri doli përjashta dhe qau me hidhërim” (Luka 22:31–34, 56–62).

Sa dhemb zemra ime për çka i ndodhi Pjetrit në atë rast.

Ky shkrim i shenjtë nga Doktrina e Besëlidhje e ka bekuar shumë jetën time; por së pari ta fitosh fjalën time dhe atëherë gjuha jote do të zgjidhet; atëherë, nëse dëshiron, ti do të kesh Shpirtin tim dhe fjalën time, po, fuqinë e Perëndisë për të bindur njerëzit” (DeB11:21).

Sipas gjykimit tim, Libri i Mormonit jep mësim të vërtetën me një qartësi dhe fuqi të pashoqe. Për shembull:

“Tani unë do të doja që ju të jeni të përlulur dhe të nënshtuar dhe të butë; të lehtë për t’u mësuar; plot durim dhe këmbëngulje; duke qenë të matur në të gjitha gjërat; duke qenë të zellshëm në zbatimin e urdhërimeve të Perëndisë në të gjitha kohët; duke kërkuar çdo gjë, për të cilën ju keni nevojë, qoftë shpirtërore ose tokësore, duke i dhënë falënderime gjithmonë Perëndisë për çdo gjë që ju merrni.

Dhe shikoni të keni besim, shpresë dhe dashuri hyjnore dhe atëherë ju do të keni gjithmonë vepra të mira” (Alma 7:23–24).

Dhe një tjetër:

“Dhe dashuria hyjnore është e duruar dhe është e mirë dhe nuk ka smirë, dhe nuk krekoset, nuk kërkon të mirën e vet, nuk nxitet lehtë në zemërim, nuk mendon keq dhe nuk gëzohet në paudhësi, por gëzohet në të vërtetën, mban të gjitha gjërat, beson të gjitha gjërat, shpreson të gjitha gjërat, duron të gjitha gjërat.

Prandaj, vëllezër të mi të dashur, në qoftë se nuk keni dashuri hyjnore, ju s’jeni asgjë, pasi dashuria hyjnore nuk dështon kurrë. Prandaj, kapuni pas dashurisë hyjnore që është më e madhja



e të gjithave, pasi të gjitha gjërat duhet të dështojnë—

Por, dashuria hyjnore është dashuria e pastër e Krishtit dhe nuk ka mbarim; dhe kushdo që gjendet i zotëruar prej saj në ditën e fundit, do të jetë mirë me të.

Prandaj, vëllezër të mi të dashur, lutiuani Atit me gjithë fuqinë e zemrës suaj, që të mbusheni me këtë dashuri që ai ua jep të gjithë atyre që janë pasues të vërtetë të Birit të Tij Jezu Krisht; që ju të mund të bëheni bijtë e Perëndisë; që kur ai të shfaqet, ne të jemi si ai, pasi ne do ta shohim atë ashtu sikurse është; që të mund të kemi këtë shpresë; që ne të mund të pastrohemi, madje ashtu si ai është i pastër” (Moroni 7:45–48).

Bashkëshortja ime e shtrenjtë, Xhenina, e donte Librin e Mormonit. Në rininë e saj, si adoleshente, ai u bë themeli i jetës së saj. Ai ishte burim dëshmie dhe mësimdhënieje gjatë shërbimit të saj misionar kohëplotë në veriperëndim të Shteteve të Bashkuara. Kur ne shërbyem në fushën e misionit në Kordovë të Argjentinës, ajo nxiste fuqimisht përdorimin e Librit të Mormonit në përpjekjet tona për ndërrim besimi. Xhenina vërtetoi herët në jetën e saj se ata që lexojnë vazhdimisht Librin e Mormonit bekohen me një masë shtesë të Shpirtit të Zotit, një vendosmëri më të madhe për t’u bindur urdhërimeve të Tij dhe me një dëshmi më të fortë për shenjtërinë e Birit të Perëndisë.¹ Nuk e di se për sa shumë vite, ndërsa afrohej fundi i vitit,

unë do ta shihja atë të ulej qetësisht, duke përfunduar leximin me kujdes të të gjithë Librit të Mormonit edhe një herë para fundit të vitit.

Në vitin 1991 unë doja t’i bëja një dhuratë të veçantë Krishtlindjeje familjes sime. Unë shënova në ditarin tim vetjak se si e përbusha atë dëshirë: “Është ora 12:38 pasdite, e mërkurë, 18 dhjetor 1991. Unë sapo përfundova një regjistrim zanor të Librit të Mormonit për familjen time. Kjo ishte një përvojë që e ka rritur dëshminë time për këtë vepër hyjnore dhe forcoi tek unë një dëshirë për t’u njohur më shumë me faqet e tij që të mësoja nga këto të vërteta të shkrimeve të shenjta, për t’i përdorur në shërbimin tim ndaj Zotit. Unë e dua këtë libër. Unë dëshmoj me shpirtin tim se ai është i vërtetë, se ai ishte përgatitur për bekimin e Shtëpisë së Izraelit dhe të gjithë pjesëve të saj të ndryshme përhapur kudo në botë. Të gjithë ata që do ta studiojnë mesazhin e tij në përlulësi, në besim duke besuar në Jezu Krisht, do ta dinë vërtetësinë e tij dhe do të gjejnë një thesar që t’i udhëheqë ata drejt një lumturie, paqeje dhe arritjeje më të madhe në këtë jetë. Unë dëshmoj në mënyrën më të shenjtë se ky libër është i vërtetë.”

U bëftë jona e gjithë pasuria e beki-meve që vjen nga studimi i shkrimeve të shenjta, lutem unë, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIM

1. Shih Gordon B. Hinckley, “A Testimony Vibrant and True”, *Liahona*, gusht 2005, f. 6.



Nga Barbara Tompson,
Këshilltare e Dytë në Presidencën e Përgjithshme
të Shoqatës së Ndihmës

Zbulesa Personale dhe Dëshmia

*Nëse i mbajmë me zell urdhërimet dhe kërkojmë në besim,
përgjigjet do të vijë në mënyrën e Zotit dhe në kohën e Tij.*

Shumë vite më parë, kur isha studente kolegji, po dëgjoja një konferencë të përgjithshme në radio, pasi nuk kishim TV në apartamentin tonë të vogël. Folësit e konferencës ishin të mrekullueshëm dhe unë po provoja ndjenja të fuqishme nga Shpirti i Shenjtë.

Më kujtohet mirë kur një Autoritet i Përgjithshëm foli për Shpëtimtarin e shërbesën e Tij dhe pastaj dha një dëshmi të zjarrtë, Shpirti i Shenjtë i dëshmoi shpirtit tim se ai kishte thënë të vërtetën. Në atë çast unë nuk kisha dyshim se Shpëtimtari jeton. Gjithashtu nuk kisha dyshim se po përjetoja zbulesë personale që më vërtetoi “se Jezu Krishti është Biri i Perëndisë”¹.

Kur isha fëmijë tetë vjeç, unë u pagëzova e u konfirmova dhe mora dhuratën e Frymës së Shenjtë. Qe një bekim i mrekullueshëm atëherë, por është bërë gjithmonë e më e rëndësishme ndërsa jam rritur dhe kam përjetuar dhuratën e Frymës së Shenjtë në shumë mënyra që atëherë.

Shpesh, ndërsa rritemi nga fëmijëria në adoleshencë dhe pastaj në pjekuri, kemi sfida dhe përvoja përgjatë udhës që na bëjnë të dimë se kemi nevojë për ndihmë hyjnore që vjen nëpërmjet

Shpirtit të Shenjtë. Ndërsa vijmë vështirësitë, ne mund të pyesim veten: “Cila është përgjigja për problemin tim?” dhe “Si mund ta di se çfarë të bëj?”

Shpesh kujtoj tregimin tek Libri i Mormonit mbi Lehin që i mëson ungjillin familjes së tij. Ai u tregoi atyre shumë zbulesa e mësimi mbi gjërat që do të ndodhnin në ditët e mëvonshme. Nefi kërkoi udhëheqjen e Zotit me qëllim që të kuptonte më plotësisht mësimet e atit të tij. Ai u lartësua moralisht, u bekua dhe u frymëzua të dinte se mësimet e atit të tij ishin të vërteta. Kjo i dha mundësi Nefit që të ndiqte me kujdes urdhërimet e Zotit dhe të bënte një jetë të drejtë. Ai mori zbulesë personale që ta udhëhiqte atë.

Nga ana tjetër, vëllezërit e tij debatonin me njëri-tjetrin sepse nuk i kuptonin mësimet e atit të tyre. Nefi atëherë bëri një pyetje shumë të rëndësishme: “A i keni kërkuar Zotit?”²

Përgjigja e tyre ishte e pafuqishme: “Ne nuk i kemi kërkuar, pasi Zoti nuk na e bën të ditur asgjë të tillë neve”³.

Nefi e përdori atë mundësi për t'u mësuar vëllezërve të tij se si të merrnin zbulesë personale. Ai tha: “A nuk i mbani mend ju gjërat që Zoti ka thënë?—Në qoftë se ju nuk

do të ngurtësoni zemrat tuaja dhe më kërkonin mua në besim, duke besuar se ju do të merrni, me zell në mbajtjen e urdhërimeve të mia, me siguri këto gjëra do t'ju bëhen të ditura.”⁴

Mënyra për të marrë zbulesë personale vërtet është mjaft e qartë. Neve na duhet të dëshirojmë që të marrim zbulesë, ne nuk duhet t'i ngurtësojmë zemrat tona dhe pastaj duhet të kërkojmë në besim, duke besuar vërtet se do të marrim një përgjigje, dhe pastaj të mbajmë me zell urdhërimet e Perëndisë.

Ndjekja e këtij modeli nuk do të thotë se çdo herë që i bëjmë një pyetje Perëndisë, përgjigja do të shfaqet menjëherë me çdo hollësi të asaj që duhet të bëjmë. Megjithatë, ajo do të thotë që, nëse i mbajmë me zell urdhërimet dhe kërkojmë në besim, përgjigjet do të vijë në mënyrën e Zotit dhe në kohën e Tij.

Kur isha fëmijë mendoja se zbulesa personale ose përgjigjet ndaj lutjeve do të vinin si një zë i dëgjueshëm. Vërtet, disa zbulesa vijmë duke dëgjuar një zë të vërtetë. Megjithatë, kam mësuar se Shpirti flet në shumë mënyra.

Doktrina e Besëlidhje, seksioni 6, shpjegon disa mënyra sipas të cilave ne mund të marrim zbulesë:

“Ke kërkuar prej meje dhe vër re, sa shpesh që ti ke kërkuar, ke marrë udhëzim nga Shpirti im”⁵.

“Unë vërtet e ndriçova mendjen tënde.”⁶

“A nuk i fola paqe mendjes tënde lidhur me çështjen?”⁷

Në shkrime të tjera të shenjta mësojmë më shumë mbi marrjen e zbulesës:

“Unë do të të them në mendjen tënde dhe në zemrën tënde, me anë të Frymës së Shenjtë, që do të vijë mbi ty dhe që do të banojë në zemrën tënde. Tani, vër re, ky është shpirti i zbulesës”⁸.

“Unë do të bëj që kraharori yt do të digjet përbrenda; si rrjedhim, do ta ndiesh që është e drejtë.”⁹

“Unë do të të jap nga Shpirti im, që do të ndriçojë mendjen tënde, që do ta mbushë shpirtin tënd me gëzim.”¹⁰

Më shpesh, zbulesa personale do të vijë ndërsa studiojmë shkrimet e shenjta, dëgjojmë e ndjekim këshillën e profetëve dhe të udhëheqësve të tjerë të Kishës, si dhe përpiqemi të jetojmë jetë besnike e të drejta. Nganjëherë frymëzimi do të vijë nga një varg i vetëm i shkrimit të shenjtë ose nga një rresht në një bisedë konference. Ndoshta përgjigjja juaj do të vijë kur fëmijët e Fillores do të jenë duke kënduar një këngë të bukur. Këto të gjitha janë forma të zbulesës.

Në ditët e hershme të Rivendosjes, shumë anëtarë kërkuan zbulesë me zell dhe u bekuan e u frymëzuan që të dinin se çfarë të bënin.

Motrës Eliza R. Snou iu dha një përgjegjësi nga profeti Brigam Jang për të ndihmuar që të nxiste e t’u jepte mësim motrave të Kishës. Ajo “dha mësim se gratë individualisht mund të merrnin frymëzim për t’i udhëhequr ato në jetën e tyre personale, familjet e tyre dhe përgjegjësitë e tyre në Kishë. Ajo tha: ‘U them motrave të shkojnë përpara dhe të përmbushin detyrat e tyre, në përlulësi e besnikëri dhe Shpirti i Perëndisë do të qëndrojë mbi to e ato do të bekohen në punët e tyre. Le të kërkojnë ato urtësi në vend të pushtetit dhe ato do të kenë të gjithë pushtetin që kanë urtësi ta ushtrojnë.’”¹¹

Motra Snou u mësoi motrave të kërkojnë udhëheqje nga Fryma e Shenjtë. “Ajo tha se Fryma e Shenjtë ‘kënaq e përmbush çdo dëshirë të zemrës njerëzore dhe mbush çdo zbrazëti. Kur mbushem me atë Shpirt, . . . shpirti im kënaqet.’”¹²

Presidenti Diter F. Uhtdorf ka



dhënë mësim se “zbulesa dhe dëshmia nuk vijnë gjithmonë me forcë të madhe. Për shumë, dëshmia vjen ngadalë – pjesë-pjesë.” Më tej ai tha: “Le të kërkojmë me zell dritën e frymëzimit vetjak. Le të lutemi te Zoti për ta pajisur mendjen dhe shpirtin tonë me fillimet e besimit që do të na mundësojnë të marrim dhe të njohim shërbesën hyjnore të Shpirtit të Shenjtë.”¹³

Dëshmitë tona na fuqizojnë e na forcojnë ndërsa përballim sfida në jetën tonë të përditshme. Disa njerëz ndeshen me probleme të vështira shëndetësore; disa përjetojnë probleme financiare; të tjerë kanë sfida në martesë ose me fëmijët e tyre; disa vuajnë nga vetmia ose shpresa dhe ëndrra të paplotësuara. Është dëshmia jonë, e ndërthurur me besimin tonë në Zotin Jezu Krisht dhe njohurinë tonë për planin e shpëtimit, që na ndihmon të kapërcejmë këto kohë sprove dhe mundimi.

Në librin *Daughters in My Kingdom [Bija në Mbretërinë Time]*, lexojmë për Motrën Hedvig Biraihel, një grua në Gjermani që vuajti shumë hidhërimi

dhe mungesa gjatë Luftës II Botërore. Për shkak të dashurisë e natyrës mirëbërëse të saj dhe madje edhe në kushte nevojë të madhe për vete, ajo me gatishmëri e ndau ushqimin e saj me një të burgosur lufte që po vdiste urie. Më vonë, kur e pyetën se si që në gjendje ta “mbante një dëshmi gjatë gjithë [atyre] sprovave”, në fakt ajo u përgjigj: “Nuk e mbajta unë dëshminë gjatë atyre kohëve – dëshmia më mbajti mua”¹⁴.

Meqë ne kemi një dëshmi të fortë kjo s’do të thotë se do të mbetet kështu gjithmonë. Ne duhet ta ushqejmë e ta forcojmë atë me qëllim që ajo të ketë fuqi të mjaftueshme sa të na mbështesë. Kjo është një nga arsytet pse ne “mblidhe[m] së bashku shpesh” – që të mund të marrim sakramentin, të përtërijmë besëlidhjet tona dhe të “ushqe[m] nga fjala e mirë e Perëndisë”. Është fjala e mirë e Perëndisë që na mban “përherë të kujdesshëm në lutje, duke u mbështetur vetëm në meritat e Krishtit që [është] autori dhe plotësuesi i besimit [tonë]”¹⁵.

Plaku Dejvid A. Bednar na ka dhënë mësim: “Kur, në mënyrën e duhur, jeni në kërkim të shpirtit të zbulësës dhe e vini në jetë atë, ju premtoj që do të [ecni] në dritën e Zotit’ (Isaia 2:5; 2 Nefi 12:5). Nganjëherë shpirti i zbulësës do të veprojë menjëherë dhe ngjeshur, herë të tjera hollë-hollë e shkallë-shkallë dhe, shpeshherë, me aq brishtësi, sa ju madje mund të mos e dalloni me vetëdije. Por, pavarësisht mënyrës me të cilën merret ky bekim, drita që ai siguron do t’jua ndrisë e do t’jua zmadhojë shpirtin, do t’jua ndriçojë të kuptuarit (shih Alma 5:7; 32:28) dhe do t’ju drejtojë e mbrojë juve dhe familjen tuaj.”¹⁶

Zoti dëshiron të na bekojë me udhëheqje, urtësi dhe drejtim në jetën tonë. Ai dëshiron të derdhë Shpirtin e Tij mbi ne. Sërish, për zbulësë personale ne duhet të dëshirojmë që ta marrim atë, ne nuk duhet t’i ngurtësojmë zemrat dhe pastaj duhet të kërkohet në besim, duke besuar vërtet se do të marrim një përgjigje, dhe pastaj të mbajmë me zell urdhërimet e Perëndisë. Atëherë, kur të kërkojmë përgjigje për pyetjet tona, Ai do të na bekojë me Shpirtin e Tij. Për këtë unë dëshmoj, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 46:13.
2. 1 Nefi 15:8.
3. 1 Nefi 15:9.
4. 1 Nefi 15:11; shih edhe vargun 10.
5. Doktrina e Besëlidhje 6:14.
6. Doktrina e Besëlidhje 6:15.
7. Doktrina e Besëlidhje 6:23.
8. Doktrina e Besëlidhje 8:2-3.
9. Doktrina e Besëlidhje 9:8.
10. Doktrina e Besëlidhje 11:13.
11. *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society* (2011), f. 45.
12. *Daughters in My Kingdom*, f. 46.
13. Diter F. Uhtdorf, “Potenciali Juaj, Privilegji Juaj”, *Liahona*, maj 2011, f. 60.
14. Shih *Daughters in My Kingdom*, f. 79.
15. Moroni 6:4-6.
16. Dejvid A. Bednar, “Shpirti i Zbulësës”, *Liahona*, maj 2011, f. 90.



Nga Plaku L. Uiti Klejton,
i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve

Koha Do Të Vijë

Me ju qëndroj me drojë e nderim ndërsa kjo punë përparon mahnitshëm, mrekullisht dhe e pandalshme.

Unë shërbeva si misionar i ri për disa muaj në zonat qendrore të Limas në Peru. Si rrjedhim, unë e përshkova shumë herë she-shin Placa de Armas. Pallati qeveritar, rezidenca zyrtare dhe zyra e presidentit të Perusë, është përballë sheshit. Shokët e mi dhe unë i ftonim njerëzit në shesh që të dëgjonin ungjillin e rivendosur. Unë shpesh pyesja veten si do të ishte të hyje në pallat, por mendimi që ta bëja ndonjëherë këtë dukej shumë pa gjasa.

Vitin e kaluar Plaku D. Tod Kristoferson, i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, disa të tjerë dhe unë u takuam me Alan Garsian, atëherë president i Perusë, në Pallatin Qeveritar. Neve na treguan dhomat e tij të mrekullueshme dhe u pritëm shumë përzemërsisht nga Presidenti Garsía. Kureshtja ime për pallatin kur isha misionar i ri që plotësuar në një mënyrë që unë nuk do ta kisha ëndërruar kurrë të mundshme në 1970-n.

Gjërat kanë ndryshuar në Peru nga koha kur unë isha misionar, sidomos për Kishën. Në atë kohë, atje kishte rreth 11.000 anëtarë të Kishës dhe vetëm një kunj. Sot, ka më shumë se 500.000 anëtarë dhe thuhet se 100 kunjë. Në qytete ku kishte vetëm grupe të vogla anëtarësh, tani hijeshojnë vendin kunjë me gjallëri dhe shtëpi

mbledhjesh tërheqëse. E njëjta gjë ka ndodhur në shumë vende të tjera përreth botës.

Kjo rritje e jashtëzakonshme e Kishës meriton shpjegim. Unë po e filloj me një profeci nga Dhiata e Vjetër.

Danieli ishte një skllav hebre në Babiloni. Atij iu dha mundësia të interpretonte një ëndërr të Mbretit Nebukadnetsar. Danieli i kërkoi Perëndisë që t’i zbulonte ëndrrën dhe interpretimin e saj dhe lutjes së tij iu dha përgjigje. Ai i tha Nebukadnetsarit: “Ka një Perëndi në qiell që zbulon sekretet, dhe ai i ka bërë të njohur mbretit Nebukadnetsarit atë që do të ndodhë ditët e fundit. [Këto kanë] . . . qenë vegimet e mendjes sate në shtratin tënd.” Ai tha se mbreti kishte parë një imazh frikësues me kokë, bust, krahë, kofshë dhe këmbë. Një gur ishte shkëputur nga një mal jo nga duar dhe u rrokullis përpara gradualisht duke u zmadhuar. Guri goditi figurën, duke e thyer në copa “dhe guri që kishte goditur figurën u bë një mal i madh, që mbushi tërë tokën”.

Danieli shpjegoi se figura përfaqësonte mbretëritë politike të së ardhmes dhe se “në kohën e këtyre mbretërve, Perëndia i qiellit do të nxjerrë një mbretëri, që nuk do të shkatërrohet kurrë; . . . por do t’i copëtojë” këto mbretëri dhe do t’i



asgjësore ato. “Dhe do të ekzistojë përjetë.”¹

Tani unë do t’i referohem një shkrimi të shenjtë të kohëve më të fundit. Engjëlli Moroni për herë të parë iu shfaq Jozef Smithit në 1823-shin dhe i tha atij se “Perëndia kishte një punë për [atë] për ta bërë; dhe se emri [i tij] do të mbahej për mirë e për keq mes të gjitha kombeve, fiseve dhe gjuhëve”². Mesazhi i Moronit sigurisht duhet ta ketë habitur Jozefin që ishte vetëm 17 vjeç.

Në 1831-shin Zoti i tha Jozef Smithit se çelësat e mbretërisë së Perëndisë përsëri i qenë “[dhënë] njeriut në tokë”. Ai tha se, “do të përhapet ungjilli deri në fundet e dheut, ashtu si guri që shpëputet pa duar nga mali . . . , derisa të ketë mbushur tërë tokën”³, pikërisht ashtu siç Danieli i pati thënë Nebukadnetsarit.

Në 1898-n, Presidenti Uilford Udraf, tregoi një përvojë që kishte pasur si anëtar i ri në vitin 1834 në një mblidhje të priftërisë pranë Kirtlandit. Ai tregonte: “Profeti i ftoi të gjithë ata që mbanin priftërinë, të mblidheshin në ndërtesën e vogël të një shkolle prej trarësh që kishin atje. Ajo ishte një shtëpi e vogël, rreth 4.3 metra katrore. . . . Kur ne u mblodhëm, Profeti i ftoi pleqtë e Izraelit . . . që të jepnin dëshmi për këtë punë. . . . Kur ata mbaruan, Profeti tha: ‘Vëllezër unë jam lartësuar dhe udhëzuar shumë nga dëshmitë tuaja sonte, por dua t’ju them përpara Zotit, se ju nuk dini më shumë lidhur me të ardhmen e kësaj

Kishe dhe të mbretërisë sesa një bebe në prehërin e nënës për të ardhmen e vet. Ju nuk e kuptoni atë. . . . Ajo është vetëm një grusht priftërie që ju e shihni këtu sonte, por Kisha do të mbushë Amerikën e Veriut dhe të Jugut—ajo do të mbushë botën.”⁴

Këto profeci që:

- mbretëria e Perëndisë si një gur i prerë nga mali do të mbushë tokën;
- emri i Jozef Smithit do të bëhet i njohur kudo në botë; dhe
- Kisha do të mbushë Amerikën dhe do të mbushë botën

mund të jenë dukur qesharake 170 vite përpara. Grupi i vogël i besimtarëve, që mezi e nxirrnin jetesën e tyre

në pjesën e papushtuar të Amerikës dhe lëviznin për t’i shpëtuar përndjekjes, nuk dukeshin si themeli i një besimi që do të kapërcente kufijtë ndërkombëtarë njëri pas tjetrit dhe do të depërtonte nëpër zemra kudo.

Por është pikërisht kjo ajo që ka ndodhur. Më lejoni të jap një shembull.

Ditën e Krishtlindjes, në 1925-n, në Buenos-Ajres, Plaku Melvin J. Ballard përkushtoi të gjithë kontinentin e Amerikës Jugore për predikimin e ungjillit. Në gusht të 1926-s një grusht të kthyerish u pagëzuan. Ata ishin anëtarët e parë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme të pagëzuar në gjithë Amerikën Jugore. Kjo ishte 85 vite përpara, brenda

Montevideo në Uruguai



periudhës së jetës së shumë personave që po dëgjojnë konferencën sot.

Ka 23 kunje të Sionit atje, me duzina kunjesh dhe dhjetra mijë anëtarë të Kishës në qytete të mëdha dhe të vogla nëpër gjithë Argjentinën. Tani atje janë mbi 600 kunjë dhe disa milionë anëtarë të Kishës nëpër të gjithë Amerikën e Jugut. Ndërsa ne vrojtojmë, mbretëria e Perëndisë po mbush kontinentin dhe emri i Jozef Smithit po botohet edhe nga ne edhe nga mosbesuesit e tij në vendet për të cilat ai mund edhe të mos kishte dëgjuar kurrë gjatë jetës së tij.

Ka afro 3.000 kunjë të Kishës në mbarë botën sot, nga Bostoni në Bangkok dhe nga Meksiko-Siti në Moskë. Ne po i afrohem 29.000 lagjeve dhe degëve. Në shumë vende ka kunjë të rritura me anëtarë, paraardhësit e të cilëve ishin të kthyer. Në të tjera, grupe të vegjël me pak anëtarë mblidhen si degë të vogla të Kishës në shtëpi me qira. Çdo vit Kisha përhapet gjithnjë e më tej nëpër rruzull.

Këto profeci rreth mbushjes së botës dhe të njohjes kudo në botë: Qesharake? Ndoshta. Pa gjasa? Sigurisht. Të pamundura? Sigurisht që jo. Kjo po ndodh përpara syve tanë.

Presidenti Gordon B. Hinkli vërejt: "Thuhej se dikur dielli nuk përndonte kurrë në Perandorinë Britanike. Ajo perandori tani është zvogëluar. Por është e vërtetë se dielli nuk përndon kurrë mbi këtë punë të Zotit ndërsa ajo po prek jetën e njerëzve kudo në tokë.

Ky është vetëm fillimi. Ne sapo kemi gërvishur sipërfaqen. . . . Puna jonë nuk njihet kufij. . . . Ato kombe dikur të mbyllura për ne, një ditë do të hapen."⁵

Sot ne mund të shohim se plotësimi i një profecie të Librit të Mormonit po afron:

"Dhe . . . do të ndodhë që mbretërit do të mbyllin gojën; pasi ata do të



Salvador në Brazil

shohin atë që nuk iu tregua; dhe do të kuptojnë atë që nuk kishin dëgjuar.

Pasi në atë ditë, për hirin tim, Ati do të përmbushë një vepër, që do të jetë një vepër madhështore dhe e mrekullueshme mes tyre."⁶

Kjo punë e Zotit është vërtet e madhe dhe e mrekullueshme, por ajo përparon thelbësisht pa rënë në sy për shumë udhëheqës politikë, kulturorë dhe akademikë të njerëzimit. Ajo përparon me radhë një nga një në çdo zemër dhe çdo familje, qetësisht, thjeshtësisht, me mesazhin dhe qëllimin e saj të shenjtë që bekon njerëzit kudo.

Një varg në Librin e Mormonit jep çelësin mbi rritjen e mrekullueshme të Kishës sot. "Dhe për më tepër, unë ju them juve se koha do të vijë kur njohuria e një Shpëtimtari do të përhapet mes çdo kombi, fisi, gjuhe dhe populli."⁷

Mesazhi ynë më i rëndësishëm, ai të cilin ne jemi hyjnisht edhe të porositur edhe të urdhëruar që ta çojmë kudo në botë, është se ka një Shpëtimtar. Ai jetoj në meridianin e kohës. Ai shleu mëkatet tona, u kryqëzua dhe u ringjall. Ai mesazh i pashoq, që ne shpallim me autoritet nga Perëndia, është arsyeja e vërtetë që kjo Kishë po rritet kështu.

Unë dëshmoj se Ai iu shfaq me Atin e Tij Jozef Smithit. Nën drejtimin e Atit, Ai vendosi ungjillin e Tij përsëri

në tokë. Ai dërgoi apostuj, profetë dhe çelësat e priftërisë përsëri në tokë. Ai drejton Kishën e Tij nëpërmjet një profeti të gjallë, Presidentit Tomas S. Monson. Kisha e Tij është ai gur i prerë nga mali pa duar që rrokulliset përpara nëpër rruzull.

Ne jemi mirënjohës për Jozef Smithin dhe vështrojmë me habi ndërsa emri i tij është i njohur, i nderuar dhe, po, madje i fyer gjithnjë dhe më gjerësisht kudo në botë. Por ne e pranojmë se kjo punë e fuqishme e ditëve të mëvonshme nuk është rreth tij. Ajo është puna e Perëndisë së plotfuqishëm dhe e Birit të Tij, Princit të Paqes. Unë dëshmoj se Jezusi është Shpëtimtari, dhe me ju, qëndroj me drojë e nderim ndërsa kjo punë përparon mahnitshëm, mrekullisht dhe e pandalshme. Vërtet, "koha [ka] ardhur kur njohuria për një Shpëtimtar . . . përhapet kudo nëpër çdo komb, dhe fis, dhe gjuhë dhe popull". Unë dëshmoj për Të, Shpëtimtarin e të gjithë njerëzimit dhe për këtë punë, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Danieli 2:28, 35, 44; shih edhe vargjet 1–45.
2. Joseph Smith—Historia 1:33.
3. Doktrina e Besëlidhje 65:2.
4. *Teachings of Presidents of the Church: Wilford Woodruff* (2004), f. 25–26.
5. Gordon B. Hinkli, "Gjendja e Kishës", *Liahona*, nëntor 2003, f. 7.
6. 3 Nefi 21:8–9.
7. Mosia 3:20.



Nga Plaku Hoze L. Alonso,
i Të Shtatëdhjetëve

Bërja e Gjësë së Duhur në Kohën e Duhur, pa Vonesë

Shpëtimtari . . . na dha një shembull të shkëlqyer për të mos pritur për t'u dhënë ndihmë atyre që kanë humbur ndjesinë e lumturisë e të gëzimit.

Në kohën tonë, shumë njerëz po jetojnë mes trishtimit dhe hutimit të madh. Ata nuk po gjejnë përgjigje për pyetjet e tyre dhe nuk janë në gjendje të plotësojnë nevojat e tyre. Disa e kanë humbur ndjesinë e lumturisë dhe të gëzimit. Profetët kanë shpallur se lumturia e vërtetë gjendet në ndjekjen e shembullit dhe të mësimëve të Krishtit. Ai është Shpëtimtari ynë, Ai është Mësuesi ynë dhe Ai është Shembulli i përsosur.

Jeta e Tij qe një jetë shërbimi. Kur i shërbejmë fqinjit tonë, ne ndihmojmë ata që janë në nevojë. Gjatë këtij procesi ne mund të gjejmë zgjidhje për vetë vështirësitë tona. Kur ndjekim shembullin e Shpëtimtarit, ne u tregojmë dashurinë tonë Atit tonë Qiellor dhe Birit të Tij, Jezu Krishtit, dhe bëhemi më shumë si Ata.

Mbreti Benjamin foli për vlerën e shërbimit, duke thënë se kur jemi “në shërbimin e bashkëqenieve [tona], [ne] je[m]i vetëm në shërbimin e Perëndisë [tonë]”¹. Gjithësecili ka mundësi për

të dhënë shërbim dhe për të shfaqur dashuri.

Presidenti Tomas S. Monson na ka kërkuar të shkojmë “në shpëtim” dhe t’u shërbejmë të tjerëve. Ai tha: “Ne do të zbulojmë se ata të cilëve u shërbejmë, që kanë ndier përmes punës sonë prekjen e dorës së Mësuesit, në një farë mënyre nuk mund ta shpjegojnë ndryshimin që vjen në jetën e tyre. Ka një dëshirë për të shërbyer besnikërisht, për të ecur përulësisht dhe për të jetuar më shumë si Shpëtimtari. Pasi kanë marrë kuptueshmërinë e tyre shpirtërore dhe kanë marrë një ide të premtimeve të përjetësisë, ata u bëjnë jehonë fjalëve të të verbrit të cilit Jezusi i ktheu shikimin dhe që tha: ‘Di një gjë, që isha i verbër dhe tani shoh’”²

Çdo ditë ne kemi mundësinë që të japim ndihmë e shërbim – të bëjmë gjënë e duhur, në kohën e duhur, pa vonesë. Mendoni për shumë njerëz që kanë një kohë të vështirë për të siguruar një punë, ose janë të sëmurë,

që ndihen të vetmuar, që madje mendojnë se kanë humbur gjithçka. Çfarë mund të bëni për të ndihmuar? Përfytyroni se një fqinj, i mbetur në shi me makinë të prishur, ju telefonon që ta ndihmoni. Cila është gjëja e duhur për të bërë për të? Kur është koha e duhur për ta bërë atë?

Më kujtohet një rast kur shkuam si familje në qendër të qytetit të Meksikos për të blerë veshje për dy fëmijët tanë. Ata ishin të vegjël. Djali ynë më i madh ishte vetëm dy vjeç dhe djali më i vogël ishte një vjeç. Rruga ishte e mbushur me njerëz. Ndërsa po bënim blerje, duke i drejtuar fëmijët për dore, ndalua për një çast për të parë diçka dhe, pa e kuptuar, e humbëm birin tonë më të madh! Nuk e dinim se si, por ai nuk ishte me ne. Pa vonuar asnjë çast, u nisëm vrap për ta kërkuar atë. Ne kërkuam dhe e thirrëm, duke ndier ankth të madh, duke menduar se mund ta humbisnim atë përgjithmonë. Në mendjet tona, po i përgjërroheshim Atit Qiellor që të na ndihmonte ta gjenim atë.

Pas pak ne e gjetëm atë. Ja ku ishte, duke parë pafajsisht lodrat në një vitrinë dyqani. Ne e përqafluam dhe e puthëm atë dhe u zotua që të vëzhgonim me zell mbi fëmijët tanë që kurrë më të mos e humbisnim ndonjërin prej tyre. Mësuam se, me qëllim që të shkonim në shpëtim të birit tonë, nuk kishte nevojë të planifikonim mbledhje. Ne thjesht vepruam, duke shkuar në kërkim të atij që kishte humbur. Mësuam gjithashtu se biri ynë nuk e kuptoi kurrë që kishte humbur.

Vëllezër e motra, mund të ketë shumë vetë që, për disa arsye, kanë humbur nga fushëpamja jonë dhe që nuk e dinë se kanë humbur. Nëse vonojmë, ne mund t’i humbasim ata përgjithmonë.

Për shumë vetë që kanë nevojë për ndihmën tonë, nuk është e



domosdoshme të krijojmë programe të reja ose të ndërmarrim veprime që janë të ndërlikuara e të shtrenjta. Atyre u duhet vetëm vendosmëria jonë për të shërbyer – për të bërë gjënë e duhur, në kohën e duhur, pa vonesë.

Kur Shpëtimtari iu shfaq njerëzve të Librit të Mormonit, Ai na dha një shembull të shkëlqyer për të mos pritur për t'u dhënë ndihmë atyre që kanë humbur ndjesinë e lumturisë e të gëzimit. Pasi u kishte dhënë mësim njerëzve, Ai pa se ata nuk qenë në gjendje të kuptonin të gjitha fjalët e Tij. Ai i ftoi ata që të shkonin në shtëpitë e tyre dhe të meditnin gjërat që Ai u kishte thënë atyre. Ai u tha atyre që t'i luteshin Atit dhe të përgatiteshin për të ardhur sërish të nesërmen, kur Ai do të kthehej që t'i mësonte ata.³

Kur përfundoi, Ai pa mbi turmën dhe i pa duke qarë, sepse ata donin shumë që Ai të qëndronte me ta.

“Dhe ai u tha atyre: Vini re, zemra ime është e mbushur me dhembshuri për ju.

A ka mes jush ndonjë që është i sëmurë? Silleni këtu. A ka ndonjë që është i çalë ose i verbër, ose i gjymtë, ose sakat, ose i lebsur, ose i deformuar, ose i shurdhër, ose i prekur në

ndonjë mënyrë? I sillni këtu dhe unë do t'i shëroj ata, pasi kam dhembshuri për ju; zemra ime është e mbushur me mëshirë.”⁴

Dhe ata i sollën të sëmurët e tyre tek Ai dhe Ai i shëroi ata. Turma u përul tek këmbët e Tij dhe e adhuroi, dhe i puthi këmbët Atij, “kaq sa ia lanë këmbët e tij me lotët e tyre”. Pastaj Ai i urdhëroi që të sillnin fëmijët e tyre të vegjël dhe i bekoj ata një e nga një.⁵ Ky është modeli që na ka dhënë Shpëtimtari. Dashuria e Tij është për të gjithë, por Ai nuk e harron kurrë asnjërin.

Unë e di se Ati ynë Qiellor është i dashur, mirëkuptues dhe i duruar. Biri i Tij, Jezu Krishti, po ashtu na do. Ata na japin ndihmë nëpërmjet profetëve të Tyre. Kam mësuar se ka siguri të madhe kur ndiqen profetët. “Shpëtimi” ende vazhdon. Presidenti Monson tha: “Zoti pret që ne të mendojmë. Ai pret që ne të veprojmë. Ai pret që ne të punojmë. Ai pret dëshmitë tona. Ai pret përkushtimin tonë.”⁶

Ne kemi një përgjegjësi dhe një mundësi të madhe. Ka shumë njerëz që kanë nevojë të provojnë sërish aromën e ëmbël të lumturisë dhe të gëzimit nëpërmjet aktivitetit në Kishë.

Ajo lumturi vjen nga marrja e ordinancave, nga bërja e besëlidhjeve të shenjta dhe nga mbajtja e tyre. Zoti ka nevojë që ne t'i ndihmojmë ata. Le të bëjmë gjënë e duhur në kohën e duhur, pa vonesë.

Unë dëshmoj se Perëndia jeton dhe është Ati ynë. Jezu Krishti jeton dhe ka dhënë jetën e Tij që ne të mund të kthehemi në praninë e Atit tonë Qiellor. Unë e di që Ai është Shpëtimtari ynë. Unë e di se shpirtmirësia e Tyre e pafundme del në dritë vazhdimisht. Unë jap dëshmi se Presidenti Tomas S. Monson është profeti i Tyre dhe se kjo është e vetmja Kishë e vërtetë mbi faqen e dheut. Unë e di se Profeti Jozef Smith ishte profeti i Rivendosjes. Unë dëshmoj se Libri i Mormonit është fjala e Perëndisë. Ai na jep udhëheqje dhe modele që t'i ndjekim me qëllim që të bëhemi më shumë si Perëndia dhe Biri i Tij i Dashur. Unë deklaroj kështu, në emrin e Zotit Jezu Krisht, amen. ■

SHËNIME

1. Mosia 2:17.
2. Thomas S. Monson, “To the Rescue”, *Liahona*, korrik 2001, f. 57, 58.
3. Shih 3 Nefi 17:1–3.
4. 3 Nefi 17:6–7; shih edhe vargun 5.
5. Shih 3 Nefi 17:9–12, 21.
6. Thomas S. Monson, *Liahona*, korrik 2001, f. 58.



Nga Presidenti Bojd K. Paker,
President i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Këshillë për Rininë

Megjithë kundërshtimin, vështirësitë dhe tundimet, ju nuk mund të dështoni apo të trembeni.

Po i flas rinisë më personalisht seç e bëj zakonisht, unë do të krahasoj rininë time me tuajën.

Ju jeni tej mase të çmuar. Unë ju kam parë në duzina vendesh dhe në çdo kontinent. Ju jeni shumë më të mirë sesa ne kur ishim të rinj. Ju dini më shumë rreth ungjillit. Ju jeni më të pjekur dhe më besnikë.

Unë tani jam 87 vjeç. Ju mund të pyesni veten se çfarë mund të kontribuoj unë në jetën tuaj në moshën time. Unë kam qenë ku ju jeni dhe e di se ku po shkoni. Por ju nuk keni qenë ende atje ku jam unë. Unë po ju citoj pak rreshta poezie klasike:

*Sorra e vjetër po bëhet e ngadalshme.
E reja jo.*

*E reja sorrë nuk di nga ato
Që e vjetra di plot.*

*Në dije gjërash, sorra e vjetër
Ende mësuese për të renë është.*

*Çfarë nuk di sorra e vjetër, e ngadaltë?
– Si të ecë më shpejt.*

*E reja fluturon sipër, poshtë,
Dhe rreth së ngadaltës sorrë të vjetër
rrathë përshkon.*

Çfarë nuk di sorra e re, e shpejtë?¹

Jo e cilësisë së Uordsuorthis, por megjithatë poezi që nuk harrohet!

Me gjithë këto që po ndodhin në botë, me uljen e standardeve morale, ju të rinjtë po rriteni në territorin e armikut.

Ne e dimë nga shkrimet e shenjta se ka pasur një luftë në qiell, se Luciferi u rebelua dhe, me ndjekësit e tij, “u hodh mbi tokë”². Ai është i vendosur të prishë planin e Atit tonë Qiellor dhe kërkon të kontrollojë mendjet dhe veprimet e të gjithëve. Ky ndikim është shpirtëror dhe ai “është përhapur në tokë”³.

Megjithë kundërshtimin, vështirësitë dhe tundimet, ju nuk mund të dështoni apo të trembeni.

Kur unë isha 17 vjeç, afër diplomimit në shkollën e mesme si nxënës shumë mesatar me disa dobësi, siç e mendoja unë, gjithçka rreth nesh u copëtua në mëngjesin e një të diele. Ditën tjetër ne u thirrëm në auditorin e shkollës së mesme. Në skenë ishte një karrige me një radio të vogël. Drejtori i shkollës e ndezi radion. Ne dëgjua atëherë zërin e Presidentit Franklin Delano Rusvelt ndërsa njoftoi se Perl Harbër ishte bombarduar. Shtetet e Bashkuara ishin në luftë me Japoninë.

Më vonë ajo skenë u përsërit. Përsëri zëri i Presidentit Rusvelt, këtë herë duke njoftuar se vendi ynë ishte në luftë me Gjermaninë. Lufta II Botërore pati shpërthyer në gjithë botën.

Brenda një çasti e ardhmja jonë u bë e pasigurt. Ne nuk dinim çfarë do të ndodhte. A do të jetonim sa të marroheshim dhe të kishim familje?

Sot ka “luftëra e ushtrime luftërash dhe i gjithë dheu [është] në rrëmuje”⁴. Ju, rinia jonë, mund të ndjeni pasiguri dhe ankth në jetën tuaj. Unë dua t’ju këshilloj dhe t’ju mësoj e t’ju jap një paralajmërim rreth disa gjërave që duhet t’i bëni dhe disa gjërave që nuk duhet t’i bëni.

Plani i ungjillit është “[plani i] madh [i] lumturisë”⁵. Familja është qendra e atij plani. Familja varet nga përdorimi i denjë i atyre fuqive jetëdhënëse që janë në trupin tuaj.

Te “Familja: Një Proklamata Drejtuar Botës”, një dokument i frymëzuar i shpallur nga Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve, ne mësojmë se në ekzistencën para lindjes “të gjitha qeniet njerëzore – meshkuj dhe femra – [qenë] krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë. Secili është një bir ose bijë shpirtërore e dashur e prindërve qiellorë dhe, si i tillë, secili ka një natyrë dhe destinacion hyjnor. Gjinia është një karakteristike thelbësore [dhe që krijuar në atë ekzistencë para lindjes]. . . .

. . . Ne më tej deklarojmë se Perëndia ka urdhëruar që fuqitë e shenjta të krijimit të jetës duhet të përdoren vetëm midis burrit dhe gruas, ligjërisht të martuar si bashkëshort e bashkëshorte.”⁶

Dënimi i madh që Luciferi dhe ndjekësit e tij i sollën vetes, ishte se ata nuk mund të kishin një trup të vdeksëm.

Shumë nga tundimet që përballni, sigurisht ato më seriozet, lidhen me trupin tuaj. Ju jo vetëm që keni fuqi të krijoni trupa për një brez të ri, por keni gjithashtu lirinë e zgjedhjes.

Profeti Jozef Smith na mësoi: “Të gjitha qeniet njerëzore që kanë trupa



kanë fuqi mbi ata që nuk kanë”⁷. Kështu çdo shpirt që jeton dhe që ka një trup fizik, në fund të fundit ka fuqi mbi kundërshtarin. Ju vuani tundime për shkak të natyrës suaj fizike, por ju gjithashtu keni fuqi mbi atë dhe engjëjt e tij.

Në kohën që ne u diplomuam nga shkolla e mesme, shumë nga shokët tanë të klasës patën shkuar në luftë, disa për të mos u kthyer kurrë. Pjesa tjetër nga ne shpejt do të futeshin në ushtri. Ne nuk dinim rreth së ardhmes tonë. A do t’i mbijetonim luftës? A do të mbetej mjaft nga bota që lamë kur ne të ktheheshim?

Ngaqë isha i sigurt se do të thirresha në ushtri, unë iu bashkova forcave ajrore. Shpejt unë isha në Santa-Ana të Kalifornisë, për trajnim parafuturues.

Unë nuk kisha atëherë dëshminë e fortë që ungjilli ishte i vërtetë, por unë e dija se mësuesit e mi të seminarit, Abel S. Riç dhe Xhon P. Liliuajt, e dinin se ai ishte i vërtetë. Unë i pata dëgjuar ata të dëshmonin dhe unë u besoja atyre. Unë mendoja me vete: “Unë do të mbështetem në dëshmitë e tyre derisa të fitoj një timen”. Dhe ashtu bëra.

Unë kisha dëgjuar rreth bekimeve patriarkale por nuk pata marrë një të tillë. Në çdo kunj ka një patriark të shuguruar që ka shpirtin e profecisë dhe shpirtin e zbulesës. Ai është i autorizuar të japë bekime personale dhe private për ata që vijnë të rekomanduar nga peshkopët e tyre. Unë i shkrova peshkopit tim për një rekomandim.

J. Roland Sendstrom ishte një patriark i shuguruar që jetonte në kunjin e Santa-Anës. Ai nuk dinte asgjë rreth meje dhe nuk më kishte parë kurrë më parë, por ai më dha bekimin tim. Në të unë gjeta përgjigje dhe udhëzime.

Megjithëse bekimet patriarkale janë shumë private, unë do të ndaj një citat të shkurtër nga imi: “Ju do të drejtoheni me anë të pëshpërimave të Frymës së Shenjtë dhe ju do të paralajmëroheni për rreziqet. Nëse ju u vini veshin atyre paralajmërimeve, Ati ynë Qiellor do t’ju bekojë në mënyrë që ju të mund të bashkoheni përsëri me të dashurit tuaj.”⁸

Ajo fjalë *nëse*, edhe pse e vogël në shtyp, përvijojë aq e madhe sa faqja.

Unë do të bekohesha për t’u kthyer nga lufta *nëse* unë i mbaja urdhërimet dhe *nëse* unë u mbaja vesh nxitjeve të Frymës së Shenjtë. Edhe pse ajo dhuratë më qe dhënë në pagëzim, unë nuk e dija ende se çfarë ishte Fryma e Shenjtë apo si funksionojnë nxitjet.

Atë që kisha nevojë të dija rreth nxitjeve unë e gjeta në Librin e Mormonit. Unë lexova se “engjëjt flasin nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë; prandaj, ata flasin fjalët e Krishtit. Prandaj, . . . ushqehuni me bollëk me fjalët e Krishtit; pasi, vini re, fjalët e Krishtit do t’ju tregojnë të gjitha gjërat që ju duhet të bëni.”⁹

Ndoshta gjëja e vetme më e madhe që unë mësova nga leximi i Librit të Mormonit, është se zëri i Shpirtit vjen si një *ndjesi* më shumë sesa një zë. Ju do të mësoni, siç unë kam mësuar, të “dëgjoni” për atë zë që *ndihet* më shumë sesa *dëgjohet*.

Nefi i qortoi vëllezërit e tij më të mëdhenj duke u thënë: “Ju keni parë një engjell dhe ai ju foli; po, ju keni dëgjuar zërin e tij herë pas here; dhe ai ju ka folur me një zë të qetë, të ulët, por ju kishit humbur *ndjesinë*, që ju nuk mund të *ndjenit* fjalët e tij”¹⁰.

Disa kritikë kanë thënë se këto vargje janë gabim pasi ju *i dëgjoni* fjalët, ju nuk *i ndieni* ato. Por nëse ju dini ndonjë gjë rreth komunikimit shpirtëror, ju e dini se fjala më e mirë për të përshkruar atë që ndodh është fjala *ndjesi*.

Dhurata e Frymës së Shenjtë, nëse e miratoni, do t’ju drejtojë e mbrojtë dhe madje do të korrigjojë veprimet tuaja. Ai është një zë shpirtëror që vjen në mendje si një mendim apo ndjenjë e vendosur në zemrën tuaj. Profeti Enos tha: “Zëri i Zotit erdhi në mendjen time”¹¹. Dhe Zoti i tha Oliver Kaudrit: “Vër re, unë do të të them në mendjen tënde dhe në zemrën tënde, me anë të Frymës së



Shenjtë, që do të vijë mbi ty”¹².

Nuk pritet që ju të shkoni nëpër jetë pa bërë gabime, por ju nuk do të bëni gabime të mëdha pa qenë të paralajmëruar më parë nga nxitjet e Frymës së Shenjtë. Ky premtim vlen për të gjithë anëtarët e Kishës.

Disa do të bëjnë gabime vërtet të rënda, duke shkelur ligjet e ungjillit. Këtu është rasti që t’ju kujtoj për Shlyerjen, pendimin dhe faljen e plotë në mënyrë që ju të mund të bëheni të pastër përsëri. Zoti tha: “Vini re, ai që është penduar për mëkatet e tij, po ai falet dhe unë, Zoti, nuk i kujtoj më ato”¹³.

Nëse kundërshtari do të ndodhë t’ju marrë të burgosur prej mëkatit tuaj, unë ju kujtoj juve se ju mbani çelësin që do të hapë derën e burgut nga brenda. Ju mund të bëheni të pastër nëpërmjet sakrificës shlyese të Shpëtimtarit Jezu Krisht.

Ju mund të mendoni në kohë andrallash se nuk jeni i denjë të shpëtoheni për shkak se keni bërë gabime, të mëdha apo të vogla, dhe ju mendoni se tani jeni i humbur. Kjo nuk është *kurrë* e vërtetë! Vetëm pendimi mund ta shërojë atë që lëndon. Por pendimi *mund* ta shërojë atë që lëndon, pavarësisht se çfarë është.

Nëse ju po përfshiheni në gjëra që nuk duhet, ose nëse ju po shoqëroheni me njerëz që po ju tërheqin në drejtim të gabuar, ajo është koha që të ushtroni pavarësinë tuaj, lirinë

tuaj të zgjedhjes. Mbani vesh zërin e Shpirtit dhe ju nuk do të udhëhiqeni shtrembër.

Unë them përsëri se rinia sot po rritet në territor armik me një standard në rënie të moralitetit. Por si shërbëtor i Zotit, unë ju premtoj se ju do të jeni të mbrojtur dhe të ruajtur nga sulmet e kundërshtarit *nëse* ju do t’u vini veshin nxitjeve që vijnë nga Fryma e Shenjtë.

Vishuni me thjeshtësi; flisni me nderim; dëgjoni muzikë që ju ngre shpirtërisht. Shmangni të gjitha imoralitetet dhe praktikatat që ju degradojnë personalisht. Kontrolloni jetën tuaj dhe komandojeni veten për të qenë besnikë. Për shkak se ne mbështetemi aq shumë të ju, ju do të jeni

Lajçester në Angli



jashtëzakonisht të bekuar. Ati juaj i dashur Qiellor ju mbikëqyr vazhdimisht.

Fuqia e dëshmisë time ka ndryshuar qysh kur unë ndieva nevojën për t’u mbështetur në dëshmitë e mësuesve të mi të seminarit. Sot unë mbështetem te të tjerë kur eci për shkak të moshës dhe të poliomielitit të fëmijërisë, por jo prej dyshimeve lidhur me gjëra shpirtërore. Unë kam arritur të besoj, të kuptoj dhe të di të vërtetat e çmuara të ungjillit dhe të Shpëtimtarit Jezu Krisht.

Si një nga dëshmitarët e Tij të veçantë, unë dëshmoj se përfundimi i kësaj beteje që filloi në jetën para lindjes, nuk vihet në dyshim. Luçiferi do të humbasë.

Ne folëm më sipër për sorra. Ju sorra të reja nuk keni nevojë të fluturoni pa qëllim andej këndeje, të pasigurt për shtegun përpara. Ka njerëz që e dinë udhën. “Sepse Zoti, Zoti, nuk bën asgjë, pa ua treguar sekretin e tij shërbëtorëve të tij, profetëve.”¹⁴ Zoti e organizoi Kishën e Tij mbi parimin e çelësave dhe të këshillave.

Në krye të Kishës janë 15 burra të mbështetur si profetë, shikues dhe zbulues. Secili anëtar i Presidencës së Parë dhe të Kuorimit të Dymbëdhjetë Apostujve mban të gjithë çelësat e priftërisë të nevojshme për drejtimin e Kishës. Apostulli më i vjetër është profeti – Presidenti Tomas S. Monson, që është i vetmi i autorizuar t’i ushtrojë të gjithë ata çelësa.

Shkrimet e shenjta kërkojnë që Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve të punojnë në këshilla dhe që vendimet e atyre këshillave të jenë unanime. Dhe kështu ndodh. Ne i besojmë Zotit të na drejtojë udhën dhe ne kërkojmë vetëm të bëjmë vullnetin e Tij. Ne e dimë se Ai ka vendosur një besim shumë të madh te ne, personalisht dhe kolektivisht.

Ju duhet të mësoni të “[kini] besim

tek Zoti me gjithë zemër dhe [të] mos . . . mbështet[eni] në gjykimin [tuaj]"¹⁵. Ju duhet të jeni të besuar dhe ta rrethoni veten me miq që dëshirojnë të jenë po ashtu.

Ndonjëherë ju mund të tundoheni të mendoni siç bëja unë herë pas here në rininë time: "Kështu si po shkojnë gjërat, bota po shkon drejt fundit. Fundi i botës do të vijë përpara se unë të arrij atje ku duhet të arrij." Kjo nuk është e drejtë! Ju mezi mund të prisni që të bëni gjërat e duhura – të martoheni, të keni familje, të shihni fëmijët dhe nipërit e mbesat tuaja, mundet madje edhe stërnipërit e stërmbesat tuaja.

Nëse ju do të ndiqni këto parime, ju do të vëzhgoheni dhe mbroheni dhe ju vetë do të dini nëpërmjet nxitjeve të Frymës së Shenjtë se në cilën udhë të shkoni, sepse "nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë, ju mund të dini të vërtetën e të gjitha gjërave"¹⁶. Unë ju premtoj se kjo do të përmbushet dhe lutem për një bekim për ju, rinia jonë e çmueshme, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. John Ciardi, "Fast and Slow", *Fast and Slow: Poems for Advanced Children and Beginning Parents* (1975), f. 1. © 1975 nga John L. Ciardi. Përdorur me leje të Shoqërisë Botuese Houghton Mifflin Harcourt. Të gjitha të drejtat rezervohen.
2. Zbulesa 12:9; shih gjithashtu Doktrina e Besëlidhje 76:25–26.
3. Doktrina e Besëlidhje 52:14.
4. Doktrina e Besëlidhje 45:26.
5. Alma 42:8.
6. "Familja: Një Proklamataë Drejtuar Botës", *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.
7. *Teachings of Presidents of the Church: Joseph Smith* (2007), f. 211.
8. Bekimi Patriarkal i Bojd K. Paker, dhënë nga J. Roland Sendstrom, janar 1944.
9. 2 Nefi 32:3.
10. 1 Nefi 17:45; kursivet janë shtuar.
11. Enosi 1:10.
12. Doktrina e Besëlidhje 8:2.
13. Doktrina e Besëlidhje 58:42.
14. Amosi 3:7.
15. Fjalët e urta 3:5.
16. Moroni 10:5.



Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Ju Keni Rëndësi për Të

Zoti përdor një peshore shumë të ndryshme nga e botës për të matur vlerën e një shpirti.

Moisiu, një nga profetët më të mëdhenj që ka njohur bota ndonjëherë, u rrit nga bija e Faraonit dhe i kaloi 40 vitet e para të jetës së tij në sallat mbretërore të Egjiptit. Ai e njohu drejtpërdrejt lavdinë dhe madhështinë e asaj mbretërie të lashtë.

Vite më vonë, në majë të një mali të largët, shumë larg nga shkëlqimi dhe madhështia e Egjiptit të fuqishëm, Moisiu qëndroi në prani të Perëndisë dhe i foli Atij ballë për ballë ashtu si një burrë flet me mikun e tij.¹ Gjatë asaj vizite, Perëndia i tregoi Moisiut mjeshtërinë e duarve të Tij, duke i dhënë një vështrim të shkurtër të veprës dhe lavdisë së Tij. Kur mbaroi veprimi, Moisiu ra në tokë për hapësirën e shumë orëve. Kur së fundi forca e tij u kthye, ai kuptoi diçka që, gjatë gjithë viteve të tij në oborrin e Faraonit, nuk e kishte menduar kurrë më parë.

"Unë e di", tha ai "se njeriu është një hiç."²

Ne Jemi më Pak nga sa Supozojmë

Sa më shumë mësojmë mbi universin, aq më shumë kuptojmë – të paktën në një pjesë të vogël – atë që dinte Moisiu. Universi është kaq i madh, i mistershëm dhe i lavdishëm sa që është e pakapshme për mendjen njerëzore. "Botë pa numër kam

krijuar", i tha Perëndia Moisiut.³ Çuditë e qiellit natën janë një dëshmi e bukur e asaj të vërtete.

Ka pak gjëra që më kanë mbushur me një nderim të tillë që të lë pa frymë, sa fluturimi në errësirën e natës përmes oqeanëve e kontinenteve dhe vështrimi nga dritarja e kabinës mbi lavdinë e pafundme të miliona yjeve.

Astronomët janë përpjekur të numërojnë numrin e yjeve në univers. Një grup shkencëtarësh vlerëson se numri i yjeve që shihen nga teleskopët tanë, është 10 herë më i madh se gjithë grimcat e rërës në plazhet dhe shkretëtirat e botës.⁴

Ky përfundim ka një ngjashmëri mbresëlënëse me deklarinimin e profetit të lashtë, Enokut: "Dhe po të ishte e mundur që njeriu të mund të numëronte pjesëzat e tokës, po, miliona tokë si kjo, nuk do të kishte fillim në morinë e krijimeve të tua"⁵.

Duke pasur parasysh pafundësinë e krijimeve të Perëndisë, nuk është çudi që Mbreti i madh Benjamin e këshilloi popullin e tij që "gjithmonë të mban[in] në kujtesë, madhështinë e Perëndisë dhe asgjësinë [e tyre]"⁶.

Ne Jemi më Shumë nga sa Supozojmë

Por edhe pse njeriu është një hiç, më mbush me habi e nderim mendimi se "vlera e shpirtave është

e madhe në sytë e Perëndisë”⁷.

Dhe ndërsa ne mund të shohim hapësirën e pafund të universit dhe të themi: “Çfarë është njeriu në krahasim me lavdinë e krijimit?” Perëndia Vetë tha se ne jemi arsyeja pse Ai krijoi universin! Vepra dhe lavdia e Tij – qëllimi për këtë univers madhështor – është të shpëtojë dhe ekzaltojë njerëzimin.⁸ Me fjalë të tjera, hapësira e pafund e përjetësisë, lavditë dhe të fshehtat e hapësirës dhe kohës së pafund, të gjitha janë ndërtuar për dobinë e të vdekshmëve të zakonshëm si ju dhe unë. Ati ynë Qiellor e krijoi universin që ne të mund të arrijmë potencialin tonë si bij e bija të Tij.

Ky është një paradoks i njeriut: krahasuar me Perëndinë, njeriu është hiç; por ende është gjithçka për Perëndinë. Ndonëse po të krahasohemi me krijimin e pafundëm ne mund të dukemi se jemi një hiç, ne kemi një shkëndijë të zjarrit të përjetshëm që digjet në kraharorin tonë. Ne kemi premtimin e paimagjinueshëm të ekzaltimit – botë pa fund – brenda rrokjes sonë. Dhe është dëshira e madhe e Perëndisë që të na ndihmojë ta arrijmë atë.

Marrëzia e Krenarisë

Mashtruesi i madh e di se një nga mjetet e tij më efikase për t’i çuar në rrugë të gabuar fëmijët e Perëndisë është që të joshë skajet e paradoksit të njeriut. Për disa, ai i josh me prirjet e tyre krenare, duke i fryrë e duke i nxitur të besojnë në fantazinë e sigurisë në vetvete dhe të pathyeshmërisë së tyre. Ai u thotë atyre se e kanë kapërcyer të zakonshmen dhe se për shkak të aftësisë, të drejtës prej lindjes, ose gjendjes shoqërore ata janë më të mirë se cilësitë e zakonshme të gjithçkaje që i rrethon. Ai i çon ata që të arrijnë në përfundimin se, si pasojë, ata nuk i nënshtrohen rregullave të askujt tjetër dhe nuk duhet të shqetësohen nga

problemet e askujt tjetër.

Thuhet se Abraham Linkoln i pëlqente një vjershë që thotë:

*Oh, përse krenar shpirti i të vdekshmit të jetë?
Si një meteor fluturues, një re që kalon shpejt,
Një shkrepje vetëtime, si përplasjet një dallgë,
Shkon njeriu nga jeta tek çlodhja e tij në varr.⁹*

Dishepujt e Jezu Krishtit e kuptojnë se, krahasuar me përjetësinë, ekzistenca jonë në këtë sferë të vdekshme është veçse “një çast i shkurtër” në hapësirë dhe në kohë.¹⁰ Ata e dinë se vlera e vërtetë e një njeriu ka të bëjë pak me atë që bota e çmon me vlerësim të madh. Ata e dinë se mund të grumbullosh të hollat e mbledhura të të gjithë botës dhe me to nuk mund të blesh as edhe një çyrek bukë në ekonominë e qiellit.

Ata që do të “trashëgoj[në] mbretërinë e Perëndisë”¹¹ janë ata që bëhen “si një fëmijë, [të] nënshtuar, [të] bindur, [të] përulur, [të] duruar, plot me dashuri”¹². “Sepse kushdo që lartohet do të ulet, dhe kush ulet, do të lartohet.”¹³ Dishepujt të tillë e kuptojnë gjithashtu “se kur ju jeni në shërbimin e bashkëqenieve tuaja, ju jeni vetëm në shërbimin e Perëndisë tuaj”¹⁴.

Ne Nuk na Kanë Harruar

Një mënyrë tjetër se si mashtron Satani është nëpërmjet shkurajimit. Ai përpiqet ta përqendrojë vështrimin tonë tek mungesa jonë e rëndësisë derisa fillojmë të dyshojmë nëse kemi vlerë të madhe. Ai na thotë se jemi tepër të vegjël sa të na vërë re ndokush, se ne na kanë harruar – veçanërisht Perëndia.

Më lejoni të ndaj me ju një përvojë personale që mund të japë ndonjë

ndihmë për ata që ndihen të pavlerë, të harruar, ose të vetmuar.

Shumë vite më parë mora pjesë në trajnim për pilot në Forcat Ajrore të Shteteve të Bashkuara. Isha shumë larg nga shtëpia, një ushtar i ri nga Gjermania Perëndimore, lindur në Çekosllovakia, që ishte rritur në Gjermaninë Lindore dhe që fliste anglisht vetëm me vështirësi të madhe. Më kujtohet qartë udhëtimi ynë për në bazën e trajnimit në Teksas. Isha në një aeroplan, ulur pranë një pasagjeri që fliste me një theks të fortë jugor. Mezi mundja të merrja vesh ndonjë fjalë që thoshte. Po vrisja mendjen vërtet, nëse ma kishin mësuar gjuhën gabim që prej fillimit. Isha i tmerruar nga mendimi se duhet të konkurroja, për vendet e para të lakmuara në trajnimin për pilot, me studentë që e kishin anglishten gjuhë amtare.

Kur arrita në bazën ajrore në qytetin e vogël Big-Spring [Burimi i Madh] në Teksas, kërkova dhe gjeta degën e shenjtorëve të ditëve të mëvonshme, që përbëhej nga një grusht anëtarësh të mrekullueshëm, të cilët mblidheshin në dhoma të marra me qira në vetë bazën ajrore. Anëtarët qenë në procesin e ndërtimit të një shtëpie të vogël mbledhesh që do të shërbente si një vend i përhershëm për Kishën. Në atë kohë, anëtarët bënin shumicën e punës për ndërtesat e reja.

Ditë pas dite, unë merrja pjesë në trajnimin për pilot e studioja sa më shumë që të mundesha dhe pastaj e kaloja shumicën e kohës sime të lirë duke punuar tek shtëpia e re e mbledhjeve. Atje mësova se dy-për-katër nuk ishte ndonjë lloj vallëzimi, por një copë druri me përmasa dy me katër inç. Gjithashtu mësova aftësinë e rëndësishme për mbijetesë që të mos godisja gishtin kur ngulja gozhdë.

Kalova kaq shumë kohë duke punuar në shtëpinë e mbledhjeve



saqë presidenti i degës – që ndodhi të ishte edhe një nga instruktorët tanë për fluturim – shprehu shqetësim se ndoshta duhej të kaloja më shumë kohë duke studiuar.

Miqtë e mi dhe bashkëstudentët për pilotë u përfshinë në aktivitete për kohën e lirë gjithashtu, ndonëse mendoj se është e drejtë të thuhet se disa nga këto aktivitete nuk do të kishin qenë në harmoni me broshurën e sotme *Për Forcën e Rinisë*. Nga ana ime, u kënaqa që isha një pjesë aktive e asaj dege të vocërr të Teksasit perëndimor, duke praktikuar aftësitë e sapofituara si karpentier dhe duke përmirësuar anglishten time, ndërsa përmbushja thirrjet e mia për të dhënë mësim në kuorumin e pleqve dhe në Shkollën e së Dielës.

Në atë kohë, Big-Springu, me gjithë emrin e tij, ishte një vend i vogël, i parëndësishëm dhe i panjohur. Dhe shpesh unë u ndieva po ashtu për veten time – i parëndësishëm, i panjohur dhe mjaft i vetmuar. Me gjithë

këtë, unë as edhe njëherë nuk e vrava mendjen nëse Zoti më kishte harruar ose nëse Ai do të ishte në gjendje ndonjëherë të më gjente atje. E dija se nuk kishte rëndësi për Atin Qiellor se ku isha, ku renditesha në lidhje me të tjerët në klasën time për trajnim si pilot, ose se cila ishte thirrja ime në Kishë. Ajo që kishte rëndësi për Të ishte se po bëja më të mirën që mundesha, se zemra ime ishte e prirur nga Ai dhe se isha i gatshëm të ndihmoja të tjerët që ishin rreth meje. E dija që, nëse do të bëja më të mirën që mundesha, gjithçka do të ishte mirë.

Dhe gjithçka shkoi mirë.¹⁵

I Fundit do të Jetë i Pari

Zoti nuk ka fare gjalle nëse ne i kalojmë ditët tona duke punuar në salla të mermerta apo në stalla ahuri. Ai e di se ku jemi, pavarësisht sa të përlurura të jenë rrethanat tona. Ai do të përdorë – në mënyrën e Tij dhe për qëllimet e Tij të shenja – ata që e duan Atë.

Perëndia e di se disa nga shpirtat më të shkëlqyer që kanë jetuar ndonjëherë, janë ata që nuk do të shfaqen kurrë në kronikat e historisë. Ata janë shpirtat e bekuar e të përlurur që ndjekin shembullin e Shpëtimtarit dhe i kalojnë ditët e jetës së tyre duke bërë mirë.¹⁶

Një çift i tillë, prindërit e një mikut tim, janë shembull i mirë i këtij parimi për mua. Bashkëshorti punonte në një uzinë çeliku në Juta. Në drekë, ai do të nxirrte shkrimet e tij të shenja, ose një revistë të Kishës dhe do të lexonte. Kur punëtorët e tjerë e panë këtë, u tallën me të dhe i sfiduan besimet e tij. Kurdoherë që e bënë këtë, ai u foli me shpirtmirësi dhe me mirëbesim. Ai nuk lejoi që mungesa e tyre e respektit ta zemëronte ose ta mërzhiste atë.

Vite më vonë, një nga tallësit më të zhurmshëm u sëmur rëndë. Përpara se të vdiste, ai kërkoi që ky burrë i përlurur të fliste në funeralin e tij – gjë që ai e bëri.

Ky anëtar besnik i Kishës nuk pati kurrë shumë nga pikëpamja e gjendjes shoqërore apo e pasurisë, por ndikimi i tij u shtri thellë tek të gjithë ata që e njihnin. Ai vdiq në një aksident industrial, ndërsa ndaloi që të ndihmonte një punëtor tjetër i cili kishte ngecur në borë.

Brenda një viti, të vesë së tij iu desh t'i nënshtrohej një operacioni në tru, që e la të paafte për të ecur. Por njerëzve u pëlqen shumë të vijnë e të kalojnë kohë me të, sepse ajo dëgjon. Ajo mban mend. Ajo përkujdeset. Në pamundësi për të shkruar, ajo mëson përmendësh numrat e telefonit të fëmijëve dhe të nipërve e mbesave të saj. Ajo kujton me dashuri datëlindjet dhe përvjetorët.

Ata që e vizitojnë atë largohen duke u ndier më mirë për jetën dhe për veten. Ata ndiejnë dashurinë e saj. Ata e dinë se ajo përkujdeset. Ajo nuk



ankohet kurrë, por i kalon ditët e saj duke bekuar jetën e të tjerëve. Një nga mikeshat e saj tha se kjo grua ishte një nga pak njerëzit që ajo kishte njohur ndonjëherë të cilët ndjekin vërtet shembullin e dashurisë e të jetës së Jezu Krishtit.

Ky çift do të kishte qenë i pari që do të thoshte se ata nuk kishin shumë rëndësi në këtë botë. Por Zoti përdor një peshore shumë të ndryshme nga e botës për të matur vlerën e një shpirti. Ai e njeh këtë çift besnik; Ai i do ata. Veprimet e tyre janë një dëshmi e gjallë e besimit të tyre të fuqishëm tek Ai.

Ju Keni Rëndësi për Të

Vëllezër e motra të mia të dashura, mund të jetë e vërtetë se njeriu është një hiç në krahasim me madhësinë e universit. Nganjëherë ne mund të ndihemi madje të parëndësishëm, të pa vënë re, të vetëm, ose të harruar. Por gjithmonë kujtoni – ju keni rëndësi për Të! Nëse ndonjëherë keni dyshuar për këtë, merrni parasysh këto katër parime hyjnore:

Së pari, Perëndia i do të përlulurit dhe të bindurit, pasi ata janë “më [të mëdhenjtë] në mbretërinë e qiejve”¹⁷.

Së dyti, Zoti ia beson “plotësi[në] e ungjillit [të Tij që] të mund t’u shpallet nga të dobët dhe të thjeshtë fundeve

të botës”¹⁸. Ai ka zgjedhur “gjërat e dobëta të botës [që] të vijnë dhe . . . të dërrmojnë gjërat e fuqishme dhe të forta”¹⁹ dhe që të turpërojnë “të fortët”²⁰.

Së treti, pavarësisht se ku jetoni, pavarësisht sa të përlulura të jenë rrethanat tuaja, sa i pakët punësimi juaj, sa të kufizuara aftësitë tuaja, sa e zakonshme pamja juaj, apo sa e vogël mund të duket se është thirrja juaj në Kishë, ju nuk jeni i pa vënë re për Atin tuaj Qiellor. Ai ju do ju. Ai e njeh zemrën tuaj të përlulur dhe veprimet tuaja të dashurisë dhe shpirtmirësisë. Së bashku, ato formojnë një dëshmi të qëndrueshme të besnikërisë dhe besimit tuaj.

Së katërti dhe së fundi, ju lutem kuptojeni se ajo çfarë shihni dhe përjetoni tani nuk është ajo që do të jetë përgjithmonë. Ju nuk do të ndieni vetmi, hidhërim, dhembje ose shkura-jim përgjithmonë. Ne kemi premtimin besnik të Perëndisë se Ai as nuk do të harrojë as nuk do braktisë ata që e duan Atë.²¹ Kini shpresë dhe besim tek ai premtim. Mësoni ta doni Atin tuaj Qiellor dhe bëhuni dishepull i Tij në fjalë e në veprim.

Sigurohuni që, nëse ju thjesht duroni, besoni tek Ai dhe mbeteni besnikë në mbajtjen e urdhërimeve, një ditë ju do të provoni për veten tuaj

premtimet që iu zbuluan Apostullit Pal: “Ato gjëra që syri nuk i ka parë dhe veshi nuk i ka dëgjuar dhe nuk kanë hyrë në zemër të njeriut, janë ato që Perëndia ka përgatitur për ata që e duan atë”²².

Vëllezër e motra, Qenia më e fuqishme në univers është Ati i shpirtit tuaj. Ai ju njeh ju. Ai ju do me dashuri të përkryer.

Perëndia ju sheh jo vetëm si një qenie e vdekshme në një planet të vogël që jeton për një stinë të shkurtër – Ai ju sheh ju si fëmijën e Tij. Ai ju sheh ju si qenia që jeni të aftë dhe të projektuar që të bëheni. Ai dëshiron që ju ta dini se ju keni rëndësi për Të.

Besofshim, mirëbesofshim dhe i jetofshim gjithmonë jetët tona në mënyrë të tillë që ta kuptojmë vlerën dhe potencialin tonë të vërtetë të përjetshëm. Qofshim të denjë për bekimet e çmuara që Ati ynë Qiellor ka gati për ne është lutja ime në emrin e Birit të Tij, madje Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Moisiu 1:2.
2. Moisiu 1:10.
3. Moisiu 1:33.
4. Shih Andrew Craig, “Astronomers count the stars”, BBC News, 22 korrik 2003, <http://news.bbc.co.uk/2/hi/science/nature/3085885.stm>.
5. Moisiu 7:30.
6. Mosia 4:11.
7. Doktrina e Besëlidhje 18:10.
8. Shih Moisiu 1:38–39.
9. William Knox, “Mortality”, në James Dalton Morrison, red., *Masterpieces of Religious Verse* (1948), f. 397.
10. Doktrina e Besëlidhje 121:7.
11. 3 Nefi 11:38.
12. Mosia 3:19.
13. Lluca 18:14; shih gjithashtu vargjet 9–13.
14. Mosia 2:17.
15. Diter F. Uhtdorf u diplomua i pari në klasën e tij.
16. Shih Veprat e Apostujve 10:38.
17. Mateu 18:4; shih gjithashtu vargjet 1–3.
18. Doktrina e Besëlidhje 1:23.
19. Doktrina e Besëlidhje 1:19.
20. 1 Korintasve 1:27.
21. Shih Hebrejve 13:5.
22. 1 Korintasve 2:9.



Paraqitur nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

Mbështetja e Drejtuesve të Kishës

Propozohet që ne të mbështesim Tomas Spenser Monson, si profet, shikues dhe zbulues, si dhe si President të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme; Henri Benion Ajring, si Këshilltar të Parë në Presidencën e Parë; dhe Diter Fridrih Uhtdorf, si Këshilltar të Dytë në Presidencën e Parë.

Ata që janë dakord, mund ta tregojnë.

Ata që janë kundër, nëse ka, mund ta tregojnë.

Propozohet që ne të mbështesim Bojd Kenet Paker, si President të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe ata që vijojnë si anëtarë të atij kuorumi: Bojd K. Paker, L. Tom Peri, Rasëll M. Nelson, Dallin H. Ouks, M. Rasëll Ballard, Riçard G. Skot, Robert D. Hejls, Xhefri R. Holland, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk, D. Tod Kristoferson dhe Nil L. Andersen.

Ata që janë dakord, ju lutem ta tregojnë.

Ndonjë kundër mund ta tregojë në të njëjtën mënyrë.

Propozohet që ne të mbështesim këshilltarët në Presidencën e Parë dhe Dymbëdhjetë Apostujt si profetë, shikues e zbulues.

Të gjithë që janë dakord, ju lutem tregojeni atë.

Kundër, në qoftë se ka, me të njëjtën shenjë.

Plaku Klaudio R. M. Kosta është liruar nga thirrja si anëtar i Presidencës së Kuorumeve të Të Shtatëdhjetëve.

Ata që mund të bashkohen me ne në një votim vlerësimi, ju lutem ta tregojnë atë.

Propozohet që ne të mbështesim Plakun Ted R. Kelister si anëtar të Presidencës së Kuorumeve të Të Shtatëdhjetëve.

Të gjithë që janë dakord, ju lutem tregojeni atë.

Ata që janë kundër, nëse ka.

Propozohet që të lirojmë Pleqtë Geri J. Koleman, Riçard G. Hinkli, Joshihiko Kikuçi, Karl B. Prat dhe Sesil O. Samuelson nga thirrjet si anëtarë të Kuorumit të Parë të Të Shtatëdhjetëve dhe t'i caktojmë ata si

Autoritete të Përgjithshme nderi.

Propozohet që të lirojmë gjithashtu Pleqtë Von Jong Ko, Louell M. Snou dhe Pol K. Sibrovski nga thirrjet si anëtarë të Kuorumit të Dytë të Të Shtatëdhjetëve.

Ata që dëshirojnë të bashkohen me ne për t'u shprehur mirënjohje këtyre Vëllezërve për shërbimin e tyre të shkëlqyer, ju lutem ta tregojnë.

Pleqtë Ralf W. Hardi i Riu, Xhon M. Hantsman Plaku, Aleksandër N. Manzhos dhe J. Uillard Mariot i Riu, janë liruar nga thirrjet si Të Shtatëdhjetë Zonalë.

Propozohet që atyre t'u jepet një votim mirënjohjeje për shërbimin e tyre të dalluar.

Të gjithë që janë dakord, ju lutemi tregojeni.

Propozohet që ne të mbështesim Autoritetet e tjera të Përgjithshme, Të Shtatëdhjetët Zonalë dhe presidentat e përgjithshme të organizatave ndihmëse me përbërjen e tyre të tanishme.

Ata që janë dakord, ju lutem ta tregojnë.

Ndonjë kundër mund ta tregojë po ashtu.

Presidenti Monson, për aq sa kam mundur të vërej, votimi në Qendrën e Konferencave ka qenë unanim.

Faleminderit, vëllezër dhe motra, për votimin tuaj mbështetës, besimin, përkushtimin dhe lutjet tuaja. ■





Nga Plaku Dejvid A. Bednar,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Zemrat e Fëmijëve Do të Kthehen

I ftoj të rinjtë e Kishës që të mësojnë e të përjetojnë Shpirtin e Elijas.

Kur studiojmë, mësojmë dhe jetojmë ungjillin e Jezu Krishtit, rendi i gjërave shpeshherë të jep mësim. Merrni parasysh, për shembull, mësimet mbi përparësitë shpirtërore që ne mësojmë nga rendi i ngjarjeve madhore që ndodhën kur plotësia e ungjillit të Shpëtimtarit u rivendos në këto ditë të mëvonshme.

Në Korijen e Shenjtë Jozef Smithi pa dhe foli me Atin e Përjetshëm dhe Jezu Krishtin. Ndër të tjera, Jozefi mësoi mbi natyrën e vërtetë të Kreut-Perëndi dhe për vazhdimin e zbulësës. Ky vegim i madhërisëm filloi “[periudhën kur] plotësoheshin kohërat” (Efesianëve 1:10) dhe është një nga ngjarjet e rëndësishme të historisë së botës.

Afërsisht tre vjet më vonë, në përgjigje të lutjes së sinqertë mbrëmjen e 21 shtatorit 1823, dhoma e fjetjes e Jozefit u mbush me dritë derisa “ishte më e shndritshme se në mesditë” (Joseph Smith – Historia 1:30). Një personazh iu shfaq në anë të shtratit, e thirri djalosin me emër dhe tha se “ishte një lajmëtar i dërguar nga prania e Perëndisë . . . dhe se emri i tij ishte Moroni” (vargu 33). Ai e udhëzoi Jozefin lidhur me ardhjen e Librit të

Mormonit. E më pas Moroni citoi nga libri i Malakias në Dhiatën e Vjetër, me pak ndryshim në gjuhën që përdoret tek Varianti i Mbretit Xhejms:

“Vini re, unë do t’ju zbuloj Priftërinë, nga dora e Elijas, profetit, përpara ardhjes së ditës së madhe e të tmerrshme të Zotit.

. . . Dhe ai do të mbjellë në zemrat e fëmijëve premtimet e bëra etërve dhe zemrat e fëmijëve do të kthehen tek etërit e tyre. Në qoftë se nuk do të ishte kështu, e tërë toka do të shkatërrohej plotësisht në ardhjen e tij” (vargjet 38:39).

Udhëzimet e Moronit drejtuar profetit të ri përfshinin së fundi dy tema parësore: 1) Librin e Mormonit dhe 2) fjalët e Malakias që parathoshte rolin e Elijas në Rivendosjen e “të gjitha gjërave, për të cilën Perëndia ka folur nëpërmjet gojës së gjithë profetëve të tij të shenjtë, që nga fillimi i botës” (Veprat e Apostujve 3:21). Kështu, ngjarjet parathënëse të Rivendosjes zbuluan një kuptim të saktë për Kreun-Perëndi, theksuan rëndësinë e Librit të Mormonit dhe parashikuan punën e shpëtimtarit të ekzaktit si për të gjallët, edhe për të

vdekurit. Kjo renditje frymëzuese të mëson mbi çështjet shpirtërore që për Hyjninë kanë përparësinë më të lartë.

Mesazhi im përqendrohet mbi shërbesën dhe Shpirtin e Elijas që u parathanë nga Moroni në udhëzimet e tij të drejtuar Jozef Smithit. Sinqerisht lutem për ndihmën e Frymës së Shenjtë.

Shërbesa e Elijas

Elija ishte një profet i Dhiatës së Vjetër, nëpërmjet të cilit u kryen mrekulli të fuqishme. Ai vulosi qiejt dhe në Izraelin e lashtë nuk ra shi për 3 vjet e gjysmë. Ai shumoi miellin dhe vajin e një vejusheje. Ngriti prej së vdekuri një djalosh dhe zbriti zjarr nga qielli, në sfidë me profetët e Baalit. (Shih 1 Mbretërit 17–18.) Në përfundim të shërbesës së Elijas në jetën e vdekshme, ai “u ngjiti në qiell në një shakullinë” (2 Mbretërve 2:11) dhe u zhvendos.

“Ne mësojmë nga zbulësia e ditëve të mëvonshme që Elija mbante fuqinë vulosëse të Priftërisë Melkizedeke dhe ishte profeti i fundit që e mbajti, para kohës së Jezu Krishtit” (Bible Dictionary, “Elijah”). Profeti Jozef Smith shpjegoi: “Shpirti, fuqia dhe thirrja e Elijas është që ju keni fuqi të mbani çelësin e . . . plotësisë së Priftërisë Melkizedeke . . . ; dhe për të marrë . . . të gjitha ordinancat që i përkasin mbretërisë së Perëndisë” (*Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith*, [2009], f. 331; kursivet janë theksime). Ky autoritet i shenjtë vulosës është thelbësor që ordinancat e priftërisë të jenë të vlefshme dhe të lidhin si në tokë, edhe në qiell.

Elija u shfaq bashkë me Moisiun në Malin e Shpërfytyrimit (shih Mateu 17:3) dhe i dha këtë autoritet Pjetrit, Jakobit dhe Gjonit. Elija u shfaq sërish me Moisiun dhe të



tjerë, më 3 prill 1836, në Tempullin e Kirtlandit dhe u dha të njëjtët çelësa Jozef Smithit dhe Oliver Kaudrit.

Shkrimi i shenjtë dokumenton që profeti Elija qëndroi para Jozefit dhe Oliverit dhe tha:

“Vini re, ka ardhur plotësisht koha, që ishte folur nga goja e Malakias, duke dëshmuar që ai [Elija] do të dërgohej, përpara se dita e madhe dhe e tmerrshme e Zotit të vinte –

Për t'i kthyer zemrat e etërve tek fëmijët dhe të fëmijëve tek etërit, përndryshe tërë toka do të goditej me një mallkim –

Si rrjedhim, çelësat e kësaj periudhe të kujdestarisë jepen në duart tuaja; dhe me anë të kësaj ju mund të dini se dita e madhe dhe e tmerrshme e Zotit është pranë, madje te dyert” (DeB 110:14–16).

Rivendosja e autoritetit vulosës nga Elija më 1836, ishte e domosdoshme për të përgatitur botën për Ardhjen e Dytë të Shpëtimtarit dhe

nisi një interesim mjaft të shtuar e mbarëbotëror në kërkimin e historisë familjare.

Shpirti dhe Puna e Elijas

Profeti Jozef Smith shpalli: “Përgjegjësia më e madhe në këtë botë që Perëndia ka vendosur mbi ne, është që të kërkojmë të vdekurit tanë. . . . Sepse është e nevojshme që fuqia vulosëse duhet të jetë në duart tona për të vulosur fëmijët tanë dhe të vdekurit tanë për plotësinë e periudhës së kohëve – një periudhë ungujlore kjo për të plotësuar premtimet e bëra nga Jezu Krishti përpara krijimit të botës për shpëtimin e njeriut. . . . Prandaj, Perëndia tha: ‘Unë do t’ju dërgoj Elian, profetin’” (*Mësimet: Jozef Smith*, f. 508).

Jozefi më tej shpjegoi:

“Por cili është synimi i [ardhjes së Elijas] apo si do të përmbushet ai? Çelësat duhet të dorëzohen, shpirti i Elijas duhet të vijë, Ungjilli të vendoset,

shenjtoret e Perëndisë të mbledhen, Sioni të ndërtohet dhe shenjtoret të ngjiten si çlirimtarë në Malin e Sionit [shih Abdia 1:21].

Por si do të bëhen ata çlirimtarë në Malin e Sionit? Duke ndërtuar tempujt e tyre . . . dhe duke shkuar përpara, dhe duke marrë të gjitha ordinancat . . . në emër të të gjithë të parëve të tyre që kanë vdekur . . . ; dhe në këtë qëndron zinxhiri që lidh zemrat e etërve me bijtë dhe të bijve me etërit, që përmbush misionin e Elijas” (*Mësimet: Jozef Smith*, f. 505–506).

Plaku Rasëll M. Nelson na ka mësuar se Shpirti i Elijas është “një shfaqje e Frymës së Shenjtë që jep dëshmi për natyrën hyjnore të familjes” (“A New Harvest Time”, *Ensign*, maj 1998, f. 34). Ky ndikim karakteristik i Frymës së Shenjtë i tërheq njerëzit për t’i gjetur, dokumentuar dhe për t’i dashur paraardhësit dhe pjesëtarët e familjes së tyre – edhe të kaluar, edhe të tanishëm.

Shpirti i Elijas ndikon njerëzit brenda dhe jashtë Kishës. Sidoqoftë, si anëtarë të Kishës së Rivendosur të Krishtit, ne kemi përgjegjësi besëlidhjeje për të gjetur paraardhësit tanë e t’u sigurojmë ordinancat shpëtuese të ungujllit. “Ata pa ne nuk mund të bëhen të përsosur” (Hebrenjve 11:40; shih edhe *Mësimet: Jozef Smith*, f. 508). Dhe “as ne nuk mundemi, pa të vdekurit tanë, të bëhemi të përsosur” (DeB 128:15).

Për këto arsye bëjmë kërkime të historisë familjare, ndërtojmë tempujt dhe kryejmë ordinanca mëkëmbëse. Për këto arsye Elija u dërgua të rivendosë autoritetin vulosës që lidh në tokë dhe në qiell. Ne jemi veprimtarët e Zotit në punën e shpëtimit dhe të ekzaltimit, e cila do të parandalojë që “tërë toka [të goditet] me një mallkim” (DeB 110:15) kur Ai të kthehet përsëri. Kjo është detyra jonë dhe bekimi ynë i madh.



Një Ftesë për Brezin e Ri

Tani unë kërkoj vëmendjen e të rinjave, të rinjve dhe të fëmijëve të brezit të ri, ndërsa i vë theksin rëndësisë së Shpirtit të Elijas në jetën tonë sot. Mesazhin tim e mendoj për tërë Kishën në përgjithësi – por për ju në veçanti.

Shumë prej jush mund të mendojnë se puna e historisë familjare duhet të kryhet kryesisht nga njerëz më të rritur. Por unë nuk di të përshkruhet asnjë kufi moshe në shkrimet e shenjtja apo në udhëzimet e shpallura nga udhëheqës të Kishës, që e kufizon këtë shërbesë të rëndësishme tek personat plotësisht të rritur. Ju jeni bij dhe bija të Perëndisë, fëmijë të besëlidhjes dhe ndërtues të mbretërisë. Nuk ju duhet të prisni derisa të arrini një moshë të kërkuar, që të përmbushni përgjegjësinë tuaj për të ndihmuar në punën e shpëtimit për familjen njerëzore.

Zoti ka bërë të mundur në kohën

tonë burime të mrekullueshme që ju aftësojnë që ta mësoni e ta doni këtë punë, e cila ndizet nga Shpirti i Elijas. Për shembull, FamilySearch është një koleksion dokumentesh, burimesh dhe shërbimesh që arrihen lehtësisht me kompjutera e pajisje të larmishme portative vetjake, i cili është projektuar t'i ndihmojë njerëzit që të zbulojnë e të dokumentojnë historinë e familjes së tyre. Këto burime gjithashtu mundësohen në qendrat e historisë familjare në shumë prej ndërtesave të Kishës sonë anembanë botës.

Nuk është rastësi që FamilySearch dhe instrumente të tjera kanë dalë në një kohë kur të rinjtë janë kaq të familjarizuar me një gamë të gjerë teknologjish të informacionit dhe të komunikimit. Gishtërinjtë tuaj janë stërvitur në shkrim e dërgim teksti për të përshpejtuar e çuar më përpara punën e Zotit – jo thjesht për të komunikuar shpejt me miqtë tuaj. Aftësitë

dhe prirjet e dukshme mes shumë të rinjve të sotëm janë një përgatitje për t'i kontribuar punës së shpëtimit.

I ftoj të rinjtë e Kishës që të mësojnë e të përjetojnë Shpirtin e Elijas. Ju inkurajoj që të studioni, të gjeni paraardhësit tuaj e të përgatiteni për të kryer pagëzime mëkëmbëse në shtëpinë e Zotit për të vdekurit e farefisit tuaj (shih DeB 124:28–36). Dhe ju nxis që të ndihmoni njerëz të tjerë për të gjetur historitë e tyre familjare.

Kur i përgjigjeni me besim kësaj ftese, zemra juaj do të kthehet drejt etërve. Premtimet që iu bënë Abrahamit, Isakut dhe Jakobit, do të nguliten në zemrën tuaj. Bekimi juaj patriarkal, me shpalljen prej tij të linjës së prejar-dhjes, do t'ju lidhë te këta etër e do të jetë për ju më kuptimplotë. Dashuria dhe mirënjohja për paraardhësit tuaj do të shtohet. Dëshmia juaj për kthimin në besim tek Shpëtimtari, do të bëhet e thellë dhe e qëndrueshme. Dhe unë ju premtoj se ju do të jeni të mbrojtur ndaj ndikimit në rritje të kundërshtarit. Ndërsa merrni pjesë dhe e doni këtë



punë të shenjtë, ju do të mbroheni në rini dhe gjatë gjithë jetës suaj.

Prindër dhe udhëheqës, ju lutem ndihmohuni fëmijët dhe të rinjtë tuaj që të mësojnë e të përjetojnë Shpirtin e Elias. Por mos e teproni programimin e kësaj përpjekjeje apo të jepni informacion ose trajnim tepër të hollësishëm. Ftojini të rinjtë që të bëjnë kërkime, të eksperimentojnë dhe të mësojnë vetë (shih Joseph Smith – Historia 1:20). Kushdo i ri ose e re mund ta bëjë atë që unë po këshilloj, duke përdorur modulet mësimore që mundësohen tek adresa lds.org/familysearch.org/ldsyoung. Presidencat e kuorumit të Priftërisë Aarone dhe të klasës së Të Rejave mund të luajnë një rol të rëndësishëm për të ndihmuar që gjithë rinia të njihet me këto burime bazë. Të rinjtë nevojitet gjithnjë e më shumë të jenë nxënës që veprojnë e që në këtë mënyrë të marrin dritë e dije shtesë nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë – dhe jo thjesht studentë pasivë që kryesisht detyrohen të veprojnë (shih 2 Nefi 2:26).

Prindër dhe udhëheqës, ju do të qëndroni plot habi që sa shpejt fëmijët tuaj dhe rinia e Kishës bëhen tepër të aftë në këto mjete. Në fakt, do të mësoni mësim të vlefshme nga këta të rinj lidhur me përdorimin e efektshëm të këtyre burimeve. Rinia mund t'u ofrojë shumë ndihmë personave më të rritur që i mundon ose i tremb teknologjia apo janë të pamësuar me FamilySearch-in. Ju gjithashtu do të numëroni bekime të shumta, teksa të rinjtë i përkushtojnë më shumë kohë punës së historisë familjare dhe shërbimit në tempull e më pak kohë lojërave elektronike, lundrimit në internet dhe përdorimit të profileve shoqërore si Facebook-u.

Troi Xhekson, Xherën Houp dhe Endrju Alen janë mbajtës të Priftërisë Aarone të cilët qenë thirrur nga një

peshkop i frymëzuar që së bashku t'i jepnin mësim një klase të historisë familjare në lagjen e tyre. Këta të rinj janë shembuj tipikë të aq shumëve prej jush në padurimin e tyre për të mësuar e dëshiruar që të shërbejnë.

Troi u shpreh: “Vija në kishë dhe thjesht ulesha aty, por tani kuptoj se nevojitet të shkoj në shtëpi e të bëj diçka. Ne të gjithë mund të bëjmë histori të familjes.”

Xherën njoftoi se, ndërsa ai mëson më shumë për historinë familjare, ai kuptoi “se këta nuk ishin thjesht emra, por njerëz të vërtetë. Më ngjallte gjithnjë e më shumë emocion çuarja e emrave në tempull.”

Dhe Endrju komentoi: “Jam pushtuar nga historia familjare me një dashuri e vull që nuk e dija se mund ta kisha. Kur përgatitesha çdo javë për të dhënë mësim, shpesh Fryma e Shenjtë më shtynte të veproja e të provoja disa nga metodat që mësoheshin

në mësim. Më parë historia familjare ishte gjë e frikshme. Por, i ndihmuar nga Shpirti, isha në gjendje të plotësoja thirrjen time e të ndihmoja shumë njerëz në lagjen tonë.”

Fort të dashur vëllezër e motra të mia të reja, historia familjare nuk është thjesht një program apo veprimtari interesante e sponsorizuar nga Kisha; më saktë, ajo është një pjesë jetësore e punës së shpëtimit e të ekzaltimit. Ju qetë përgatitur për këtë kohë dhe për të ngritur mbretërinë e Perëndisë. Jeni këtu mbi tokë tani për të ndihmuar në këtë punë të lavdishme.

Unë dëshmoj që Elija u kthye në tokë dhe e rivendosi autoritetin e shenjtë vulosës. Dëshmoj se çfarë lidhet mbi tokë, mund të lidhet në qiell. Dhe unë e di se rinia e brezit të ri ka një rol kyç për të luajtur në këtë përpjekje të madhe. Kështu dëshmoj në emrin e shenjtë të Zotit Jezu Krisht, amen. ■

THE CHURCH OF JESUS CHRIST OF LATTER DAY SAINTS

Sign In Languages

Menu Tools Search all LDS.org

Youth

YOUTH FAMILY HISTORY AND YOUTH

FamilySearch

Youth and Family History

Home Discover Serve Experiences

Now that you have experienced the joy of discovering your own family history, here are some ways you and your class or quorum can help others do the same.

Video: Help the Families You Home Teach
Watch video >

Video: Help Others Come Back to Church
Watch video >

Video: Help New Members Take a Name to the Temple
Watch video >

"Spiritual connections . . . are formed when a young woman helps her grandmother enter family information into a computer or when a young man sees the name of his great-grandfather on a census record. When our hearts turn to our ancestors, something changes inside us. We feel part of something greater than ourselves."
Russell M. Nelson



Nga Plaku Nil L. Andersen,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Fëmijët

Unë dëshmoj për bekimin e madh të fëmijëve dhe të lumturisë që ata do të na sjellin në këtë jetë dhe në përjetësi.

Kur vështrojmë në sytë e një fëmije, ne shohim një bashkëbir apo bashkëbijë të Perëndisë që ishte me ne në jetën para lindjes.

Është një privilegj i madh i një bashkëshorti dhe një bashkëshorteje që janë në gjendje të lindin fëmijë për të dhënë trupa të vdekshëm për këta fëmijë shpirtra të Perëndisë. Ne besojmë te familjet dhe ne besojmë te fëmijët.

Kur një bashkëshorti dhe një bashkëshorteje u lind një fëmijë, ata po plotësojnë një pjesë të planit të Atit tonë Qiellor për të sjellë fëmijë në tokë. Zoti ka thënë: “Sepse, vër re, kjo është vepra ime dhe lavdia ime – të bëj të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut”¹. Përpara pavdekësisë duhet të ketë vdekshmëri.

Familja shugurohet nga Perëndia. Familjet janë qendrore në planin e Atit tonë Qiellor këtu në tokë dhe në gjithë përjetësitë. Pasi Adami dhe Eva u bashkuan në martesë, shkrimi i shenjtë thotë: “Dhe Perëndia i bekoi; dhe Perëndia u tha atyre: ‘Të jeni të frytshëm dhe shumëzohuni, mbushni tokën’”². Në ditët tona profetët dhe apostujt kanë thënë: “Urdhërimi i parë që Perëndia i dha Adamit dhe Evës, lidhje me potencialin e tyre për të qenë prindër si bashkëshort e bashkëshorte. Ne deklarojmë se urdhërimi i Perëndisë për fëmijët e Tij që të shumohen

dhe të mbushin tokën, mbetet i vlefshëm.”³

Ky urdhërim nuk është harruar apo lënë mënjanë në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.⁴ Ne shprehim mirënjohje të thellë për besimin e madh që tregohet nga bashkëshortët dhe bashkëshortet (veçanërisht bashkëshortet tona) në vullnetin e tyre për të pasur fëmijë. Kur ta kesh një fëmijë dhe sa fëmijë të kesh, janë vendime personale që merren midis një bashkëshorti e bashkëshortes dhe Zotit. Këto janë vendime të shenjta – vendime që duhet të merren me lutje të sinqertë dhe të veprohet me besim të madh.

Vite përpara Plaku Xhejms O. Mason, i Të Shtatëdhjetëve, ndau këtë histori me mua: “Lindja e fëmijës sonë të gjashtë ishte një përjetim i paharrueshëm. Ndërsa e vështroja ngultas këtë bijë të re, të mrekullueshme në inkubator në çastet pas lindjes së saj, unë dallueshëm dëgjova një zë që tha: ‘Do të ketë edhe një tjetër dhe ai do të jetë djalë’. I pamatur, me nxitim u ktheva nga ana e shtratit të bashkëshortes time absolutisht të rraskapitur dhe i thashë asaj lajmin e mirë. Ishte një kohë e zgjedhur mjaft keq nga ana ime.”⁵ Vit pas viti Masonët parandienin ardhjen e fëmijës së tyre të shtatë. Tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë vjet kaluan.

Më në fund, pas tetë vjetësh fëmija i tyre i shtatë lindi – një djalë i vogël.

Prillin e kaluar, Presidenti Tomas S. Monson deklaroi:

“Dikur standardet e Kishës dhe standardet e shoqërisë përgjithësisht përputheshin, tani ka një ndryshim të madh midis nesh dhe ai po rritet gjithnjë më shumë. . . .

Shpëtimtari i njerëzimit e përshkroi veten që ishte në botë por jo prej bote. Ne gjithashtu mund të jemi në botë por jo prej bote kur kundërshojmë konceptet false e mësimet false dhe qëndrojmë të vërtetë në atë që Perëndia ka urdhëruar.”⁶

Shumë zëra në botë sot e zhvlefëtojnë rëndësinë e të paturit fëmijë ose sugjerojnë vonimin ose kufizimin e fëmijëve në familje. Vajzat e mia kohët e fundit, më treguan një koment në internet shkruar nga një nënë e krishterë (jo e besimit tonë) me pesë fëmijë. Ajo thoshte: “[E rritur] në këtë kulturë është shumë e vështirë të kesh një këndvështrim biblik mbi mëmësinë. . . . Fëmijët renditen shumë më poshtë për nga rëndësia sesa studimi në kolegji. Më poshtë se udhëtimi nëpër botë sigurisht. Më poshtë se mundësia për të dalë natën për të kaluar kohën. Më poshtë për mirësimin të trupit tuaj në palestër. Më poshtë çfarëdo pune që mund të keni apo shpresoni ta fitoni.” Ajo pastaj shton: “Mëmësia nuk është një hobi, ajo është një thirrje. Ju nuk mblidhni fëmijë sepse ju duken më të bukur se pullat. Nuk është diçka për ta bërë nëse mund t’i ngjeshni brenda kohës suaj. Të pasurit e fëmijëve është ajo për të cilën Perëndia ju dha kohë.”⁷

Të kesh fëmijë të vegjël nuk është e lehtë. Shumë ditë janë thjesht të vështira. Një nënë e re hipi në një autobus me shtatë fëmijë. Shoferi i autobuzit pyeti: “A janë të gjithë këta tuajt, zonjë? Apo është një piknik?”



“Ata janë të gjithë të mitë”, u përgjigj ajo. “Dhe nuk është piknik!”⁸

Ndërsa bota gjithnjë e më shumë pyet: “A janë të gjithë këta tuajt?” ne ju falënderojmë që krijoni brenda Kishës një vend të shenjtë për familje, ku ne nderojmë dhe ndihmojmë nënat me fëmijë.

Për një baba të drejtë, nuk ka fjalë të mjaftueshme që të shprehë mirënjohjen dhe dashurinë që ndien për dhuratën e pallogaritshme të lindjes e përkujdesjes për fëmijët e tyre nga bashkëshortja e tij.

Plaku Mason pati një përjetim tjetër vetëm pak javë pas martesës së tij që e ndihmoi të vendoste përparësitë e përgjegjësive të tij familjare. Ai tha:

“Meri dhe unë patëm arsyetuar se, që unë të kryeja shkollën mjekësore, do të ishte e nevojshme që ajo të vazhdonte punën. Edhe pse kjo nuk ishte ajo që ne [donim] të bënim, fëmijët duhej të vinin më vonë. [Ndërsa po shihja revistën e Kishës në shtëpinë e prindërve të mi] unë pashë një artikull nga Plaku Spenser W. Kimball, atëherë në Kuorumin e Të Dymbëdhjetëve, [që thekson] përgjegjësitë që shoqërojnë martesën. Sipas Plakut Kimball, një përgjegjësi e shenjtë ishte të shumohesh dhe të mbushje tokën. Shtëpia e prindërve të mi ishte [pranë] Ndërtesës së Administratës së Kishës. Unë menjëherë shkova tek zyrat dhe tridhjetë

minuta pas leximit të artikullit të tij, unë u gjenda i ulur në tryezë përballë me Plakun Spenser W. Kimball.” (Të flasësh me një autoritet të përgjithshëm pa caktuar një takim do të ishte e pamundur në kushtet e sotme.)

Unë i shpjegova se doja të bëhesha doktor. Nuk kishte mundësi tjetër përveçse të shtynim pasjen e fëmijëve tanë. Plaku Kimball dëgjoi me durim dhe pastaj u përgjigj me një zë të butë: “Vëlla Mason, a do të donte Zoti që ju të thyni një nga urdhërimet e tij të rëndësishme me qëllim që ju të bëheni doktor? Me ndihmën e Zotit, ju mund të keni familjen tuaj dhe përsëri të bëheni doktor. Ku është besimi juaj?”

Plaku Mason vazhdoi: “Fëmija jonë i parë lindi në më pak se një vit më vonë. Maria dhe unë punuam shumë dhe Zoti hapi pragjet e qiellit.” Masonët u bekuan me dy fëmijë të tjerë përpara se ai të diplomohet nga shkolla e mjekësisë katër vjet më vonë.⁹

Nëpër botë, kjo është një kohë paqëndrueshmërie ekonomike e pasigurie financiare. Në konferencën e përgjithshme të prillit, Presidenti Tomas S. Monson tha: “Nëse jeni të shqetësuar rreth sigurimit financiarisht për një bashkëshorte dhe familje, unë mund t’ju siguroj se nuk ka turp te një çift që i duhet të shtrëngohet dhe të kursejë. Është gjatë këtyre periudhave sfiduese përgjithësisht që ju do të

afroheni më shumë së bashku, duke mësuar të sakrifikoni dhe të merrni vendime të vështira.”¹⁰

Pyetja depërtuese e Plakut Kimball “Ku është besimi juaj?” na kthen te shkrimet e shenjta.

Nuk ishte në Kopshtin e Edenit ku Adami dhe Eva lindën fëmijën e tyre të parë. Duke lënë kopshtin, “Adami [dhe Eva] filluan të lëro[nin] tokën. . . . Adami e njohu gruan e tij dhe ajo i dha atij bij e bija dhe ata [duke vepruar në besim] filluan të shumëzohen e të mbushin tokën.”¹¹

Nuk ishte në shtëpinë e tyre në Jeruzalem, me ar, argjend dhe gjëra të çmuara, që Lehi dhe Sara, duke vepruar në besim, lindën djemtë e tyre Jakobin dhe Jozefin. Kjo ndodhi në vendin e shkretëtë. Lehi iu drejtua birit të tij Jakobit: “I parëlinduri im në ditët e vuajtjes sime në vendin e shkretëtë”¹². Lehi i tha Jozefit: “Ti ishe lindur në vendin e shkretëtë të mjerimeve [tona]; po, në ditët e pikëllimit [tonë] më të madh, të lindi nëna ty”¹³.

Në librin e Eksodit një burrë dhe një grua u martuan dhe, duke vepruar në besim, patën një fëmijë djalë. Nuk pati ndonjë tabelë mirëseardhjeje në derën ballore që të njoftonte lindjen e tij. Ata e fshehën atë sepse Faraoni pati udhëzuar që çdo mashkull i parëlindur izraelit duhej “të hidhej” në lumë¹⁴. Ju e dini pjesën tjetër të historisë: fëmija



Davao në Filipine

me dashuri u vendos në një kanistër prej xunkthi, u vendos në lumë, u mbikëqyr nga motra e tij, u gjet nga e bija e Faraonit dhe pati përkujdesjen nga vetë nëna e tij si dado. Djali u rikthye tek e bija e Faraonit, që e mori atë si djalin e saj dhe e quajti Moisi.

Në historinë më të dashur të lindjes së një fëmije, nuk pati çerdhe të zbukuruar apo djep fëmijësh të modës – vetëm një grazhd për Shpëtimtarin e Botës.

Në “kohët më të mira [dhe] . . . kohët më të këqija”¹⁵, shenjtoret e vërtetë të Perëndisë, duke vepruar në besim, nuk e kanë harruar, larguar apo shpërfillur kurrë “urdhërimin e Perëndisë . . . për t’u shumëzuar dhe mbushur tokën”¹⁶. Ne përparojmë në besim – duke kuptuar se vendimi se sa fëmijë të kenë dhe kur t’i kenë është midis një bashkëshorti e bashkëshortes dhe Zotit. Ne nuk duhet të gjykojmë njëri-tjetrin për këtë çështje.

Lindja e fëmijëve është një temë delikate që mund të jetë shumë e dhembshme për gratë e drejta, që nuk kanë mundësinë të martohen dhe të kenë familje. Juve gra fisnike, Ati ynë Qiellor i di lutjet dhe dëshirat tuaja. Sa mirënjohës jemi ne për ndikimin tuaj

të mrekullueshëm, përfshirë ndihmën me krahë dashurie për fëmijët që kanë nevojë për besimin dhe forcën tuaj.

Lindja e fëmijëve mund të jetë gjithashtu një temë zemërndrydhëse për çifte të drejtë që martohen dhe shohin se nuk mund të kenë fëmijët, që ata i prisnin me aq ankth, ose për një bashkëshort dhe një bashkëshorte, që planifikojnë të kenë një familje të madhe, por janë bekuar me një familje më të vogël.

Ne nuk mund të shpjegojmë gjithmonë vështirësitë e vdekshmërisë sonë. Ndonjëherë jeta duket shumë e padrejtë – veçanërisht kur dëshira jonë më e madhe është të bëjmë saktësisht atë që Zoti ka urdhëruar. Si shërbëtor i Zotit unë ju siguroj ju se ky premtim është i sigurt: “Anëtarët besnikë, rrethanat e të cilëve nuk i lejojnë ata të marrin bekimet e martesës së përjetshme dhe të prindërisë në këtë jetë, do të marrin të gjitha bekimet e premtuara në përjetësitë, [kur] ata t’i mbajnë besëlidhjet që kanë bërë me Perëndinë”¹⁷.

Presidenti J. Skot Dorius i Misionit të Perusë, Lima Perëndimore më tregoi historinë e tij me bashkëshorten. Ai tha: “Beki dhe unë ishim të martuar për 25 vjet pa qenë në gjendje të kishim

[apo adoptonim] fëmijë. Ne u përpoqëm disa herë. Ta prezantonim veten në çdo situatë të re ishte e sikletshme dhe ndonjëherë e dhembshme. Anëtarët e lagjes habiteshin përse ne [nuk kishim] fëmijë. Ata nuk ishin të vetmit që habiteshin, ne vetë po ashtu.

Kur u thirra si peshkop, anëtarët e lagjes [shprehën] shqetësimin që unë nuk kisha ndonjë përvojë me fëmijë dhe me adoleshentë. Unë i falënderova për votën e tyre mbështetëse dhe u kërkova të më lejonin të praktikoj aftësitë e mia për rritje fëmijësh me fëmijët e tyre. Ata me dashuri më lejuan.

Ne pritëm, fituam një këndvështrim dhe mësuam durimin. Pas 25 vjetësh martese, një fëmijë mrekullie erdhi në jetën tonë. Ne adoptuam Nikolën dy vjeçare dhe pastaj të porsalindurin Nikolai. Të huajt tani na përgëzojnë për mbesat dhe nipërit tanë të mrekullueshëm. Ne qeshim dhe themi: ‘Ata janë fëmijët tanë. Ne e kemi jetuar jetën tonë mbrapsht.’¹⁸

Vëllezër dhe motra, ne nuk duhet të jemi gjykues me njëri-tjetrin në këtë përgjegjësi të shenjtë dhe private.

“Dhe [Jezusi] mori një fëmijë . . . në krahë dhe u tha . . .

Cilido që pranon një nga këta

fëmijë në emrin tim, më pranon mua; Dhe kushdo që më pranon mua, . . . [pranon] . . . atë që më ka dërguar.”¹⁹

Çfarë bekimi të mrekullueshëm kemi që të pranojmë bijtë dhe bijat e Perëndisë në shtëpinë tonë.

Le të kërkojmë përlësisht dhe me lutje të kuptojmë dhe të pranojmë urdhërimet e Perëndisë, duke mbajtur vesh me nderim për zërin e Shpirtit të Tij të Shenjtë.

Familjet janë qendrore për planin e përgjithshëm të Perëndisë. Unë dëshmoj për bekimin e madh të fëmijëve dhe të lumturisë që ata do të na sjellin në këtë jetë dhe në përjetësi, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Moisiu 1:39.
2. Zanafilla 1:28.
3. “Familja: Një Proklamata Drejtuar Botës”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.
4. Sipas Studimit vjetor të Komunitetit Amerikan, nxjerrë nga Zyra e Regjistrimit të Popullatës së SHBA, “Juta ende ka familjet më të mëdha të kombit, nivelin më të lartë të lindshmërisë, moshën më të ulët mesatare, moshën më të re në martesë dhe shumicën e nënave shtëpiake” (“Who Are Utahns? Survey Shows We’re Highest, Lowest, Youngest”, *Salt Lake Tribune*, 22 shtator 2011, Al, A8).
5. Postë elektronike e marrë nga Plaku James O. Mason, 25 qershor 2011.
6. Tomas S. Monson, “Fuqia e Përfuturisë”, *Liahona* maj 2011, f. 66, 67.
7. Rachel Jankovic, “Motherhood Is a Calling (and Where Your Children Rank)”, 14 korrik 2011, desiringgod.org.
8. Shih “Jokes and Funny Stories about Children”, thejokes.co.uk/jokes-about-children.php.
9. Postë elektronike e marrë nga Plaku James O. Mason, 29 qershor 2011.
10. Tomas S. Monson, *Liahona*, maj 2011, f. 67.
11. Moisiu 5:1, 2.
12. 2 Nefi 2:1.
13. 2 Nefi 3:1.
14. Eksodi 1:22.
15. Charles Dickens, *A Tale of Two Cities* (Signet Classic, 1997), f. 13.
16. *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.
17. *Handbook 2: Administering the Church* (2010), 1.3.3.
18. Postë elektronike nga Presidenti J. Scott Dorius, 28 gusht 2011.
19. Mateu 9:36–37.



Nga Plaku Jan S. Ardern,
i Të Shtatëdhjetëve

Një Kohë për t’u Përgatitur

Ne duhet t’ia përkushtojmë kohën tonë gjërave që kanë më shumë rëndësi.

Kapitulli i tetë i manualit *Predikoni Ungjillin Tim* e përqendron vëmendjen tonë te përdorimi i mençur i kohës. Në këtë kapitull, Plaku M. Rasëll Ballard na kujton se ne duhet të vendosim qëllime dhe të mësojmë si të përvetësojmë teknikat e të jetuarit për të arritur qëllimet (shih *Predikoni Ungjillin Tim: Një udhëzues për Shërbimin Misionar* [2004], f. 146). Përvetësimi i teknikave të nevojshme për të arritur qëllimet tona përfshin aftësimin në përdorimin e kohës sonë.

Unë jam mirënjohës për shembullin e Presidentit Tomas S. Monson. Me gjithçka që bën si profet i Perëndisë, ai garanton, ashtu siç bëri Shpëtimtari, se ka ende kohë të mjaftueshme për të vizituar të sëmurët (shih Lluca 17:12–14), për të lartësuar ata që janë të shkurajuar dhe për t’u bërë shërbëtor i të gjithëve. Unë jam mirënjohës gjithashtu, për shembullin e shumë të tjerëve që japin nga koha e tyre në shërbim të bashkëqenieve të tyre. Unë dëshmoj se dhënia e kohës sonë për t’u shërbyer të tjerëve, e kënaq Perëndinë dhe duke bërë kështu, ne do të afrohem më shumë me Të. Shpëtimtari ynë do t’i përmbahet fjalës së Tij se “ai që është besnik dhe i mençur në kohë, llogaritet

i denjë për të trashëguar banesat e përgatitura për të prej Atit tim” (DeB 72:4).

Koha kurrë nuk shitet; pavarësisht sa mund të përpiqeni, koha është një artikull që nuk mund të blihet në asnjë dyqan me asnjë lloj çmimi, por nëse përdoret me mençuri, vlera e saj është aq e madhe sa që nuk mund të matet. Sidoqoftë kur koha përdoret me mençuri, vlera e saj është e pamatshme. Në çdo ditë të dhënë ne të gjithëve na janë caktuar, pa asnjë pagesë, sasi të njëjta minutash dhe orësh për t’i përdorur dhe shpejt ne mësojmë, siç na mëson himni i njohur me kaq maturi, “koha fluturon mbi krahët e dritës; ne nuk mund ta kthejmë më” (“Improve the Shining Moments” *Hymns*, nr. 226). Ne duhet ta përdorim me mençuri kohën që kemi. Presidenti Brigham Jang tha: “Ne jemi të gjithë borxhlinj ndaj Perëndisë për aftësinë e përdorimit të kohës për të përfituar dhe ai do të kërkojë llogari të dreptë për përdorimin e [saj]” (*Teachings of Presidents of the Church: Brigham Young* [1997], f. 286).

Me gjërat që na kërkohen, ne duhet të mësojmë t’i ndajmë zgjedhjet tona sipas përparësive, që ato të përputhen me qëllimet tona ose të rrezikojmë t’i dorëzohemi zvarritjes dhe ta shpenzojmë

kohën tonë me shumë aktivitete që e çojnë dëm atë. Neve na janë mësuar shumë mirë përparësitë nga Mësuesi Mjeshtër kur ai shpalli në Predikimin e Tij në mal: “Si rrjedhim, mos kërkonti gjërat e kësaj bote, por para së gjithash kërkonti të ndërtoni mbretërinë e Perëndisë dhe të vendosni drejtësinë e tij” (Mateu 6:33, shënim nga Përkthimi prej Joseph Smithit, Mateu 6:38). (Shih edhe Dallin H. Oaks, “Focus and Priorities”, *Liahona*, korrik 2001, f. 99–102.)

Alma foli për përparësitë kur ai dha mësim se “kjo jetë u bë një gjendje e përkohshme prove; një kohë për t’u përgatitur që të takojmë Perëndinë” (Alma 12:24). Për mënyrën se si ta përdorim më së miri dhuratën e çmuar të kohës që të përgatitemi për të takuar Perëndinë mund të na duhet udhëzim, por me siguri që ne do ta vendosnim Zotin dhe familjet tona në krye të listës së përparësive. Presidenti Diter F. Uhtdorf na kujtoi se “në marrëdhëniet familjare *dashuria* në të vërtetë shqiptohet *k-o-h-ë*” (“Për Gjërat që Kanë më Shumë Rëndësi”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 22). Unë dëshmoj se kur ndihma kërkohet me lutje dhe sinqeritet, Ati ynë Qiellor do të na ndihmojë t’i japim rëndësi asaj që meriton kohën tonë në vend të diçkaje tjetër.

Përdorimi i gabuar i kohës është një kushëri i afërm me përtacinë. Ndërsa zbatojmë urdhrin që të pushojmë së qenuri përtacë (DeB 88:124), ne duhet të jemi të sigurt se kur jemi të zënë jemi edhe frytdhënës. Për shembull, është e mrekullueshme të kesh mjetet e komunikimit të kohës me kuptimin e vërtetë të fjalës në gishtërinjtë tanë, por le të jemi të sigurt që nuk bëhemi fanatikë të komunikimit me gishtërinj. Unë kam përshtypjen se ne kemi ngecur në një varësi të re gllabëruese të kohës – një varësi që na skllavëron që të jemi vazhdimisht duke kontrolluar dhe duke dërguar mesazhe sociale e

megjithatë duke dhënë përshtypjen e rreme se jemi të zënë dhe frytdhënës.

Ka shumë përfitime nga qasja jonë e lehtë në komunikim dhe informacion. Mua më është dukur shumë e dobishme të kem mundësi të bëj kërkime mbi shkrime, biseda të konferencave, regjistrave të paraardhësve dhe të marr mesazhe elektronike, lajmërim nga facebook-u, twitteri dhe mesazhe nëpërmjet telefonit. Sado të mira që janë këto gjëra, ne nuk mund t’i lejojmë ato që të zëvendësojnë gjërat që janë më të rëndësishme. Sa e trishtë do të ishte nëse telefoni dhe kompjuteri, me të gjithë ndërlikimin e tyre, të zëvendësonin thjeshtësinë e një lutjeje të sinqertë ndaj një Ati të dashur në Qiell. Le të jemi aq të gatshëm për t’u gjuhëzuar sa jemi për të dërguar mesazhe.

Lojërat elektronike dhe marrëdhëniet në internet nuk janë zëvendësues të qëndrueshëm të miqve të vërtetë që mund të japin një përqafim inkurajues, që mund të luten për ne dhe të kërkojnë më të mirën për ne. Sa mirënjohës kam qenë që kam parë anëtarët e kuorumit, orëve mësimore dhe të Shoqatës së Ndihmës të bashkohen për të mbështetur njëri-tjetrin. Në të tilla raste, e kam kuptuar më mirë se çfarë kishte ndër mend apostulli Pal kur tha: “Ju pra nuk jeni më të huaj, as bujtës, por bashkëqytetarë të shenjtoreve” (Efesianëve 2:19).

Unë e di se lumturia jonë më e madhe vjen kur ne e përqendrojmë vëmendjen tonë te Zoti (shih Alma 37:37) dhe tek ato gjëra që sjellin një shpërblim që zgjat, në vend që ta përqendrojmë vëmendjen tonë në mënyrë të pamend tek përdorimi i mediave virtuale, kopshtaria në internet dhe videolojëra të tjera. Unë e nxis çdonjërin prej nesh që t’i marrim ato gjëra që na vjedhin nga koha jonë e çmuar dhe të vendosim t’i zotërojmë ato, në vend që të lejojmë që

nëpërmjet natyrës së tyre varësuese të na zotërojnë ato ne.

Që të kemi paqen për të cilën flet Shpëtimtari (shih Gjoni 14:27), ne duhet t’ia përkushtojmë kohën tonë gjërave që kanë më shumë rëndësi dhe gjërat e Perëndisë kanë më shumë rëndësi. Ndërsa ne komunikojmë në lutje të sinqertë me Perëndinë, lexojmë dhe studiojmë çdo ditë nga shkrimet, meditojmë mbi atë që kemi lexuar e ndier dhe më pas, i zbatojmë e i jetojmë mësimet që mësuam, ne do të afrohem më shumë me Perëndinë. Premtimi i Perëndisë është se kur ne kërkojmë me zell nga librat më të mirë “[Ai] do t’ju japë juve dituri me anë të Shpirtit të tij të Shenjtë” (DeB 121:26; shih edhe DeB 109:14–15).

Satani do të na tundojë që ne ta keqpërdorim kohën tonë me zbatim të maskuara. Megjithëse do të ketë tundime, Plaku Kuentin L. Kuk dha mësim se “shenjtoret që i përgjigjen mesazhit të Shpëtimtarit, nuk do të drejtohen kurrë në rrugë të gabuar nga aktivitete hutuese e shkatërruese” (“Are You a Saint?” *Liahona*, nëntor 2003, f. 96). Hiram Pejxh, një nga tetë dëshmitarët e Librit të Mormomit, na mësoi një mësim me vlerë rreth aktiviteteve hutuese. Ai pati njëfarë guri dhe duke e parë atë

Salvador në Brazil



ai shënoi ato që mendonte se ishin zbulues për Kishën (shih DeB 28). Pasi u qortua, një tregim thotë se guri u mor dhe u gropos nën dhe që të mos bëhej më kurrë një aktivitet hutues.¹ Unë e ftoj secilin prej nesh që të gjejë cilat janë aktivitetet që e çojnë dëm kohën në jetën tonë të cilat duhet t'i groposim nën dhe në mënyrë figurative. Neve do të na duhet të jemi të mençur në gjykimin tonë për t'u siguruar se mënyra se si ne e përdorim kohën tonë është e ekuilibruar mjaftueshëm që të përfshijë Zotin, familjen, punën dhe aktivitete të shëndosha argëtuese. Ashtu siç shumë e kanë zbuluar tashmë, ka një shtim të lumturisë në jetë kur ne e përdorim kohën për të kërkuara ato gjëra që janë "të virtytshme, të dashura ose me famë të mirë apo të denj[a] për t'u lavdëruar" (Nenet e Besimit 1:13).

Koha kalon shumë shpejt. Sot do të ishte një ditë e mirë, ndërkohë që koha e jetës sonë në tokë kalon, që të rishikojmë se çfarë po bëjmë që të përgatitemi për të takuar Perëndinë. Unë dëshmoj se shpërblime të mëdha i presin ata që e përdorin kohën e jetës tokësore për t'u përgatitur për pavdekshmërinë dhe jetën e përjetshme. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIM

1. Shih Procesverbalet e Përgjithshme të Kunjtit të Jutas, 6 prill 1856, Vëll. 10 (1855–1860), Church History Library, Salt Lake City, f. 273 (shqiptimi, pikësimi dhe shkronjat kapitale të ndryshuara): "Plaku [Emer] Harris tha se Apostulli kishte thënë se ne duhet të luftojmë kundër principatave dhe pushteteve në vendet qiellore. Vëllai Hiram Page gërmoi dhe nxori nga toka një gur të zi [dhe] e futi në xhep. Kur u kthye në shtëpi, ai i hodhi një vështrim gurit. Guri kishte një fjali të shkruar mbi një letër që e shoqëronte. Sapo ai shkroi një fjali, një fjali tjetër u shfaq në gur, derisa ai shkroi 16 faqe. Vëllait Jozef iu tregua rreth këtij fakti. Një njeri e pyeti Jozefin nëse ishte e drejtë. Ai tha se nuk e dinte, por ai u lut dhe mori zbulësë se guri ishte nga djalli. Pastaj guri u shkërmoq në pluhur dhe shkrimet u dogjën. Ajo ishte punë e fuqisë së errësirës. Amen."



Nga Plaku Karl B. Kuk,
i Të Shtatëdhjetëve

Është më Mirë të Shohim Lart

Në qoftë se ne, si Presidenti Monson, e ushtrojmë besimin tonë dhe kërkojmë te Perëndia për ndihmë, nuk do të pushtohemi nga barrat e jetës.

Në fund të një dite veçanërisht të lodhshme drejt përfundimit të javës time të parë si një Autoritet i Përgjithshëm, çanta ime ishte e mbingarkuar dhe mendja ime shqetësohej nga pyetja: "Vallë, si mund ta bëj unë këtë?" U largova nga zyra e Të Shtatëdhjetëve dhe hyra në ashensorin e Ndërtesës së Administratës së Kishës. Ndërsa ashensori zbriti, e kisha kokën të ulur dhe shihja ngultas, me vështrim të zbrazët, në dysheme.

Dera u hap dhe dikush hyri, por unë nuk i ngrita sytë. Pasi dera u mbyll, dëgjova dikë të më pyeste: "Çfarë je duke parë atje poshtë?" E njoha atë zë—ishte Presidenti Tomas S. Monson.

Shpejt ngrita sytë dhe iu përgjigja: "Oh, asgjë". (Unë jam i sigurt se ai reagim i zgjuar frymëzoi mirëbesim në aftësitë e mia!)

Por ai kishte parë fytyrën time të ndrydhur dhe çantën time të rëndë. Ndërsa ishte duke treguar me gisht drejt qiellit, ai buzëqeshi dhe me përzemërsi sugjeroi: "Është më mirë të shohësh lart!" Ndërsa zbritëm një kat më poshtë, ai më shpjegoi me gëzim se ishte rrugës për në tempull. Kur

më uroi rrugë të mbarë, shikimi i tij i fundit i foli përsëri zemrës sime: "Tani, kujto, është më mirë të shohësh lart".

Kur u ndamë, më erdhën në mendje fjalët e një shkrimi të shenjtë: "Besoni në Perëndinë; besoni se ai është . . . ; besoni se ai ka të gjithë diturinë dhe të gjithë fuqinë, si në qiell ashtu edhe në tokë"¹. Ndërsa mendova për fuqinë e Atit Qiellor dhe të Jezu Krishtit, zemra ime gjeti ngushëllimin që unë kërkoja më kot nga dyshemeja e atij ashensori në zbritje.

Qysh atëherë unë e kam menduar këtë përvojë dhe rolin e profetëve. Unë isha i ngarkuar dhe koka ime ishte e ulur. Kur profeti foli, unë pashë nga ai. Ai ridrejtoi përqendrimin tim për t'i ngritur sytë lart te Perëndia, ku unë mund të shërohesha dhe forcohesha nëpërmjet Shlyerjes së Krishtit. Kjo është ajo çfarë profetët bëjnë për ne. Ata na drejojnë te Perëndia.²

Unë dëshmoj se Presidenti Monson nuk është vetëm një profet, shikues dhe zbulues; ai është gjithashtu një shembull i mrekullueshëm i të jetuarit të parimit të të parit lart. Sikurse të gjithë njerëzit, ai mund të ndihej i rënduar nga përgjegjësitë e tij. Në vend të kësaj,

ai ushtron besim të madh dhe është i mbushur me optimizëm, mençuri dhe dashuri për të tjerët. Sjellja e tij është ajo që “mund të bëjmë” dhe “do të bëjmë”. Ai i beson Zotit e mbështetet tek Ai për forcë dhe Zoti e bekon atë.

Përvoja më ka mësuar se, në qoftë se ne, si Presidenti Monson, e ushtrojmë besimin tonë dhe kërkojmë te Perëndia për ndihmë, ne nuk do të pushtohemi nga barrat e jetës. Ne nuk do ndihemi të paafte në bërjen e asaj që jemi thirrur për të bërë ose duhet të bëjmë. Ne do të forcohemi dhe jetët tona do të jenë të mbushura me paqe dhe gëzim.³ Ne do të arrijmë të kujtojmë se shumica e asaj për të cilën shqetësohemi nuk është me rëndësi të përgjeshme – dhe, nëse është, Zoti do të na ndihmojë. Por ne duhet të kemi besimin për të parë lart dhe guximin për të ndjekur drejtimin e Tij.

Pse të shohësh lart vazhdimisht është një sfidë në jetën tonë? Ndoshta ne nuk kemi besimin se një veprim kaq i thjeshtë mund të zgjidhë problemet tona. Për shembull, kur bijtë e Izraelit u kafshuan nga gjarpërinj helmues, Moisiu u urdhërua të ngrinte një gjarpër prej bronzi në një shtizë. Gjarpri prej bronzi përfaqësonte Krishtin. Ata që panë te gjarpri, siç u paralajmëruan nga profeti, u shëruan.⁴ Por shumë të tjerë nuk panë dhe mbaruan.⁵

Alma ishte dakord se arsyeja pse izraelitët nuk panë te gjarpri ishte se ata nuk besonin se nëse do të vepronin ashtu do të shëroheshin. Fjalët e Almës janë të përshtatshme për ne sot:

“O vëllezër të mi, në qoftë se ju mund të shëroheshit vetëm duke i hedhur sytë diçkaje që të shëroheshit, a nuk do t’i hidhni sytë me të shpejtë, apo do të ngurtësonit zemrat tuaja në mosbesim dhe do të ishit përtacë . . . ?

Në qoftë se është kështu; mjerimi do të vijë mbi ju; por në qoftë se jo, atëherë hidhni sytë dhe filloni të



besoni në Birin e Perëndisë, se ai do të vijë të shëlbejë popullin e tij dhe se ai do të vuajë dhe do të vdesë që të shlyejë mëkatet [tona]; dhe se ai do të ngrihet përsëri nga të vdekurit.”⁶

Inkurajimi i Presidentit Monson për të parë lart është një metaforë për të kujtuar Krishtin. Kur kujtojmë Atë dhe besojmë në fuqinë e Tij, ne marrim forcë nëpërmjet Shlyerjes së Tij. Kjo është mënyra përmes së cilës ne mund të lirohemi nga shqetësimet, barrat dhe vuajtjet tona. Kjo është mënyra përmes së cilës ne mund të falemë dhe të shërohemi nga dhimbja e mëkateve tona. Kjo është mënyra përmes së cilës ne mund të marrim besim dhe forcë për të duruar të gjitha gjërat.⁷

Kohët e fundit, unë dhe Motra Kuk morëm pjesë në konferencën e grave në Afrikën e Jugut. Pasi dëgjuam disa mesazhe frymëzuese mbi zbatimin e Shlyerjes në jetën tonë, presidentja e Shoqatës së Ndihmës e kunjit ftoi çdonjërin të dilte jashtë. Secilit prej nesh iu dha një tullumbace me helium. Ajo shpjegoi se tullumbacja jonë përfaqësonite çfarëdo barre, sprove ose vështirësie që ishte duke na frenuar në jetën tonë. Pas numërimit deri në tre, ne i lëshuam tullumbacet tona, ose “barrat” tona. Ndërsa hodhëm sytë lart dhe pamë barrat tona të “fluturonin”, atje u dëgjua një “ahhhh”. Ai veprim i thjeshtë i lëshimit të tullumbaceve tona dha një

kujtesë të mahnitshme të gëzimit të papërshtueshëm që vjen nga të parit lart dhe të menduarit për Krishtin.

Ndryshe nga lëshimi i një tullumbaceje me helium, të parit lart shpirtërisht nuk është një përvojë një herëshe. Ne mësojmë nga lutja e sakramentit se ne gjithmonë do ta kujtojmë Atë dhe do të zbatojmë urdhërimet e Tij, që të mund të kemi gjithmonë Shpirtin e Tij me ne çdo ditë për të na drejtuar.⁸

Kur bijtë e Izraelit ishin duke u endur në shkretëtirë, Zoti e drejtoi udhëtimin e tyre çdo ditë ndërsa ata panë tek Ai për drejtim. Te Eksodi lexojmë: “Dhe Zoti shkante para tyre, ditën në një kolonë resh për t’i udhëhequr në rrugë, dhe natën në një kolonë zjarri për t’u bërë atyre dritë”⁹. Drejtimi i Tij ishte i vazhdueshëm dhe unë ju jap juve dëshminë time të përlulur se Zoti mund të bëjë të njëjtën gjë për ne.

Pra, si do të na drejtojë Ai ne sot? Me anë të profetëve, apostujve dhe udhëheqësve të priftërisë dhe përmes ndjenjave që vijnë tek ne pasi kemi derdhur në lutje zemrat dhe shpirtrat tanë për te Ati Qiellor. Ai na drejton ne kur braktisim gjërat e botës, pendohe mi dhe ndryshojmë. Ai na drejton ne kur zbatojmë urdhërimet e Tij dhe përpiqemi të jemi më shumë si Ai. Dhe Ai na drejton ne nëpërmjet Frymës së Shenjtë.¹⁰



Nga Plaku LeGrand R. Kurtis i Riu,
i Të Shtatëdhjetëve

Në mënyrë që të drejtohem i në udhëtimin e jetës dhe të kemi shoqërimin e vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë, ne duhet të kemi “veshin që dëgjon” dhe “syrin që sheh”, të dy të drejtuar lart.¹¹ Ne duhet të veprojmë nën drejtimin që marrim. Ne duhet të shohim lart dhe të veprojmë. Ndërsa veprojmë kështu, unë e di se do të mbushemi me gëzim, sepse Perëndia do që ne të jemi të lumtur.

Ne jemi fëmijët e Atit Qiellor. Ai dëshiron që të jetë pjesë e jetës sonë, për të na bekuar dhe për të na ndihmuar. Ai do të shërojë plagët tona, do të thajë lotët tanë dhe do të na ndihmojë përgjatë shtegut tonë për t’u kthyer në praninë e Tij. Ndërsa shohim tek Ai, Ai do të na drejtojë ne.

*Zoti është drita ime; ndaj pse duhet të kem frikë?
Ditë e natë prania e tij është pranë. . . .
Ai është gëzimi im dhe kënga ime.
Ditë e natë ai më drejton . . . mua përpara.¹²*

Unë jap dëshminë se mëkatet tona falen dhe barrat tona lehtësohen ndërsa ne shohim te Krishti. “Le ta kujtojmë atë, . . . dhe të mos ulim kokat tona”¹³, pasi, sikurse Presidenti Monson tha: “Është më mirë të shohim lart”.

Unë dëshmoj se Jezusi është Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Mosia 4:9.
2. Shih 2 Nefi 25:23, 26.
3. Shih Mosia 24:15.
4. Shih Numrat 21:8–9.
5. Shih 1 Nefi 17:41.
6. Alma 33:21–22; shih gjithashtu vargjet 19–20.
7. Shih Alma 36:3, 17–21; 3 Nefi 9:13.
8. Shih Doktrina e Besëlidhje 20:77.
9. Eksodi 13:21.
10. Shih 2 Nefi 9:52; 31:13; Doktrina e Besëlidhje 121:46.
11. Fjalët e Urta 20:12.
12. “The Lord Is My Light”, *Hymns*, nr. 89.
13. 2 Nefi 10:20.

Shëlbimi

Me anë të Krishtit, njerëzit munden dhe e ndryshojnë jetën e tyre si dhe marrin shëlbim.

Ka emra të ndryshëm që përdoren për t’u referuar Zotit Jezu Krisht. Këta emra na bëjnë mendjemprenhtë ndaj aspekteve të ndryshme të misionit shlyes të Zotit. Për shembull, marrim titullin “Shpëtimtar”. Ne të gjithë e kemi një kuptim të asaj se çfarë do të thotë të jesh i shpëtuar, sepse secili prej nesh ka shpëtuar në një kohë nga diçka. Kur ishim fëmijë, unë dhe motra ime ishim duke luajtur mbi lumë, brenda një varke të vogël kur në mënyrë të pamend u larguam nga vendi ynë i sigurt i lojës dhe e gjetëm veten duke u shtyrë nga rryma në drejtim të rreziqeve të panjohura. Për shkak të klithmave tona, ati ynë vrapoi për të na shpëtuar, duke na ruajtur nga rreziqet e lumit. Kur mendoj për shpëtimin, mendoj për atë përvojë.

Titulli “Shëlbues” jep njohuri të ngjashme. “Të shëlbesh” do të thotë të blesh ose riblesh. Si një çështje ligjore, prona shpengohet duke paguar plotësisht hipotekën ose barra të tjera për të. Në kohët e Dhiatës së Vjetër, ligji i Moisiut siguronte mënyra të tjera se si shërbëtorët dhe prona të mund të liroheshin, ose shpengoheshin, nëpërmjet pagimit të të hollave (shih Levitiku 25:29–32, 48–55).

Një përdorim i spikatur i shkrimeve të shenjta për fjalën *shëlbim* lidhet me çlirimin e bijve të Izraelit nga robëria

e tyre në Egjipt. Pas atij çlirimi, Moisiu u tha atyre: “Sepse Zoti ju do, . . . [Ai] ju nxori me një dorë të fuqishme dhe ju shpëtoi nga shtëpia e skllavërisë, nga dora e Faraonit, mbretit të Egjiptit” (Ligji i Përtërirë 7:8).

Tema e Jehovahit duke çliruar popullin e Izraelit nga robëria është përsëritur shumë herë në shkrimet e shenjta. Shpesh, kjo është bërë për të kujtuar njerëzit për mirësinë e Zotit në çlirimin e bijve të Izraelit nga egjiptianët. Por gjithashtu, është bërë për t’u mësuar atyre se do të kishte një shëlbim tjetër më të rëndësishëm për Izraelin. Lehi mësoi: “Dhe Mesia vjen në plotësinë e kohës, që ai të mund t’i shëlbëjë fëmijët e njerëzve nga rënia” (2 Nefi 2:26).

Psalmist i shkroi: “Por Perëndia im do ta shpengojë shpirtin tim nga pushteti i Sheolit” (Psalmëve 49:15).

Zoti deklaroi nëpërmjet Isaia: “I fshiva shkeljet e tua si një re e dendur, dhe mëkatet e tua si një mjegullinë; kthehu tek unë, sepse unë të kam çliruar” (Isaia 44:22).

Sigurisht, shëlbimi i përmendur në këto tri shkrime të shenjta është Shlyerja e Jezu Krishtit. Ky është “shpëtim[i] plotë”, dhënë nga Perëndia ynë i dashur (Psalmëve 130:7). Ndryshe nga shëlbimet sipas ligjit të Moisiut ose në marrëveshjet ligjore moderne,



ky shëlbim nuk vjen nga “gjëra[t] që prishen, si argjendi ose ari” (1 Pjetrit 1:18). “Në [Krishtin] kemi shpengimin me anë të gjakut të tij, faljen e mëkateve sipas pasurisë së hirit të tij” (Efesianëve 1:7). Presidenti Xhon Teilor na mësoi se për shkak të sakrificës së Shëlbuesit, “borxhi është paguar, shëlbimi është kryer, besëlidhja është bërë, drejtësia është plotësuar, vullneti i Perëndisë është përmbushur dhe e gjithë fuqia është . . . dhënë në duart e Birit të Perëndisë” (*Teachings of Presidents of the Church: John Taylor* [2001], f. 44).

Pasojat e këtij shëlbimi përfshijnë mposhtjen e vdekjes fizike për të gjithë fëmijët e Perëndisë. Që do të thotë se, vdekja tokësore është mposhtur dhe të gjithë do të ringjallen. Një aspekt tjetër i këtij shëlbimi me anë të Krishtit, është fitorja mbi vdekjen shpirtërore. Nëpërmjet vuajtjes dhe vdekjes së Tij, Krishti pagoi për mëkatet e të gjithë njerëzimit me kusht pendimin individual.

Si rrjedhim, nëse pendohemi, ne mund të falemi për mëkatet tona, çmimi është paguar nga Shëlbuesi ynë. Ky është lajm i mirë për të gjithë ne, “sepse të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë”

(Romakëve 3:23). Ata, të cilët janë larguar në mënyrë të konsiderueshme nga shtigjet e drejtësisë, kanë nevojë dëshpërimisht për këtë shëlbim dhe, nëse pendohen plotësisht, ata mund ta marrin atë. Por edhe ata që kanë punuar shumë për të jetuar një jetë të mirë, gjithashtu kanë nevojë dëshpërimisht për këtë shëlbim, pasi askush nuk mund të shkojë në praninë e Atit pa ndihmën e Krishtit. Për pasojë, ky shëlbim i dashur lejon ligjet e drejtësisë dhe mëshirës të përmbushen në jetën e të gjithë atyre që pendohen dhe ndjekin Krishtin.

*Sa i madh, i lavdishëm dhe i plot,
Plani i shëlbimit t’ij,
ku drejtësia e mëshira
jan’ në harmoni!
“Oh, sa Urti dhe Dashuri”, Himne
dhe Këngë të Fëmijëve, nr. 19)*

Presidenti Bojd K. Paker dha mësim: “Ka një Shëlbues, një Ndërmjetës, i cili qëndron si i gatshëm edhe i aftë për të plotësuar kërkesat e drejtësisë dhe për të shtrirë mëshirën tek ata që janë penduar” (“The Mediator”, *Ensign*, maj 1977, f. 56).

Shkrimet e shenjta, shkrime të tjera të ndryshme dhe përvojat e jetës janë

të mbushura me histori për shëlbimin. Me anë të Krishtit, njerëzit mundën dhe e ndryshojnë jetën e tyre dhe marrin shëlbim. Më pëlqejnë shumë historitë për shëlbimin.

Unë kam një mik, i cili nuk i ndoqi mësimet e Kishës në rininë e tij. Kur ishte i ri në moshë madhore, ai e kuptoi se çfarë kishte humbur nga të mos jetuarit e ungjillit. Ai u pendua, ndryshoi jetën e tij dhe ia përkushtoi veten të jetuarit të drejtë. Një ditë, vite pas shoqërisë tonë në rini, e takova në tempull. Unë mund të shihja në sytë e tij se ai e jetonte ungjillin dhe e ndieva se ai ishte anëtar i përkushtuar i Kishës që përpiquej ta jetonte plotësisht ungjillin. Historia e tij është një histori shëlbimi.

Një herë unë intervistova një grua për pagëzim, e cila kishte qenë fajtoreshë për një mëkat shumë të rëndë. Gjatë intervistës e pyeta nëse ajo e kuptoi se nuk mund ta përsëriste më atë mëkat. Me emocion të thellë në sy dhe në zërin e saj, ajo tha: “Oh President, unë kurrë nuk do mundja ta bëja përsëri atë mëkat. Kjo është arsyeja pse unë dua të pagëzohem – të pastrohem nga pasojat e atij mëkati të tmerrshëm.” Rasti i saj është një histori shëlbimi.

Në vitet e fundit, ndërsa kam vizituar konferenca të kunjeve dhe mbledhje të

tjera, unë kam kujtuar sfidën e Presidentit Tomas S. Monson për të shpëtuuar anëtarët më pak aktivë të Kishës. Në një konferencë kunji, unë tregova historinë e një anëtari më pak aktiv, i cili u kthye në aktivitet të plotë pasi peshkopi i tij dhe udhëheqës të tjerë e vizituan atë në shtëpinë e tij, i thanë se kishin nevojë për të dhe e thirrën për të shërbyer në lagje. Burri në këtë histori, jo vetëm që e pranoi thirrjen por edhe ndryshoi jetën e zakonet e tij dhe u bë plotësisht aktiv në Kishë.

Një miku im ishte në mbledhjen në të cilën unë ndava atë histori. Shprehia e fytyrës së tij ndryshoi dukshëm ndërsa u tregua historia. Ditën tjetër ai më dërgoi një mesazh elektronik, duke më thënë se reagimi i tij emocional ndaj historisë erdhi për arsye se historia e kthimit të vjehrrit të tij në aktivitet në Kishë ishte shumë e ngjashme me atë që unë kisha treguar. Ai më tha se si rezultat i një vizite të ngjashme nga një peshkop dhe një ftese për të shërbyer në Kishë, vjehri i tij e rivlerësoi jetën dhe dëshminë e tij, bëri ndryshime të mëdha në jetë dhe e pranoi thirrjen. Ai burrë i riaktivizuar tani ka 88 pasardhës të cilët janë anëtarë aktivë të Kishës.

Në një mbledhje disa ditë më vonë, unë i ndava të dyja historitë. Të nesërmen unë mora një tjetër mesazh elektronik i cili fillonte kështu: “Kjo është historia e babait tim gjithashtu”. Ai mesazh elektronik nga një president kunji, tregoi se si babai i tij ishte ftuar për të shërbyer në Kishë, edhe pse ai nuk kishte qenë aktiv dhe kishte pasur disa vese që duheshin ndryshuar. Ai e pranoi thirrjen dhe gjatë procesit u pendua, pastaj shërbeu si president kunji e më vonë si president misioni dhe hodhi themelet për pasardhësit e tij që ata të ishin anëtarë besnikë të Kishës.

Disa javë më vonë, unë i tregova të tria historitë në një konferencë tjetër



kunji. Pas mbledhjes, një burrë erdhi tek unë dhe më tha se ajo nuk ishte historia e babait të tij. Ajo ishte historia e tij. Ai më tregoi për ngjarjet që e bënë atë të pendohej dhe të kthehej përsëri në përfshirjen e plotë në Kishë. Dhe kështu shkoi. Ndërsa kisha thirrjen për të shpëtuar më pak aktivët, unë dëgjova histori pas historie të njerëzve që u ishin përgjigjur ftesave për t'u kthyer përsëri dhe për të ndryshuar jetën e tyre. Unë dëgjova vazhdimisht histori për shëlbimin.

Edhe pse ne kurrë nuk mund t'ia kthejmë Shëlbuesit atë që Ai pagoi në emrin tonë, plani i shëlbimit kërkon që me përpjekjet tona më të mira të pendohejmë plotësisht dhe të bëjmë vullnetin e Perëndisë. Apostulli Orson F. Uitin shkroi:

*“Shpëtimtari, Shëlbuesi i shpirtit tim,
duart e fuqishme të të Cilit më kanë
bërë të plotë,
fuqia e mrekullueshme e të Cilit më
ngriti lart
dhe ma mbushi kupën e hidhur me
ëmbëlsi!”*

*Cila gjuhë mund ta tregojë
mirënjohjen time,
O Perëndi shpirtmirë i Izraelit.*

*Kurrë nuk mund të ta shlyej
borxhin, Zot,
por mund të të dua ty. Fjalët e tua
të pastra,
a nuk janë i vetmi adhurimi im,
gëzimi im gjatë ditës, ëndrra ime
gjatë natës?*

*Ndaj lëre buzën time ta shpallë
atë përsëri
dhe gjithë jeta ime të reflektojë
vullnetin tënd.”*

*(“Savior, Redeemer of My Soul”
[“Shpëtimtari, Shëlbuesi i Shpirtit
Tim”], Hymns, nr. 112)*

Unë jap dëshminë time për fuqinë e Shlyerjes së Krishtit. Kur ne pendohejmë dhe vijmë tek Ai, ne mund të marrim të gjitha bekimet e jetës së përjetshme. Që ne të mund ta bëjmë këtë, të marrim historinë tonë të shëlbimit, është lutja ime në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Plaku D. Tod Kristoferson,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Dhurata Hyjnore e Pendimit

Vetëm nëpërmjet pendimit ne fitojmë të drejtën për hirin shlyes të Jezu Krishtit.

Libri i Mormonit përmban rrëfim për një njeri të quajtur Nehor. Është e lehtë të kuptohet përse Mormoni, duke përmbledhur një mijë vite të dokumentimeve nefite, e mendoi si të rëndësishme të përfshinte diçka lidhur me këtë njeri dhe ndikimin e zgjatur të doktrinës së tij. Mormoni po kërkonte të na paralajmëronte, duke e ditur që kjo filozofi do të rishfaqej në kohën tonë.

Nehori u shfaq në skenë rreth 90 vjet para lindjes së Krishtit. Ai mësonte “se i gjithë njerëzimi duhet të shpëtohet ditën e fundit . . . ; pasi Zoti kishte krijuar të gjithë njerëzit dhe kishte shëlbuar gjithashtu të gjithë njerëzit dhe në fund të gjithë njerëzit do të kishin jetë të përjetshme” (Alma 1:4).

Rreth 15 vjet më vonë, Korihori erdhi mes nefitëve duke predikuar e përforcuar doktrinën e Nehorit. Libri i Mormonit shënon se “ai ishte Antikrisht, pasi filloi t’u predikonte njerëzve kundër profecive . . . në lidhje me ardhjen e Krishtit” (Alma 30:6). Predikimi i Korihorit e kishte thelbin “se nuk mund të bëhet asnjë shlyerje për mëkatet e njerëzve, por që çdo njeri e kalonte këtë jetë sipas mënyrës së tij të sjelljes; prandaj çdo njeri përparonte

sipas gjenisë së tij dhe se çdo njeri fitonte sipas fuqisë së tij; dhe çdo gjë që një njeri bënte nuk ishte krim” (Alma 30:17). Këta profetë të rremë dhe pasesit e tyre “nuk besonin në pendimin e mëkateve të tyre” (Alma 15:15).

Sikurse në ditët e Nehorit dhe të Korihorit, ne jetojmë në një kohë jo shumë përpara ardhjes së Jezu Krishtit – në rastin tonë, koha e përgatitjes për Ardhjen e Tij të Dytë. Dhe, në ngjashmëri, mesazhi i pendimit shpesh nuk mirëpritet. Disa pretendojnë që, nëse ka Perëndi, Ai nuk ka kërkesa të vërteta ndaj nesh (shih Alma 18:5). Të tjerë, sot pretendojnë se një Perëndi i përzemërt e fal të gjithë mëkatën në bazë të një rrëfimi të thjeshtë ose, në rast se ka me të vërtetë ndëshkim për mëkatën, “Perëndia do të na qëllojë pak me kamxhik dhe në fund ne do të shpëtohem në mbretërinë e Perëndisë” (2 Nefi 28:8). Të tjerë, njësoj me Korihorin, mohojnë madje ekzistencën e Krishtit dhe çfarëdo gjëje të tillë si mëkati. Doktrina e tyre është se vlerat, standardet dhe madje e vërteta janë të gjitha relative. Si rrjedhojë, çfarëdo që dikush mendon se është e drejtë për të, nuk mund të gjykohet prej të tjerëve e gabuar ose mëkatare.

Në sipërfaqe filozofi të tilla duken tërheqëse, ngaqë ato na japin lejë për të kënaqur çdo oreks ose dëshirë pavarësisht nga pasojat. Duke përdorur mësime të Nehorit dhe Korihorit ne mund të përligjim e të justifikojmë çdo gjë. Kur profetët vijnë duke thirrur për pendim, kjo “ua ftoh mbrëmjen gazmore” mëkatarëve. Por, në të vërtetë, thirrja profetike duhet të pranohet me gëzim. Pa pendim nuk ka përparim ose përmirësim të vërtetë në jetë. Pretendimi se nuk ekziston mëkati, nuk e pakëson barrën dhe dhembjen e tij. Vuajtja për mëkatën, vetvetiu nuk ndryshon ndonjë gjë për më mirë. Vetëm pendimi të çon tek lartësitë plot diell të një jete më të mirë. Dhe, natyrisht, vetëm nëpërmjet pendimit ne fitojmë të drejtën për hirin shlyes të Jezu Krishtit dhe për shpëtim. Pendimi është një dhuratë hyjnore dhe duhet të na buzëqeshë fytyra kur ne flasim për të. Ai na drejton tek liria, vetëbesimi dhe paqja. Në vend të ndërprerjes së festës, dhurata e pendimit është shkak për kremtim të vërtetë.

Pendimi ekziston si mundësi vetëm për shkak të Shlyerjes së Jezu Krishtit. Është sakrificë e Tij e pafundme ajo që “u sjell njerëzve mjete që ata të mund të kenë besim deri në pendim” (Alma 34:15). Pendimi është kushti i domosdoshëm dhe hiri i Krishtit është fuqia nëpërmjet së cilës “mëshira mund të kënaqë kërkesat e drejtësisë” (Alma 34:16). Dëshmia jonë është kjo:

“Dhe ne e dimë se shfajësimi [ose falja e mëkateve] përmes hirit të Zotit dhe Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht është i drejtë dhe i vërtetë;

Dhe ne e dimë gjithashtu se shenjtërimi [ose pastrimi nga efektet e mëkateve] përmes hirit të Zotit dhe Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht është i drejtë dhe i vërtetë; për të gjithë ata që e duan dhe i shërbejnë Perëndisë me gjithë fuqinë, mendjet dhe forcën

e tyre” (DeB 20:30–31).

Pendimi është një temë e gjerë, por sot do të dëshiroja të përmend vetëm pesë aspekte të këtij parimi themelor të ungjillit, që shpresoj se do të jenë të dobishme.

Së pari, ftesa për t’u penduar është shprehje e dashurisë. Kur Shpëtimtari “filloi të predikojë dhe të thotë: ‘Pendohuni, sepse mbretëria e qiejve është afër!’” (Mateu 4:17), ky ishte një mesazh i dashurisë, që e ftonte gjithkënd që do të dëshironte të përmbushte cilësitë, të bashkohej me Të “dhe të [gëzonte] fjalët e jetës së përjetshme në këtë botë dhe [vetë] jetën e përjetshme në botën që vjen” (Moisiu 6:59). Nëse ne nuk i ftojme të tjerët që të ndryshojnë ose, nëse nuk ia kërkojmë pendimin vetes, ne dëshojmë në një detyrë themelore për të cilën i detyrohemi njëri-tjetrit dhe vetes. Një prind lejues, një mik tolerues, një udhëheqës Kishe i frikshëm, në të vërtetë, janë më të shqetësuar për veten sesa për mbarëvajtjen dhe lumturinë e atyre që ata mund t’i ndihmonin. Po, thirrja në pendim nga njëherë konsiderohet si jotolerante ose fyese dhe madje mund të urrehet, por, e udhëhequr nga Shpirti, ajo në të vërtetë është një akt i përkujdesjes së sinqertë (shih DeB 121:43–44).

Së dyti, pendim do të thotë të përpiqesh të ndryshosh. Do të ishte tallje me vuajtjen e Shpëtimtarit për ne në Kopshtin e Gjetsemanit dhe në kryq, nëse presim që Ai të na shndërrojë në qenie engjëjlore, pa asnjë përpjekje të vërtetë nga ana jonë. Më saktë, ne e kërkojmë hirin e Tij për të plotësuar dhe shpërblyer përpjekjet tona më të zellshme (shih 2 Nefi 25:23). Ndoshta ne, po aq sa lutemi për mëshirë, duhet të lutemi për kohë e mundësi për të vepruar, për t’u përpjekur dhe për të kapërcyer. Sigurisht që Zoti i buzëqesh dikujt që dëshiron të vijë me denjësi te



gjykimi, që punon me vendosmëri ditë për ditë për ta zëvendësuar dobësinë me fuqi. Pendimi i vërtetë, ndryshimi i vërtetë mund të kërkojë përpjekje të përsëritura, por në një përpjekje të tillë ka diçka përpunuese dhe të shenjtë. Falja dhe shërimi hyjnor rrjedhin mjaft natyrshëm te një shpirt i tillë, sepse, në të vërtetë, “virtyti e dashuron virtytin; drita kapet pas dritës [dhe] mëshira ka dhembshuri në mëshirën dhe i kërkon të vetët (DeB 88:40).

Me pendim ne mund të përmirësohemi rregullisht në aftësinë për të jetuar ligjin çelestial, sepse e kuptojmë që “ai që nuk është në gjendje t’i qëndrojmë ligjit të një mbretërie çelestiale, nuk mund të durojë një lavdi çelestiale” (DeB 88:22).

Së treti, pendim do të thotë jo vetëm të braktisësh mëkatën, por edhe të zotohesh për bindje. Bible Dictionary [Fjalori Biblik] bën të ditur: “Pendim do të thotë kthim i zemrës dhe i vullnetit në drejtim të Perëndisë [si edhe] heqje dorë prej mëkatit ndaj të cilit priremi natyrshëm”¹. Njëri nga disa shembujt e këtij mësimi prej Librit të Mormonit, gjendet në fjalët e Almës për një nga bijtë e tij:

“Prandaj, të urdhëroj biri im, në frikën e Perëndisë, që të përmbahesh nga paudhësitë e tua;

Që ti të kthehesh drejt Zotit me tërë mendjen, fuqinë dhe forcën tënde” (Alma 39:12–13; shih edhe Mosia 7:33; 3 Nefi 20:26; Mormoni 9:6).

Që kthimi ynë drejt Zotit të jetë i plotë, duhet të përfshijë asgjë më pak se një besëlidhje për bindje ndaj Tij. Shpeshherë ne flasim për këtë besëlidhje si besëlidhja e pagëzimit, meqenëse ajo dëshmohet duke u pagëzuar në ujë (shih Mosia 18:10). Pagëzimi i vetë Shpëtimtarit, duke dhënë shembullin, ripohoi besëlidhjen e Tij të bindjes ndaj Atit. “Por megjithëse ishte i shenjtë, ai u tregon fëmijëve të njerëzve se, sipas mishit, ai përul veten para Atit dhe i dëshmon Atit se ai do të jetë i bindur ndaj tij, në zbatimin e urdhërimeve të tij” (2 Nefi 31:7). Pa këtë besëlidhje, pendimi mbetet i paplotë dhe heqja e mëkatëve e porealizueshme.² Sipas shprehjes së paharrueshme të Profesor Noel Reynoldsit, “Zgjedhja për t’u penduar është një zgjedhje për të djegur urat në çdo drejtim, [duke vendosur] të ndjekim përgjithmonë vetëm një udhë, shtegun e vetëm që të çon drejt jetës së përjetshme”³.

Së katërti, pendimi kërkon seriozitet në qëllim dhe gatishmëri për të këmbëngulur, madje edhe përmes dhembjes. Përpjekjet për të krijuar një



listë të hapave të veçantë për pendim, mund të jenë të dobishme për disa, por kjo gjithashtu mund të çojë në një trajtim mekanik e formal, pa ndjenjë ose ndryshim të vërtetë. Pendimi i vërtetë nuk është sipërfaqësor. Zoti jep dy kërkesa gjithëpërfshirëse: “Në këtë mënyrë ju mund të dini nëse një njeri pendohet për mëkatet e tij – vini re, ai do t’i rrëfejë ato e do t’i braktisë ato” (DeB 58:43).

Rrëfimi dhe braktisja janë koncepte të fuqishme. Janë shumë më tepër se të thuash me raste: “E pranoj; më vjen keq”. Rrëfimi është një njohje e thellë, nganjëherë pikëlluese, e gabimit dhe e fyerjes ndaj Perëndisë dhe njeriut. Tri-stitim e keqardhje dhe lotë të hidhur shoqërojnë shpesh rrëfimin e dikujt, veçanërisht kur veprimet e veta kanë qenë shkak për dhembjen e tjetërkujt apo, më keq, kanë çuar një tjetër në mëkat. Është ky ankth i thellë, kjo pamje e gjërave ashtu siç ato janë, që e çon dikë, sikurse Alma, të thërrasë: “O Jezus, ti Biri i Perëndisë, ki mëshirë mbi mua që jam në vrerin e hidhësisirës dhe që jam rrethuar nga zinxhirët e përjetshëm të vdekjes” (Alma 36:18).

Me besim tek Shëlbuesi i mëshirshëm dhe fuqia e Tij, dëshpërimi kthehet në shpresë. Ndryshojnë pikërisht zemra dhe dëshirat e dikujt dhe, mëkati dikur tërheqës, bëhet gjithnjë e më i neveritshëm. Një vendosmëri e fortë për të hequr dorë e braktisur mëkatin dhe për të ndrequr sa më

plotësisht që mundet dëmin që ka shkaktuar, zhvillohet tani në atë zemër të re. Kjo vendosmëri shpejt piqet për t’u bërë një besëlidhje e bindjes ndaj Perëndisë. Me vendosjen e asaj besëlidhjeje, Fryma e Shenjtë, lajmë-tari i hirit hyjnor, do të sjellë lehtësim dhe falje. Personi frymëzohet për të shprehur sërish, tok me Almën: “Dhe oh, çfarë gëzimi dhe çfarë drite të mrekullueshme [shoh]; po, shpirti im më [është] mbushur me një gëzim po aq të madh, sa kishte qenë dhembja ime!” (Alma 36:20).

Çdo dhembje e kërkuar nga pendimi do të jetë shumë më pak, sesa vuajtja që kërkohet për të kënaqur drejtësinë për shkeljen e pazgjdhur. Shpëtimtari foli paksa për atë që Ai duroi që të kënaqte kërkesat e drejtësisë dhe të shlyente për mëkatet tona, por Ai bëri këtë deklaratë qartësuese:

“Pasi vër re, unë, Perëndia, i kam vuajtur këto gjëra për të gjithë, që ata të mos vuajnë nëse do të pendohen;

Por nëse nuk do të pendohen, ata duhet të vuajnë po aq sa unë;

Vuajtje që më bëri mua, madje Perëndi, më i madhi i të gjithëve, të dridhem për shkak të dhembjes e të më dalë gjak nga çdo por dhe të vuaj si në trup e në shpirt—dhe të dëshiroj që të mos e pi kupën e hidhur” (DeB 19:16–18).

Së pesti, cilido qoftë çmimi i pendimit, ai përpihet në gëzimin e faljes. Në një fjalim në konferencë të

përgjithshme, të titulluar “The Brilliant Morning of Forgiveness” [“Mëngjesi i Shndritshëm i Faljes”], Presidenti Bojd K. Paker bëri këtë analogji:

“Në prill të 1847-ës, Brigam Jangu udhëhoqi kompaninë e parë të pionierëve e nisur nga Lagjet Dimërore. Në të njëjtën kohë, 2.575 kilometra në perëndim, të mbijetuarit prekës të Doner Partit endeshin në pjerrësitë e Maleve të Sierra-Nevadës në Luginën e Sakramentos.

Ata e kishin kaluar dimrin e egër të zënë në pirqjet e dëborës poshtë majave. Është pothuaj e pabesueshme që ndonjë i mbijetoi ditëve, javëve dhe muajve të mosushyerjes dhe vuajtjes së papërshkrueshme.

Ndër ta ishte pesëmbëdhjetëvjeçari Xhon Brin. Natën e 24 prillit ai po shkonte drejt Fermës së Xhonsonit. Vite më vonë Xhoni shkroi:

‘Vetëm kohë pasi kishte rënë mu-zgu, ne arritëm në Fermën e Xhonsonit, prandaj hera e parë që e pashë ishte mëngjesi herët. Moti ishte i shkëlqyer, toka mbulohej nga bari i gjelbër, zogjtë po këndonin nga majat e pemëve dhe udhëtimi kishte mbaruar. Mezi mund ta besoja që isha gjallë.

Skena që pashë atë mëngjes duket sikur të jetë e fotografuar në mendjen time. Shumica e ngjarjeve kanë ikur nga kujtesa, por përherë arrij të shoh kampin pranë Fermës së Xhonsonit.’”

Presidenti Paker tha: “Në fillim isha shumë në mëdyshje nga thënia e tij se ‘shumica e ngjarjeve kanë ikur nga kujtesa’. Si mundej vallë që muaj të gjatë vuajtjeje dhe pikëllimi të pabesueshëm t’i iknin atij nga mendja? Si mundej ai dimër i errët i vrazhdë të zëvendësohej me një mëngjes të shndritshëm?”

Pasi u mendova më shumë, vendosa që kjo nuk ishte për t’u hutuar aspak. Unë kam parë t’u ndodhë diçka të ngjashme njerëzve që i

kam njohur. Kam parë disa, që kanë kaluar një dimër të gjatë faji dhe mosshqyerjeje shpirtërore, të dalin tek mëngjesi i faljes. Kur erdhi mëngjesi, ata mësuuan këtë:

‘Vini re, ai që është pënuar për mëkatet e tij, po ai falet dhe unë, Zoti, nuk i kujtoj më ato’ [DeB 58:42].⁴

Unë njoh dhe dëshmoj me mirë-njohje që vuajtja e pakapshme, vdekja dhe Ringjallja e Zotit tonë “përmbush kushtin e pendimit” (Helamani 14:18). Dhurata hyjnore e pendimit është çelësi i lumturisë këtu dhe paskëtaj. Me fjalët e Shpëtimtarit dhe me përlësi e dashuri të thellë, unë i ftoj të gjithë të “[pendohen], sepse mbretëria e qiejve është afër!” (Mateu 4:17). Unë e di që me pranimin e kësaj ftese, ju do të gjeni gëzim tani dhe përgjithmonë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Bible Dictionary, “Repentance”.
2. Libri i Mormonit flet në mënyrë të përsëritur për t’u “[pagëzuar] në pendim (shih Mosia 26:22; Alma 5:62; 6:2; 7:14; 8:10; 9:27; 48:19; 49:30; Helamani 3:24; 5:17, 19; 3 Nefi 1:23; 7:24–26; Moroni 8:11). Gjon Pagëzori përdori të njëjtat fjalë (shih Mateu 3:11) dhe Pali foli për “pagëzimin e pendimit” (Veprat e Apostujve 19:4). Kjo shprehje shihet edhe në Doktrina e Besëlidhje (shih DeB 35:5; 107:20). “Pagëzimi i pendimit ose në pendim” thjesht i referohet faktit që pagëzimi me besëlidhjen e tij të bindjes është pika kulmore e pendimit. Me pendimin e plotë, përfshirë pagëzimin, një njeri përmbush cilësitë për vënieën e duarve për dhuratën e Frymës së Shenjtë dhe është pikërisht nëpërmjet Frymës së Shenjtë që dikush merr pagëzimin e Shpirtit (shih Gjoni 3:5) dhe faljen e mëkateve: “Pasi porta nëpër të cilën ju duhet të hyni është pendimi dhe pagëzimi me anë të ujit; dhe pastaj vjen një heqje e mëkateve tuaja me anë të zjarrit dhe me anë të Frymës së Shenjtë” (2 Nefi 31:17).
3. Noel B. Reynolds, “The True Points of My Doctrine”, *Journal of Book of Mormon Studies*, vëll. 5, nr. 2 (1996): 35; kursivet janë theksime.
4. Shih Boyd K. Packer, në Conference Report, tetor 1995, f. 21; shih edhe “The Brilliant Morning of Forgiveness”, *Ensign*, nëntor 1995, f. 18.



Nga Plaku L. Tom Peri,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Dashuria e Përsosur e Nxjerr Jashtë Frikën

Në qoftë se do t’i përgjigjeni ftesës për të ndarë ato çka besoni dhe ndjenjat tuaja rreth ungjillit të rivendosur të Jezu Krishtit, shpirti i dashurisë dhe shpirti i kurajës do të jenë shoqëruesit tuaj të vazhdueshëm.

Presidenti Monson, ne të gjithë jemi të kënaqur me lajmin emocionues për disa tempuj të rinj. Veçanërisht ishte emocionuese për shumë, shumë të afërm në shtetin e Uaiomingut.

Kisha në të gjithë botën bën diçka kur ndërtohet një tempull i ri, që është një traditë mjaft e zakonshme në Shtetet e Bashkuara dhe Kanada – ne mbajmë një shtëpi të hapur. Gjatë javëve, pak përpara dedikimit të një tempulli të ri, ne hapim dyert dhe ftojmë udhëheqësit qeveritarë dhe ata fetarë të zonës, anëtarët e zonës të Kishës dhe njerëz të besimeve të tjera për të ardhur dhe për të vizituar tempullin e ndërtuar rishtas.

Këto janë ngjarje të mrekullueshme që i ndihmojnë personat e panjohur me Kishën të mësojnë pak më shumë për të. Pothuajse të gjithë ata që vizitojnë një tempull të ri, mahnitën si me bukurinë e jashtme dhe me atë të brendshme. Atyre u lë mbresa ustallëku dhe kujdesi ndaj detajit të çdo veçorie të një tempulli. Veç kësaj, shumë nga vizitorët ndiejnë diçka unike dhe të veçantë ndërsa

drejtohen nëpër tempullin e padedikuar. Këto janë përgjigjet e përgjithshme të vizitorëve për shtëpitë tona të hapura, por ato nuk janë përgjigjet më të zakonshme. Ajo që mahnit më shumë se çdo gjë tjetër shumë vizitorë janë anëtarët e Kishës që takojnë në shtëpitë tona të hapura. Vizitorët largohen përgjithmonë të mahnitur nga mikpritësit e tyre, shenjtorët e ditëve të mëvonshme.

Kishës nëpër botë po i kushtohet më shumë vëmendje se kurrë më parë. Pjesëmarrës të mediave shkruajnë ose flasin për Kishën çdo ditë, duke raportuar mbi aktivitetet e saj të shumta. Shumë nga mediat më të mirënjohura në Shtetet e Bashkuara diskutojnë rregullisht për Kishën ose anëtarët e saj. Këto diskutime po ndodhin gjithashtu në të gjithë botën.

Kisha gjithashtu tërheq vëmendjen në internet, që, siç e dini, ka ndryshuar rrënjësisht mënyrën se si njerëzit shkëmbejnë informacion. Në çdo kohë të ditës në të gjithë botën, Kisha dhe mësimet e saj janë duke u diskutuar në internet, në blogje dhe



rrjete sociale nga njerëz që kurrë nuk kanë shkruar për një gazetë ose revistë. Ata janë duke bërë video dhe duke i vendosur ato në internet. Këta janë njerëz të zakonshëm – si anëtarë të besimit tonë edhe të besimeve të tjera – të cilët po flasin rreth Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Ndryshimet në mënyrën se si komunikojnë shpjegojnë pjesërisht përse ne “mormonët” jemi më të përmendur se kurrë. Por Kisha gjithashtu, është në rritje dhe duke ecur përpara. Shumë njerëz, kanë fqinj dhe miq anëtarë të Kishës dhe këta janë anëtarë të njohur të Kishës në qeveri, në biznes, në industrinë e argëtimit, në arsim dhe gjithkund tjetër, kjo duket. Edhe ata të cilët nuk janë anëtarë të Kishës, e kanë vënë re këtë dhe pyesin veten se çfarë po ndodh. Është e mrekullueshme që kaq shumë njerëz tashmë janë të informuar për Kishën dhe shenjtorët e ditëve të mëvonshme.

Ndërkohë që Kisha po bëhet më e dukshme, ka ende shumë njerëz të cilët nuk e kuptojnë atë. Disa njerëzve u është mësuar të jenë dyshues për Kishën, të besojnë stereotipe negative rreth Kishës pa pyetur për burimin dhe bazueshmërinë e informacionit. Ekziston edhe një keqinformim dhe ngatërrësë e madhe për atë se çfarë është Kisha dhe çfarë ajo përfaqëson. Kjo ka qenë e vërtetë që nga koha e Profetit Jozef Smith.

Jozef Smithi e shkroi këtë histori pjesërisht “për të korrigjuar mendjen publike dhe për t’i vendosur të gjithë kërkuesit e së vërtetës në zotërim të fakteve” (Joseph Smith – Historia 1:1). Është e vërtetë se do të ketë gjithmonë nga ata që do ta

shtrembërojnë të vërtetën dhe qëllimisht do të paraqesin ndryshe mësimet e Kishës. Por pjesa më e madhe e atyre që kanë pyetje në lidhje me Kishën, vetëm duan të kuptojnë. Këta njerëz me mendje jo të keqe janë me të vërtetë kureshtarë për ne.

Dukshmëria dhe reputacioni në rritje i Kishës përfaqësojnë një mundësi të mrekullueshme tek ne si anëtarë të saj. Ne mund të ndihmojmë “për të korrigjuar idetë e gabuara të njerëzve” dhe për të ndrequr keqinformimin kur ne portretizohemi si diçka që nuk jemi. Akoma dhe më e rëndësishme, ne mund t’u tregojmë të tjerëve se kush jemi.

Ka shumë gjëra që ne mund të bëjmë – që ju mund të bëni – për të rritur kuptueshmërinë për Kishën. Nëse e bëjmë atë me të njëjtin qëndrim dhe nëse sillemi vetë në të njëjtën mënyrë se si sillemi kur presim njerëz në shtëpinë e hapur të tempullit, miqtë dhe fqinjët tanë do të na kuptojnë më mirë. Dyshimet e tyre do të zhduken, stereotipet negative do të fshihen dhe ata do të fillojnë ta kuptojnë Kishën ashtu siç është në të vërtetë.

Më lejoni të sugjeroj disa ide për atë se çfarë mund të bëjmë.

Së pari, ne duhet të jemi të guximshëm në deklaratat tona për Jezu Krishtin. Ne dëshirojmë që të tjerët të dinë se, ne besojmë se Ai është personi më i rëndësishëm në të gjithë historinë e njerëzimit. Jeta dhe mësimet e Tij janë mesazhi qendror i Biblës dhe i librave të tjerë që ne i konsiderojmë shkrime të shenjta. Dhiata e Vjetër na përgatit për shërbesën e vdekshme të Krishtit. Dhiata e Re përshkruan shërbesën e Tij të

vdekshme. Libri i Mormonit na jep dëshminë e dytë të shërbesës së Tij të vdekshme. Ai erdhi në tokë për të shpallur ungjillin e Tij që të jetë një themel për gjithë njerëzimin në mënyrë që gjithë fëmijët e Perëndisë të mund të mësojnë rreth Tij dhe mësimet e Tij. Më pas Ai dha jetën e Tij për të qenë Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë. Vetëm me anë të Jezu Krishtit, është i mundur shpëtimi. Kjo është arsyeja se përse ne besojmë se Ai është personi më i rëndësishëm në gjithë historinë e njerëzimit. Fati ynë i përjetshëm gjithmonë është varur nga fuqia e Tij. Është një gjë e lavdishme të besojmë në Të dhe ta pranojmë Atë si Shpëtimtarin tonë, Zotin tonë dhe Mësuesin tonë.

Ne gjithashtu besojmë se vetëm nëpërmjet Krishtit është e mundur të gjejmë kënaqësi, shpresë e lumturi më të madhe – si në këtë jetë edhe në përjetësi. Siç është dhënë mësim në Librin e Mormonit, doktrina jonë prerazi shpall: “Kështu që, ju duhet të shkoni përpara me një vendosmëri në Krisht, duke pasur një ndriçim të përkryer të shpresës dhe një dashuri



për Perëndinë dhe për gjithë njerëzit. Prandaj, në qoftë se ju do të shkoni përpara, duke u ushqyer me bollëk mbi fjalën e Krishtit dhe të duroni deri në fund, vini re, kështu thotë Ati: Ju do të keni jetën e përjetshme” (2 Nefi 31:20).

Ne shpallim besimin tonë në Jezu Krisht dhe e pranojmë Atë si Shpëtimtarin tonë. Ai do të na bekojë dhe drejtojë ne në të gjitha përpjekjet tona. Ndërsa mundohemi këtu në vdekshmëri, Ai do të na forcojë dhe do të na sjellë paqe në kohë sprovash. Anëtarët e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme e jetojnë jetën me besim në Atë, Kisha e të cilit është kjo.

Së dyti, jini shembuj të drejtë për të tjerët. Pas deklaratës tonë për ato çka besojmë, ne duhet të ndjekim këshillën e dhënë për ne të 1 Timoteu 4:12: “Por bëhu shembull për besimtarët në fjalë, në sjellje, në dashuri, në Frymë, në besim dhe në dëlirësi”.

Shpëtimtari na mësoi mbi rëndësinë e të qenit shembull të besimit tonë, duke thënë: “Ashtu le të shndritë drita juaj para njerëzve, që të shohin veprat tuaja të mira dhe ta lëvdojnë Atin tuaj që është në qiej” (Mateu 5:16).

Jeta jonë duhet të jetë shembull i mirësisë dhe i virtytit, ndërsa përpikemi të ndjekim shembullin e Tij në botë. Veprat e mira nga secili prej nesh mund të rrisin reputacionin si të Shpëtimtarit edhe të Kishës së Tij. Ndërsa jeni të përfshirë në bërjen e veprave të mira, duke qenë gra dhe burra të ndershëm dhe të drejtë, Drita e Krishtit do të reflektohet përmes jetës tuaj.

Tjetër, flisni në mbrojtje të Kishës. Gjatë jetës tonë të përditshme, ne bekohemi me shumë mundësi për të ndarë me të tjerët ato që ne besojmë. Kur kolegët tanë profesionistë dhe të ngushtë na pyesin rreth bindjeve tona fetare, ata po na ftojnë të ndajmë atë



që ne jemi dhe çfarë ne besojmë. Ata mund të jenë ose mund të mos jenë të interesuar për Kishën, por ata janë të interesuar për të na njohur ne më thellësisht.

Rekomandimi im për ju është që t'i pranoni ftesat e tyre. Kolegët tuaj nuk janë duke ju ftuar për t'ju predikuar, për t'ju dhënë mësim, për t'ju sqaruar ose këshilluar. Ftojini ata në një bisedim të dyanshëm – ndani diçka mbi bindjet tuaja fetare por edhe pyetini rreth atyre që ata besojnë. Vlerësoni nivelin e interesit nga pyetjet që bëjnë. Nëse janë duke ju bërë shumë pyetje, përqendrojeni bisedën në dhënien e përgjigjeve për ato pyetje. Gjithmonë mbani mend se është më mirë që t'ju pyesin ata se sa t'u tregoni ju vetë.

Disa anëtarë duket sikur duan ta mbajnë sekret anëtarësinë e tyre në Kishë. Ata kanë arsytet e tyre. Për shembull, ata mund të mendojnë se nuk u takon atyre të tregojnë ato çka besojnë. Ndoshta ata janë të frikësuar se mund të gabohen ose mund t'u bëhet një pyetje që ata nuk mund t'i përgjigjen. Nëse ju vijnë ndonjëherë mendime të tilla, kam disa këshilla për ju. Thjesht kujtoni fjalët e Gjonit: “Në dashuri nuk ka frikë, madje dashuria e përsosur e nxjerr jashtë frikën” (1 Gjoni 4:18). Nëse thjesht e duam Perëndinë dhe i duam fqinjët tanë, neve na është premtuar se ne do t'i mposhtim frikërat tona.

Nëse keni vizituar kohët e fundit faqen e internetit Mormon.org, që

është faqja zyrtare e Kishës, për ata që janë të interesuar për të mësuar rreth Kishës, ju mund të keni parë anëtarë të cilët kanë ndarë informacion për veten e tyre. Ata kanë krijuar profile në internet që shpjegojnë se cilët janë dhe përse bindjet e tyre fetare janë të rëndësishme për ta. Ata po flasin hapur rreth besimit të tyre.

Ne duhet t'i vlerësojmë dhe qasim bashkëbisedimet e tilla me dashuri si të Krishtit. Toni ynë, qoftë duke folur apo shkruar, duhet të jetë plot respekt dhe i qytetëruar, pavarësisht nga përgjigjet e të tjerëve. Ne duhet të jemi të ndershëm e të hapur dhe të përpikemi të jemi të qartë në atë që themi. Ne duam të shmangim debatin ose të qenit në mbrojtje në çfarëdo mënyre.

Apostulli Pjetër shpjegoi: “Po ashtu siç është i shenjtë ai që ju thirri, të jini edhe ju të shenjtë në gjithë sjelljen tuaj” (1 Pjetrit 1:15).

“Mënyra e bisedimit” të sotëm duket sikur përfshin gjithnjë e më shumë internetin. Ne i nxisim njerëzit, të rinj dhe të vjetër, ta përdorin internetin dhe median sociale për të përhapur dhe ndarë bindjet e tyre fetare.

Ndërsa shfrytëzoni internetin, ju do të hasni bashkëbisedime të vazhdueshme rreth Kishës. Kur të drejtoheni nga Shpirti, mos ngurroni të shtoni mendimin tuaj te këto bashkëbisedime.

Mesazhi i ungjillit të Jezu Krishtit është ndryshe nga çdo gjë tjetër që ju do të ndani me të tjerët. Në epokën



Nga Plaku Xhefri R. Holland,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

e informacionit, ai është informacioni më i çmuar në të gjithë botën. Nuk ka dyshime rreth vlefshmërisë së tij. Është një margaritar me vlerë të madhe (shih Mateu 13:46).

Kur flasim për Kishën, ne nuk përpiqemi ta bëjmë atë të duket më e mirë se sa është. Ne nuk duhet ta tjerim mesazhin tonë. Ne duhet ta përcjellim mesazhin ndershmërisht dhe në mënyrë direkte. Nëse do t'i hapim rrugët e komunikimit, mesazhi i ungjillit të rivendosur të Jezu Krishtit do të vërtetohet vetë tek ata të cilët janë të përgatitur për ta marrë atë.

Ndonjëherë ka një ndryshim të madh – një mospërputhje në të kuptuarin – mes mënyrës se si ne e përjetojmë Kishën si anëtarë dhe mënyrës se si të tjerët e shohin atë nga jashtë. Kjo është arsyeja kryesore që ne kemi shtëpi të hapura për tempujt, përpara se të arrihet çdo dedikim. Anëtarët vullnetarë në shtëpitë e hapura për tempujt thjesht përpiqen t'i ndihmojnë të tjerët ta shohin Kishën në mënyrën që ata e shohin si anëtarë. Ata e njohin Kishën si një punë të mrekullueshme dhe një çudi, dhe ata duan që të tjerët ta dinë këtë gjithashtu. Unë ju kërkoj juve të bëni të njëjtën gjë.

Unë ju premtoj se, në qoftë se do t'i përgjigjeni ftesës për të ndarë ato çka besoni dhe ndjenjat tuaja rreth ungjillit të rivendosur të Jezu Krishtit, shpirti i dashurisë dhe shpirti i kurajës do të jenë shoqëruesit tuaj të vazhdueshëm, pasi “dashuria e përsosur e nxjerr jashtë frikën” (1 Gjoni 4:18).

Kjo është koha e rritjes së mundësive për të ndarë ungjillin e Jezu Krishtit me të tjerët. E përgatitshim veten për të shfrytëzuar mundësitë që i janë dhënë secilit prej nesh për të ndarë ato çka besojmë, unë lutem plot nderim, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

Ne Jemi të Gjithë të Rekrutuar

Unë i kërkoj çdo burri, të ri dhe të vjetër, që mban priftërinë, të ketë një zë më të fortë dhe më të përkushtuar, . . . një zë për të mirën, një zë për të përhapur ungjillin, një zë për Perëndinë.

Në shpirtin e këtij himni të mrekullueshëm e nxitës dhe me lutjen shprehëse të Plakut Riçard G. Hinkli në zemër, unë dëshiroj të flas shumë çiltërsisht sonte vëllezër dhe unë përfshij në këtë çiltërsi të rinjtë e Priftërisë Aarone.

Kur flasim për madhështinë e Vegimit të Parë të Jozef Smithit, ne ndonjëherë flasim shumë pak rreth kundërvënies kërcënuese që ndodhi pak përpara tij, një kundërvënie qëllimi i së cilës ishte ta shkatërronte djaloshin nëse ishte e mundur, por nëse nuk ishte e mundur, të bllokonte zbuluesën që do t'i jepej atij. Ne nuk flasim për Satanin më shumë se sa na duhet të flasim dhe mua nuk më pëlqen fare të flas për të, por përvoja e të riut Jozef na kujton atë që çdo burrë, duke përfshirë çdo të ri, mes këtij publiku ka nevojë të kujtojë.

Së pari, Satani ose Luciferi ose ati i gënjeshtrevë – pavarësisht si e quani – është i vërtetë, pasqyrimi i vërtetë i së keqes. Arsyet e tij janë në çdo rast keqdashëse dhe ai dridhet dhunshëm përpara shfaqjes së dritës shëlbuese,

vetëm nga mendimi i së vërtetës. Së dyti, ai është përjetësisht kundër dashurisë së Perëndisë, Shlyerjes së Jezu Krishtit dhe punës së paqes e të shpëtimtimit. Ai do të luftojë kundër këtyre gjërave kurdo dhe kudo që të mundet. Ai e di se do të mundet dhe do të flaket në fund, por është i vendosur që të shkatërrojë sa më shumë njerëz të tjerë që të mundet.

Pra, cilat janë disa nga taktikat e djallit në këtë betejë kur jeta e përjetshme është në rrezik? Përsëri, përvoja në Korijen e Shenjtë na mëson disa nga taktikat e djallit. Jozefi shënoi se në përpjekje për të kundërshtuar ngjarjet që do të ndodhnin më vonë, Luciferi ushtroi “një ndikim kaq të mahnitshëm mbi mua, sa të ma lidhte gjuhën, kështu që unë nuk mund të flisja”¹.

Sic dha mësim Presidenti Bojd K. Paker këtë mëngjes, Satani nuk mund ta vrasë dikë drejtpërdrejt. Kjo është një nga gjërat e shumta që ai nuk i bën dot. Por me sa duket përpjekja e tij për të ndaluar punën do të jetë e suksesshme deri në një farë mase, nëse ai ia del t'i pengojë njerëzit



besnikë që të flasin. Vëllezër, nëse kështu është puna, unë sonte po kërkoj burra të rinj e të moshuar, të cilët kujdesen mjaftueshëm për këtë betejë mes së mirës e së ligës sa të përfshihen dhe të flasin haptas. Ne jemi në luftë dhe për këto pak minuta në vazhdim, unë dëshiroj të përfshij ushtarë të rinj në këtë betejë.

A nevojitet të këndoj nën zë këngën “We Are All Enlisted” [“Ne Jemi të Gjithë të Rekrutuar”]? Ju e njihni vargun “Ne po presim ushtarë, kush do dalë vullnetar?”² Me siguri, gjëja madhështore e kësaj kërkesë për vullnetarë që të luftojnë është se ne *nuk* kërkojmë vullnetarë që të hapin zjarr me pushkë apo të hedhin një granatë dore. Jo, ne duam batalione që do të marrin si armë “çdo fjalë që del nga goja e Perëndisë”³. Kështu që, unë sonte jam në kërkim të misionarëve që nuk do të heshtin vullnetarisht, por që me Shpirtin e Zotit dhe fuqinë e priftërisë së tyre, do t’i hapin gojët e tyre dhe do të paralajmërojnë e kryejnë mrekulli. Një fjalim i tillë, thanë dikur vëllezërit që jetonin në fillim të kësaj periudhe ungjillore, do të ishte mjete nëpërmjet të cilit “veprat më të mrekullueshme [të besimit] janë kryer dhe do të kryhen”⁴.

Unë u kërkoj veçanërisht të rinjve të Priftërisë Aarone që të ngrihen dhe të jenë të vëmendshëm. Për ju, më lejoni të bëj një lidhje me sportet. Të rinj, kjo është një betejë për jetë a vdekje në të cilën jemi, kështu që unë do të qëndroj shumë pranë jush, kokë më kokë, me shumë emocion – në të njëjtën mënyrë siç bëjnë trajnerët kur loja është duke filluar dhe fitorja e lojës është gjëja më e rëndësishme. Dhe për shkak se rezultati i lojës varet nga ju, ajo që ky trajner [Plaku Holland] po ju thotë juve është se, që të luani në këtë ndeshje, disa nga ju duhet të jenë më të pastër moralisht nga ç’janë. Në këtë betejë mes së mirës

dhe së ligës, ju nuk mund të luani për kundërshtarin sa herë hasni në një tundim dhe pastaj të vishni uniformën e Shpëtimtarit në tempull dhe në kohën e misionit sikur s’ka ndodhur asgjë. Këtë gjë, miqtë e mi të rinj, nuk mund ta bëni. Nuk mund të talleni me Perëndinë.

Pra, unë dhe ju sonte jemi përpara një situatë sfiduese. Ajo është se tashmë ka mijëra të rinj në moshën e Priftërisë Aarone në regjistrat e kësaj Kishe që janë misionarë të mundshëm në të ardhmen. Por sfida është që t’i bëjmë ata dhjakë, mësues dhe priftërinj që të qëndrojnë mjaftueshëm aktivë dhe mjaftueshëm të denjë sa që të shugurohen si pleq [eldra] dhe të shërbejnë si misionarë. Pra, ne kemi nevojë që të rinjtë që tashmë janë në ekip, të *qëndrojnë* në ekip dhe të mos bëjnë më triblime jashtë fushe pikërisht atëherë kur na duheni që të futeni në lojë dhe të luani me më të mirën tuaj. Në pjesën më të madhe të garave atletike që unë njoh, ka disa vija kufizuese të vizatuara mbi dyscheme ose në fushë brenda të cilave duhet të qëndrojnë çdo pjesëmarrës në mënyrë që të konkurrojnë. Pra, Zoti ka vizatuar vija denjësie për ata që janë thirrur të punojnë me Të në këtë punë. Asnjë misionar nuk mund t’i ftojë të tjerët të pendohen për shkelje seksuale, gjuhë përdhosëse apo për shikimin e pornografisë nëse nuk është penduar vetë më parë që i ka bërë këto gjëra. Ju nuk mund ta bëni këtë! Shpirti nuk do të jetë me ju dhe fjalët do t’ju ngecin në grykë ndërkohë që i thoni. Ju nuk mund të ecni nëpër ato që Lehi i quajti “shtigje të ndaluara”⁵ dhe të prisni që t’i drejtoni të tjerët për tek “shtegu i ngushtë dhe i

ngushtuar”⁶, kjo – nuk mund të bëhet.

Por ka një mënyrë që ju t’i kapërceni mëkatet tuaja po aq sa ka dhe për një kërkues të cilin ju do ta mësoni të kapërcëjë mëkatet e tij. Kushdo që të jeni dhe çfarëdo të keni bërë, ju mund të merrni falje. Secili prej ju të rinjve mund të lerë pas çdo shkelje me të cilën është duke luftuar. Kjo është “mrekullia e faljes”, kjo është mrekullia e Shlyerjes së Zotit Jezu Krisht. Por ju nuk mund ta bëni pa një zotim veprues ndaj ungjillit dhe nuk mund ta bëni pa pendim, aty ku është i nevojshëm. Unë po ju kërkoj ju të rinjve të jeni aktivë dhe të jeni të pastër. Nëse është e nevojshme, unë po ju kërkoj të *bëheni* aktivë dhe të *bëheni* të pastër.

Vëllezër, në këtë çast ne ju flasim juve haptazi, sepse e folura delikate rrallë ndodh të ketë efektin e dëshiruar te ju. Ne flasim haptazi pasi Satani është një qenie e vërtetë, e vendosur t’ju shkatërrojë dhe ju përballeni me ndikimin e tij në një moshë gjithmonë e më të re. Kështu që, ne ju kapim nga jaka dhe thërrasim me gjithë forcën që mundemi:

*Mbani vesh tingullin e betejës që
zhurmon fort dhe qartë;
Ejani bashkohuni me ushtrinë!*⁷

Miqtë e mi të rinj, ne kemi nevojë për dhjetëra mijëra misionarë më shumë në muajt dhe vitet në vijim. Ata duhet të vijnë nga një numër më i madh i mbajtësve të Priftërisë Aarone që do të jenë të shuguruar, aktivë, të pastër dhe të denjë për të shërbyer.

Për ata prej jush që kanë shërbyer në misione ose janë duke shërbyer tani, ne ju falënderojmë për të mirën

që keni bërë dhe për jetët që keni prekur. Bekuar qofshit! Ne gjithashtu e dimë se ka disa që kanë shpresuar gjatë gjithë jetës që të shërbenin në misione, por për arsye shëndetësore ose pengesa të tjera jashtë kontrollit të tyre, nuk mund ta bëjnë këtë. Ne e përshëndesim publikisht dhe me krenari këtë grup. Ne i njohim dëshirat tuaja dhe ju përgëzojmë për përkushtimin tuaj. Ju keni dashurinë dhe admirimin tonë. Ju jeni “në ekip” dhe do të jeni gjithmonë, megjithëse ju jeni të justifikuar me nder nga shërbimi me kohë të plotë. Por ne kemi nevojë për pjesën tjetër prej jush!

Tani, ju vëllezër të Priftërisë Melkizedeke, mos buzëqeshni dhe mos qëndroni në rehatinë e ndenjësve tuaja. Unë nuk kam mbaruar së foluri. Ne kemi nevojë për mijëra çifte misionarësh më shumë që të shërbejnë në misionet e Kishës. Çdo president misioni lutet që në misionin e tij të dërgohen më shumë çifte misionarësh. Kudo që shërbejnë, çiftet tona i shtojnë një pjekuri punës që asnjë numër 19-vjeçarësh, sado të zotë të jenë, nuk mund ta sigurojnë.

Që të nxisë më shumë çifte për të shërbyer, Presidenca e Parë dhe Kuarumi i Të Dymbëdhjetëve kanë bërë një nga lëvizjet më të hapura dhe bujare që janë parë ndonjëherë në punën misionare në 50 vitet e fundit. Në maj të këtij viti, udhëheqësit e priftërisë në terren, morën një lajmërim se kostot e strehimit për çiftet (dhe ne e kemi fjalën *vetëm* për kostot e strehimit) do të plotësohen nga fondi i Kishës për misionarët nëse kostoja kalon një sasi të paracaktuar në muaj. Ç’bekim! Kjo është një ndihmë dërguar nga qielli që do të përdoret për shpenzimin e vetëm më të madh me të cilin përballen çiftet në misionet e tyre. Vëllezërit kanë vendosur gjithashtu, që misionet në çift mund të jenë për 6 ose 12



muaj, njëkohësisht edhe si zakonisht 18 apo 23 muaj. Me një gjest tjetër të mrekullueshëm, çifteve u jepet leje që, me shpenzimet e tyre, të kthehen në shtëpi për pak kohë për ngjarje shumë të rëndësishme familjare. Dhe mjaft u shqetësuar se do t’ju duhet të trokisni nëpër dyer ose të keni të njëjtin program si 19-vjeçarët! Ne nuk ju kërkojmë juve ta bëni këtë, por ka shumë gjëra të tjera që ju mund të bëni dhe ju do të keni shumë liri për të vendosur se si do t’i bëni ato.

Vëllezër, ne e kuptojmë se disa nga *ju* nuk do të kenë mundësi të shkojnë në mision për momentin ose ndoshta asnjëherë për arsye të mira e të mjaftueshme shëndeti, familjare ose ekonomike. Por me pak planifikim, shumë nga ju mundën të shkojnë në mision.

Peshkopë dhe presidentë të kunjeve, diskutoni për këtë nevojë në këshillat dhe konferencat tuaja. Uluni në krye të mbledhjeve tuaja dhe kërkoni me lutje përshtypje për pjesëmarrësit e mbledhjes që duhet të marrin një thirrje për të shkuar në mision. Pastaj këshillohuni me ta dhe ndihmojini të vendosin një datë për shërbimin e tyre. Vëllezër, kur kjo të ndodhë, thuajuni grave tuaja se nëse ju mund ta lini divanin tuaj të rehatshëm dhe telekomandën e televizorit për pak muaj të shkurtër, edhe ato

mund t’i lënë nipërit dhe mbesat. Ata pëllumba të vegjël do të jenë mirë dhe unë ju premtoj se ju do të bëni gjëra për ta gjatë shërbimit për Zotin që, për mijëra vjet nuk do t’i bënit dot kurrë nëse do të qëndronit në shtëpi për t’u kujdesur për ta. Çfarë dhurate më të madhe mund t’i japin gjyshërit pasardhësve të tyre sesa t’u thonë me vepra dhe me fjalë: “Në këtë familje, ne shërbejmë misione!”

Puna misionare nuk është e vetmja gjë që na duhet të bëjmë në këtë Kishë, të madhe në numër, të gjerë geografikisht dhe të mrekullueshme. Por pothuajse gjithçka tjetër që na duhet të bëjmë, varet së pari nga fakti nëse njerëzit dëgjojnë ungjillin e Jezu Krishtit dhe kthehen në besim. Me siguri kjo është arsyeja pse urdhri i fundit i Jezusit për Të Dymbëdhjetët ishte ai kryesori – “Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë”⁸. Pas kësaj dhe vetëm atëherë, mund të vijë

Montreal, Kebek në Kanada



pjesa tjetër e bekimeve të ungjillit – solidariteti familjar, programet rinore, premtimet e priftërisë dhe ordinancat që na drejtojnë për në tempull. Por ashtu siç dëshmoi Nefi, asnjë nga këto gjëra nuk mund të vijë derisa një njeri të ketë “hy[rë] në . . . portë”⁹. Për shkak të gjithçkaje që duhet bërë në shtegun e jetës së përjetshme, ne kemi nevojë për më shumë misionarë që ta hapin portën dhe t’i ndihmojnë të tjerët të hyjnë në të.

Unë i kërkoj çdo burri, të ri dhe të vjetër, që mban priftërinë, të ketë një zë më të fortë dhe më të përkushtuar, një zë jo vetëm kundër së keqes dhe atij që është mishërimi i saj, por një zë për të mirën, një zë për të përhapur ungjillin, një zë për Perëndinë. Vëllezër të të gjitha moshave, zgjidhni gjuhët tuaja dhe shikoni se si fjalët tuaja do të bëjnë mrekulli në jetën e atyre “të cilët mbahen larg nga e vërteta vetëm ngaqë nuk dinë se ku ta gjejnë atë”¹⁰.

*Nxitoni për në betejë, nxitoni për në fushë;
E vërteta është helmata, mbrojtja dhe streha jonë.
Qëndrojmë pranë flamurit tonë, që me krenari valëvitet!
Ne me gëzim, me gëzim po marshojmë për në qiell.*¹¹

Në emrin e Jezu Krishtit, Mjeshtër tonë, amen. ■

SHËNIME

1. Joseph Smith—Historia 1:15.
2. “We Are All Enlisted”, *Hymns*, nr. 250.
3. Doktrina e Besëlidhje 84:44; shih edhe Ligji i Përtërirë 8:3; Mateu 4:4.
4. *Lectures on Faith* (1985), f. 73.
5. 1 Nefi 8:28.
6. 2 Nefi 31:18.
7. *Hymns*, nr. 250.
8. Mateu 28:19.
9. 2 Nefi 33:9.
10. Doktrina e Besëlidhje 123:12.
11. *Hymns*, nr. 250.



Nga Peshkopi Keith B. Mek-Mullin,
Këshilltar i Dytë në Peshkopatën Kryesuese

Fuqia e Priftërisë Aarone

Ju dhe detyra që mbani në Priftërinë Aarone, janë thelbësore për punën e Atit Qiellor me fëmijët e Tij dhe për përgatitjen e kësaj toke për Ardhjen e Dytë.

Në një sesion trajnimi të kohëve të fundit për Autoritetet e Përgjithshme, Presidenti Tomas S. Monson theksoi sërish detyrat dhe mundësitë për mbajtësit e Priftërisë Aarone.¹ Me të njëjtin synim si ato udhëzime, unë ju drejtohem juve.

Detyra, e kryer siç duhet, përcakton fatin e popujve dhe të kombeve. Kaq themelor është parimi i detyrës saqë mbajtësit e priftërisë paralajmërohen: “Si rrjedhim, tani çdo njeri duhet ta thirrjen që është caktuar, gjithë zell”².

Presidenti Monson shpjegon: “Thirrja e detyrës mund të vijë qetësisht, ndërsa ne që mbajmë priftërinë u përgjigjemi caktimeve që marrim”³. Presidenti Monson citoi Xhorxh Albert Smithin: “Së pari është detyra juaj të mësoni atë që dëshiron Zoti dhe pastaj, me anë të fuqisë dhe forcës së Priftërisë së Tij të shenjtë, të lartësoni thirrjen tuaj në prani të shokëve tuaj në mënyrë të tillë që njerëzit të jenë të gëzuar t’ju ndjekin ju”⁴.

Duke folur për detyrën e Tij, Zoti ynë tha: “Nuk kërkoj vullnetin tim, por vullnetin e Atit”⁵. “Sepse unë kam zbritur nga qielli jo për të bërë vullnetin tim, por vullnetin e atij që më ka dërguar.”⁶ Sepse Jezu Krishti e kreu detyrën e Tij, “i gjithë njerëzimi mund

të shpëtohet, me anë të bindjes ndaj ligjeve dhe ordinancave të Ungjillit”⁷. Vëllezër, ky është standardi që duhet të ndjekim.

Në përvojën time unë kam vërejtur se ju që shërbeni si dhjakë, mësues dhe priftërinj, jeni aq të gatshëm, të besueshëm dhe të aftë në kryerjen e detyrës suaj sa ne presim të jeni. Ne ju admirojmë. Gjallëria juaj është ngjitëse, aftësitë tuaja befasuese, shoqërimi juaj gjallërues për ne. Ju dhe detyra që mbani në Priftërinë Aarone, janë thelbësore për punën e Atit Qiellor me fëmijët e Tij dhe për përgatitjen e kësaj toke për Ardhjen e Dytë të Birit të Tij të shenjtë. Ndërsa ju marrim parasysht, ne shohim përtej moshës tuaj. Pali foli për ju duke thënë: “Askush të mos e shpërfillë moshën tënde të re, por bëhu shembull për besimtarët në fjalë, në sjellje, në dashuri, në Frymë, në besim dhe dëlirësi”⁸.

*Priftëria që mori emrin e Aaronit,
Burra në kohë të lashta u erdhi.
Nëpërmjet levitëve, priftërinjve edhe profetëve,
Për të bekuar bijtë e Perëndisë ajo shërbeu.*

*Pastaj Shpëtimtari i botës erdhi
Dhe një njeri që quhej Gjon kërkoj,*



*Që të pagëzohej po nga kjo fuqi
Dhe punën e shpëtimit filloi.*

*Në ditët e mëvonshme po kjo fuqi
Sërish u rivendos në tokë,
Të vërtetat e ungjillit nga e para
tek e fundit
Të mund të nguleshin në zemrat tona.*

*Priftëri Aarone, e vërteta madhështore,
Për përgatitje erdhi –
Që të mund të kishim shëlbim
Prej të Dashurit Bir të Perëndisë!*

*Dhe atij që i përdor këto fuqi –
Një djalë i thjeshtë ta bëjë nuk mund.
Me mantelin e priftërisë hedhur mbi të
Ne i themi: “Ky është njeriu!”*

“Fuqia dhe autoriteti i Priftërisë . . . Aarone është të mbajë çelësat e shërbesës së engjëjve dhe të administrojë në ordinancat e jashtme, letrën e ungjillit, pagëzimin e pendimit për heqjen e mëkateve, në përputhje me besëlidhjet dhe urdhërimet.”¹⁰ Presidenti Bojd K. Paker ka vërejtur: “Ne kemi bërë shumë mirë në shtrirjen e autoritetit të priftërisë. Ne e kemi vendosur autoritetin e priftërisë thuasje kudo. . . . Po përhapja e autoritetit të priftërisë ka përparuar, mendoj unë, më shumë se përhapja e fuqisë së

priftërisë.”¹¹ Për mirëqenien e përhershme të fëmijëve të Perëndisë, kjo duhet korrigjuar.

Profeti ynë na ka treguar se si mund të bëhet kjo. Duke cituar Xhorxh Q. Kanonin, Presidenti Monson tha: “Unë dëshiroj ta shoh të forcuar fuqinë e priftërisë. . . . Unë dëshiroj ta shoh këtë forcë e fuqi të shpërndarë nëpër të gjithë trupin e Priftërisë, që të arrijë nga kryet deri poshtë tek dhjaku më i vogël e më i përlulur në Kishë. Çdo burrë duhet të kërkojë e të gëzojë zbulësat e Perëndisë, dritën e qiellit që t’i shkëlqejë në shpirt dhe që t’i japë drituri lidhur me detyrat e tij, lidhur me atë pjesë të punës . . . që është përgjegjësia e tij në Priftërinë e tij.”¹²

Çfarë mund të bëjë një dhjak, mësues, ose prift për të marrë shpirtin e zbulësës dhe për të lartësuar thirrjen e tij? Ai mund të jetojë në mënyrë të tillë që të gëzojë fuqinë pastruese, shenjtëruese dhe ndriçuese të Frymës së Shenjtë.

Rëndësia e kësaj gjendet në këto fjalë nga Alma: “Dhe tani unë ju them juve se ky është urdhri sipas të cilit jam thirrur, . . . për t’u predikuar . . . brezit të ri . . . që ata duhet të pendohen dhe të *linden përsëri*”¹³. Kur dikush lindet përsëri, zemra e tij

ndryshon. Ai nuk ka dëshirë për gjëra të liga ose të papastra. Ai ndjen një dashuri të thellë dhe të qëndrueshme për Perëndinë. Ai dëshiron të jetë i mirë, t’u shërbejë të tjerëve dhe të mbajë urdhërimet.¹⁴

Presidenti Jozef F. Smith e përshkroi përvojën e tij me këtë ndryshim të fuqishëm: “Ndjenja që erdhi mbi mua ishte ajo e paqes së kulluar, e dashurisë dhe e dritës. Ndjeva në shpirtin tim që, nëse kisha mëkatuar . . . më ishte falur; se vërtet isha pastruar nga mëkati im; zemra ime ishte prekur dhe ndjeva se nuk dëshiroja të lëndoja as insektin më të vogël nën këmbët e mia. Ndjeva sikur dëshiroja të bëja mirë kudo, gjithkujt dhe gjithçkaje. Ndjeva një risi jete, një risi dëshirë për të bërë atë që është e drejtë. Nuk kishte mbetur asnjë copëz dëshirë për të ligën në shpirtin tim. Isha veçse një djalë i vogël, është e vërtetë, . . . por ky ishte ndikimi që erdhi mbi mua dhe e di se ishte nga Perëndia, dhe ishte e ka qenë gjithmonë një dëshmi e gjallë për mua se isha i pranuar nga Zoti.”¹⁵

Kështu ne ju bëjmë thirrje juve vëllezër të rinj e të mrekullueshëm që të përpiqeni me zell që të “linden[i] përsëri”¹⁶. Lutuni që ta merrni këtë ndryshim të fuqishëm në jetën tuaj. Studioni shkrimet e shenjta. Dëshironi

më shumë se gjithçka tjetër që ta njihni Perëndinë dhe të bëheni si Biri i Tij i shenjtë. Gëzojeni rininë tuaj por “i flak[ni] gjërat fëminore”¹⁷:

Shmangni bisedat profane dhe të pamend.

Largohuni nga gjithçka e ligë.

Shmangni grindjen.

Pendohuni kur është enevojshe.¹⁸

Kjo do t’ju ndihmojë të bëheni një burrë i pjekur dhe me dinjitet. Cilësitë e kurajës, besueshmërisë, përlulesisë, besimit dhe mirësisë do të jenë tuajat. Miqtë do t’ju admirojnë, prindërit do t’ju lavdërojnë, vëllezërit në priftëri do të mbështeten tek ju dhe të rejtat do t’ju adhurojnë e do të bëhen edhe më të mira për shkakun tuaj. Perëndia do t’ju nderojë dhe do t’i dhurojë shërbimit tuaj në priftëri *fuqi nga lart*.

Ne të tjerët, do të bëjmë pjesën tonë. Si prindër e gjyshër ne do t’ju përgatisim ju për shërbim më besnik në mbretërinë e Perëndisë. Si vëllezërit tuaj, ne do të jemi shembuj që ju t’i ndiqni. Ne do ta rrisim forcën e kuorumeve tuaja. Ne do t’i mbështesim presidencat e kuorumeve tuaja ndërsa ato ushtrojnë çelësat e tyre drejtues. Ne do t’ju sigurojmë mundësi që të kryeni plotësisht detyrat e Priftërisë Aarone dhe të lartësoni thirrjen tuaj aty.

Nëpërmjet shërbesës suaj, bekime të mëdha do t’i vijnë Kishës. “Engjëjt flasin nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë.”¹⁹ Edhe ju mund të bëni po ashtu. Ndërsa flisni me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë dhe administroni emblemat e shenjta të sakramentit, burrat e gratë, djemtë e vajzat do të përpqen fort që të pendohen, të rrisin besimin e tyre në Krisht dhe të kenë Shpirtin e Shenjtë gjithmonë me ta.

Kur të agjëroni dhe të mblidhni ofertat e agjërimin, anëtarët do të nxiten t’i modelojnë veprat e tyre sipas Shpëtimtarit. Zoti u kujdes për të varfrit, të shtypurit dhe bëri shenjë:



“Eja e më ndiq”²⁰. Shërbimi juaj në përkujdesje për njerëzit me më pak fat na përfshin në punën e Tij të shenjtë dhe na ndihmon të ruajmë falje për mëkatet tona të shkuara.²¹

Kur të “vizito[ni] shtëpinë e çdo anëtar”²², mos jini të frikësuar ose të turpshëm. Fryma e Shenjtë do t’ju japë ju në po atë çast fjalët që të thoni, dëshminë që të tregoni, shërbimin që të jepni.

Përpjekjet tuaja të zellshme që “të vëzhgo[ni] mbi kishën gjithmonë”²³ do të jenë të frytshme. Sjellja juaj e përuhur dhe e sinqertë do të zbusë zemrën edhe të njeriut më mosbesues dhe do të zvogëlojë kontrollin e Satanit mbi të. Ftesa juaj për të tjerët që të vijnë në kishë me ju, të marrin sakramentin me ju dhe të shërbejnë me ju do të bëhet një balsam i mirëpritur për ata që kanë humbur në hijet ku drita e ungjillit është veçse një thëngjill i zbehtë ose që nuk ndriçon fare.

Oh, vëllezërit e mi të dashur e të rinj, “mos e [lini] pas dore dhuntinë që është në [ju]”²⁴, që e morët kur iu dha Priftëria Aarone dhe u shuguruar.

“Sepse Perëndia nuk na ka dhënë frymë frike, por force, dashurie dhe urtësie.

Mos ki turp, pra, të dëshmosh Zotin tonë. . . . Por hiq keq . . . për ungjillin, sipas fuqisë së Perëndisë,

që na . . . thirri me një thirrje të shenjtë, . . . që na u dha në Krishtin Jezus përpara fillimit të kohëve.”²⁵

Profeti ynë i dashur “ju ka thirrur te flamuri”²⁶. Ne ju përshëndesim, lutemi për ju, gëzojmë në shërbimin me ju dhe i japim falënderime Perëndisë për fuqinë e shërbesës suaj shpëtuese.

Unë jap dëshmi, Perëndia është Ati ynë i Përvetshëm dhe banon atje në qiej. Jezusi, Krishti është Biri i shenjtë i Perëndisë, Shëlbuesi i botës, dhe ju mbajtësit besnikë të Priftërisë Aarone jeni të dërguarit e Tij në tokë, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Thomas S. Monson, General Authority training meeting, prill 2010.
2. Doktrina e Besëlidhje 107:99.
3. Thomas S. Monson, “The Sacred Call of Service”, *Liahona*, maj 2005, f. 54.
4. George Albert Smith, në Conference Report, prill 1942, f. 14; shih edhe Thomas S. Monson, *Liahona*, maj 2005, f. 54.
5. Gjoni 5:30.
6. Gjoni 6:38.
7. Nenet e Besimit 1:3.
8. 1 Timoteut 4:12.
9. Vjershë nga Keith B. McMullin; shih Keith B. McMullin, “Behold the Man”, *Ensign*, nëntor 1997, f. 42.
10. Doktrina e Besëlidhje 107:20.
11. Bojd K. Paker, “Fuqia e Priftërisë”, *Liahona*, maj 2010, f. 7.
12. George Q. Cannon, *Deseret Weekly*, 2 nëntor 1889, f. 593; cituar nga Thomas S. Monson në General Authority training meeting, prill 2010.
13. Alma 5:49; është shtuar theksimi.
14. Shih Marion G. Romney, “According to the Covenants”, *Ensign*, nëntor 1975, f. 71–73.
15. Joseph F. Smith, në Conference Report, prill 1898, f. 66.
16. Shih Gjoni 3:3–7; Alma 5:14–21, 49.
17. 1 Korintasve 13:11.
18. Shih 2 Timoteut 2:16, 22–26.
19. 2 Nefi 32:3.
20. Lluca 18:22; shih edhe Gjoni 14:12–14.
21. Shih Mosia 4:26.
22. Doktrina e Besëlidhje 20:47.
23. Doktrina e Besëlidhje 20:53.
24. 1 Timoteut 4:14.
25. 2 Timoteut 1:7–9.
26. Thomas S. Monson, General Authority training meeting, prill 2010.



Nga Plaku W. Kristofer Uadell,
i Të Shtatëdhjetëve

Mundësia Unike në Jetë

Nëpërmjet shërbimit tuaj të përkushtuar dhe sakrificës së vullnetshme, misioni juaj do të bëhet përvojë e shenjtë për ju.

Një ngjarje kulmore në jetën e një misionari/eje është intervista e tij ose e saj përfundimtare, ose intervista “e mbylljes” me presidentin e misionit. Në thelb të intervistës do të jetë një diskutim i asaj që duket të jetë një ngjarje domethënëse e përvojave të paharrueshme dhe mësimave thelbësore që janë marrë në vetëm 18 deri në 24 muaj.

Ndërsa shumë nga këto përvoja dhe mësim mund të jenë të përbashkëta për shërbimin misionar, çdo mision është unik, me sfidat dhe mundësitë që do të na tendosin dhe do të na provojnë sipas nevojave dhe personaliteteve tona të veçanta.

Kohë para se të linim shtëpinë tonë tokësore për të shërbyer një mision kohëplotë, ne lamë prindërit qiellorë për të përmbushur misionin tonë në vdekshmëri. Ne kemi një Atë në Qiell, i cili na njeh – pikat tona të forta dhe dobësitë, aftësitë dhe potencialin tonë. Ai e di se për cilin president e shokë misioni dhe cilët anëtarë e kërkues kemi nevojë në mënyrë që të jemi misionari, bashkëshorti dhe babai, dhe mbajtësi i priftërisë që jemi i aftë për t’u bërë.

Profetët, shikuesit dhe zbuluesit i caktojnë misionarët nën drejtimin dhe ndikimin e Frymës së Shenjtë. Presidentët e misioneve të frymëzuar

drejtojnë transferime çdo gjashtë javë dhe shpejt mësojnë se Zoti e di saktësisht ku Ai dëshiron që secili misionar të shërbejë.

Disa vite më parë, Plaku Javier Misiego, nga Madridi në Spanjë, ishte duke shërbyer një mision kohëplotë në Arizona. Në atë kohë, thirrja e misionit të tij në Shtetet e Bashkuara iu duk disi e pazakontë, sepse shumica e të rinjve nga Spanja ishin thirrur për të shërbyer në vendin e tyre.

Në përfundim të një mbrëmjeje rreth vatrës të kunjit, ku ai dhe shoku i tij ishin ftuar për të marrë pjesë, Plakut Misiego iu qas një anëtar më pak aktiv i Kishës, i cili ishte sjellë nga një mik. Ishte hera e parë në kaq vite që ky burrë kishte qenë brenda një godine kishtarë. Plakun Misiego e pyeti nëse ai mund të njihje një Hozé Misiego në Madrid. Kur Plaku Misiego iu përgjigj se emri i babait të tij ishte Hozé Misiego, burri i emocionuar i bëri edhe disa pyetje më shumë për të vërtetuar se ky ishte *i njëjti* Hozé Misiego. Kur u kuptua se ata ishin duke folur për të njëjtin njeri, ky anëtar më pak aktiv filloi të qante. “Babai yt ishte i vetmi person që pagëzova gjatë gjithë misionit tim”, i shpjegoi ai dhe ai përshkroi se si misioni i tij, në mendjen e tij, kishte qenë një dështim. Vitet e tij të pasivitetit ai ua atribuoi disa ndjenjave

të papërshtatshmërisë dhe shqetësimit, duke besuar se, në një farë mënyre, e kishte lënë në baltë Zotin.

Më pas, Plaku Misiego përshkroi se çfarë nënkuptonte për familjen e tij ky dështim i supozuar i një misionari. Ai i tha atij se babai i tij, i pagëzuar si një i ri beqar në moshë madhore, ishte martuar në tempull, se Plaku Misiego ishte i katërti nga gjashtë fëmijët, që të tre djemtë dhe një motër kishin shërbyer mision kohëplotë, që të gjithë ishin aktivë në Kishë, dhe se të gjithë ata që ishin martuar, ishin vulosur në tempull.

Misionari i rikthyer më pak aktiv filloi të qante me dënësë. Ai tani mësoi se, nëpërmjet përpjekjeve të tij, shumë jetë ishin bekuar dhe Zoti kishte dërguar një plak nga Madridi i Spanjës, gjithë atë rrugë për në një mbrëmje rreth vatrës në Arizonë për t’i treguar atij se ai nuk kishte qenë një dështak. Zoti e di se ku dëshiron Ai që të shërbejë secili misionar.

Në çfarëdo mënyre Zoti mund të zgjedhë për të na bekuar gjatë rrjedhës së një misioni, bekimet e shërbimit misionar nuk janë paracaktuar për të përfunduar kur ne lirohemi nga presidenti ynë i kunjit. Misioni juaj është një terren përgatitjeje për jetën. Përvojat, mësimet dhe dëshmia të marra nëpërmjet shërbimit besnik janë destinuar për të siguruar një themel të përqendruar të ungjilli që do të zgjasë gjatë gjithë vdekshmërisë dhe në përjetësi. Megjithatë, janë disa kushte që duhet të përmbushen, që bekimet të vazhdojnë pas misionit. Te Doktrina e Besëlidhje lexojmë: “Sepse të gjithë ata që dëshirojnë të kenë bekim nga dora ime, duhet t’i binden ligjit që u caktua për atë bekim dhe kushteve të tij” (DeB 132:5). Ky parim jepet mësim në historinë e Eksodit.

Pas marrjes së urdhrin nga Zoti, Moisiu u kthye në Egjipt për të nxjerrë

bijtë e Izraelit nga robëria. Plagë pas plage nuk arriti të siguronte lirinë e tyre, duke i çuar te plaga e 10-të dhe e fundit: “Atë natë unë do të kaloj nëpër vendin e Egjiptit dhe do të godas çdo të parëlindur në vendin e Egjiptit” (Eksodi 12:12).

Për mbrojtje kundër “shkatërruesit” (vargu 23), Zoti e udhëzoi popullin e Tij për të ofruar një sakrificë, një qengji “pa të meta” (vargu 5), dhe për të marrë gjakun nga sakrificat. Më pas ata do “të [merrnin] nga ai gjak” dhe do ta vinin në hyrje të çdo shtëpie – mbi “dy shtalkat dhe mbi arkitraun” (vargu 7) – me këtë premtim: “Kur unë të shoh gjakun do të kaloj tutje dhe nuk do të ketë plagë mbi ju për t’ju zhdukur” (vargu 13).

“Bijtë e Izraelit shkuan dhe . . . ata bënë ashtu si i kishte urdhëruar Zoti” (vargu 28). Ata ofruan sakrificën, morën gjakun dhe e vunë te shtëpitë e tyre. “Prandaj ndodhi që në mesnatë Zoti goditi tërë të parëlindurit në vendin e Egjiptit” (vargu 29). Moisiu dhe populli i tij u mbrojtën sipas premtimit të Zotit.

Gjaku i përdorur nga izraelitët, simbolikë e Shlyerjes së ardhshme për njerëzimin të Shpëtimarit, ishte produkt i sakrificës që ata kishin ofruar. Megjithatë, vetëm sakrificat dhe gjaku nuk do të kishin qenë të mjaftueshme për të marrë bekimin e premtuar. *Pa vënien e gjakut në arkitra, sakrificat do të kishte qenë e kotë.*

Presidenti Tomas S. Monson na ka mësuar: “Puna misionare është e vështirë. Ajo shteron energjitë e dikujt, sforcon kapacitetin e dikujt, ajo kërkon përpjekjen më të mirë të dikujt. . . . Asnjë punë tjetër nuk kërkon orë më të gjata ose përkushtim më të madh, ose sakrificë të tillë dhe lutje të zjarrtë” (“That All May Hear”, *Ensign*, maj 1995, f. 49).

Si rezultat i asaj sakrifice, ne



kthehemi nga misionet me dhuratat tona: Dhuratën e besimit. Dhuratën e dëshmisë. Dhuratën e të kuptuarit të rolit të Shpirtit. Dhuratën e studimit të përditshëm të ungjillit. Dhuratën që i kemi shërbyer Shpëtimarit tonë. Dhurata të paketuara me kujdes me shkrime të shenjta të ngrëna nga përdorimi, kopje të bëra copë të manualit *Predikoni Ungjillin Tim*, ditare të misionarit dhe zemra mirënjohëse. Megjithatë, ashtu si bijtë e Izraelit, bekimet e vazhdueshme që lidhen me shërbimin misionar, kërkojnë vënien në jetë pas sakrificës.

Disa vite më parë, kur unë dhe Motra Uadell kryesua në Misionin e Spanjës, Barcelonë, unë do t’i caktoja një detyrë të fundit secilit misionar/e gjatë intervistës së tyre përfundimtare. Kur ata/ato të ktheheshin në shtëpi, iu kërkuar që menjëherë të përdornin kohë për të menduar mbi mësimet dhe dhuratat e ofruara atyre nga një Atë bujar në Qiell. Atyre iu kërkuar që me lutje të renditnin dhe të merrnin parasysh se si t’i zbatonin më mirë këto mësimet në jetën pas

misionit – mësimet që do të ndikonin çdo aspekt të jetës së tyre: arsimimin dhe zgjedhjen e karrierës, martesën dhe fëmijët, shërbimin e ardhshëm në Kishë dhe, akoma më e rëndësishmja, se cilët do të vazhdonin të bëheshin dhe zhvillimin e tyre të vazhdueshëm si dishepuj të Jezu Krishtit.

Nuk është kurrë vonë për asnjë misionar të kthyer për të menduar mësimet e fituara përmes shërbimit besnik dhe për t’i aplikuar ato me më shumë zell. Kur e bëjmë këtë, ne do ta ndiejmë ndikimin e Shpirtit më plotësisht në jetën tonë, familjet tona do të forcohen dhe do të afroheni më pranë Shpëtimarit dhe Atit tonë në Qiell. Në një konferencë të mëparshme të përgjithshme, Plaku L. Tom Peri dha këtë ftesë: “Unë ju bëj thirrje ju misionarëve të kthyer që të ripërkushtoheni, të rizbuloni dëshirën dhe shpirtin e shërbimit misionar. Unë ju bëj thirrje që t’i ngjani, të jeni dhe të veproni si një shërbëtor i Atit tonë në Qiell. . . . Unë dëshiroj t’ju premtoj juve se ka bekime të mrekullueshme gati për ju nëse vazhdoni të ecni

përpara me zellin që ju dikur e kishit si një misionar kohëplotë” (“The Returned Missionary”, *Liahona*, janar 2002, f. 88, 89; *Ensign*, nëntor 2001, f. 77).

Tani, për të rinjtë që kanë ende për të të shërbyer një mision kohëplotë, unë ndaj këshillën e Presidentit Monson nga tetori i kaluar: “Unë ju përsëris atë që kanë dhënë mësim prej kohësh profetët – që çdo i ri i denjë dhe i aftë duhet të përgatitet që të shërbejë në mision. Shërbimi misionar është një detyrë priftërie – një detyrim që Zoti e pret prej nesh, të cilëve na është dhënë kaq shumë” (“Ndërsa Prapë Takohemi së Bashku”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 5–6).

Ashtu si me misionarët e kaluar dhe të tanishëm, Zoti ju njeh ju dhe ka një përvojë misioni të përgatitur për ju. Ai e njeh presidentin tuaj të misionit dhe bashkëshorten e tij të mrekullueshme, të cilët do t’ju duan juve si fëmijët e tyre dhe që do të kërkojnë frymëzim dhe drejtim në emrin tuaj. Ai e njeh secilin prej shokëve tuaj dhe çfarë ju do të mësoni nga ata. Ai e njeh çdo zonë në të cilën ju do të punoni, anëtarët që do të takoni, njerëzit që do të mësoni dhe jetët që do të ndikoni për përjetësinë.

Nëpërmjet shërbimit tuaj të përkushtuar dhe sakrificës së vullnetshme, misioni juaj do të bëhet përvojë e shenjtë për ju. Ju do të dëshmoni mrekullinë e kthimit në besim ndërsa Shpirti punon përmes jush për të prekur zemrat e atyre që ju mësoni.

Ndërsa përgatiteni për të shërbyer, ka shumë për të bërë. Të bërit një shërbëtor i dobishëm i Zotit do të kërkojë më shumë se të qenit të veçuar, se të vendosurit e emrit në pllakëz ose të futurit në qendrën e trajnimit misionar. Ai është një proces që fillon shumë kohë para se të referoheni si “Plaku”.

Mbërrini në misionin tuaj me dëshminë tuaj vetjake për Librin e

Mormonit, të marrë nëpërmjet studimit dhe lutjes. “Libri i Mormonit është një dëshmi e fuqishme e hyjnisë së Krishtit. Ai është gjithashtu një provë e Rivendosjes me anë të Profetit Jozef Smith. . . . Si një misionar, në fillim ju duhet të keni vetë një dëshmi personale se Libri i Mormonit është i vërtetë. . . . Kjo dëshmi e Frymës së Shenjtë [do të bëhet] epiqendra e mësimdhënies tuaj” (*Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* [2004], f. 107).

Mbërrini në misionin tuaj të denjë për shoqërimin e Frymës së Shenjtë. Sipas fjalëve të Presidentit Ezra Taft Benson: “Shpirti është elementi i vetëm më i rëndësishëm i kësaj pune. Me Shpirtin që lartëson thirrjen tuaj, ju mund të bëni mrekulli për Zotin, në fushën e misionit. Pa Shpirtin, ju kurrë nuk do të përparoni *pavarësisht* nga talenti dhe aftësitë tuaja” (në *Predikoni Ungjillin Tim*, f. 182).

Mbërrini në misionin tuaj gati për të punuar. “Suksesi juaj si misionar [do të] matet kryesisht nga përkushtimi juaj për të gjetur, mësuar, pagëzuar dhe konfirmuar.” Nga ju pritet të “punoni efektivisht çdo ditë, [duke dhënë] maksimumin tuaj për të sjellë shpirtin te Krishti” (*Predikoni Ungjillin Tim*, f. 10, 11).

Unë e përsëris ftesën e Plakut M. Rasëll Ballard, dhënë një grupi të rinjsh të mëparshëm që po përgatiteshin për të shërbyer: “Ne e hedhim vështrimin tek ju, vëllezërit e mi të rinj të Priftërisë Aarone. Ne kemi nevojë për ju. Ashtu si 2.000 ushtarët e rinj të Helamanit, ju jeni gjithashtu bij shpirtërorë të Perëndisë dhe ju gjithashtu mund të pajiseni me fuqinë për të ngritur dhe mbrojtur mbretërinë e Tij. Ne kemi nevojë që ju të bëni besëlidhje të shenjta, sikurse ata i bënë. Ne kemi nevojë që ju të jeni plotësisht të bindur dhe besnikë,

sikurse ishin ata” (“The Greatest Generation of Missionaries”, *Liahona*, nëntor 2002, f. 47).

Ndërsa ju pranoni këtë ftesë, ju do të mësoni një mësim të mrekullueshëm, siç mësoi Plaku Misiego dhe të gjithë ata që kanë shërbyer, janë rikthyer dhe e kanë vënë në jetë me besnikëri. Ju do të mësoni se fjalët e profetit tonë, Presidentit Tomas S. Monson, janë të vërteta: “Mundësia unike në jetë e misionit është e juaja. Bekimet e përjetësisë ju presin juve. I juaji është privilegj për të mos qenë spektatorë por pjesëmarrës në skenën e shërbimit të priftërisë” (*Ensign*, maj 1995, f. 49). Unë dëshmoj se kjo është e vërtetë, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■





Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Ndihma sipas Mënyrës së Zotit

Parimet e mirëqenies së Kishës nuk janë thjesht ide të mira; ato janë të vërteta të zbuluara nga Perëndia – ato janë mënyra e Tij për të ndihmuar nevojtarët.

Gjashtëdhjetë e pesë vjet më parë, pak pas Luftës II Botërore, unë përjetova bekime vetjake nga programi i Kishës për mirëqenien. Megjithëse isha një fëmijë i vogël, unë ende e kujtoj shijen e ëmbël të pjeshkëve të konservuara me qull gruri dhe aromën e veçantë të veshjeve të dhuruara që iu dërguan shenjtorëve gjermanë pas luftës nga anëtarë të përkujdesur të Kishës në Shtetet e Bashkuara. Unë nuk do t'i harroj kurrë dhe do t'i ruaj përgjithmonë kujtimet e këtyre veprave të dashurisë dhe mirësisë për ata si ne që ishin në nevojë të madhe.

Kjo përvojë vetjake dhe 75-vjetori i planit të frymëzuar të mirëqenies më japin mua arsye për të menduar sërish mbi parimet themelore të përkujdesjes për të varfrin dhe nevojtarin, të bërit të mbështetur te vetja dhe shërbimin ndaj bashkëqenieve tona.

Në Rrënjë të Besimit Tonë

Ndonjëherë, ne e konsiderojmë mirëqenien thjesht si një parim tjetër ungjilli – një prej shumë degëve të pemës së ungjillit. Por unë besoj se në planin e Zotit, zotimi ynë ndaj

parimeve të mirëqenies duhet të jetë shumë në rrënjën e besimit dhe përkushtimit tonë ndaj Tij.

Që prej fillimit të kohëve, Ati ynë Qiellor ka folur shumë qartë mbi këtë temë, duke përfshirë lutjen e dhembshur: “Nëse më do . . . ti do të kujtosh të varfërit dhe do të përku-shtosh prej gjithë pronave të tua për mbështetjen e tyre”¹; si dhe urdhër të drejtpërdrejtë: “Kujtoni në gjithçka të varfërit dhe nevojtarët, të sëmurët dhe të bregosurit, sepse ai që nuk i bën këto gjëra, po ai nuk është dishepulli im”² dhe gjithashtu, paralajmërime të theksuara dhe të forta: “Si rrjedhim, në qoftë se dikush do të marrë nga bollëku që kam krijuar dhe nuk do t’u japë nga pjesa e tij, sipas ligjit të ungjillit tim, të varfërve dhe nevojtarëve, ai, me të ligjtë, do t’i hapë sytë e tij në ferr, duke qenë i munduar”³.

Fizikja dhe Shpirtërorja Janë të Lidhura Bashkë

Dy urdhërimet e mëdha – ta doni Perëndinë dhe të afërmin tuaj – janë një bashkim i fizikes dhe shpirtërores. Është e rëndësishme të dallojmë se këto dy urdhërime quhen “të mëdha”

pasi nga këto dy urdhërime varet i tërë ligji dhe profetët.⁴ Me fjalë të tjera, përparësitë tona vetjake, familjare dhe të Kishës duhet të fillojnë me këto dy urdhërime. Të gjithë qëllimet dhe veprimet e tjera duhet të rrjedhin nga burimi i këtyre dy urdhërimeve të mëdha – nga dashuria jonë për Perëndinë dhe për të afërmit tanë.

Njësoj si dy anët e një mone-dhe, fizikja dhe shpirtërorja janë të pandashme.

Dhuruesi i jetës ka shpallur: “Si rrjedhim, me të vërtetë unë ju them se gjithë gjërat për mua janë shpirtërore dhe asnjëherë nuk ju kam dhënë një ligj që është tokësor”⁵. Kjo për mua do të thotë që “përbërësi i parë i jetës shpirtërore është të jetuarit. Nuk është thjesht diçka që duhet njohur e studiuar, është diçka që duhet jetuar.”⁶

Fatkeqësisht, ka nga ata që e anashkalojnë fiziken pasi ata e konsiderojnë atë më pak të rëndësishme. Ata ruajnë si thesar shpirtëroren ndërkohë që e zbehin fiziken. Ndërsa është e rëndësishme që t’i kemi mendimet e drejtuara nga qielli, ne humbasim thelbin e fesë sonë nëse veprimet tona nuk janë gjithashtu të drejtuara nga bashkëqeniet tona.

Për shembull, Enoku ndërtoi një shoqëri Sioni nëpërmjet procesit shpirtëror të të bërit që njerëzit të ishin të një zemre dhe të një mendjeje dhe të punës fizike për të siguruar se “nuk kishte të varfër mes tyre”⁷.

Si gjithmonë ne mund të shohim shembullin tonë të përkryer, Jezu Krishtin, për model. Siç na mësoi Presidenti J. Ruben Klark: “Kur Shpëtimtari erdhi në tokë, ai kishte dy misione të mëdha; njëri ishte të përmbushte rolin si Mesia, shlyerjen për rënien dhe përmbushjen e ligjit, misioni tjetër ishte puna që ai bëri mes vëllezërve dhe motrave të tij në mish, të cilët i çliroi nga vuajtjet e tyre”⁸.

Në mënyrë të ngjashme, përparimi ynë shpirtëror është i lidhur në mënyrë të pandashme me shërbimin fizik që ne u japim të tjerëve.

Njëri plotëson tjetrin. Njëri pa tjetrin është një shtrembërim i planit të lumturisë të Perëndisë.

Mënyra e Zotit

Ka shumë njerëz dhe organizata të mira në botë që po përpiqen të plotësojnë nevojat e ngutshme të të varfërve dhe nevojtarëve gjithandej. Ne jemi mirënjohës për këtë, por mënyra e përkujdesjes së Zotit për nevojtarët është e ndryshme nga mënyra e botës. Zoti ka thënë: “Por duhet të bëhet sipas mënyrës sime”⁹. Ai nuk interesohet vetëm për nevojat tona të ngutshme; Ai shqetësohet edhe për përparimin tonë të përjetshëm. Për këtë arsye, mënyra e Zotit ka përfshirë gjithmonë mbështetjen te vetja dhe shërbimin ndaj të afërmeve tanë përveç përkujdesjes ndaj të varfërve.

Në vitin 1941 lumi Hila doli nga shtrati dhe përmyti luginën Dankan në Arizona. Një president i ri kunji me emrin Spenser W. Kimball, u takua me këshilltarët e tij, bëri vlerësimin e dëmit dhe dërgoi një telegram në Solt-Lejk-Siti duke kërkuar një shumë të madhe parash.

Në vend që t’u dërgonte para, Presidenti Hibër J. Grant u dërgoi tre burra: Henri D. Moilin, Marion G. Romnin dhe Harold B. Linë. Ata shkuan për vizitë së bashku me Presidentin Kimball dhe i mësuat atij një mësim të rëndësishëm: “Ky nuk është një program ‘me jepni mua’”, thanë ata. “Ky është një program i ‘të ndihmuarit të vetes’”.

Shumë vite më vonë, Presidenti Kimball tha: “Do të kishte qenë një gjë e lehtë, mendoj, që vëllezërit të na i kishin dërguara [paratë] dhe nuk do të kishte qenë shumë e vështirë të uletsha



San-Salvador në Salvador

në zyrën time dhe t’i shpërndaja ato; por sa shumë të mira na erdhën kur patëm qindra nga [njerëzit tanë] që shkuan në Dankan e ndërjuan gardhe dhe çuan sanën, niveluan tokën dhe bënë të gjitha gjërat që duheshin bërë. Kjo është të ndihmosh veten.”¹⁰

Duke ndjekur mënyrën e Zotit, anëtarëve të kunjit të Presidentit Kimball jo vetëm që iu plotësuan nevojat e tyre të ngutshme, por ata zhvilluan edhe mbështetjen te vetja, iu lehtësuan vuajtjet dhe u rritën në dashuri e unitet ndërkohë që i shërbyen njëri-tjetrit.

Ne Jemi të Gjithë të Rekrutuar

Në këtë çast ka shumë anëtarë të Kishës që po vuajnë. Ata janë të uritur, me probleme financiare dhe duke luftuar me vuajtjen fizike, emocionale dhe shpirtërore. Ata lutën me gjithë energjinë e shpirtit të tyre për ndihmë, për lehtësim.

Vëllezër, ju lutem mos mendoni se kjo është përgjegjësia e tjetërkujt. Ajo është e imja dhe e juaja. Ne jemi të gjithë të rekrutuar. “Të gjithë” do të thotë *të gjithë* – çdo mbajtës i priftërisë Aaronë dhe Melkizedeke, i pasur apo i varfër, në çdo komb. Në planin e Zotit, secili ka diçka me të cilën mund të ndihmojë.¹¹

Mësimi që ne marrim brez pas brezi, është se të pasurit dhe të varfërit kanë të *gjithë* të njëjtin detyrim të shenjtë për të ndihmuar të afërmin e tyre. Do të na duhet të gjithëve të punojmë që t’i zbatojmë me sukses parimet e mirëqenies

dhe mbështetjes te vetja.

Shumë shpesh ne i vëmë re nevojat që ka rrotull nesh, duke shpresuar se dikush nga larg do të shfaqet në mënyrë magjike për t’i plotësuar këto nevoja. Ndoshta ne presim që probleme të caktuara t’i zgjidhin ekspertë me njohuri të specializuara. Kur e bëjmë këtë, ne i mohojmë të afërmit tonë shërbimin që mund t’i bënim dhe i mohojmë vetes mundësinë për të shërbyer. Megjithatë nuk ka asgjë kundër ekspertëve, le të jemi të vërtetë: nuk do të ketë kurrë ekspertë të mjaftueshëm për t’i zgjidhur gjithë problemet. Në vend të tyre, Zoti e bëri priftërinë e Tij dhe organizatën e saj lehtësisht të gjindshme në çdo vend të botës ku Kisha është ngritur. Dhe së bashku me të, Ai ka vënë në dispozicion edhe Shoqatën e Ndihmës. Siç e dimë ne mbajtësit e priftërisë, asnjë përpjekje për mirëqenie nuk është e suksesshme nëse nuk arrin të përdorë dhuratat dhe talentet e mrekullueshme të grave.

Mënyra e Zotit nuk është të ulemi buzë përroit të problemeve dhe të presim sa të thahet uji përpara se të kalojmë. Mënyra e Zotit është që të mblidhemi së bashku, të përveshim mëngët, të shkojmë të punojmë dhe të ndërtojmë një urë ose një barkë që të kalojmë ujërat e sfidave tona. Ju burra të Sionit, ju mbajtës të priftërisë, jeni ata që mund të drejtoni dhe t’u sillni lehtësim shenjtë duke zbatuar parimet e frymëzuara të programit të mirëqenies! Është misioni

juaj që të hapni sytë, të përdorni priftërinë tuaj dhe të shkoni të punoni sipas mënyrës së Zotit.

Organizata më e Madhe mbi Tokë

Gjatë Depresionit të Madh, Harold B. Li-së, duke shërbyer atëherë si president kunji, iu kërkua nga Vëllezërit që të gjente një përgjigje për varfërinë shtypëse, hidhërimin dhe urinë që ishin të përhapura aq shumë nëpër botë në atë kohë. Ai u mundua që të gjente një zgjidhje dhe e çoi çështjen te Zoti, dhe e pyeti: “Çfarë lloj organizate duhet të kemi . . . për ta bërë këtë?”

Dhe “ndodhi që Zoti i tha [atij]: ‘Shiko, bir. Ju nuk keni nevojë për asnjë organizatë tjetër. Unë ju kam dhënë organizatën më të mirë që gjendet në faqen e tokës. Asgjë nuk është më e madhe se organizata e priftërisë. Gjithçka që ju duhet të bëni është ta vini priftërinë në punë. Kjo është e gjitha.’”¹²

Kjo është pika e nisjes në jetën tonë gjithashtu. Ne tashmë e kemi të vendosur organizatën e Zotit. Sfidat janë të përcaktuara se si do ta përdorim.

Ne duhet të fillojmë duke u mësuar vetë me atë që Zoti ka zbuluar tashmë. Ne nuk duhet ta marrim të mirëqenë se e dimë. Ne duhet t'i qasemi kësaj çështjeje me përvullësinë e një fëmije. Çdo brez duhet t'i mësojë nga e para doktrinat që janë baza e mënyrës së Zotit për t'u kujdesur për nevojtarët. Ndërsa shumë profetë na kanë udhëzuar përgjatë viteve, parimet e mirëqenies së Kishës nuk janë thjesht ide të mira; ato janë të vërteta të zbuluara nga Perëndia – ato janë mënyra e Tij për të ndihmuar nevojtarët.

Vëllezër, studioni së pari parimet dhe doktrinat e zbuluara. Lexoni manualët lidhur me mirëqenien e Kishës;¹³ shfrytëzoni faqen e internetit



Lajçester në Angli

providentliving.org; rilexoni artikullin e qershorit të *Liahonës* së vitit 2011 mbi planin e mirëqenies së Kishës. Zbuloni rreth mënyrës së Zotit për të ndihmuar shenjtoret e Tij. Mësoni se si e plotësojnë njëri-tjetrin parimet e kujdesit për nevojtarin, shërbimit ndaj të afërmit dhe parimi i mirëqenies. Mënyra e Zotit për mirëqenien përfshin në një mënyrë të ekuilibruar shumë aspekte të jetës, duke përfshirë arsimimin, shëndetin, punësimin, ekonominë e familjes dhe forcën shpirtërore. Njihuni me programin modern të Kishës për mirëqenien¹⁴.

Pasi t'i keni studiuar doktrinat dhe parimet e planit të mbarë Kishës për mirëqenien, shihni t'i zbatoni ato që keni mësuar për nevojat e atyre të cilëve jeni përgjegjës t'u shërbeni. Kjo do të thotë që, në pjesën më të madhe, juve do t'ju duhet ta zbuloni vetë. Çdo familje, çdo mbledhje, çdo zonë e botës është e ndryshme. Nuk ka përgjigje që të zbatohet për të gjithë në mirëqenien e Kishës. Ai është një program i të ndihmuarit të vetes ku individët janë përgjegjës për mbështetjen përkatëse te vetja. Burimet tona përfshijnë lutjen vetjake, talentet dhe aftësitë përkatëse që na janë dhënë nga Perëndia, pasuri që na vihen në dispozicion nga vetë familjet tona dhe anëtarët e fisit, burimet e ndryshme të komunitetit dhe me siguri mbështetjen përkujdesëse të kuorumeve të priftërisë e të Shoqatës së Ndhimës. Kjo do të na udhëheqë përgjatë modelit të

frymëzuar të mbështetjes te vetja.

Do t'ju duhet të bëni një plan që është në përputhje me doktrinën e Zotit dhe që u përgjigjet rrethanave të zonës suaj gjeografike. Për t'i vënë në zbatim parimet hyjnore të mirëqenies, nuk keni pse të shikoni gjithmonë nga Solt-Lejk-Siti. Përkundrazi, ju duhet të shihni në manualët tuaja, në zemrën tuaj dhe në qiell. Mirëbesojini frymëzimit të Zotit dhe ndiqni mënyrën e Tij.

Në fund të fundit, ju duhet të bëni në zonën tuaj atë që kanë bërë dishepujt e Krishtit në çdo periudhë ungjillore: të këshilloheni bashkë, të përdorni gjithë burimet që keni në dispozicion, të kërkoni frymëzimin e Frymës së Shenjtë, të kërkoni miratimin e Zotit dhe pastaj të përvishni mëngët e të filloni nga puna.

Unë ju jap një premtim: “nëse ju do të ndiqni këtë model, ju do të merrni udhëzime të detajuara se *kë, çfarë, kur* dhe *ku* duhet të ndihmoni sipas mënyrës së Zotit.

Bekimet e Ndhimës sipas Mënyrës së Zotit

Premtimet dhe bekimet profetike të mirëqenies së Kishës, të ndihmës sipas mënyrës së Zotit, janë disa nga më madhështoret dhe të mrekullueshmet që Zoti u ka dhënë fëmijëve të Tij. Ai tha: “Në rast se plotëson nevojat e të uriturit dhe ngop shpirtin e pikëlluar, atëherë drita jote do të lindë nga terri dhe terri yt do të jetë si mesdita: Dhe Zoti do të të udhëheqë vazhdimisht.”¹⁵

Qoftë nëse jemi të pasur apo të varfër, pavarësisht se ku jetojmë në këtë botë, ne të gjithë kemi nevojë për njëri-tjetrin, dhe kjo bëhet duke sakrifikuar kohën, talentet dhe burimet tona që shpirtat tanë të rriten dhe të gdhenden.

Kjo punë e ndihmës sipas mënyrës së Zotit nuk është thjesht një artikull tjetër në listën e programeve të Kishës.

Ajo nuk mund të mos përfillet apo të lihet mënjatë. Ajo është qendrore për doktrinën tonë, është thelbi i besimit tonë. Vëllezër, është privilegj i madh dhe i veçantë për ne si mbajtës të priftërisë që ta përdorim priftërinë për të kryer punën. Ne nuk duhet t'i largojmë zemrat ose mendjet tona nga të mbështeturit më shumë të vetja, përkujdesja më e mirë për nevojtarët dhe dhënia e shërbimit të dhembshur.

Gjërat fizike janë të lidhura ngushtë me ato shpirtërore. Perëndia na e ka dhënë këtë përvojë tokësore dhe sfidat fizike që janë të lidhura me të si një laborator ku ne mund të rritemi për t'u bërë qeniet që Ati Qiellor dëshiron që ne të bëhemi. E kuptofshim detyrën dhe bekimin e madh që vijnë nga ndjekja dhe ndihma sipas mënyrës së Zotit është lutja ime, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 42:29, 30.
2. Doktrina e Besëlidhje 52:40.
3. Doktrina e Besëlidhje 104:18.
4. Shih Mateu 22:36–40.
5. Doktrina e Besëlidhje 29:34.
6. Thomas Merton, *Thoughts in Solitude* (1956), f. 46.
7. Moisiu 7:18.
8. J. Reuben Clark Jr., në Conference Report, prill 1937, f. 22.
9. Doktrina e Besëlidhje 104:16; shih edhe vargun 15.
10. Spencer W. Kimball, në Conference Report, prill 1974, f. 183, 184.
11. Shih Mosia 4:26;18:27.
12. Harold B. Lee, fjalim i mbajtur në një mbledhje për planin bujqësor të mirëqenies, tetor 1970, f. 20.
13. Shih *Handbook 1: Stake Presidents and Bishops* (2010), kapitulli 5, "Administering Church Welfare"; *Handbook 2: Administering the Church* (2010), kapitulli 6, "Welfare Principles and Leadership"; *Providing in the Lord's Way: Summary of a Leader's Guide to Welfare* (broshurë, 2009).
14. Libri i Plakut Glen L. Rudd *Pure Religion: The Story of Church Welfare since 1930* (1995), i disponueshëm nga Shërbimet e Shpërndarjes për Kishën, është një vend i mrekullueshëm për të studiuar doktrinën dhe historinë e programit të Zotit për mirëqenien.
15. Isaia 58:10–11; shih edhe vargjet 7–9.



Nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

Përgatitja në Priftëri: "Unë Kam Nevojë për Ndhimën Tuaj"

Mos u shqetësoni se sa të papërvojë jeni ose mendoni se jeni, por mendoni se çfarë mund të bëheni me ndihmën e Zotit.

Vëllezërit e mi të dashur, është një gëzim për mua të jem me ju në këtë mbledhje mbarëbotërore të priftërisë së Perëndisë. Sonte do të flas për përgatitjen e priftërisë, si për tonën edhe për atë që ne ndihmojmë të sigurohet për të tjerët.

Nganjëherë, shumica prej nesh mund të pyesin veten: "A jam i përgatitur për këtë detyrë në priftëri?" Përgjigjja ime është: "Po, ju keni qenë të përgatitur". Qëllimi im sot është për t'ju ndihmuar juve ta njihni atë përgatitje dhe të merrni guxim prej saj.

Siç e dini, Priftëria Aarone është përcaktuar si një priftëri përgatitore. Pjesa më e madhe e mbajtësve të Priftërisë Aarone janë dhjakë, mësues dhe priftërinj të rinj, midis moshës 12 dhe 19 vjeç.

Ne mund të mendojmë për përgatitjen e priftërisë që ndodh në vitet e Priftërisë Aarone. Por Ati ynë Qiellor na ka përgatitur ne që kur po merrnim mësim në praninë e Tij, në mbretërinë e Tij përpara se të lindnim. Ai është duke na përgatitur ne sonde. Dhe Ai

do të vazhdojë të na përgatisë për aq kohë sa ne do ta lejojmë Atë.

Qëllimi i gjithë përgatitjes së priftërisë, në jetën para lindjes dhe në këtë jetë, është të na përgatisë ne dhe ata që i shërbejnë Atij për jetën e përjetshme. Disa nga mësimet e para në jetën para lindjes, pa dyshim që përfshinin planin e shpëtimit, me Jezu Krishtin dhe Shlyerjen e Tij në qendër të tij. Ne jo vetëm që na u mësua plani, por ishim në këshillin ku e zgjedhëm planin.

Për shkak se një vel harrese u vendos në mendjen tonë në lindje, ne duhet të gjenim një mënyrë për t'i mësuar përsëri në këtë jetë ato që dikur i dinim dhe i mbronim. Pjesë e përgatitjes sonë në këtë jetë ka qenë gjetja e asaj të vërtetë të çmuar, në mënyrë që më pas të zotohemi sërish për të përmes besëlidhjes. Kjo ka kërkuar besim, përlësi dhe guxim nga ana jonë, si dhe ndihmë nga njerëzit që e kishin gjetur të vërtetën dhe më pas e ndanë atë me ne.

Ata mund të kenë qenë prindërit,

misionarët apo miqtë. Por ajo ndihmë ishte pjesë e përgatitjes sonë. Përgatitja jonë në priftëri gjithmonë përfshin të tjerët që tashmë kanë qenë të përgatitur për të na ofruar neve mundësinë për të pranuar ungjillin dhe që më pas zgjedhin të veprojnë përmes mbajtjes së besëlidhjeve, për ta bërë atë pjesë të zemrës tonë. Në mënyrë që ne të kualifikohemi për jetën e përjetshme, shërbimi ynë në këtë jetë duhet të përfshijë të punuarin me gjithë zemrën, mendjen dhe fuqinë e forcën tonë për të përgatitur të tjerët që të kthehen tek Perëndia me ne.

Pra, pjesë e përgatitjes së priftërisë që ne do të kemi në këtë jetë do të jenë mundësitë për t'u shërbyer dhe dhënë mësim të tjerëve. Kjo mund të përfshijë të qenit mësues në Kishë, baba i urtë e i dashur, anëtar i një kuorumi dhe misionar për Zotin Jezu Krisht. Zoti do t'i ofrojë mundësitë, por do të varet nga ne nëse do jemi të përgatitur. Synimi im sonte është të vë në dukje disa nga zgjedhjet vendimtare të domosdoshme për përgatitjen e priftërisë për të pasur sukses.

Zgjedhjet e drejta si nga personi që e përgatit edhe nga ai që po përgatitet, varen nga disa njohuri rreth mënyrës se si Zoti i përgatit shërbëtorët e Tij të priftërisë.

Së pari, Ai thërret njerëz, të rinj dhe të vjetër, që mund të duken të jenë të dobët dhe të thjeshtë tek njerëzit e kësaj bote, madje edhe tek vetja e tyre. Zoti mund t'i shndërrojë ato mangësi në dukje në pika të forta. Kjo do të ndryshojë mënyrën se si udhëheqësi i urtë zgjedh kë dhe si do ta përgatisë. Dhe kjo mund të ndryshojë mënyrën se si mbajtësi i priftërisë u përgjigjet mundësive për zhvillim, që po i ofrohen.

Le të marrim parasysh disa shembuj. Unë isha një prift i papërvojë në një lagje të madhe. Peshkopi im më telefonoi



një pasdite të diele. Kur iu përgjigja në telefon, ai tha: "A keni kohë të vini me mua? Unë kam nevojë për ndihmën tuaj." Ai thjesht më shpjegoi se donte që të shkoja si shoku i tij shoqëruar për të vizituar një grua, që nuk e njihja, por që nuk kishte ushqim dhe kishte nevojë që të mësonte si t'i administronte të ardhurat e saj më mirë.

Atëherë, unë e dija se ai kishte dy këshilltarë me përvojë në peshkopatën e tij. Të dy ishin njerëz të pjekur, që kishin përvojë të madhe. Njëri këshilltar ishte pronari i një biznesi të madh, i cili më vonë u bë president misioni dhe një Autoritet i Përgjithshëm. Këshilltari tjetër ishte një gjykatës i mirënjohur në qytet.

Unë isha ndihmësi i parë, i sapothi-rurrur i peshkopit në kuorumin e priftërinjve. Ai e dinte se unë nuk kuptoja shumë rreth parimeve të mirëqenies. Dija akoma dhe më pak për financat vetjake. Unë ende nuk kisha firmosur një çek; nuk kisha një llogari bankare; madje nuk kisha parë një buxhet vetjak. Megjithatë, pavarësisht mungesës time të përvojës, unë e kuptova se ai ishte tepër serioz kur tha: "Unë kam nevojë për ndihmën tuaj".

Unë arrita të kuptoja se çfarë donte të thoshte ai peshkop i frymëzuar. Ai më pa mua si një mundësi të shkëlqyer për të përgatitur një mbajtës

priftërie. Jam i bindur se ai nuk parashikoi një anëtar të ardhshëm të Peshkopatës Kryesuese tek ai djalë i pastërvitur. Por që nga ajo ditë, dhe gjithë ditët që e njoha atë gjatë viteve, ai më trajtoi si një projekt përgatitjeje shumë premtues.

Ai dukej që gëzohej nga kjo, por për të ishte punë. Pas kthimit tonë për në shtëpinë time, pasi vizituam të venë në nevojë, ai parkoi makinën. Ai hapi shkrimet e tij shenja shumë të përdorura dhe të nënvizuara shumë. Dhe ai më qortoi ëmbëlsisht. Ai më tha se unë duhet të studioja shkrimet e shenja dhe të mësoja më shumë. Por ai duhet të ketë parë se unë isha mjaftueshëm i dobët dhe i thjeshtë për të nxënë. Edhe sot më kujtohet çfarë më mësoi ai atë pasdite. Por më shumë më kujtohet se sa i sigurt ishte ai që unë mund të mësoja dhe të isha më i mirë – dhe se unë do të isha.

Ai pa përtej realitetit se kush isha unë me mundësitë e ardhshme të dikujt që ndihet mjaftueshëm i dobët dhe i thjeshtë për të dashur ndihmën e Zotit dhe për të besuar se ajo do t'i vijë.

Peshkopët, presidentët e misioneve dhe baballarët mund të zgjedhin për të vepruar mbi këto mundësi. E pashë atë të ndodhte kohët e fundit në një mbledhje agjërimit ndërsa një president i kuorunit të dhjakëve ndau dëshminë

e tij. Ai po përgatitej për t'u bërë mësues dhe për të lënë pas vetes anëtarët e kuorumit të tij.

Ai dëshmoi me emocione të mëdha në zë për rritjen në mirësi dhe fuqi tek anëtarët e kuorumit të tij. Unë kurrë nuk kam dëgjuar një person të lavdërojë një organizatë në mënyrë më të mrekullueshme se e bëri ai. Ai e lëndoi shërbimin e tyre. Dhe më pas tha se ai e dinte se kishte qenë në gjendje t'i ndihmonte dhjakët e rinj kur ata ndiheshin të hutuar, sepse ishte ndier i hutuar kur ai hyri në priftëri.

Ndjenjat e tij të dobësisë e kishin bërë atë më shumë të duruar, më të dhimbsur dhe si pasojë, më të aftë për të forcuar dhe për t'u shërbyer të tjerëve. Në ato dy vite në Priftërinë Aarone, më dukej sikur ai ishte bërë i përgatitur dhe i urtë. Ai kishte mësuar se ishte ndihmuar si president i kuorumit nga një kujtim i qartë dhe i gjallë i vetë nevojave të tij kur ishte dy vjet më i ri. Sfidat e tij në të ardhmen në udhëheqjen e tij dhe e jona do të vijë kur kujtime të tilla zbehen dhe bëhen të turbullta nëpërmjet kohës dhe suksesit tonë.

Pali duhet ta ketë parë atë rrezik në këshillën për shokun e tij më të ri, misionar në priftëri, Timoteun. Ai e nxiti dhe e udhëzoi atë në përgatitjen e tij për priftërinë dhe në dhënien e ndihmës ndaj Zotit për të përgatitur të tjerët.

Dëgjoni se çfarë i tha Pali Timoteut, shokut të tij më të ri:

“Askush të mos e shpërfillë moshën tënde të re, por bëhu shembull për besimtarët në fjalë, në sjellje, në dashuri, në Frymë, në besim dhe në dëlirësi.

Kushtoj leximit, këshillimit dhe mësimit derisa të vij unë.

Mos e lër pas dore dhuntinë që është në ty, e cila të është dhënë me anë profecie, me vënien e duarve. . .

Ruaje veten tënde dhe mësimin;¹ qëndro në këtë gjëra, sepse, duke vepruar kështu, do të shpëtosh veten dhe ata që të dëgjojnë”².

Pali dha këshilla të dobishme për të gjithë ne. Mos u shqetësoni se sa të papërvojë jeni ose mendoni se jeni, por mendoni se çfarë mund të bëheni me ndihmën e Zotit.

Doktrina që Pali na nxiti ne për t'u ushqyer me bollëk në përgatitjen tonë në priftëri, janë fjalët e Krishtit dhe që kështu të kualifikohemi për marrjen e Frymës së Shenjtë. Atëherë, ne mund ta dimë se çfarë Zoti do që ne të bëjmë në shërbimin tonë dhe mund të marrim guximin për ta bërë atë, pavarësisht nga rrethanat me të cilat përballemi në të ardhmen.

Ne jemi duke u përgatitur për shërbimin e priftërisë që do të bëhet më sfidues me kalimin e kohës. Për shembull, muskujt tanë dhe mendja jonë vjetërohen çdo ditë. Aftësia jonë për të mësuar dhe mbajtur mend se çfarë kemi lexuar do të zvogëlohet. Për të dhënë shërbimin e priftërisë që Zoti pret prej nesh do të na duhet gjithnjë e më shumë vetëdisiplinë çdo ditë të jetës sonë. Ne mund të bëhemi të përgatitur për atë provë duke ndërtuar besimin përmes shërbimit çdo ditë.

Zoti na ka dhënë mundësinë për t'u përgatitur me diçka që Ai e quajti “betimi dhe besëlidhja [e] priftërisë”³.

Ajo është një besëlidhje që bëjmë me Perëndinë për të mbajtur të gjitha urdhërimet e Tij dhe për të dhënë shërbim siç Ai do ta kishte dhënë nëse do ishte personalisht i pranishëm. Të jetuarit me atë standard me më të mirën që mundemi, ndërton forcën që do të na duhet për të duruar deri në fund.

Përgatitës priftërie të efektshëm më kanë treguar si ta ndërtoj atë forcë: ajo është të krijosh një zakon të kapërcimit të lodhjes dhe frikës që mund t'ju bëjë të mendoni të hiqni dorë.

Këshilltarët e mrekullueshëm të Zotit më kanë treguar se fuqia e qëndrueshme shpirtërore vjen nga të punuarit përtej kufirit ndërkohë që të tjerët do të çlodheshin.

Ju udhëheqës fisnikë të priftërisë, që e keni ndërtuar atë forcë shpirtërore në rininë tuaj ende e zotëroni atë kur forca fizike dobësohet.

Vëllai im më i vogël ishte në një qytet të vogël të Jutas për punë. Ai mori një telefonatë në hotelin e tij nga Presidenti Spenser W. Kimball. Ishte vonë në darkë, pas një dite të vështirë pune për vëllanë tim dhe me siguri edhe për Presidentin Kimball, i cili e filloi bisedën në këtë mënyrë. Ai tha: “Dëgjova se keni qenë në qytet. E di që është vonë dhe që mund të jeni në shtrat, por a mund të më ndihmoni? Kam nevojë që të jeni shoku im shoqëruar për të parë gjendjen e të gjitha kishave tona në qytet.” Vëllai im shkoi me të atë natë, pa pasur njohuri për mirëmbajtjen dhe për asgjë rreth godinave kishtarë dhe duke mos e ditur se përse Presidenti Kimball duhet të bënte diçka të tillë pas një dite të gjatë për të, apo përse ai kishte nevojë për ndihmë.

Vite më vonë unë mora një telefonatë të ngjashme vonë natën në një hotel në Japoni. Atëherë unë isha përfaqësues i ri i arsimit për Kishën. E dija se Presidenti Gordon B. Hinkli po qëndronte diku në të njëjtin hotel, në detyrën e tij të veçantë në Japoni. Unë u përgjigja në telefon menjëherë pasi isha shtrirë në shtrat për të fjetur, i raskapitur nga bërja e gjithçkaje që mendoja se kisha forcën për të bërë.

Presidenti Hinkli me zërin e tij të këndshëm pyeti: “Përse je duke fjetur kur unë këtu jam duke lexuar një dorëshkrim që na është kërkuar ta shqyrtojmë?” Kështu që u ngrita dhe shkova të punoja edhe pse e dija se Presidenti Hinkli mund t'i jepte një



Davao në Filipine

shqyrtim më të mirë një dorëshkrimi, se sa ndoshta mund t'i jepja unë. Por në njëfarë mënyre ai më bëri të ndiej se kishte nevojë për ndihmën time.

Presidenti Tomas S. Monson, në fund të pothuajse çdo takimi e pyet sekretarin e Presidencës së Parë: "A jam i informuar për të rehat në punë?" Dhe ai gjithmonë buzëqesh kur i kthehet përgjigjja: "Oh, po, President, jeni i informuar". Buzëqeshja e kënaqur e Presidentit Monson më jep një mesazh. Ai më bën të mendoj: "A ka ndonjë gjë më shumë që mund të bëj në detyrat e mia?" Dhe pastaj shkoj përsëri në zyrë për të punuar.

Mësues të mrekullueshëm më kanë treguar se si të përgatitem për të mbajtur betimin dhe besëlidhjen kur koha dhe mosha e bëjnë më të vështirë. Ata më kanë treguar dhe mësuar si ta disiplinoh veten për të punuar më shumë se sa mendoja se mundja, ndërsa unë ende gëzoj shëndet dhe forcë.

Unë nuk mund të jem një shërbëtor i përsosur çdo orë, por unë mund të përpjekem për të dhënë më shumë përpjekje se sa mendoj unë se mund të jap. Me këtë zakon të formuar që herët, unë do jem i përgatitur më vonë për sprovat. Unë dhe ju mund të jemi të përgatitur me forcën për të mbajtur betimin dhe besëlidhjen nëpërmjet provave, që pa dyshim do të vijnë në fund të jetës.

Unë pashë provën për këtë në takimin e Bordit të Kishës për Arsimin.

Presidenti Spenser W. Kimball deri atëherë kishte ofruar vite shërbimi ndërsa duronte një seri sfidash të shëndetit që vetëm Jobi do t'i kuptonte. Ai ishte duke drejtuar mbledhjen atë mëngjes.

Papritmas, ai ndaloi së foluri. Ai ra në karrigen e tij. Sytë e tij u mbyllën. Koka i ra në gjoksin e tij. Unë isha ulur afër tij. Plaku Holland ishte afër nesh. Të dy ne u ngritëm për ta ndihmuar. Si të papërvojë që ishim për rastet emergjente, vendosëm ta mbartnim atë deri në zyrën e tij aty pranë, ashtu siç ishte ulur në karrigen tij.

Ai u bë mësuesi ynë në atë moment të vështirësisë së tij. Duke ngritur bashkë të dyja anët e karriges të tij, ne dolëm nga dhoma e mbledhjes në korridorin e Ndërtesës së Administratës së Kishës. Ai hapi sytë përgjysmë, ende dukshëm i habitur, dhe tha: "Oh, ju lutem, kini kujdes. Mos lëndoni kurrizin". Ndërsa u afruam te dera e zyrës së tij, ai tha: "Oh, ndihem keq që e ndërpreva takimin". Pak minuta pasi e çuam në zyrën e tij, ende duke mos e ditur se çfarë kishte, ai ngriti sytë tek ne dhe tha: "A nuk mendoni se duhet të ktheheni përsëri në mbledhje?"

Ne e lamë dhe nxituam, duke e ditur se në një farë mënyre prania jonë atje duhet të ishte e rëndësishme për Zotin. Presidenti Kimball kishte që në fëmijërinë e tij që e shtynte veten përtej kufijve të tij të durimit për t'i shërbyer dhe për ta dashur Zotin. Ishte një zakon kaq shumë i rrënjësor,

saqë ishte atje kur ai kishte nevojë për të. Ai ishte i përgatitur. Dhe kështu ai ishte në gjendje që të na mësonte dhe tregonte neve se si të jemi të përgatitur për të mbajtur betimin dhe besëlidhjen: përmes përgatitjes së qëndrueshme përgjatë viteve, përmes gjithë forcës tonë në ato që mund të duken detyra të vogla me pasoja të vogla.

Lutja ime është që ne t'i mbajmë besëlidhjet tona të priftërisë për ta kualifikuar veten për jetën e përjetshme dhe për të gjithë ata që jemi thirrur për t'i përgatitur. Unë ju premtoj se nëse ju bëni gjithçka që mundeni, Perëndia do ta rrisë forcën dhe urtësinë tuaj. Ai do t'ju përgatisë. Unë ju premtoj se ata që i përgatisni dhe u jepni shembull do ta lëvdojnë emrin tuaj sikurse unë sot lëvdoj përgatitësit e mrekullueshëm që kam njohur.

Unë dëshmoj se Perëndia, Ati, jeton dhe ju do. Ai ju njeh ju. Ai dhe Biri i Tij i ringjallur dhe i përlëvdur, Jezu Krishti iu shfaqën një djali të papërvojë, Jozef Smithit. Ata i besuan atij rivendosjen e plotësisë së ungjillit dhe të Kishës së vërtetë. Ata e nxitën atë kur ai kishte nevojë. Ata e lejuan atë të ndiente qortimin e dashur, që kur ta rrëzonte ta ngrinte lart. Ata e përgatitën atë dhe Ata janë duke na përgatitur ne, për forcën që të vazhdojmë të punojmë drejt lavdisë çelestiale që është qëllimi dhe arsyeja e gjithë shërbimit të priftërisë.

Unë ju lë juve bekimin tim, që ju do të jeni në gjendje të njihni mundësitë e mrekullueshme që Perëndia ju ka dhënë në thirrjen dhe përgatitjen tuaj për shërbimin ndaj Tij dhe shërbimin ndaj të tjerëve. Në emrin e udhëheqësit dhe mësuesit tonë të dashur, Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih 2 Nefi 32:3-6.
2. 1 Timoteu 4:12-14, 16.
3. Doktrina e Besëlidhje 84:39.



Nga Presidenti Tomas S. Monson

Kini Guxim të Qëndroni Vetëm

Qofshim ne gjithmonë të guximshëm dhe të përgatitur që të qëndrojmë për atë që besojmë.

Vëllezërit e mi të dashur, është një privilegj shumë i madh të jem me ju sonte. Ne që mbajmë priftërinë e Perëndisë, krijojmë një lidhje dhe vëllazëri të shkëlqyer.

Ne lexojmë në Doktrina e Besëlidhje, në seksionin 121, vargu 36, “që të drejtat e priftërisë lidhen në mënyrë të pandashme me fuqitë e qiellit”. Çfarë dhurate e mrekullueshme na është dhënë – të mbajmë priftërinë, që është “e lidhur në mënyrë të pandashme me fuqitë e qiellit”. Sidoqoftë, kjo dhuratë e çmuar përfshin jo vetëm bekime të veçanta, por edhe përgjegjësi të shenjta. Ne duhet ta drejtojmë jetën tonë në mënyrë të tillë, që të jemi gjithmonë të denjë për priftërinë që mbajmë. Ne jetojmë në një kohë kur jemi të rrethuar nga shumë gjëra të cilat kanë për synim të na tërheqin nëpër shtigje që mund të na çojnë drejt shkatërrimit. Për t'i shmangur shtigje të tilla kërkohet vendosmëri dhe guxim.

Mua më kujtohet një kohë – dhe disave prej jush këtu sonte do t'ju kujtohet gjithashtu – kur standardet e pjesës më të madhe të njerëzve ishin të ngjashme me standardet tona. Nuk është më kështu. Unë lexova së

fundi një artikull në revistën *New York Times* lidhur me një studim që u krye gjatë verës së vitit 2008. Një sociolog i njohur i Notre Dame-it udhëhoqi një ekip kërkimi për të bërë intervista të hollësishme me 230 beqarë në moshë madhore përreth Amerikës. Unë besoj se ne mund ta supozojmë me siguri se përfundimet do të ishin të ngjashme në shumicën e vendeve të botës.

Unë po ju tregoj vetëm një pjesë të këtij artikulli shumë informues:

“Intervistuesit bënë pyetje të hapura rreth të drejtës e të gabuarës, mëdyshjeve morale dhe kuptimit të jetës. Mes përgjigjeve të hallakatura, . . . ju shihni se të rinjtë po përpiqeshin të thonin gjëra kuptimplote mbi këto çështje. Por ata thjesht nuk kanë konceptet ose fjalorin e nevojshëm për ta bërë këtë.

Kur iu kërkua të përshkruanin një mëdyshje morale me të cilën ishin përballur, dy të tretat e të rinjve ose nuk mundeshin të jepnin përgjigje ose përshkruanin probleme që nuk ishin aspak morale, si p.sh. nëse ata mund të përballonin marrjen me qira të një apartamenti apo nëse kishin monedha për t'i futur në një kohëmatës parkimi për një vend për të parkuar.”

Artikulli vazhdon:

“Qëndrimi tipik, të cilit shumica e tyre iu rikthye përsëri e përsëri, ishte se zgjedhjet morale varen nga preferencat individuale. ‘Është personale’, ishte përgjigja tipike e të intervistuarve. ‘Varet nga individi. Kush jam unë që ta them këtë?’

Duke hedhur poshtë bindjen e plotë ndaj autoritetit, shumë nga të rinjtë kaluan në ekstrem tjetër, [duke thënë]: ‘Unë do të bëja atë çka do të mendoja se do të më bënte të lumtur ose do të veproja siç e ndieja. Unë nuk kam mënyrë tjetër për ta ditur ç’të bëj përveçse nga mënyra se si ndihem brenda.’”

Ata që drejtuan intervistat vunë në dukje se shumicës së të rinjve me të cilët folën “nuk u ishin dhënë burimet – nga shkollat, institucionet [ose] familjet – që të kultivonin konceptin e tyre të moralit”¹.

Vëllezër, asnjëri që po më dëgjoni tani nuk duhet të ketë mëdyshje lidhur me atë që është e moralshme dhe atë që nuk është, as nuk duhet të jetë dikush në mëdyshje rreth asaj çka pritët nga ne, mbajtësit e priftërisë së Perëndisë. Neve na janë mësuar dhe ende vazhdojnë të na mësohen ligjet e Perëndisë. Pavarësisht se çfarë mund të shihni apo dëgjoni diku tjetër, këto ligje janë të pandryshueshme.

Ndërsa ne jetojmë ditë pas dite, është pothuajse e pashmangshme që besimi ynë do të vihet në provë. Ndonjëherë, ne mund ta gjejmë veten të rrethuar nga njerëz të tjerë dhe prapë se prapë duke qenë pjesë e pakicës ose duke qëndruar të vetëm lidhur me atë që është e pranueshme dhe atë që nuk është. A e kemi ne guximin moral për të qëndruar të vendosur për ato çka besojmë, megjithëse duke bërë kështu do të na duhet të qëndrojmë të vetëm? Si mbajtës të priftërisë së Perëndisë, është thelbësore që ne të



jemi në gjendje të përballojmë – me guxim – çfarëdolloj sfidash që na dalin përpara. Kujtoni fjalët e poetit Tenison: “Forca ime është sa për dhjetë vetë, sepse zemra ime është e dëlirë”².

Gjithnjë e më shumë, disa njerëz të famshëm dhe të tjerë që – për ndonjë arsye apo tjetër – janë në qendër të vëmendjes së publikut, kanë një prirje për ta vënë në lojë fenë në përgjithësi dhe ndonjëherë, Kishën në veçanti. Nëse dëshmitë tona nuk kanë një themel të fortë mjaftueshëm, kritika të tilla mund të na bëjnë që të dyshojmë tek ato që besojmë ose të lëkundemi në vendosmërinë tonë.

Në vegimin e Lehit, të pemës së jetës, që gjendet tek 1 Nefi 8, Lehi shikon, përveç të tjerëve, ata që mbahen te shufra e hekurit derisa shkojnë përpara dhe marrin frutin e pemës së jetës, të cilin e dimë së përfaqëson dashurinë e Perëndisë. Dhe më pas, në mënyrë të trishtë, pasi ata kanë marrë nga fruti, disa turpërohen prej atyre që janë në “ndërtesën e madhe dhe të gjerë”, të cilët përfaqësojnë krenarinë e fëmijëve të njerëzve, që po tregojnë me gisht në drejtim të tyre dhe po i përqeshin ata; ata largohen nëpër shtigje të ndaluara dhe humbasin.³ Çfarë arme e fuqishme e kundërshtarit është vënia në lojë dhe përqeshja! Përsëri, vëllezër, a e kemi ne guximin për të qëndruar të fortë e të vendosur përpara një kundërshtimi kaq të madh?

Unë besoj se përvoja ime e parë e të pasurit guxim për bindjet e mia ndodhi kur po shërbeja në Marinën e Shteteve të Bashkuara në fund të Luftës II Botërore.

Trajnimi për anëtarët e rinj të marinës, nuk ishte një përvojë e lehtë për mua dhe për çdokënd që e ka duruar. Gjatë tri javëve të para unë ndihesha sikur isha në rrezik fizik. Marina nuk po përpiquej të më stërviste; po përpiquej të më vriste.

Unë do ta kujtoj gjithmonë kur erdhi sërish e diela pas javës së parë. Na u thanë fjalët e mirëseardhjes nga nënoficeri. Ndërsa po qëndronim drejt në pozicion në zonën e stërvitjes, nën një fllad të akullt të Kalifornisë, ne dëguam urdhrin e tij: “Sot të gjithë shkojnë në kishë – të gjithë, domethënë, përveç meje. Unë do bëj pushim!” Pastaj ai bërtiti: “Të gjithë ju katolikë, ju do të mblidheni në Kampin Diketër – dhe mos u ktheni deri në orën tre fiks. Përpara, marsh!” Një kontigjent mjaft i konsiderueshëm u largua. Më pas ai dha me ashpërsi urdhrin tjetër: “Ata prej jush që janë judenj, ju do të mblidheni në Kampin Henri – dhe mos u ktheni deri në orën tre fiks. Përpara, marsh!” Një kontigjent paksa më i vogël marshoi tutje. Pastaj ai tha: “Pjesa tjetër prej jush protestantëve, ju do të mblidheni në sallën e Kampit Ferëgat – dhe mos u ktheni deri në orën tre fiks. Përpara, marsh!”

Në çast në mendje më lindi mendimi: “Monson ti nuk je as katolik, nuk je as jude; nuk je as protestant. Ti je mormon, kështu që ti thjesht qëndro këtu!” Unë mund t’ju siguroj se ndihesha krejtësisht vetëm. I guximshëm dhe i vendosur, po – por i vetëm.

Dhe më pas dëgjova fjalët më të ëmbla që kisha dëgjuar ndonjëherë të shqiptoheshin nga ai nënoficer. Ai pa drejt meje dhe më pyeti: “Po ju djema si e quani veten?” Deri në atë çast unë nuk e kisha kuptuar se të tjerë kishin qëndruar pas meje në zonën e stërvitjes. Pothuajse njëzëri, secili prej nesh u përgjigj: “Mormonë!” Është e vështirë ta përshkruaj gëzimin që mbushi zemrën time kur u ktheva dhe pashë disa marinarë të tjerë.

Nënoficeri kruajti kokën me një shprehje hutimi, por së fundi tha: “Mirë, shkoni gjeni një vend për t’u mbledhur. Dhe mos u ktheni deri në orën tre fiks. Përpara, marsh!”

Ndërkohë që ne marshonim tutje, unë mendova për fjalët e një rime që kisha mësuar në Filllore vite më parë:

*Guxo të jesh mormon;
Guxo të qëndrosh i vetëm.
Guxo të kesh një zotim të fortë;
Guxo t’ua tregosh të tjerëve këtë zotim.*

Megjithëse përvoja doli ndryshe nga ajo që prisja, unë kisha qenë i gatshëm të qëndroja vetëm, nëse kjo do të kishte qenë e nevojshme.

Që nga ajo ditë, ka pasur kohë kur nuk ka pasur asnjë që të qëndronte pas meje dhe kështu unë vërtet qëndrova i vetëm. Sa mirënjohës jam që e kam marrë shumë kohë më parë vendimin për të qëndruar i fortë dhe i vërtetë, gjithmonë i përgatitur dhe gati për të mbrojtur besimin tim, kur të ishte e nevojshme.

Në rast se ndihemi ndonjëherë të



papërshtatshëm për detyrat përpara nesh, vëllezër, më lejoni të ndaj me ju një deklaratë të bërë në vitin 1987 nga Presidenti i Kishës në atë kohë Ezra Taft Benson kur ai iu drejtua një grupi të madh anëtarësh në Kaliforni. Presidenti Benson tha:

“Gjatë gjithë epokave, profetët e kanë vështruar, përmes tuneleve kohore, kohën tonë. Miliarda që kanë vdekur dhe ata që ende do të lindin, i kanë sytë tek ne. Mos u gaboni për këtë – ju jeni një brez i shënuar. . . .

Për afërsisht gjashtë mijë vjet, Perëndia ju ka mbajtur në stolin e rezervave për t’ju shfaqur në ditët e fundit përpara ardhjes së dytë të Zotit. Disa njerëz do të largohen nga Kisha; por mbretëria e Perëndisë do të mbetet e pacënuar për të mirëpritur kthimin e udhëheqësit të saj – madje Jezu Krishtit.

Ndërkohë që ky brez do të jetë i krahasueshëm për ligësinë me ditët e Noeut, kur Zoti e pastroi tokën me përmbytje, ka një ndryshim më të madh në këtë kohë: [ai është që] Perëndia ka ruajtur për periudhën e Tij të fundit disa prej më të fortëve . . . nga fëmijët e tij, që do të japin ndihmën e vet për ta nxjerrë mbretërinë triumfuese.”⁴

Po, vëllezër, ne përfaqësojmë disa nga fëmijët e Tij më të fortë. E jona është përgjegjësia për të qenë të denjë për të gjitha bekimet e lavdishme që Ati ynë në Qiell ka ruajtur për ne. Kudo që të shkojmë, e kemi priftërinë me vete. A po qëndrojmë në vende të shenjtja? Ju lutem, përpara se ta vini veten dhe priftërinë tuaj në rrezik duke shkuar

nëpër vende ose duke marrë pjesë në aktivitete që nuk janë të denja për ju ose për atë priftëri, ndaluni për të marrë parasysh pasojat. Secilit prej nesh iu dha Priftëria Aarone. Gjatë procesit, çdonjëri mori fuqinë që mban çelësat e shërbesës së engjëjve. Presidenti Gordon B. Hinkli tha:

“Ju nuk mund t’ia lejoni vetes që të bëni diçka që do të vendoste një perde midis jush dhe shërbesës së engjëjve në emrin tuaj.

Ju nuk mund të jeni të pamoralshëm në asnjë mënyrë. Ju nuk mund të jeni të pandershëm. Ju nuk mund të mashtroni ose të gënjeni. Ju nuk mund ta përmendni emrin e Perëndisë më kot, ose të përdorni gjuhë përdhosëse dhe prapë të keni të drejtën e shërbesës së engjëjve.”⁵

Nëse ndonjëri prej jush ka mëkatuar në udhëtimin e tij, unë dua që ju të kuptoni pa asnjë dyshim se sidoqoftë ka një mënyrë për t’u kthyer prapa. Procesi quhet pendim. Shpëtimtari dha jetën e Tij për t’ju siguruar juve dhe mua atë dhuratë të bekuar. Pavarësisht faktit se shtegu i pendimit nuk është i lehtë, premtimet janë të vërteta. Ne na është thënë: “Edhe sikur mëkatet tuaja të ishin të kuqe flakë, do të bëhen të bardha si bora”⁶. “Dhe unë nuk do t’i kujtoj më ato.”⁷ Çfarë shpalljeje. Ç’bekim. Ç’premtim.

Mund të ketë disa nga ju që po mendoni me vete: “Epo, unë nuk jam duke i jetuar të gjitha urdhërimet dhe unë nuk jam duke bërë gjithçka që duhet të bëj dhe prapë jeta im po shkon shumë mirë. Unë mendoj se mund ta shijoj jetën dhe të mos jem i

detyruar të mbaj urdhërimet.” Vëllezër, unë ju premtoj se kjo nuk do të funksionojë në periudha afatgjata.

Jo shumë muaj më parë, unë mora një letër nga një burrë që dikur mendonte se mund t’i shërbente dy zotërinjve. Ai tashmë është penduar dhe e ka vënë jetën në pajtim me parimet e ungjillit dhe urdhërimet. Unë dua t’ju tregoj një paragraf nga letra e tij, sepse ai përfaqëson realitetin e mendjelehtësisë: “M’u desh të mësoja për veten time (në mënyrën e vështirë) se Shpëtimtari kishte absolutisht të drejtë kur tha: ‘Askush nuk mund t’u shërbejë dy zotërinjve: sepse ose do të urrejë njërin dhe do ta dojë tjetrin; ose do t’i qëndrojë besnik njerit dhe do të përçmojë tjetrin. Ju nuk mund t’i shërbeni Perëndisë dhe mamonit.’⁸ Unë u përpoqa, aq shumë sa është përpjekur ndonjëherë ndokush që t’i bëja të dyja. Në fund, tha ai, unë ndieja gjithë boshllëkun, errësirën dhe vetminë që Satani ua jep atyre që besojnë në mashtrimet, iluzionet dhe gënjeshttrat e tij.”

Në mënyrë që të jemi të fortë dhe t’u bëjmë ballë të gjitha forcave që na shtyjnë në drejtimin e gabuar ose të gjithë zërave që na nxisin të marrim rrugën e gabuar, ne duhet të kemi dëshminë tonë vetjake. Qoftë nëse jeni 12 apo 112 vjeç – ose sado mes këtyre – ju mund ta dini për veten tuaj se ungjilli i Jezu Krishtit është i vërtetë. Lexoni Librin e Mormonit. Meditoni rreth mesimeve të tij. Pyeteni Atin Qiektor nëse është i vërtetë. Ne kemi premtimin se “në qoftë se ju do të kërkoni me një zemër të sinqertë, me qëllim të vërtetë duke pasur besim në Krisht, ai do t’ju tregojë të vërtetën, nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë”⁹.

Kur ne dimë se Libri i Mormonit është i vërtetë, më pas ne dimë se Jozef Smithi ishte me të vërtetë një profet dhe se ai pa Perëndinë, Atin



Autoritetet e Përgjithshme të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Tetor 2011

PRESIDENCA E PARË



Henri B. Ajring,
Keshilltar i Parë



Tomas S. Monson
President



Dieter F. Uchtdorf
Keshilltar i Dytë

KUORUMI I DYMËDHJETË APOSTUJVE



Boyd K. Paker



L. Tom Peri



Russell M. Nelson



Dallin H. Oaks



M. Russell Ballard



Richard G. Scott



Robert D. Hejls



Xhefri R. Holland



Devid A. Bednar



Kuentin L. Kuk



D. Tod Kristoferson



Nil L. Andersen

PRESIDENCA E TË SHITATËDHJETËVE



Ronald A. Rasband



Shien E. Snou



Uolter F. Gonzales



L. Ullin Klejton



Xhef E. Xhensen



Donald L. Halstrom



Ted R. Kelsler

KUORUMI I PARË I TË SHITËDHJETËVE

(sipas rendit alfabetik)



Markos A. Adukaritis



Hoze L. Alonso



Karlus H. Amado



Jan S. Andern



Mervin B. Arnold



Dejvid S. Bakster



Shien M. Bouen



Zherald Kosë



Jun Huan Çoi



Krieg C. Kristensen



Don R. Clark



Karl B. Kuk



Lenens E. Korrieh



Klaudio R. M. Kosta



leGrand R. Kurtis i Riu



Benjamin De Hajas



Xhon B. Dikson



Kevin R. Dankan



Dejvid F. Evans



Enike R. Falabela



Eduardo Gararet



Karlus A. Goadi



Kristofel Golden i Riu



Gerit W. Gong



C. Skot Gou




Xhejms J. Hamula



Keith K. Hibing



Martin K. Hlansen



Daniel L. Hnanson



Pol V. Hnanson



Panik Kieion



Pol E. Kalliker



Erik W. Kapisike



Ricard J. Menis



Markus B. Nash



Brent H. Nilson



Alan F. Parker



Kevin W. Pirson



Ertion D. Peckins



Pol B. Pipper



Raimel E. Pino



Bus D. Porter



Dej G. Renlund



Majkel T. Ringud



Lin G. Robins



Xhozet W. Sitari



Ulkes Soaresht



Geri E. Sivenson



Majkel Xhon U. Teh



Zhoze A. Teshetra



Uilford W. Andersen



Koig Joigigi



Randall K. Benet



Kraig A. Kardon



Brus A. Karlson



J. Dejn Kornish



Keith R. Edwards



Stenli G. Eiks



Breth D. Foster



Leni W. Ghans



O. Yinsenst Haleb



Leni R. Laners



Per G. Mulin



Xhejms B. Martino



Jaro Maccaqaradi



Kent F. Richards



Gregori A. Shvicer



Kent D. Utanson



Leni Y. Ujison

PESHKOPATA KRYEJESUE



Ricard C. Exhli
Keshillari i Parë



H. Dejvid Barton
Peshkopi Kryesues



Keith B. Mek-Mullin
Keshillari i Dytë

W. Krieg Zaik

Klaudio D. Zivc

Horge F. Lehdos

Kazuniko Jamashito

F. Majkel Utanson

Uilham R. Uolker

W. Kristofer Uadell

Francisko J. Vinjias

Huan A. Ucedo

Oktoviano Tenorio



Shenjtoret e ditëve të mëvonshme mbliidhen në vende [të ndryshme] në mbarë botën për të dëgjuar fjalimet e konferencës së përgjithshme “në gjuhën e [tyre]” (DeB 90:11). Paraqiten sipas drejtimit të orës nga këndi sipër majtas anëtarë të Kishës në Johannesburg të Afrikës së Jugut, Salvador në Brazil, San-Salvador në Salvador, Montreal, Kebek në Kanada, Montalban në Filipine, Gómez Palasio në Meksikë dhe Tokio në Japoni.



e Përrjetshëm dhe Birin e Tij, Jezu Krishtin. Ne gjithashtu dimë, se ungjilli u rivendos në këto ditë të mëvonshme nëpërmjet Jozef Smithit – duke përfshirë rivendosjen e të dyja Priftërive, Aarone dhe Melkizedeke.

Pasi ne kemi një dëshmi, është përgjegjësia jonë që ne ta ndajmë këtë dëshmi me të tjerët. Shumë nga ju vëllezër kanë shërbyer si misionarë anëmbanë botës. Shumë nga ju të rinj nuk keni shërbyer akoma. Përgatitni veten tani për atë mundësi. Sigurohuni që të jeni të denjë për të shërbyer.

Nëse jemi të përgatitur për ta ndarë ungjillin, ne jemi gati për t'iu përgjigjur këshillës së Apostullit Pjetër, që na nxiti: "Jini gjithnjë gati për t'iu përgjigjur në mbrojtjen tuaj kujtdo që ju kërkon shpjegime për shpresën që është në ju"¹⁰.

Ne do të kemi mundësi përgjatë jetës sonë për të ndarë ato çka besojmë, megjithëse ne nuk e dimë gjithnjë se kur do të thirremi për ta bërë këtë. Një mundësi e tillë, më erdhi në vitin 1957 kur punoja në një shtëpi botuese dhe m'u kërkua të shkoja në Dallas të Teksasit, të quajtur ndonjëherë "qyteti i kishave" për të folur në një marrëveshje biznesi. Pas përfundimit të marrëveshjes, unë mora një autobus turistik për të bërë një turne përmes rrethinave të qytetit. Ndërsa kalonim pranë kishave të bukura, shoferi ynë do të komentonte: "Në të majtë po shihni Kishën Metodiste", ose, "Atje në të djathtë është Katedralja Katolike".

Ndërsa kaluam pranë një ndërtese të bukur me tulla të kuqe të vendosur mbi një kodër, shoferi na informoi: "Ajo ndërtesë është vendi ku mblihdhen mormonët". Zëri i një zonje nga fundi i autobusit pyeti: "Shofer, a mund të na thoni diçka mbi mormonët?"

Shoferi e ndaloi autobusin në anë të rrugës, u rrotullua në karrigen e tij dhe u përgjigj: "Zonjë, gjithçka që di



unë për mormonët është se ata mblihdhen në atë ndërtesë me tulla të kuqe. A ka ndonjë njeri në këtë autobus që di diçka për mormonët?"

Unë prita që dikush të përgjigjej. Unë ia ngula sytë shprehjes në fytyrën e secilit person duke kërkuar ndonjë shenjë njohjeje, pak dëshirë për të komentuar. Asgjë. Unë e kuptova se ishte radha ime për të bërë siç këshilloi Apostulli Pjetër që të "jeni gjithnjë gati për t'iu përgjigjur në mbrojtjen tuaj kujtdo që ju kërkon shpjegime për shpresën që është në ju". Unë kuptova gjithashtu, vërtetësinë e fjalës së urtë: "Kur vjen koha për të marrë vendime, ka ikur koha për përgatitje".

Për pothuajse 15 minutat vijuese, unë pata privilegjin që t'u tregoja atyre që ishin në autobus, dëshminë time lidhur me Kishën dhe ato çka ne besojmë. Unë isha mirënjohës për dëshminë time dhe mirënjohës që isha i përgatitur ta ndaja atë.

Me gjithë zemrën dhe shpirtin tim, unë lutem që çdo burrë që mban priftërinë do ta nderojë atë priftëri dhe do të jetë i vërtetë ndaj mirëbesimit që iu tregua kur iu dha ajo priftëri. E ditë çdonjëri prej nesh që mban priftërinë e Perëndisë, se çfarë beson. Qofshim ne gjithmonë të guximshëm dhe të përgatitur që të qëndrojmë për atë që besojmë, dhe nëse do të na duhet të qëndrojmë vetëm në këtë proces, e bëfshim këtë me guxim, të forcuar nga njohuria se në të vërtetë ne nuk jemi

kurrë vetëm kur ne qëndrojmë për Atin tonë në Qiell.

Ndërsa sodisim dhuratën e madhe që na është dhënë – "të drejtat e priftërisë lidhen në mënyrë të pandashme me fuqitë e qiellit" – vendosmëria jonë u bëftë gjithmonë rojë dhe e mbroftë atë që të jetë e denjë për premtimet e saj të mëdha. E ndjekshim ne udhëzimin e Shpëtimtarit për ne, që gjendet në librin e 3-të të Nefit: "Mbani lart dritën tuaj që të ndriçojë tërë botën. Vini re, unë jam drita që ju duhet të mbani lart – atë që më keni parë duke bërë".¹¹

E ndjekshim ne përherë atë dritë dhe e mbafshim atë lart që e gjithë bota ta shohë, është lutja ime në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. David Brooks, "If It Feels Right . . .", revista "New York Times", 12 shtator 2011, nytimes.com.
2. Alfred, Lord Tennyson, "Sir Galahad", në *Poems of the English Race*, përzgji. Raymond Macdonald Alden (1921), f. 296.
3. Shih 1 Nefi 8:26–28.
4. Ezra Taft Benson, "In His Steps" (Mbrëmja rreth vatrës e Sistemit Arsimor të Kishës, 8 shkurt 1987); shih edhe "In His Steps" në *1979 Devotional Speeches of the Year: BYU Devotional and Ten-Stake Fireside Addresses* (1980), f. 59.
5. Gordon B. Hinckley, "Personal Worthiness to Exercise the Priesthood," *Liahona*, korrik 2002, f. 59.
6. Isaia 1:18.
7. Jeremia 31:34.
8. Mateu 6:24.
9. Moroni 10:4.
10. 1 Pjetrit 3:15.
11. 3 Nefi 18:24.



Nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

Një Dëshmi

Libri i Mormonit është udhëzuesi më i mirë për të mësuar se sa mirë po i bëjmë këto gjëra dhe si mund të përmirësohemi më shumë.

Unë jam mirënjohës për këtë mundësi që t'ju flas juve në këtë ditë Shabati në një konferencë të përgjithshme të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Çdo anëtar i Kishës ka të njëjtën detyrë të shenjtë. Ne e pranuan dhe premtuam se do ta mbanim atë kur u pagëzuam. Ne mësojmë nga fjalët e Almës, profetit të madh të Librit të Mormonit, se çfarë i premtuam Perëndisë se do të bëheshim: “Po, dhe jeni të gatshëm të vajtoni me ata që vajtojnë; po, dhe të ngushëlloni ata që kanë nevojë të ngushëllohen dhe të qëndroni si dëshmitarë të Perëndisë në të gjitha kohërat dhe në të gjitha gjërat dhe në të gjitha vendet që ju të gjendeni, madje deri në vdekje, që ju të mund të shëlbeheni nga Perëndia dhe të numëroheni me ata të ringjalljes së parë, që ju të mund të keni jetën e përjetshme”.¹

Kjo është një detyrë e rëndësishme dhe një premtim i lavdishëm nga Perëndia. Mesazhi im sot është një mesazh nxitës. Njësoj siç na e bën të qartë detyrën Libri i Mormonit, ai gjithashtu, na drejton për të shkuar përpara drejt shtegut të jetës së përjetshme.

Së pari, ne kemi premtuar të

kemi dashurinë hyjnore. Së dyti, ne kemi premtuar të jemi dëshmitarë të Perëndisë. Dhe së treti, ne premtuam të duronim. Libri i Mormonit është udhëzuesi më i mirë për të mësuar se sa mirë po i bëjmë këto gjëra dhe si mund të përmirësohemi më shumë.

Le të fillojmë me të pasurit e dashurisë hyjnore. Unë do t'ju kujtoj për disa përvoja të kohëve të fundit. Shumë nga ju kanë marrë pjesë në një ditë shërbimi. Ka pasur mijëra ditë shërbimi të organizuara anembanë botës.

Një këshill i bashkëshenjtorëve tuaj u lut për të ditur se çfarë shërbimi të planifikonte. Ata e pyetën Perëndinë për të ditur se kujt duhej t'i shërbenim ne, çfarë shërbimi të jepnim dhe kë të ftonim për të marrë pjesë. Ata mund të jenë lutur madje edhe që të mos harrojnë lopatat ose ujin e pijshëm. Mbi të gjitha, ata u lutën që të gjithë, ata që shërbyen dhe ata që e morën këtë shërbim, të ndienin dashurinë e Perëndisë.

Unë e di se këto lutje morën përgjigje në të paktën një lagje. Mbi 120 anëtarë dolën vullnetarë për të ndihmuar. Brenda tri orësh ata e pastruan tokën përreth kishës në komunitetin tonë. Ishte një punë e lodhshme dhe

lumturuese. Shërbestarët e kishës së cilës iu bë shërbimi, ndien mirënjohje. Të gjithë ata që punuan së bashku atë ditë, ndien unitet dhe dashuri më të madhe. Disa madje thanë se ndien gëzim ndërkohë që shkullnin barërat e këqija dhe shkurtonin shkurret.

Fjalët nga Libri i Mormonit i ndihmuan ata të kuptonin pse. Ishte Mbreti Beniamin që i tha popullit të tij: “Mësoni se kur jeni në shërbimin e bashkëqenieve tuaja, ju jeni vetëm në shërbimin e Perëndisë tuaj”.² Dhe ishte Mormoni që na mësoi me fjalët e tij në Librin e Mormonit se: “Dashuria hyjnore është dashuria e pastër e Krishtit dhe nuk ka mbarim; dhe kushdo që gjendet i zotëruar prej saj në ditën e fundit, do të jetë mirë me të”.³

Zoti po i mban premtimet e Tij ndaj jush kur ju i mbani tuajat. Ndërsa ju u shërbeni të tjerëve për Të, Ai ju lejon të ndieni dashurinë e Tij. Dhe me kohë, ndjenjat e dashurisë hyjnore bëhen pjesë e asaj që ju jeni. Dhe ju do të merrni sigurimin e Mormonit në zemrat tuaja se, kur vazhdoni që t'u shërbeni të tjerëve në jetë, gjithçka do të jetë mirë.

Ashtu siç i premtuat Perëndisë që të keni dashuri hyjnore, ju i premtuat të jeni dëshmitarët e Tij kudo që të jeni përgjatë jetës suaj. Përsëri, Libri i Mormonit është udhëzuesi më i mirë që njoh për të na ndihmuar që ta mbajmë atë premtim.

Njëherë, më ftuan të flisja në ceremoninë e diplomimit të një universiteti. Presidenti kishte dashur që i ftuar të ishte Presidenti Gordon B. Hinkli, por kishte marrë vesh se ai ishte i padisponueshëm. Kështu për pasojë, e mora unë ftesën. Në atë kohë isha një anëtar i ri i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve.

Personi që më ftoi të flisja, ishte në ankth kur mësoi më shumë rreth thirrjes sime si një Apostull. Ajo më

mori në telefon dhe më tha se tani e kuptoi se detyra ime ishte që të isha një dëshmitar i Jezu Krishtit.

Me një ton shumë të prerë, ajo më tha se unë nuk mund ta bëjë atë kur të flisja. Ajo më shpjegoi se universiteti i respektonte njerëzit e të gjitha besimeve, përfshirë ata që e mohonin ekzistencën e një Perëndie. Ajo përsëriti: “Ju nuk mund ta përmbushni detyrën tuaj këtu”.

Unë e mbylla telefonin me pyetje serioze në mendje. A duhet t'i them universitetit se unë nuk do ta plotësoja marrëveshjen time për të folur? Ishte vetëm disa javë përpara ceremonisë. Paraqitja ime atje ishte njoftuar. Çfarë efekti do të kishte mosmbajtja e marrëveshjes sime në emrin e mirë të Kishës?

Unë u luta që të dija se çfarë dëshironte Perëndia që unë të bëja. Përgjigja erdhi në një mënyrë të habitshme për mua. Unë kuptova se shembujt e Nefit, Abinadit, Almës, Amulekut dhe bijve të Mosias kishin ndikuar te ajo çka isha. Ata ishin dëshmitarë të patrembur të Jezu Krishtit ndërsa përballëshin me rreziqe vdekjeprurëse.

Kështu që e vetmja zgjedhje që duhej bërë, ishte se si të përgatitesha. Unë bëra kërkime për gjithçka që mund të mësoja rreth universitetit. Ndërkohë që dita e bisedës afrohej, ankthi im rritej dhe lutjet e mia shtoheshin.

Si në një zgjidhje mrekullibërëse, unë gjeta një artikull gazete. Universiteti ishte nderuar për të njëjtën gjë që Kisha kishte mësuar të bënte në përpjekjet e saj humanitare në të gjithë botën. Dhe kështu në bisedën time, unë përshkrova se çfarë kishim bërë ne dhe ata për t'i ndihmuar njerëzit në nevojë të madhe. Thashë se unë e dija se Jezu Krishti ishte burimi i bekimeve që kishin ardhur në jetën e atyre që ne dhe ata u kishim shërbyer.



Pas mbledhjes, salla u ngrit në këmbë dhe duartrokiti, gjë që m'u duk pak e pazakontë. Unë isha i mahnitur, por ende pak në ankth. Unë kujtoja ç'i ndodhi Abinadit. Vetëm Alma e kishte pranuar dëshminë e tij. Por atë natë, në një darkë të madhe zyrtare, unë dëgjova presidentin e universitetit të thoshte se ai kishte dëgjuar fjalët e Perëndisë në fjalimin tim.

Një shpëtim kaq i mrekullueshëm është i rrallë në përvojën time si dëshmitar i Krishtit. Por efekti i Librit të Mormonit në karakterin, fuqinë dhe guximin tuaj për të qenë një dëshmitar i Perëndisë është i sigurt. Doktrina dhe shembujt e guximshëm në atë libër do t'ju lartësojnë, udhëzojnë dhe do t'ju japin guxim.

Çdo misionar që është duke shpallur emrin dhe ungjillin e Jezu Krishtit, do të bekohet nga të ushqyerit çdo ditë me bollëk nga Libri i Mormonit. Prindërit që mundohen të marrin një dëshmi për Shpëtimtarin në zemrën e fëmijës, do të ndihmohen kur ata të kërkojnë një mënyrë për t'i futur fjalët dhe ndikimin e librit të Mormonit në shtëpi dhe në jetën e familjes së tyre. Kjo është vërtetuar për ne.

Unë e shoh se kjo mrekulli po ndodh në çdo mbledhje sakramenti dhe orë mësimore të Kishës që unë frekuentoj. Folësit dhe mësuesit

tregojnë dashuri dhe një kuptueshmëri të pjekur të shkrimeve të shenjta, veçanërisht të Librit të Mormonit. Dhe dëshmitë vetjake vijnë pa dyshim nga thellësia e zemrave të tyre. Ata japin mësim me bindje të madhe dhe japin dëshmi me fuqi.

Unë shoh fakte po ashtu se ne po përmirësohemi në pjesën e tretë të premtimit që bëmë në pagëzim. Ne bëmë besëlidhje që të durojmë, të mbajmë urdhërimet e Perëndisë për sa të kemi jetë.

I shkova për vizitë në spital një mikeje të vjetër që ishte diagnostikuar me kancer të pashërueshëm. Mora me vete dy bijat e mia të vogla. Unë nuk e prisja që ajo do të ishte në gjendje t'i njihje ato. Familja e saj ishte mbledhur, duke qëndruar rrotull shtratit të saj kur ne hymë.

Ajo ngriti vështrimin dhe buzëqeshi. Unë do ta kujtoj gjithmonë shikimin e saj kur pa se gruaja ime dhe unë kishim marrë bijat tona me vete. Ajo i ftoi ato t'i shkonin më pranë. Qëndroi ulur në shtrat, i përqafoi ato dhe i njohu me familjen e saj. Ajo foli për madhështinë e këtyre vajzave të vogla. Ishte sikur ajo po prezantonte princesha në një pallat mbretëror.

Unë prisja që vizita jonë të përfundonte shpejt. Sigurisht, mendova, ajo është e lodhur. Por ndërkohë që e

shihja, ishte sikur vitet të mos kishin kaluar. Ajo ishte rrezatuese dhe e mbushur dukshëm me dashuri për të gjithë ne.

Dukej që ajo po e gëzonte momentin sikur koha të kishte ndalur. Ajo e kishte kaluar pjesën më të madhe të jetës duke u kujdesur për fëmijët e Zotit. Ajo e dinte nga Libri i Mormonit se Shpëtimtari i ringjallur i kishte marrë fëmijët një e nga një, i kishte bekuar dhe kishte qarë nga gëzimi.⁴ Dhe ajo e kishte përjetuar atë gëzim mjaft gjatë sa kishte qenë në gjendje të duronte në shërbimin e Tij të dashur deri në fund.

Unë pashë të njëjtën mrekulli në dhomën e gjumit të një burri që kishte dhënë shërbim të mjaftueshëm sa që unë mendoja se kishte bërë mjaftueshëm sa që mund të meritonte çlodhje.

Unë e dija se ai i ishte nënshtruar një trajtimi të stërgjatur e të dhimbshëm prej një sëmundjeje dhe mjekët i kishin thënë se ishte e pashërueshme. Ata nuk i dhanë as trajtim të mëtejshëm dhe as shpresë.

Bashkëshortja e tij më çoi te një dhomë gjumi në shtëpinë e tyre. Ai ishte atje, duke qëndruar në shpinë mbi një shtrat të rregulluar me kujdes. Ai kishte veshur një këmishë të bardhë të sapohekurosuar, një kollare dhe këpucë të reja.

Ai e pa vështrimin e habitës në sytë e mi, qeshi qetësisht dhe më shpjegoi: “Pasi të më japësh një bekim, unë dua të jem gati që t’i përgjigjem thirrjes për t’u çuar nga shtrati e për të shkuar në punë”. Ishte e qartë se ai ishte gati për intervistën që do të kishte së shpejti me Mjeshtrin, për të cilin kishte punuar kaq besnikërisht.

Ai ishte një shembull i shenjtoreve të kthyer me të vërtetë në besim që unë i takoj shpesh, pasi kanë kaluar një jetë me shërbim të përkushtuar. Ata shkojnë përpara.

Presidenti Marion G. Romni e përshkroi atë në këtë mënyrë: “Tek dikush që është kthyer plotësisht në besim, ka vdekur dëshira për gjërat që janë [në kundërshtim] me ungjillin e Jezu Krishtit dhe si pasojë është zëvendësuar me një dashuri për Perëndinë me një vendosmëri të palëkundshme dhe udhëzuese për të ndjekur urdhërimet e tij”⁵.

Kjo është ajo vendosmëri e palëkundshme gjithmonë e më e shpeshtë në dishepujt me përvojë të Jezu Krishtit. Njësoj si motra që përshëndeti bijat e mia dhe burri me këpucë të reja, gati për t’u ngritur e për të marshuar për Zotin, ata e ndjekin urdhrin e Tij deri në fund. Të gjithë ju e keni parë këtë.

Ju mund ta shihni atë përsëri, nëse i drejtoheni Librit të Mormonit. Unë ende ndiej admirim në zemrën time ndërsa lexoj këto fjalë të një shërbëtori të pjekur e të vendosur të Perëndisë: “Pasi madje në këtë kohë, i tërë trupi im dridhet jashtëzakonisht, ndërsa po përpiqem t’ju flas; por Zoti . . . më mbështet mua dhe më ka lejuar që unë t’ju flas”⁶.

Ju mund të merrni guxim siç më ndodh mua nga shembulli i durimit që na jepet nga Moroni. Ai ishte i vetëm në shërbesën e tij. Ai e dinte se fundi

ishte afër për të. Dhe përsëri dëgjoni atë që ai shkroi për hir të njerëzve që nuk kishin lindur ende dhe pasardhësve të armiqve të tij për vdekje: “Po, ejani te Krishti dhe përsosuni në të dhe i mohoni vetes çdo ligësi; dhe në qoftë se do t’i mohoni vetes çdo ligësi dhe ta doni Perëndinë me gjithë fuqinë, mendjen dhe forcën tuaj, atëherë hiri i tij mjafton për ju, se me anë të hirit të tij ju mund të bëheni të përsosur në Krisht”⁷.

Moroni dha dëshmi si një fjalim lamtumire ndaj jetës e shërbesës së tij. Ai na nxiti për dashuri hyjnore ashtu siç bëjnë profetët përgjatë Librit të Mormonit. Ai e shtoi dëshminë e tij për Shpëtimtarin kur po i vinte vdekja. Ai ishte me të vërtetë një fëmijë i Perëndisë i kthyer në besim, siç mund të jemi ne: i mbushur me dashuri hyjnore, i qëndrueshëm e i patrembur si një dëshmitar i Shpëtimtarit dhe ungjillit të Tij, dhe i vendosur për të duruar deri në fund.

Moroni na mësoi se çfarë kërkohet prej nesh. Ai tha se hapi i parë drejt kthimit të plotë është besimi. Studimi me lutje i Librit të Mormonit do të ndërtojë besim në Perëndinë, Atin, në Birin e Tij të dashur dhe në ungjillin e Tij. Ai do të ndërtojë besimin tuaj te profetët e Perëndisë, të lashtët dhe të kohës sonë.



Ai mund t'ju afrojë më shumë me Perëndinë se çdo libër tjetër. Ai mund ta ndryshojë jetën për më mirë. Unë ju nxis juve që të bëni atë që bëri shoku im në mision. Kur ai u largua nga shtëpia kur ishte adoleshent, dikush e kishte vendosur Librin e Mormonit në një kuti që ai e mori me vete gjatë kërkimit të tij për më shumë lumturi.

Kaluan vite. Ai lëvizi nga një vend në tjetrin anembanë botës. Ai ishte vetëm dhe jo i lumtur një ditë kur pa kutinë. Kutia ishte mbushur me gjëra që ai i kishte marrë me vete. Në fund të kutisë, ai gjeti Librin e Mormonit. Ai e lexoi premtimin dhe e vuri atë në provë. Ai e dinte se ai ishte i vërtetë. Ajo dëshmi i ndryshoi jetën. Ai gjeti lumturinë që ia kalonte edhe ëndrrave më të bukura.

Kopja juaj e Librit të Mormonit ndoshta nuk është duke u lexuar aq shumë sa duhet për shkak të aktiviteteve tuaja të përditshme. Unë ju lutem që ju t'i studioni thellësisht dhe shpesh faqet e tij. Ai ka brenda tij plotësinë e ungjillit të Jezu Krishtit, që është e vetmja rrugë për t'u kthyer në shtëpi të Perëndia.

Unë ju lë dëshminë time të sigurt se Perëndia jeton dhe do t'u përgjigjet lutjeve tuaja. Jezu Krishti është Shpëtimtari i botës. Libri i Mormonit është një dëshmi e vërtetë dhe e sigurt se Ai jeton dhe Ai është Shpëtimtari ynë i ringjallur dhe i gjallë.

Libri i Mormonit është një dëshmitar i çmuar. Unë lë tani dëshminë time me ju në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Mosia 18:9.
2. Mosia 2:17.
3. Moroni 7:47.
4. Shih 3 Nefi 17:21–22.
5. Marion G. Romney, në Conference Report, tetor 1963, f. 23.
6. Mosia 2:30.
7. Moroni 10:32.



Nga Plaku Robert D. Hejls,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Të Presësh Nga Zoti: U Bëftë Vullneti Yt

Qëllimi i jetës sonë mbi tokë është që të rritemi, të zhvillohemi e të forcohemi përmes përvojave vetjake.

Në këtë mëngjes Shabati, ne japim falënderime dhe dëshmojmë për realitetin që Shpëtimtari ynë jeton. Ungjilli i Tij është rivendosur nëpërmjet Profetit Jozef Smith. Libri i Mormonit është i vërtetë. Ne udhëhiqemi nga një profet i gjallë sot, Presidenti Tomas S. Monson. Mbi të gjitha, ne japim dëshmi solemne për Shlyerjen e Jezu Krishtit dhe bekimet e përjetshme që rrjedhin prej saj.

Gjatë pak muajve të kaluar, kam pasur mundësinë që të studioj e të mësoj më shumë për sakrificën shlyese të Shpëtimtarit dhe mënyrën si e përgatiti Ai Vetën që të bënte blatin e përjetshëm për secilin prej nesh.

Përgatitja e Tij filloi në jetën paratokësore, kur Ai priti nga Ati i Tij, duke thënë: “Atë, vullneti yt u bëftë dhe lavdia qoftë e jotja përgjithmonë”¹. Duke filluar në atë çast e duke vazhduar sot, Ai e ushtron lirinë e Tij të zgjedhjes për të pranuar dhe përmbushur planin e Atit tonë Qiellor. Shkrimet e shenjta na mësojnë se gjatë rinisë së Tij Ai shkoi “të [merrej] me punët e Atit [Tij]”² dhe “priti nga Zoti që koha e shërbesës së tij të vinte”³. Në moshën 30 vjeç Ai vuajti një

tundim të vështirë, megjithatë zgjodhi që të rezistojë, duke thënë: “Largohu prej meje, Satan”⁴. Në Gjetseman, Ai i mirëbesoi Atit, duke thënë: “Megjithatë mos u bëftë vullneti im, por yti”⁵ dhe atëherë Ai e ushtroi lirinë e Tij të zgjedhjes që të vuante për mëkatet tona. Gjatë poshtërimit nga një gjyq publik dhe agonisë së kryqëzimit, Ai priste nga Ati i Tij, i gatshëm që të “[plagosej] për shkeljet tona . . . [dhe të shtypej] për paudhësitë tona”⁶. Madje dhe kur thirri: “Perëndia im, Perëndia im, përse më ke braktisur?”⁷ Ai priste nga Ati i Tij — duke ushtruar lirinë e Tij të zgjedhjes që të falte armiqtë e Tij⁸, të kujdesej që nënën e Tij ta mbronin⁹ dhe të duronte deri në fund, derisa jeta dhe misioni i Tij tokësor mbaruan.¹⁰

Unë shpesh kam menduar: përse ndodh që Biri i Perëndisë dhe profetët e Tij të shenjtë, dhe të gjithë shenjtorët besnikë të kenë prova dhe vuajtje, edhe kur po përpiqen të bëjnë vullnetin e Atit Qiellor? Përse të jetë aq e vështirë, veçanërisht për ta?

Mendoj për Jozef Smithin, i cili vuajti sëmundje kur ishte djalë dhe përndjekje gjatë gjithë jetës. Ashtu si Shpëtimtari, ai thirri: “O Perëndi, ku



je ti?"¹¹ Megjithatë, kur, me sa dukej, ishte vetëm, ai e ushtroi lirinë e tij të zgjedhjes që të priste nga Zoti dhe të plotësonte vullnetin e Atit të Tij Qiellor.

Mendoj për stërgjyshërit tanë pionierë, të përzënë nga Navuja e duke kaluar pllajtat, duke e ushtuar lirinë e tyre të zgjedhjes që të ndiqnin një profet, edhe kur vuajtën sëmundjen, mungesat dhe disa madje dhe vdekjen. Përse vuajtje kaq e tmerrshme? Për çfarë përfundimi? Për çfarë qëllimi?

Ndërsa ne bëjmë këto pyetje, ne kuptojmë se qëllimi i jetës sonë mbi tokë është që të rritemi, të zhvillohemi e të forcohemi përmes përvojave vetjake. Si e bëjmë ne këtë? Shkrimet e shenjta na japin përgjigje në një frazë të thjeshtë: ne "presim Zotin"¹². Provat dhe sprovat na jepen të gjithëve ne. Këto sfida tokësore na lejojnë ne dhe Atin tonë Qiellor të shohim nëse do ta ushtrojmë lirinë tonë të zgjedhjes që të ndjekim Birin e Tij. Ai tashmë e di dhe ne kemi mundësinë për të mësuar se, pavarësisht sa të vështira janë rrethanat tona, "gjithë këto gjëra do të l jenë për përvojën tonë] dhe . . . të mirën [tonë]"¹³.

A do të thotë kjo se ne përherë do t'i kuptojmë sfidat tona? A nuk do kemi të gjithë ne, ndonjëherë, arsye për të pyetur: "Oh Perëndi, ku je ti?"¹⁴ Po! Kur një bashkëshorte vdes, një bashkëshort do ta pyesë veten. Kur një vështirësi ekonomike i bie një familjeje, një baba do të pyesë. Kur fëmijët shmangen nga shtegu, një nënë e baba do të thërrasin me trishtim. Po, "të qarat mund të vazhdojnë një natë, por në mëngjes shpërthen një britmë gëzimi"¹⁵. Pastaj, në agim të besimit dhe të të kuptuarit tonë të rritur, ne ngrihemi dhe zgjedhim që të presim nga Zoti, duke thënë: "U bëftë vullneti yt"¹⁶.

Atëherë, çfarë do të thotë të presësh nga Zoti? Në shkrimet e shenjta, fjala *pres* do të thotë të shpresosh, të parashikosh dhe të mirëbesosh. Të shpresosh e të mirëbesosh te Zoti, kërkon besim, durim, përlulesi, zemërbutesi, durueshmëri, zbatim të urdhërimeve dhe durim deri në fund.

Të presësh nga Zoti, do të thotë të mbjellësh farën e besimit dhe ta ushqesh "me zell të madh dhe . . . durim"¹⁷.

Do të thotë të lutesh siç bëri Shpëtimtari – drejt Perëndisë, Atit tonë Qiellor – duke thënë: "Ardhtë mbretëria jote. U bëftë vullneti yt."¹⁸ Ajo është një lutje që ne e ofrojmë me gjithë shpirtin tonë, në emrin e Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit.

Të presësh nga Zoti, do të thotë të mendohemi thellë në zemër e "të [marrim] Frymën e Shenjtë", në mënyrë që të mund të dimë "të gjitha gjërat që duhet të [bëjmë]"¹⁹.

Kur i ndjekim pëshpëritjet e Shpirtit, zbulojmë që "shtrëngimi prodhon këmbënguljen"²⁰ dhe ne mësojmë të "[vazhdojmë] me durim derisa të [përsosemi]"²¹.

Të presësh nga Zoti, do të thotë të "[qëndrojmë] të vendosur"²² dhe të "[shkujmë] përpara" me besim, "duke pasur një ndriçim të përkryer të shpresës"²³.

Do të thotë "[të mbështetemi] vetëm në meritat e Krishtit"²⁴ dhe "me hirin [e Tij] duke [na] ndihmuar, [të themi]: 'Vullneti yt u bëftë, O Zot, dhe jo i yni'"²⁵.

Kur presim nga Zoti, ne jemi "të palëvizshëm në zbatimin e urdhërimeve"²⁶, duke ditur që "një ditë do të mund të [pushojmë] nga të gjitha pikëllimet [tona]"²⁷.

Dhe "[nuk e hedhim] tej [bindjen]"²⁸ se "të gjitha gjërat me të cilat [jemi] munduar, do të veprojnë së bashku për të mirën [tonë]"²⁹.

Ato pikëllime do të vijnë në lloj-lloj formash dhe madhësish. Përvoja e Jobit na rikujton se çfarë mund të na kërkohet të durojmë. Jobi i humbi të gjitha zotërimet e tij, përfshirë tokën, shtëpinë dhe kafshët; pjesëtarët e familjes së tij; famën e tij; shëndetin e tij fizik; dhe madje mirëqenien e tij mendore. Megjithatë, ai priti nga Zoti dhe dha një dëshmi vetjake të fuqishme. Ai tha:

"Por unë e di që Shpëtimtari im

jeton dhe që në fund do të ngrihet mbi tokë.

Mbas shkatërrimit të lëkurës sime, në mishin tim do të shoh Perëndinë.”³⁰

“Ja, ai do të më vrasë, [sidoqoftë, do të shpresoj në Të].”³¹

Madje edhe me shembujt e shkëlqyer të Jobit, të profetëve dhe të Shpëtimtarit, neve ende do të na duket sfiduese të presim nga Zoti, veçanërisht kur nuk mundemi të kuptojmë plotësisht planin dhe qëllimet e Tij për ne. Ai kuptim, më së shpeshti, na jepet “rresht pas rreshti [dhe] parim pas parimi”³².

Në jetën time kam mësuar se nganjëherë nuk marr një përgjigje për një lutje, ngaqë Zoti e di se nuk jam gati. Kur Ai i përgjigjet, shpeshherë është “pak këtu dhe pak atje”³³, sepse kjo është gjithçka që unë mund të mbaj ose që jam i gatshëm të bëj.

Shumë shpesh, ne lutemi që të kemi durim, por e dëshirojmë tani, në çast! Kur ishte djalë, Presidenti Dejvid O. Mek-Kei lutej për një dëshmi të vërtetësisë së ungjillit. Shumë vite më vonë, ndërsa po shërbente në një mision në Skoci, ajo dëshmi më në fund erdhi. Më vonë ai shkroi: “Kjo që për mua një siguri se lutja e sinqertë merr përgjigje ‘dikur, diku’”³⁴.

Ne mund të mos e dimë se kur apo në ç’mënyrë do të jepen përgjigjet e Zotit, por, në kohën e Tij dhe mënyrën e Tij, unë dëshmoj, përgjigjet e Tij do të vijnë. Për disa përgjigje ne mund të na duhet të presim deri pas kësaj jete. Kjo mund të jetë e vërtetë për disa premtime në bekimin tonë patriarkal dhe për disa bekime që u jepen pjesëtarëve të familjes. Le të mos heqim shpresat tek Zoti. Bekimet e Tij janë të përrjetshme, jo të përkohshme.

Të priturit nga Zoti, na jep një mundësi të paçmuar që të zbulojmë se janë të shumtë ata që presin nga ne. Fëmijët tanë presin nga ne të



tregojmë durim, dashuri dhe mirëkuptim ndaj tyre. Prindërit tanë presin nga ne të tregojmë mirënjohje dhe dhembshuri. Vëllezërit dhe motrat tona presin nga ne të jemi të duruar, të mëshirshëm dhe shpirtbutë. Bashkëshortet tona presin nga ne që t’i duam sikurse Shpëtimtari e ka dashur çdonjërin prej nesh.

Kur durojmë vuajtje fizike, ne jemi gjithnjë e më të vetëdijshëm se sa të shumtë janë ata që presin nga çdonjëri prej nesh. Për të gjitha martiet dhe martat, për të gjithë samaritanët e mirë që u shërbejnë të sëmurëve, që ndihmojnë të dobtit dhe kujdesen për të sëmurët mendorë dhe fizikë, e ndiej mirënjohjen e një Ati të përzemërt Qiellor dhe të Birit të Tij të Dashur. Në shërbesën tuaj Krishtërore të përditshme ju po prisni nga Zoti dhe po bëni vullnetin e Atit tuaj Qiellor. Garantimi i Tij ndaj jush është i qartë: “Sa herë ia keni bërë këtë ndonjërit prej këtyre vëllezërve të mi më të vegjël, këtë ma bë të mua”³⁵. Ai i njeh sakrificat dhe trishtimet tuaja. Ai i dëgjon lutjet tuaja. Paqja dhe prehja e Tij qofshin tuajat teksa vazhdoni të prisni nga Ai me besim.

Çdokush prej nesh është për Zotin

më i shtrenjtë, sesa ndoshta ne mund ta kuptojmë apo përfytyrojmë. Le të jemi, pra, më dashamirës ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj vetes. Le të sjellim ndër mend që, kur presim nga Zoti, ne po bëhemi “[shenjtore] nëpërmjet shlyerjes së [Tij], . . . [të] nënshtruar, [të] bindur, [të] përlulur, [të] duruar, plot me dashuri, [të] gatshëm t’u [nënshtrohemi] të gjitha gjërave që Zoti i sheh të përshtatshme të shkaktojë mbi [ne], madje sikurse një fëmijë i nënshtrohet atit të tij”³⁶.

I tillë që nënshtrimi i Shpëtimtarit tonë para Atit të Tij, në Kopshtin e Gjetsemanit. Ai iu përgjërua dishepujve të Tij: “Rrini zgjuar bashkë me mua”, megjithatë, tri herë Ai u kthye duke i gjetur me sy të përgjumur.³⁷ Pa shoqërimin e këtyre dishepujve dhe, në fund, pa praninë e Atit të Tij, Shpëtimtari zgjodhi që të vuajë tonat “dhembje dhe hidhërimi dhe tundime të çdo lloji”³⁸. Duke pasur një engjell të dërguar që ta forconte³⁹, Ai nuk u mpak në pirjen e kupës së hidhur⁴⁰. Ai priti nga Ati i Tij duke thënë: “U bëftë vullneti yt!”⁴¹ dhe përlësisht e shkeli i vetëm presën e verës⁴². Tani, si një nga Dymbëdhjetë Apostujt e Tij në këto ditë të mëvonshme, unë lutem që ne të forcohemi për të vigjëlur me Të dhe për të pritur nga Ai gjatë gjithë ditëve tona.

Në këtë mëngjes Shabati, unë shpreh mirënjohje që, në Gjetsemanin tim⁴³ dhe tuajin, ne nuk jemi vetëm. Ai që vigjëlton mbi ne, “nuk dremit dhe nuk fle”⁴⁴. Engjëjt e Tij këtu dhe përtej velit, janë “përreth [nesh], për [të na] ngritur lart”⁴⁵. Jap dëshminë time të veçantë se premtimi i Shpëtimtarit tonë është i vërtetë, sepse Ai thotë: “Ata që shpresojnë te Zoti fitojnë forca të reja, ngrihen me krahë si shqiponja, vrapojnë pa u lodhur dhe ecin pa u lodhur”⁴⁶. Qoftë e mundur që ne të presim nga Ai duke shkuar përpara

me besim, që ne të mund të themi në lutjet tona: “U bëftë vullneti yt”⁴⁷ dhe të kthehemi tek Ai me nder. Në emrin e shenjtë të Shpëtimtarit dhe Shëlbuesit tonë, madje Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Moisiu 4:2.
2. Lluka 2:49.
3. Përkthimi i Joseph Smith-it, Mateu 3:24, tek Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta.
4. Lluka 4:8.
5. Lluka 22:42.
6. Isaia 53:5; Mosia 14:5.
7. Mateu 27:46; Marku 15:34.
8. Shih Lluka 23:34.
9. Shih Gjoni 19:27.
10. Shih Gjoni 19:30.
11. Doktrina e Besëlidhje 121:1.
12. Psalmet 37:9; 123:2; Isaia 8:17; 40:31; 2 Nefi 18:17.
13. Doktrina e Besëlidhje 122:7.
14. Doktrina e Besëlidhje 121:1.
15. Psalmet 30:5.
16. Mateu 6:10; 3 Nefi 13:10; shih edhe Mateu 26:39.
17. Alma 32:41.
18. Mateu 6:10; Lluka 11:2.
19. 2 Nefi 32:5.
20. Romakëve 5:3.
21. Doktrina e Besëlidhje 67:13.
22. Alma 45:17.
23. 2 Nefi 31:20.
24. Moroni 6:4.
25. Doktrina e Besëlidhje 109:44.
26. Alma 1:25.
27. Alma 34:41.
28. Hebrejve 10:35.
29. Doktrina e Besëlidhje 98:3.
30. Jobi 19:25–26.
31. Jobi 13:15.
32. 2 Nefi 28:30.
33. 2 Nefi 28:30.
34. *Teachings of Presidents of the Church: David O. McKay* (2003), f. xviii.
35. Mateu 25:40.
36. Mosia 3:19.
37. Mateu 26:38; shih edhe vargjet 39–45.
38. Alma 7:11.
39. Shih Lluka 22:43.
40. Shih “In Memory of the Crucified”, *Hymns*, nr. 190; shih edhe 3 Nefi 11:11; Doktrina e Besëlidhje 19:18–19.
41. Mateu 26:42.
42. Shih Doktrina e Besëlidhje 76:107; 88:106; 133:50.
43. Shih “Where Can I Turn for Peace?” *Hymns*, nr. 129.
44. Psalmet 121:4.
45. Doktrina e Besëlidhje 84:88.
46. Isaia 40:31.
47. Mateu 26:42.



Nga Plaku Ted R. Kelister,
i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve

Libri i Mormonit – një Libër nga Perëndia

Së bashku me Biblën, Libri i Mormonit është një dëshmitar i domosdoshëm i doktrinave të Krishtit dhe hyjnueshmërisë së Tij.

Vite më parë stër-stërgjyshi im prej nënës, mori për herë të parë një kopje të Librit të Mormonit. Ai e hapi atë në mes dhe lexoi disa faqe. Ai më pas shpalli: “Ai libër është shkruar ose nga Perëndia ose nga djalli, dhe unë kam për ta zbuluar se kush e shkroi atë”. Ai e lexoi atë të gjithin dy herë në 10 ditët vijuese dhe më pas shpalli: “Djalli nuk mund ta ketë shkruar atë– duhet të jetë nga Perëndia”¹.

Kjo është mrekullia e Librit të Mormonit – nuk ka paanësi lidhur me vërtetësinë. Ose është fjala e Perëndisë siç pretendohet, ose është e gjitha një mashtrim. Ky libër nuk pretendon vetëm të jetë një ligjëratë e shkruar mbi moralin ose një koment teologjik apo një përmbledhje shkrimesh të thella. Ai pretendohet të jetë fjala e Perëndisë – çdo fjali, çdo varg, çdo faqe. Jozef Smithi deklaroi se një engjell i Perëndisë e udhëzoi atë për te fletët e arta, që përmbanin shkrimet e profetëve në Amerikën e lashtë dhe që ai i përktheu ato fletë duke përdorur fuqi hyjnore. Nëse ajo histori është e vërtetë, atëherë Libri i Mormonit është shkrim i shenjtë, siç deklarohet se është; nëse jo, atëherë është i stërholluar, por ama

një mashtrim djallëzor.

C. S. Luis foli rreth një mëdyshjeje të tillë të përjetuar nga dikush që duhet të zgjedhë nëse duhet ta pranojë apo ta refuzojë hyjnueshmërinë e Shpëtimtarit – ku gjithashtu, nuk ka rrugë të mesme: “Unë po përpiqem të parandaloj secilin këtu, të thotë ndonjë gjë të pamend që njerëzit thonë shpesh për Të: ‘Unë jam gati ta pranoj Jezusin si një mësues të madh morali, por nuk e pranoj pretendimin e Tij se është Perëndi’. Kjo është ajo gjë që ne nuk duhet ta themi. Një njeri që do të ishte thjesht një njeri dhe do të thoshte gjërat që Jezusi tha, nuk do të ishte një mësues i madh morali. . . . Ju duhet të bëni zgjedhjen tuaj. Ose ky njeri ishte dhe është Biri i Perëndisë ose ndryshe një i çmendur apo diçka më e keqe. . . . Por le të mos japim ide të pakuptimta rreth të qenit të Tij një mësues i madh njerëzor. Ai nuk na e ka lënë këtë interpretim neve. Ai nuk kishte këtë synim.”²

Në të njëjtën mënyrë, ne duhet të bëjmë një zgjedhje të thjeshtë me Librin e Mormonit: ai është ose nga Perëndia ose nga djalli. Nuk ka zgjedhje tjetër. Unë ju ftoj, për një çast, që të bëni një provë që do t’ju ndihmojë

ju të vendosni rreth karakteristikave të këtij libri. Pyeteni veten nëse shkrimet e mëposhtme nga Libri i Mormonit ju afrojnë ju më pranë Perëndisë apo djallit:

“Ushqehuni me bollëk me fjalët e Krishtit; pasi, vini re, fjalët e Krishtit do t’ju tregojnë të gjitha gjërat që ju duhet të bëni” (2 Nefi 32:3).

Ose merrni parasysh këto fjalë nga një baba i dashur ndaj bijve të tij: “Dhe tani bijtë e mi, mbani mend, mbani mend se është mbi shkëmbin e Shëlbuesit tonë që është Krishti, biri i Perëndisë, që ju duhet të ndërtoni themelin tuaj” (Helamani 5:12).

Ose meditoni mbi fjalët e një profeti: “Ejani te Krishti dhe përsosuni në të” (Moroni 10:32).

A mund të bëheshin në ndonjë mënyrë këto deklaratat në Librin e Mormonit nga djalli? Pasi Shpëtimtari dëboi disa demonë, farisenjtë pretenduan se Ai e bëri këtë “me fuqinë e Beelzebubit, princit të demonëve”. Shpëtimtari iu përgjigj se një përfundim i këtillë ishte i pakuptimtë, Ai u tha: “Çdo mbretëri, që përçahet në vetvete, shkon drejt shkatërrimit; dhe çdo . . . shtëpi, që përçahet në vetvete, nuk shkon gjatë”. Dhe më pas, argumenti i Tij përfundimtar: “*Atëherë, në qoftë se Satani dëbon Satanë, ai është përçarë në vetvete, dhe si mund të qëndrojë mbretëria e tij?*” (Mateu 12:24–26; kursivet shtuar).

Nëse vargjet që unë sapopërmenda nga Libri i Mormonit na mësojnë ne ta adhurojmë, ta duam dhe t’i shërbejmë Shpëtimtarit (gjë që e bëjnë), si mund të jenë ato nga djalli? Nëse do të ishte kështu, ai do të përçante veten dhe për rrjedhojë do të shkatërronte mbretërinë e vet, dhe ky është kushti i saktë që Shpëtimtari tha se nuk mund të ekzistonte. Një lexim i sinqertë me mendje të hapur, pa paragjykitime i Librit të Mormonit, do ta çojë dikë në



të njëjtin përfundim me stërstërgjyshin tim, që është: “Djali nuk mund ta ketë shkruar atë – duhet të jetë nga Perëndia”.

Por përse Libri i Mormonit është kaq thelbësor kur ne e kemi tashmë Biblën për të na mësuar rreth Jezu Krishtit? A e keni pyetur ndonjëherë veten pse ka kaq shumë fe të krishtera në botë sot kur ato e marrin doktrinën e tyre kryesisht nga e njëjta Bibël? Kjo ndodh sepse ato e interpretojnë Biblën në mënyra të ndryshme. Nëse ato do ta interpretonin njësoj, ato do të ishin e njëjta kishë. Kjo nuk është gjendja që Zoti dëshiron, pasi apostulli Pal shpalli se “është një Zot i vetëm, një besim i vetëm, një pagëzim i vetëm” (Efesianëve 4:5). Për të ndihmuar që të ndodhë ky unitet, Zoti vendosi një ligj hyjnor dëshmitarësh. Pali dha mësim: “Çdo gjë do të qëndrojë me gojën e dy a tre dëshmitarëve” (2 Korintasve 13:1).

Bibla është njëri dëshmitar i Jezu Krishtit; Libri i Mormonit është tjetri. Përse ky dëshmitar i dytë është kaq vendimtar? Shembulli i mëposhtëm pamor mund të ndihmojë: Sa vija të drejta mund të vizatoni duke u nisur nga një pikë e vetme në një letër? Përgjigjja është një numër të pafund. Mendoni për një çast se pika e vetme përfaqëson Biblën dhe ato qindra vija të drejta të vizatuara nga ajo pikë përfaqësojnë interpretimet e ndryshme të Biblës dhe se secili nga ato interpretime përfaqëson një fe të ndryshme.

Mirëpo çfarë ndodh, nëse në atë letër, ka një pikë të dytë që përfaqëson

Librin e Mormonit? Sa vija të drejta mund të vizatoni midis këtyre pikave të referimit: Biblës dhe Librit të Mormonit? Vetëm një. Vetëm një interpretim i doktrinave të Krishtit mund të ekzistojë me dëshminë e këtyre dy dëshmitarëve.

Libri i Mormonit vepron vazhdimisht si një dëshmitar vërtetues, qartësues e bashkues i doktrinave që jepen mësim në Bibël, në mënyrë që të jetë “një Zot i vetëm, një besim i vetëm, një pagëzim i vetëm”. Për shembull, disa njerëz nuk e dinë nëse është apo jo pagëzimi thelbësor për shpëtimin megjithëse Shpëtimtari shpalli përpara Nikodemit: “Në të vërtetë, në të vërtetë po të them se kush nuk ka lindur nga uji dhe nga Fryma, nuk mund të hyjë në mbretërinë e Perëndisë” (Gjoni 3:5). Por Libri i Mormonit zhdruk çdo dyshim mbi këtë çështje: “Dhe ai urdhëron të gjithë njerëzit, që ata duhet të pendohen dhe të pagëzohen në emrin e tij, . . . ose ata nuk mund të shpëtohen në mbretërinë e Perëndisë” (2 Nefi 9:23).

Ekzistojnë metoda të ndryshme pagëzimi në botë sot, megjithëse Bibla na e tregon mënyrën me të cilën u pagëzua Shpëtimtari, Shembulli ynë i madh: “[Ai] doli nga uji” (Mateu 3:16). A mund të dilte Ai nga uji nëse nuk ishte futur më parë në ujë? Që të mos të ketë ndonjë mosmarrëveshje mbi këtë temë, Libri i Mormonit e përshkruan atë me këtë deklaratë të thjeshtë të doktrinës lidhur me mënyrën e përshtatshme të kryerjes së pagëzimit: “Dhe atëherë do t’i zhytni



Jundiaí në Brazil

në ujë dhe do të dilni përsëri nga uji” (3 Nefi 11:26).

Shumë besojnë se Zoti ndaloi së dhëni zbulesa ndaj njerëzve pasi u shkrua Bibla megjithëse, vetë Bibla është një dëshmi e modelit zbulues të Perëndisë e mbi 4.000 viteve të ekzistencës së njeriut. Por një doktrinë e pasaktë si kjo, është si një domino që shkakton rënien njëra pas tjetrës të një rreshti dominosh ose në këtë rast rënien e doktrinave të sakta. Besimi në fundin e zbulësive bën që të bjerë doktrina se “Perëndia është i njëjti dje, sot dhe përgjithmonë” (Mormoni 9:9); bën që të bjerë doktrina e dhënë mësim nga Amosi se “Zoti, Zoti, nuk bën asgjë, pa ua treguar sekretin e tij shërbëtorëve të tij, profetëve” (Amos 3:7); dhe bën që të bjerë edhe doktrina se “Në të vërtetë unë po e marr vesh se Perëndia nuk tregohet i anshëm” (Veprat e Apostujve 10:34) dhe për pasojë Ai u flet të gjithë njerëzve në të gjitha kohët për rënien. Por fatmirësisht, Libri i Mormonit rikurorëzon të vërtetën biblike të dhënies së zbulësive të vazhdueshme:

“Dhe përsëri unë ju flas juve që mohoni zbulësat e Perëndisë dhe thoni se ato nuk ndodhin më, se nuk ka më zbulësa. . . .

A nuk lexojmë ne se Perëndia është

i njëjtë dje, sot dhe përgjithmonë . . . ?” (Mormoni 9:7, 9).

Me fjalë të tjera, nëse Perëndia që është i pandryshueshëm, foli në kohët e lashta Ai do të flasë njësoj edhe në kohët moderne.

Lista e vërtetimeve dhe qartësimeve doktrinae vazhdon përsëri e përsëri, por asnjë nga pohimet doktrinae nuk është më i fuqishëm, më prekës se ligjëratat e Librit të Mormonit mbi Shlyerjen e Jezu Krishtit. A do t’ju pëlqente të vërtetonit në shpirtin tuaj një dëshmi të pamohueshme se Shpëtimtari shleu për mëkatet tuaja dhe se nuk ka mëkat, as gjendje vdekshmërie të vështirë që të mbetet jashtë përfshirjes mëshirëplotë në Shlyerjen e Tij – që për çdo mundim tuajin, Ai ka një ilaç me fuqinë më të lartë shëruese? Më pas lexoni Librin e Mormonit. Ai do t’ju mësojë dhe do t’ju dëshmojë se Shlyerja e Krishtit është e pafundme sepse mbulon, merr parasysh dhe është më e madhe se çdo dobësi tokësore e njeriut. Kjo është arsyeja pse profeti Mormon shpalli: “Ju duhet të keni shpresë nëpërmjet shlyerjes së Krishtit” (Moroni 7:41).

Nuk është çudi që Libri i Mormonit shpall me guxim: “Dhe nëse ju do të besoni në Krisht, ju do të besoni në këto fjalë, pasi ato janë fjalët e Krishtit”

(2 Nefi 33:10). Së bashku me Biblën, Libri i Mormonit është një dëshmitar i domosdoshëm i doktrinae të Krishtit dhe hyjnueshmërisë së Tij. Së bashku me Biblën ai “ u mëso[n] të gjithë njerëzve, që ata duhet të bëjnë mirë” (2 Nefi 33:10). Dhe së bashku me Biblën, ai na sjell në përfundimin se ka vetëm “një Zot, një besim, një pagëzim”. Kjo është arsyeja pse Libri i Mormonit është kaq vendimtar në jetën tonë.

Disa vite më parë, unë mora pjesë në një nga mbledhjet e adhurimit në Toronto të Kanadasë. Ishte folëse një vajzë 14-vjeçare. Ajo tha se kishte diskutuar rreth fesë me një nga shoqet e saj në shkollë. Shoqja e saj i tha: “Cilës fe i përket?”

Ajo u përgjigj: “Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme ose Mormonëve”.

Shoqja e saj u përgjigj: “Unë e njoh atë kishë dhe e di se ajo nuk është e vërtetë”.

“Nga e di ti këtë?”, u përgjigj vajza.

“Sepse, unë kam bërë kërkime rreth saj”, tha shoqja.

“A ke lexuar Librin e Mormonit?”

“Jo”, ishte përgjigjja. “Nuk e kam lexuar.”

Atëhere kjo vajzë e re, e ëmbël u përgjigj: “Epo ti nuk ke bërë kërkime rreth kishës sime, pasi unë kam lexuar çdo faqe të Librit të Mormonit dhe unë e di se është i vërtetë”.

Unë gjithashtu, kam lexuar çdo faqe të Librit të Mormonit, vazhdimisht dhe unë jap dëshminë time solemne, njësoj si stër-stërgjyshi im, se është nga Perëndia. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Willard Richards, në LeGrand Richards, *A Marvelous Work and a Wonder*, botim i rishikuar (1972), f. 81, 82.
2. C. S. Lewis, *Mere Christianity* (1952), f. 40–41.



Nga Elen S. Dalton,
Presidente e Përgjithshme e Të Rejave

Duaje Nënë e Saj

Si mundet një baba ta rrisë një bijë të lumtur dhe të edukuar mirë në botën që sa vjen e bëhet më helmuese? Përgjigjja na është mësuar nga profetët e Zotit.

Është e vështirë të përshkruhet çasti i shenjtë kur një baba i ri mban një foshnjë vajzë në krahë për herë të parë. Këtë vit tre nga bijtë tanë janë bërë baballarë të disa vogëlushëve. Kur e pashë birin tonë të sertë, të fortë, lojtar të regbisë, Xhonin, duke mbajtur foshnjën e tij të parë vajzë në krahë, ai e pa me një dhembshuri nderuese dhe pastaj pa drejt meje me një shprehi që dukej sikur thoshte: “Si ta rris unë një vajzë?”

Këtë mëngjes unë dëshiroj t’u flas bijve tanë dhe të gjithë baballarëve. Si mundet një baba ta rrisë një bijë të lumtur dhe të edukuar mirë në botën e sotme që sa vjen e bëhet më helmuese? Përgjigjja na është mësuar nga profetët e Zotit. Është një përgjigje e thjeshtë dhe është e vërtetë – “Gjëja më e rëndësishme që një baba mund të bëjë për [bijën] e tij është të dojë nënën e [saj]”¹. Nga mënyra se si ju e doni nënën e saj, ju do t’i mësoni bijës suaj rreth dhembshurisë, besnikërisë, respektit, mëshirës dhe përkushtimit. Ajo do të mësojë nga shembulli juaj se çfarë të presë nga një djalë i ri dhe cilat cilësi të kërkojë te një bashkëshort i ardhshëm. Ju mund t’i tregoni bijës suaj nga mënyra se si e doni dhe e nderoni gruan tuaj, se ajo duhet të presë të martohet me dikë që do ta dojë dhe do

ta nderojë. Shembulli juaj do t’i mësojë bijës suaj vlerën e të qenit grua. Ju po i tregoni asaj se ajo është një bijë e Atit tonë Qiellor, që e do atë.

Duajeni nënën e saj aq shumë, saqë martesë juaj të jetë celestiale. Një martesë në tempull për gjithë kohën dhe përjetësinë është e denjë për përpjekjet tuaja më të mëdha dhe që të jetë përparësia juaj më e madhe. Ishte vetëm pasi Nefi përfundoi tempullin në vendin e shkretët që ai shpalli: “Dhe . . . ne jetuam sipas mënyrës së lumturisë”². “Mënyra e lumturisë” gjendet në tempull. Është mbajtje besëlidhjeje. Mos lejoni asnjë ndikim që vjen në jetën apo shtëpinë tuaj, që do të shkaktonte që ju të rrezikonit besëlidhjen apo zotimin tuaj ndaj gruas dhe familjes.

Te klasa e Të Rejave ne po e ndihmojmë bijën tuaj të kuptojë identitetin e saj si bijë e Perëndisë dhe rëndësinë e të qëndruarit e virtytshme dhe e denjë për të marrë bekimet e tempullit dhe për një martesë në tempull. Ne po i mësojmë bijës suaj rëndësinë e të bërit dhe mbajtjes së besëlidhjeve të shenjta. Ne po i mësojmë asaj të zotohet tani, që të jetojë në mënyrë të tillë, që të jetë gjithmonë e denjë për të hyrë në tempull dhe të mos lejohet asgjë që ta frenojë, ta hutojë

apo ta përjashtojë atë nga të qenit e denjë për në tempull. Shembulli juaj, si babai i saj, është më ndikues se fjalët tona të rëndësishme. Të rejat shqetësohen për baballarët e tyre. Shumë e shprehin dëshirën e tyre të madhe që të bashkohen përjetësisht si një familje. Ato dëshirojnë që ju të jeni atje kur ato të shkojnë në tempull apo të martohen në tempull. Qëndrojeni pranë bijës suaj dhe ndihmoheni atë të përgatitet dhe të qëndrojë e denjë për në tempull. Kur ajo të bëhet 12 vjeç, merreni me vete në tempull shpesh, që të kryejë pagëzime për paraardhësit tuaj dhe të të tjerëve. Ajo do t’i ruajë ato kujtime përgjithmonë.

Kultura e përhapur e të sotmes përpiket të shkatërrojë dhe të poshtërojë rolin tuaj të përjetshëm si patriark dhe baba e t’i zvogëlojë në kulm përgjegjësitë tuaja më të rëndësishme. Këto përgjegjësi ju janë dhënë juve “nëpërmjet planit hyjnor” dhe, si etër, ju “duhet të kryeso[ni] familjet [tuaja] me dashuri e drejtësi dhe jeni përgjegjës për të siguruar gjërat e nevojshme për jetën dhe mbrojtjen për familjet [tuaja]”³.

Baballarë, ju jeni rojtarët e shtëpive tuaja, bashkëshorteve tuaja dhe fëmijëve tuaj. Sot, “nuk është gjë e lehtë ta mbrosh familjen nga prania e padëshiruar e së keqes në mendjen dhe shpirtin e [tyre]. . . . Këto ndikime mundën dhe futën të papenguara në shtëpi. Satani [është shumë i zgjuar]. Ai nuk ka nevojë të shpërthejë derën që të hyjë.”⁴

Ju duhet të jeni rojtarët e virtytit. “Një mbajtës priftërie është i virtytshëm. Sjellja e virtytshme nënkupton që [ju keni] mendime të dëlira dhe veprime të ndershme. . . . Virtyti është . . . një tipar i perëndishmërisë.” Ai “është i ngjashëm me shenjtërinë”⁵. Vlerat e Të Rejave janë tipare si të Krishtit që përfshijnë edhe vlerën e virtytit. Ne tani ju bëjmë thirrje që të bashkoheni me ne



që ta drejtojmë botën drejt një kthimi ndaj virtutit. Në mënyrë që ta bëni këtë, ju “duhet të ushtroni virtut dhe shenjtëri”⁶ duke hequr nga jeta juaj çdo gjë që është e ligë dhe e papajtueshme për dikë që mban priftërinë e shenjtë të Perëndisë. “Virtyti duhet t’i stolisë mendimet e tua pa pushim; atëherë do të forcohet vetbesimi yt në prani të Perëndisë; dhe . . . Fryma e Shenjtë do të jetë shoqëruesi yt i vazhdueshëm”⁷. Kështu që jini të matur rreth asaj që shikon në televizor, internet ose shtypin e shkruar. Virtyti juaj personal do të jetë shembull për bijat tuaja dhe gjithashtu, edhe për bijtë tuaj, se çfarë force dhe kurajoje e vërtetë morale jeni ju. Duke qenë rojtari i virtutit në vetë jetën tuaj, në shtëpinë tuaj dhe në jetën e fëmijëve tuaj, ju po i tregoni gruas dhe bijave tuaja çfarë është në të vërtetë dashuria. Pastërtia juaj vetjake do t’ju japë fuqi.

Ju jeni rojtari i bijës suaj në një kuptim më të gjerë sesa ai ligjor. Jini të pranishëm në mënyrë aktive në jetën e bijës suaj. Vëreni atë në dijeni të standardeve tuaja, pritshmërive tuaja, shpresave tuaja dhe ëndrrave për suksesin dhe lumturinë e saj. Bëjini asaj pyetje, njihuni me miqtë e saj dhe kur të vijë koha me ata që do dalë në takime. Ndhimoheni atë ta kuptojë rëndësinë e arsimimit. Ndhimoheni atë të kuptojë se parimi i modestisë është mbrojtje. Ndhimoheni atë të zgjedhë muzikën, revistat, programet televizive, filmat dhe faqet në internet që ftojnë Shpirtin dhe janë në pajtim me

identitetin e saj hyjnor. Jini një pjesë aktive e jetës së saj. Dhe, nëse gjatë viteve të saj të adoleshencës ndodh që ajo nuk do të kthehet në orar në shtëpi nga një takim, shkoni dhe merrni atë. Ajo do të kundërshtojë dhe do t’ju thotë se ju i keni shkatërruar jetën e saj shoqërore, por së brendshmi ajo do ta dijë se ju e doni dhe se ju interesoheni aq shumë për të sa të jeni rojtari i saj.

Ju nuk jeni burra të zakonshëm. Për shkak të trimërisë suaj në mbretërinë paratokësore, ju u kualifikuat që të jeni udhëheqës dhe që të zotëroni fuqinë e priftërisë. Atje ju shfaqët “besim të jashtëzakonshëm dhe vepra të mira” dhe ju jeni këtu tani që të bëni të njëjtën gjë⁸. Priftëria juaj ju veçon nga të tjerët.

Në pak javë tre bijtë tanë do t’u kenë dhënë bijave të tyre vogëlushe një emër dhe një bekim. Unë shpresoj se ky do të jetë i pari nga shumë bekime priftërie që ato do të marrin nga baballarët e tyre, pasi në botën në të cilën do të rriten, ato do të kenë nevojë për ato bekime. Bija juaj do ta ruajë në kujtesë priftërinë dhe do të vendosë në zemrën e saj se kjo është ajo që dëshiron në shtëpinë dhe familjen e saj të ardhshme. Kujtoni gjithmonë “që të drejtat e priftërisë lidhen në mënyrë të pandashme me fuqitë e qiellit dhe se fuqitë e qiellit nuk mund të kontrollohen, as përdoren, vetëm mbi bazën e parimeve të drejtësisë”⁹.

Baballarë, ju jeni heroi i bijës suaj.

Babai im ishte heroi im. Unë e kisha zakon të prisja te shkallët e shtëpisë tonë për të kur ai kthehej çdo natë nga puna në shtëpi. Ai më merrte në krahë dhe më rrotullonte e pastaj më lejonte t’i vendosja këmbët në këpucët e tij të mëdha dhe pastaj unë vallëzoja me të në shtëpi. Më pëlqente shumë sfida që të përpiqesha të ndiqja çdo hap të tijin. Ende më pëlqen.

A e dinit se dëshmia juaj ka një ndikim të fuqishëm te bijat tuaja? Unë e dija se babai im kishte një dëshmi. Unë e dija se ai e donte Zotin. Dhe për shkak se babai im e donte Zotin, edhe unë e doja gjithashtu. Unë e dija se ai kujdesej për vejjshat pasi ai i kaloi ditët e pushimeve të tij nga puna duke lyer shtëpinë e vejjshës që jetonte aty ngjitur. Unë mendova se ato ishin pushimet më të bukura që kishim kaluar ndonjëherë si familje, pasi ai më mësoi mua të lyeja! Ju do ta bekoni jetën e bijës suaj në vitet që do vijin, nëse do të kërkoni mënyra për të kaluar kohë me të dhe për të ndarë dëshminë tuaj me të.

Në librin e Mormonit, Abishi u kthye në besim ngaqë babai i saj i tregoi vegimin e tij të mrekullueshëm. Për shumë vite, ajo e mbajti dëshminë e saj në zemër dhe jetoj drejtësisht në një shoqëri shumë të ligë. Pastaj erdhi koha kur ajo nuk mundi të heshte më dhe ajo vrapoi shtëpi më shtëpi për të ndarë dëshminë e saj dhe mrekuilitë që i kishte dëshmuar në pallatin e mbretit. Fuqia e kthimit të kësaj të reje dhe e dëshmisë qenë një mjet për ndryshimin e të gjithë shoqërisë. Populli që e dëgjoj atë të dëshmonte, u bë një popull që “u kthyen në besim te Zoti, [dhe] nuk hoqën dorë kurrë nga besimi i tyre” dhe bijtë e tyre u bënë djem luftëtarë!¹⁰

Ashtu siç thotë himni, “Rise up, O men of God!” [“Ngrihuni, O burra të Perëndisë”]¹¹ Kjo është një thirrje për

ju, burra që mbani priftërinë e shenjtë të Perëndisë. U thëntë për ju ashtu siç u tha për kapiten Moronin:

“[Ai] ishte njeri i fortë dhe i fuqishëm; . . . ai ishte njeri me kuptim të përsosur; . . . një njeri i vendosur në besimin e Krishtit. . . .

. . . Në qoftë se të gjithë njerëzit kishin qenë dhe ishin, ose do të jenë ndonjëherë, sikurse Moroni, vini re, fuqitë e vërteta të ferrit do të ishin tundur përgjithnjë; po, djalli nuk do të kishte kurrë më fuqi mbi zemrat e fëmijëve të njerëzve”¹².

Vëllezër, baballarë, të rinj: “Jini mbretër ndaj mbretit brenda jush”¹³.

Pra, si ta rrisni një vajzë? Duajeni nënën e saj. Drejtojeni familjen tuaj për në tempull, jini rojtarë të virtytit dhe lartësoni priftërinë tuaj. Baballarë, juve ju janë besuar bijat mbretërore të Atit tonë Qiellor. Ato janë të virtutshme dhe të zgjedhura. Është lutja ime që ju të kujdeseni për to, t’i forconi ato, të jepni shembull për një sjellje të virtutshme dhe t’u mësoni atyre të ndjekin shembullin e Shpëtimtarit – pasi Ai jeton! Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Presidenti David O. McKay shpesh e citonte këtë deklaratë të Theodore Hesburgh, në “Quotable Quotes”, *Reader’s Digest*, janar 1963, f. 25; shih edhe *Richard Evans’ Quote Book* (1971), f. 11.
2. 2 Nefi 5:27.
3. “Familja: Një Proklamatë Drejtuar Botës”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.
4. A. Theodore Tuttle, “The Role of Fathers”, *Ensign*, janar 1974, f. 67.
5. Ezra Taft Benson, “Godly Characteristics of the Master”, *Ensign*, nëntor 1986, f. 46.
6. Doktrina e Besëlidhje 46:33.
7. Doktrina e Besëlidhje 121:45, 46.
8. Alma 13:3; shih edhe vargun 2.
9. Doktrina e Besëlidhje 121:36.
10. Alma 23:6; shih edhe Alma 19:16–17; 53:10–22.
11. “Rise Up, O Men of God”, *Hymns*, nr. 323.
12. Alma 48:11, 13, 17.
13. Në Harold B. Lee, “Be Loyal to the Royal within You”, në *Speeches of the Year: BYU Devotional and Ten-Stroke Fireside Addresses 1973* (1974), f. 100.



Nga Plaku M. Rasëll Ballard,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Rëndësia e një Emri

Le ta zhvillojmë zakonin . . . për ta bërë të qartë se Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është emri me të cilin Vetë Zoti na ka udhëzuar që të njihemi.

Plaku Hejls, në emër të të gjithëve ne, ju shprehim dashurinë tonë të thellë dhe jemi shumë mirënjohës që jeni këtu këtë mëngjes.

Qysh nga konferenca e përgjithshme e prillit të kaluar, mendja ime vazhdimisht është përqendruar në temën e rëndësisë së një emri. Në këto muajt e fundit, disa stërnipër e stërmbesa kanë lindur në familjen tonë. Edhe pse stërnipërit dhe stërmbesat duken sikur erdhën në jetë më shpejt se sa mund t’i prisja, secili fëmijë është një gëzim i madh në familjen tonë. Secili ka marrë një emër të veçantë të zgjedhur nga prindërit e tij ose të saj, një emër që do të njihet gjatë gjithë jetës së tij ose të saj, duke e dalluar atë nga dikush tjetër. Kjo është e vërtetë në çdo familje dhe është gjithashtu e vërtetë midis feve të botës.

Zoti Jezu Krisht e dinte se sa e rëndësishme ishte ta emëronte qartë Kishën e Tij në këto ditë të fundit. Në seksionin 115 të Doktrinës e Besëlidhjeve, Ai Vetë e emërtoi Kishën: “Sepse kështu do të quhet kisha ime në ditët e fundit, madje Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme” (vargu 4).

Dhe mbreti Beniamin e mësoi popullin e tij në kohët e Librit të Mormonit:

“Unë do të doja që ju të merrni mbi vete emrin e Krishtit, të gjithë ju që keni hyrë në besëlidhje me Perëndinë, se ju do të jeni të bindur deri në fund të jetës tuaj. . . .

Dhe unë do të doja që ju gjithashtu të kujtoni se ky është emri që unë thashë se do t’ju jepja, që nuk do të fshihet kurrë, veçse nëpërmjet shkeljes; prandaj kini vëmendjen që ju të mos bëni shkelje, që emri të mos fshihet nga zemrat tuaja” (Mosia 5:8, 11).

Ne marrim mbi vete emrin e Krishtit në ujërat e pagëzimit. Ne e përtërijmë efektin e atij pagëzimi çdo javë ndërsa marrim sakramentin, duke treguar gatishmërinë tonë për të marrë mbi vete emrin e Tij dhe duke premtuar se gjithmonë do ta kujtojmë Atë (shih DeB 20:77, 79).

A e kuptojmë ne se sa të bekuar jemi që marrim mbi vete emrin e Birit të Dashur dhe të Vetëmlindur të Perëndisë? A e kuptojmë se sa domethënëse është kjo? Emri i Shpëtimtarit është i vetmi emër nën qiell, nëpërmjet të cilit njeriu mund të shpëtohet (shih 2 Nefi 31:21).

Nëse e mbani mend, Presidenti Bojd K. Paker në konferencën e përgjithshme të prillit të kaluar diskutoi rreth rëndësisë së emrit të Kishës. Ai shpjegoi se: “Të bindur ndaj zbulësës,



ne e quajmë veten Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme më mirë se Kisha Mormone” (“Të Drejtuar nga Shpirti i Shenjtë”, *Liahona*, maj 2011, f. 30).

Për shkak se emri i plotë i Kishës është kaq i rëndësishëm, unë përsëris zbuluesat nga shkrimet e shenjta, udhëzimet e Presidencës së Parë në dokumentet zyrtare të vitit 1982 e 2001 dhe fjalët e apostujve të tjerë, që kanë nxitur anëtarët e Kishës të mbrojnë dhe t’i mësojnë botës se Kisha njihet me emrin e Zotit Jezu Krisht. Ky është emri me të cilin Zoti do të na thërrasë në ditën e fundit. Është emri me të cilin Kisha e Tij do të dallohet nga gjithë të tjerat.

Kam menduar shumë se përse Shpëtimtari i dha Kishës së Tij të rivendosur emër të gjatë. Mund të duket i gjatë, por nëse e mendojmë atë si një përshkrim të asaj se çfarë është Kisha, papritur ai bëhet mrekullisht i shkurtër, i qartë dhe i lehtë. Si mund të jetë më i drejtpërdrejtë e i qartë ndonjë përshkrim dhe ende të shprehet në kaq pak fjalë?

Çdo fjalë është sqaruese dhe domethënëse. Fjala *Kisha* në trajtën e shquar tregon pozicionin unik të Kishës së

rivendosur midis feve të botës.

Fjalët *Kisha e Jezu Krishtit* tregojnë që është Kisha e Tij. Në Librin e Mormonit, Jezusi na mësoi: “Dhe si do të ishte kisha ime nëse nuk do të quhej me emrin tim? Pasi, në qoftë se një kishë quhet me emrin e Moisiut, atëherë do të jetë kisha e Moisiut; ose në qoftë se quhet me emrin e një njeriu [si Mormon], atëherë do të jetë kisha e një njeriu; por në qoftë se quhet me emrin tim, atëherë është kisha ime, në qoftë se ata janë ndërtuar mbi ungjillin tim” (3 Nefi 27:8).

Ditëve të Mëvonshme shpjegon se është e njëjta Kishë me Kishën e Jezu Krishtit të krijuar gjatë shërbesës së Tij të vdekshme por e rivendosur në këto ditë të fundit. Ne e dimë se kishte një rënie, ose një braktisje, duke bërë të nevojshme rivendosjen e Kishës së Tij të vërtetë dhe të plotë në kohën tonë.

Shenjtorëve do të thotë se anëtarët e saj e ndjekin Atë dhe përpiqen të bëjnë vullnetin e Tij, të mbajnë urdhërimet e Tij, dhe të përgatiten edhe një herë për të jetuar me Të dhe Atin tonë Qiellor në të ardhmen. *Shenjtorëve* thjesht u referohet atyre që kërkojnë ta bëjnë jetën e tyre të shenjtë duke u angazhuar për të ndjekur Krishtin.

Emri që Shpëtimtari i kishte dhënë Kishës së Tij na tregon saktësisht se kush jemi dhe çfarë besojmë. Ne besojmë se Jezu Krishti është Shpëtimtari dhe Shëlbuesi i botës. Ai shleu për të gjithë ata që do të pendohen për mëkatet e tyre, dhe këputi lidhjet e vdekjes e siguroi ringjalljen e të vdekurve. Ne ndjekim Jezu Krishtin. Dhe sikurse mbreti Beniamin i tha popullit të tij, ashtu dhe unë ripohoj për të gjithë ne sot: “Ta kujtoni dhe ta mbani emrin [e Tij] gjithmonë të shkruar në zemrat tuaja” (Mosia 5:12).

Neve na është kërkuar të qëndrojmë si dëshmitarë të Tij “në të gjitha kohët, në të gjitha gjërat dhe në të gjitha vendet” (Mosia 18:9). Kjo do të thotë se ne duhet të jemi të gatshëm t’u tregojmë të tjerëve se cilin ndjekim dhe Kishës së kujt i përkasim: Kishës së Jezu Krishtit. Ne me siguri dëshirojmë ta bëjmë këtë me një qëndrim dashurie dhe dëshmie. Ne duam ta ndjekim Shpëtimtarin duke shpallur me thjeshtësi e qartësi, por sidoqoftë me përulësi se ne jemi anëtarë të Kishës së Tij. Ne e ndjekim Atë duke qenë shenjtorë të ditëve të mëvonshme–dishepuj të ditëve të mëvonshme.

Njerëzve dhe organizatave shpesh u janë vënë pseudonime nga të tjerët. Një pseudonim mund të jetë një formë e shkurtër e një emri, ose mund të rrjedhë nga një ngjarje apo disa karakteristika fizike ose të tjera. Ndërkohë që pseudonimet nuk kanë të njëjtën gjendje ose domethënie si emrat ekzistues, ato mund të përdoren siç duhet.

Kisha e Zotit si në kohën e lashtë edhe atë moderne ka pasur pseudonime. Shenjtorët në kohët e Dhiatës së Re u quajtën *të krishterë* sepse ata deklaruan besimin në Jezu Krisht. Ai emër, përdorur më parë negativisht nga kritikuesit e tyre, tani është një emër dallues; dhe ne jemi të nderuar të quhemi një kishë e krishterë.

Anëtarët tanë janë quajtur *mormonë* sepse ne besojmë në Librin e Mormonit: Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit. Të tjerët mund të përpiqen ta përdorin fjalën *Mormon* më gjerësisht, për të përfshirë dhe për t'ju referuar atyre që janë larguar nga Kisha dhe grupeve të ndryshme të formuara nga ata që janë larguar [nga Kisha]. Një përdorim i tillë çon në ngatërresë. Ne jemi mirënjohës për përpjekjet e mediave për t'u përmbytur nga përdorimi i fjalës *Mormon* në një mënyrë që mund ta bëjë publikun të ngatërrojë Kishën me poligamistët ose grupe të tjera fundamentaliste. Më lejoni të shpall qartë se asnjë grup poligamist, përfshirë ata të cilët e quajnë veten Mormonë fundamentalistë ose variante të tjera të emrit tonë, nuk ka asnjë lidhje çfarëdo qoftë me Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Ndërsa emri *Mormon* nuk është emri i plotë dhe i saktë i Kishës, edhe pse ai është dhënë fillimisht nga kritikuesit tanë gjatë viteve tona të hershme të persekutimit, ai është bërë një pseudonim i pranueshëm kur përdoret për anëtarët më shumë se sa institucionin. Ne nuk duhet të reshtim



së përdoruri emrin *Mormon* kur është e nevojshme, por duhet të vazhdojmë t'i vëmë theksin emrit të plotë dhe të saktë të Kishës vetë. Me fjalë të tjera, ne duhet të shmangim dhe të kundërshtojmë termin "Kisha Mormone".

Përgjatë viteve, ndërsa kam përmbytur detyra nëpër botë, jam pyetur shumë herë nëse i përkas Kishës Mormone. Përgjigjja ime ka qenë: "Unë jam anëtar i Kishës së Jezu Krishtit. Për shkak se ne besojmë në Librin e Mormonit, që është emërtuar sipas një udhëheqësi, profeti të lashtë amerikan dhe që është një dëshmi tjetër e Jezu Krishtit, ne nganjëherë jemi quajtur mormonë". Në çdo rast kjo përgjigje është pritur mirë dhe faktikisht më ka krijuar shumë mundësi për të shpjeguar rivendosjen e plotësisë së ungjillit në këto ditë të mëvonshme.

Vëllezër dhe motra, thjesht mendoni se çfarë ndikimi mund të kemi ne vetëm duke iu përgjigjur e përdorur emrin e plotë të Kishës, siç Zoti e shpalli që ne duhet ta bëjmë. Dhe në qoftë se nuk mund ta përdorni përnjëherësh emrin e plotë, të paktën thoni: "Unë i përkas Kishës së Jezu Krishtit" dhe më pas sqaroni "të Shenjtorëve të

Ditëve të Mëvonshme".

Disa mund të pyesin, po faqet e internetit të tilla si Mormon.org si edhe fushata të ndryshme mediatike të iniciuara nga Kisha? Sikurse ju thashë, t'u referohesh bashkërisht anëtarëve si *mormonë* ndonjëherë është e përshtatshme. Si një rast i përdorshëm, ata që nuk janë të besimit tonë vijnë duke na kërkuar ne për të ditur për atë term. Por sapo të hapni Mormon.org, emri i saktë i Kishës shpjegohet në faqen zyrtare dhe duket në çdo faqe tjetër në site. Nuk është praktike që të presësh njerëzit për të shkruar emrin e plotë të Kishës, kur kërkojnë të na gjejnë ne ose kur hyjnë në faqen tonë të internetit.

Ndërsa këto praktika mund të vazhdojnë, nuk duhet t'i ndalojmë njerëzit nga përdorimi i emrit të plotë të Kishës kur është e mundur. Le ta zhvillojmë zakonin brenda familjeve tona dhe aktiviteteve të Kishës tonë e ndërveprimeve tona të përditshme, për ta bërë të qartë se Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është emri me të cilin Vetë Zoti na ka udhëzuar që të njihemi.

Një anketë e kohëve të fundit tregoi se ende shumë njerëz nuk e

kuptojnë drejt se fjala *Mormonë* u referohet anëtarëve të Kishës sonë. Dhe një shumicë njerëzish ende nuk janë të sigurt se mormonët janë të krishterë. Edhe kur lexojnë për punën e Duarve Ndihmëtare në të gjithë botën si pasojë e uraganeve, tërmeteve, përmbytjeve dhe zisë së bukës ata nuk bëjnë lidhjen e përpjekjeve tona humanitare me ne si një organizatë e krishterë. Sigurisht që, nëse do e referonim veten tonë si anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme do të ishte më e lehtë për ta që ta kuptonin se ne besojmë dhe ndjekim Shpëtimtarin. Në këtë mënyrë, ata që e dëgjojnë emrin *Mormon* do ta bëjnë lidhjen e fjalës me emrin tonë të zbuluar dhe me njerëzit që ndjekin Jezu Krishtin.

Ashtu si Presidenca e Parë kërkoi në dokumentin e saj zyrtar të 23 shkurtit 2001: "Përdorimi i emrit të zbuluar, Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. . . , është gjithnjë e më i rëndësishëm në përgjegjësinë tonë për të shpallur emrin e Shpëtimtarit në të gjithë botën. Prandaj, ne kërkojmë që kur t'i referohemi Kishës ta përdorim emrin e tij të plotë kurdoherë që është e mundur".

Përsëri në konferencën e përgjithshme të tetorit në 1948, Presidenti Xhorxh Albert Smith tha: "Vëllezër dhe motra, kur të largoheni nga konferenca sot, ju mund të bashkëveproni me grupe të ndryshme fetare të botës, por mos harroni se ka vetëm një Kishë në të gjithë botën që me urdhrin hyjnor mban emrin e Jezu Krishtit, Zotit tonë" (në Conference Report, tetor 1948, f. 167).

Vëllezër dhe motra, e kujtofmish gjithmonë këtë këshillë kur të largoheni sot nga konferenca. Le të dëgjojnë dëshmitë tona për Të dhe dashuria jonë për Të të jetë gjithmonë në zemrat tona, unë lutem përulësisht në emrin e Tij, Zotit Jezu Krisht, amen. ■



Nga Presidenti Tomas S. Monson

Qëndroni në Vende të Shenjta

Komunikimi me Atin tonë në Qiell – përfshirë lutjet tona ndaj Tij dhe frymëzimin e Tij ndaj nesh – është i nevojshëm në mënyrë që ne t'u shpëtojmë stuhive dhe sprovave të jetës.

Vëllezër dhe motra të mia të dashura, kemi dëgjuar mesazhe të shkëlqyera këtë mëngjes dhe e përgëzoj çdonjërin që ka marrë pjesë. Ne jemi veçanërisht të kënaqur të kemi me ne edhe një herë Plakun Robert D. Hejls dhe që ndihet më mirë (pas të qenit sëmurë). Ne të duam, Bob.

Ndërsa kam menduar se çfarë do të doja t'ju thoja këtë mëngjes, e kam ndier të nevojshme të ndaj disa mendime dhe ndjenja, që mendoj të jenë me vend dhe të kohës. Unë lutem që të mund të udhëhiqem në bisedën time.

Kam jetuar në këtë tokë për 84 vite tashmë. Për t'ju dhënë një përfytyrim të shkurtër, kam lindur në të njëjtin vit që Çarls Lindberq bëri fluturimin e parë vetëm, pa ndalesa nga Nju-Jorku në Paris, vetëm me një motor, në një aeroplan me një palë krahë dhe një ndenjësë. Që nga ajo kohë, gjatë 84 viteve shumë gjëra kanë ndryshuar. U bë një kohë e gjatë që kur njerëzit kanë udhëtuar. Në fakt, gjërat që më parë ishin vetëm fantashkencë tani janë bërë realitet. Dhe në saje të teknologjisë së sotme, ai realitet po ndryshon kaq shpejt sa që mezi mund të njihemi me të – madje edhe mund

të mos njihemi fare me të. Për ata prej nesh që i kujtojnë telefonat analogë dhe makinat e shkrimit të dorës, teknologjia e sotme është më shumë se thjesht e mahnitshme.

Standardet morale të shoqërisë kanë ndryshuar shpejt. Sjelljet që dikur konsideroheshin të papërshtatshme dhe të pamoralshme, tani jo vetëm që tolerohen, por konsiderohen edhe si të pranueshme nga shumë njerëz.

Kohët e fundit kam lexuar në gazetën "Wall Street" një artikull nga Xhonathën Saks, kryetari i rabinëve [mësues ose meshtar i fesë hebreje] të Britanisë. Ndër të tjera, ai shkruan: "Në pothuajse çdo shoqëri perëndimore në vitet 1960 ka pasur një ndryshim të papritur në standardet morale, një braktisje të një grupi rregullash tradicionale, sipas të cilave njerëzit do të kufizonin sjelljen e tyre. Gjithçka që ju nevojitet është dashuria, kënduan Bitëllsat. Standardet tradicionale të moralit të Judaizmit dhe Krishtëritimit u braktisën. Në vend të tyre erdhi [një thënie e njohur]: [Bëj] çfarëdo që të sjell dobi ty. Dhjetë Urdhërimet u rishkruan si Dhjetë Propozimet Krijuese."

Rabini Saks shpreh me keqardhje se:

“Ne jemi duke braktisur parimet tona morale me të njëjtën pakujdesi që jemi duke shpenzuar burimet tona financiare. . . .

Ka vende të mëdha [të botës] ku feja është një gjë e së kaluarës dhe nuk ka asnjë zë për balancimin e ideve kulturore që nxisin njerëzit për të blerë gjëra, për të shpenzuar para, për të veshur veshje që bien në sy dhe për t’i nxjerrë në publik sepse e meritojnë. Mesazhi është që parimet morale janë të dala mode, ndërgjegjja është për njerëzit e dobët dhe urdhërimi më i rëndësishëm është: “Ti nuk do të zbulohesh.”¹

Vëllezër dhe motra të mia, kjo – për fat të keq – përshkruan shumë për botën rreth nesh. A duhet të dëshpërohemi dhe të pyesim veten se si do të mbijetojmë vallë në një botë të tillë? Jo. Në të vërtetë, ne kemi ungjillin e Jezu Krishtit në jetën tonë dhe ne e dimë se parimet morale nuk janë të dala mode, se ne kemi ndërgjegjen tonë për të na udhëhequr dhe se ne jemi përgjegjës për veprimet tona.

Edhe pse bota ka ndryshuar, ligjet e Perëndisë mbeten të pandryshuara. Ato nuk kanë ndryshuar; ato nuk do të ndryshojnë. Dhjetë Urdhërimet janë pikërisht ato – urdhërime. Ato *nuk* janë sugjerime. Ato sot janë njëlloj të nevojshme siç ishin kur Perëndia ua dha bijve të Izraelit. Nëse vetëm u vëmë veshin, dëgjojmë jehonën e zërit të Perëndisë, duke na folur këtu dhe tani:

“Nuk do të kesh perëndi të tjerë para meje.

Nuk do të bësh skulpturë ose shëmbëlltyrë të asnjë gjëje. . . .

Nuk do ta përdorësh emrin e Zotit, të Perëndisë tënd, kot. . . .

Mbaje mend ditën e shtunë për ta shenjtëruar. . . .

Do të nderosh atin tënd dhe nënën tënde. . . .

Nuk do të vrasësh.



Nuk do të shkelësh besnikërinë bashkëshortore.

Nuk do të vjedhësh.

Nuk do të bësh dëshmi të rreme. . . .

Nuk do të dëshirosh shtëpinë e të afërmit tënd.”²

Kodi ynë i sjelljes është përfundimtar; nuk është i diskutueshëm. Ai gjendet jo vetëm te Dhjetë Urdhërimet, por edhe në Predikimin në mal, që na u dha nga Shpëtimtari kur Ai eci mbi tokë. Ai gjendet në të gjitha mësimet e Tij. Ai gjendet në fjalët e zbulesës bashkëkohore.

Ati ynë në Qiell është i njëjtë dje, sot dhe përgjithmonë. Profeti Moroni na thotë se Perëndia është “i pandryshueshëm nga e gjithë përjetësia në të gjithë përjetësinë”³. Në këtë botë ku gjithçka duket sikur do të ndryshojë, qëndrueshmëria e Tij është diçka në të cilin mund të mbështetemi, një spirancë në të cilën ne mund të mbahemi mirë dhe të jemi të sigurt, kështu që mos të fshihemi në ujërat e panjohur.

Ndonjëherë mund t’ju duket se ata jashtë në botë po argëtohen më shumë se sa ju. Disa prej jush mund të ndjehen të kufizuar nga kodi i sjelljes, të cilit i përmbahemi ne në Kishë. Megjithatë, vëllezër dhe motra të mia, unë ju shpall juve, se nuk ka *asgjë* që mund të sjellë më shumë gëzim në jetën tonë ose më shumë paqe për shpirtin tonë se sa Shpirti i cili mund

të vijë te ne ndërsa ndjekim Shpëtimtarin dhe mbajmë urdhërimet. Ai Shpirt nuk mund të jetë i pranishëm në llojet e aktiviteteve në të cilat aq shumë nga bota marrin pjesë. Apostulli Pal deklaroi të vërtetën: “Dhe njeriu natyror nuk i rrok gjërat që janë të Frymës së Shenjtë; sepse për të janë marrëzi dhe nuk mund t’i njohë; sepse ato gjykohen frymërisht”⁴. Termi “*njeriu natyror*” mund t’i referohet secilit prej nesh nëse e lejojmë veten tonë të jemi të tillë.

Ne duhet të jemi të vëmendshëm në një botë në të cilën kultura është larguar shumë nga gjërat shpirtërore. Është e nevojshme që ne të refuzojmë çdo gjë që nuk përputhet me standardet tona, duke mos pranuar gjatë procesit që të dorëzojmë atë që dëshirojmë shumë: jetën e përjetshme në mbretërinë e Perëndisë. Herë pas here ne ende do të kemi vështirësi, por ato janë një pjesë e pashmangshme e përvojës sonë në vdekshmëri. Megjithatë, ne do të jemi shumë më të përgatitur për t’u marrë me to, për të mësuar prej tyre dhe për t’i kapërcyer ato, nëse kemi ungjillin që të jetë themeli i jetës sonë dhe dashurinë e Shpëtimtarit në zemrat tona. Profeti Isaia deklaroi: “Pasoje e drejtësisë do të jetë paqja, rezultat i drejtësisë qetësia dhe siguria përjetë”⁵.

Për shkak se jemi në botë por jo të botës, është e nevojshme që ne të



komunikojmë me Atin tonë Qiellor nëpërmjet lutjes. Ai dëshiron që ne të veprojmë kështu; Ai do t'u përgjigjet lutjeve tona. Shpëtimtari na këshilloi ne, siç është shënuar te 3 Nefi 18, për "[t'ju] lut[ur] gjithnjë, që të mos [biem] në tundim pasi Satani dëshiron [të na] ketë ne. . . .

Prandaj, [ne] duhet t'i lute[mi] gjithmonë Atit në emrin [e Tij];

Dhe çdo gjë që [ne] do [t'i] kërkojmë] Atit në emrin [e Tij], që është e drejtë, duke besuar se do ta [marrim], vini re, ajo do [të na] jepet."⁶

Unë e fitova dëshminë time për fuqinë e lutjes kur isha 12 vjeç. Kisha punuar shumë për të fituar disa të holla dhe kisha arritur të ruaja pesë dollarë. Kjo qe gjatë Depresionit të Madh, kur pesë dollarëshi ishte një shumë e konsiderueshme parash – sidomos për një djalë 12-vjeçar. Ia dhashë të gjitha monedhat e mia, të cilat kapnin shumë pesë dollarë, babait tim, dhe ai në këmbim më dha një kartëmonedhë pesë dollarëshe. E di se kishte diçka të veçantë që planifikova të blija me pesë dollarëshin, edhe pse gjithë këto vite më vonë unë nuk mund ta kujtoj se çfarë ishte. Unë thjesht mbaj mend se sa të rëndësishme ishin për mua ato parë.

Në atë kohë ne nuk kishim një makinë larëse, kështu që mamaja ime do të çonte në lavanderi çdo javë rrobat tona që kishin nevojë të laheshin.

Pas disa ditësh, një ngarkesë të cilën e quanim "lavanderi e patharë" do të kthehej te ne dhe mamaja do t'i varte rrobat në telin tonë prapa shtëpisë për t'u tharë.

Unë e kisha vendosur kartëmonedhën time pesë dollarëshe në xhepin e xhinseve të mia. Dhe siç mund ta merrni me mend, xhinset e mia ishin dërguar në lavanderi me paratë ende në xhep. Kur e kuptova se çfarë kishte ndodhur, u mbusha me shqetësim.

E dija se xhepat ishin kontrolluar në mënyrë rutine në lavanderi para se të laheshin. Nëse paratë e mia nuk ishin zbuluar dhe marrë gjatë atij procesi, e dija, isha pothuajse i bindur se paratë do të binin nga xhepi im gjatë larjes dhe se do të njoftohej nga punonjësi i lavanderisë, i cili nuk do kishte asnjë ide se kujt duhet t'i ktheheshin paratë, edhe nëse do të kishte mirësinë ta bënte këtë. Shansi për të marrë mbrapsht pesë dollarëshin tim ishte shumë i vogël – një e vërtetë që mamaja ime e dashur e pohoi kur i thashë se kisha lënë paratë në xhepin tim.

Unë i doja ato para; unë kisha nevojë për ato para; unë kisha punuar shumë për t'i fituar ato para. E kuptova se mund të bëja vetëm një gjë. Me ankth të madh u ktheva tek Ati im në Qiell dhe iu luta Atij që të m'i ruante në njëfarë mënyre paratë në atë xhep derisa lavanderia jonë e patharë të kthehej.

Pas dy ditësh shumë të gjata, kur e dija se ishte koha që makina e shpërndarjes të sillte rrobat tona të lara, unë u ula duke pritur pranë dritares. Ndërsa kamioni ndali në buzë të trotuarit, zemra ime po rrihte. Sapo rrobat e pathara ishin në shtëpi, unë rrëmbeva xhinset e mia dhe vrapova për në dhomën time. Arrita te xhepi me duar të dridhura. Kur nuk gjeta gjë direkt, mendova se kishin humbur. Dhe më pas gishtërinjtë e mi prekën atë

kartëmonedhë të lagur pesë dollarëshe. Ndërsa e tërhoqa nga xhepi, unë përjetova një ndjenjë të thellë besimi. I ofrova një lutje të çiltër mirënjohjeje Atit tim në Qiell, pasi e dija se Ai i ishte përgjigjur lutjes sime.

Që nga ajo kohë kam pasur përgjigje të panumërta të lutjeve. Asnjë ditë nuk ka kaluar që unë të mos kem komunikuar me Atin tim në Qiell nëpërmjet lutjes. Kjo është një marrëdhënie që unë e mbaj gjallë – do të isha i humbur pa atë marrëdhënie. Nëse nuk keni një marrëdhënie të tillë me Atin tuaj në Qiell, unë ju bëj thirrje për të punuar në drejtim të këtij qëllimi. Ndërsa e bëni këtë, ju do të keni të drejtën e frymëzimit të Tij dhe udhëzimit në jetën tuaj – nevoja për secilin prej nesh, nëse duam të mbijetojmë shpirtërisht gjatë udhëtimit tonë këtu në tokë. Frymëzimi dhe udhëheqja e tillë janë dhurata që Ai na i jep bujarisht në qoftë se i kërkojmë ato. Ato janë thesare të mëdha.

Unë jam gjithmonë i përlurur dhe mirënjohës kur Ati im Qiellor komunikon me mua me anë të frymëzimit të Tij. Kam mësuar ta njoh, t'i besoj dhe ta ndjek atë. Shumë herë unë kam marrë një frymëzim të tillë. Një përvojë mjaft dramatike ndodhi në gusht të 1987-ës gjatë dedikimit të Tempullit të Frankfurtit në Gjermani. Presidenti Ezra Taft Benson kishte qenë me ne ditën e parë ose të dytë të dedikimit, por u kthye në shtëpi, dhe kështu ishte mundësia ime për të drejtuar sesionet e mbetura.

Të shtunën ne kishim një sesion për anëtarët tanë hollandezë, që ishin në distriktin e tempullit të Frankfurtit. Unë e njihja mirë një nga udhëheqësit tanë të shquar nga Holanda, vëllanë Pitër Morek. Vetëm pak para sesionit, unë pata përshtypjen e veçantë se Vëllait Morek duhej t'i kërkohej për të folur për anëtarët, miq të tij hollandezë

gjatë sesionit dhe se, në fakt, ai duhet të ishte folësi i parë. Duke mos e parë në tempull atë mëngjes, unë lashë një pusullë te Plaku Karlos E. Esei, Presidenti ynë i Zonës, duke e pyetur nëse Pitër Morek ishte i pranishëm në sesion. Vetëm pak para ngritjes në këmbë për të filluar sesionin, unë mora një pusullë nga Plaku Esei, duke më treguar se faktikisht Vëllai Morek *nuk* ishte i pranishëm në mbledhje, se ai ishte angazhuar diku tjetër dhe se ai po planifikonte të merrte pjesë në sesionin e dedikimit të tempullit të nesërmen me kunjet e ushtrisë.

Ndërsa qëndrova në podium për t'u uruar mirëseardhjen njerëzve dhe për të prezantuar programin, unë përsëri mora frymëzim të pagabueshëm se duhet të njoftoja Pitër Morekun si folësin e parë. Kjo ishte kundër të gjitha instikteve të mia, sepse sapo kisha dëgjuar nga Plaku Esei se Vëllai Morek pa dyshim që *nuk* ishte në tempull. Megjithatë, duke i besuar frymëzimit, unë njoftova prezantimin e korit, lutjen dhe më pas tregova se folësi ynë i parë do të ishte Vëllai Pitër Morek.

Kur u ktheva në vendin tim, unë hodha shikimin drejt Plakut Esei; unë pashë në fytyrën e tij një vështrim alarmues. Ai më pas më tha se kur unë njoftova Vëllanë Morek si folësin e parë, ai nuk mund t'u besonte veshëve. Ai tha se e dinte se unë e kisha marrë shënimin e tij, se me të vërtetë e kisha lexuar atë dhe nuk mund ta kuptonte se përse atëherë unë do të njoftoja Vëllanë Morek si folësin e parë, duke e ditur se ai nuk ishte gjëkund në tempull.

Gjatë kohës që e gjitha kjo po ndodhte, Pitër Morek ishte në një mbledhje në zyrat e zonës në Porthshtrase. Ndërsa mbledhja e tij po vazhdonte, ai papritur u kthye nga Plaku Tomas A. Houks i Riu, i cili atëherë ishte përfaqësuesi krahinor, dhe e pyeti: "Sa shpejt mund të më çoni në tempull?"



Plaku Houks, i cili ishte i njohur se e drejtonte disi me mjaft shpejtësi makinën e tij të vogël, sportive, iu përgjigj: "Mund t'ju çoj atje për 10 minuta! Por përse duhet të shkoni në tempull?"

Vëllai Morek pohoi se nuk e dinte se përse ai duhej të shkonte në tempull, por që ai e dinte se duhet të shkonte atje. Që të dy u nisën menjëherë për në tempull.

Gjatë numrit mahnitës të korit, unë hodha një shikim përreth, duke menduar se në një çast do të shihja Pitër Morekun. Unë nuk e pashë. Megjithatë, mrekullisht nuk u ndieva i alarmuar. Pata një siguri të ëmbël, të pamohueshme se gjithçka do të shkonte mirë.

Vëllai Morek hyri në derën kryesore

të tempullit sapo lutja e hapjes po mbaronte, ende pa e ditur përse ai ishte aty. Ndërsa nxitoi poshtë shkallëve, ai pa figurën time në monitor dhe më dëgjoi mua të njoftoja: "Dhe tani do të dëgjojmë nga Vëllai Pitër Morek".

Për çudinë e Plakut Esei, Pitër Morek menjëherë hyri në sallë dhe zuri vendin e tij në podium.

Pas sesionit, unë dhe Vëllai Morek diskutuam se çfarë kishte ndodhur përpara mundësisë së tij për të folur. Kam menduar thellë për frymëzimin që erdhi atë ditë jo vetëm tek unë, por edhe te Pitër Morek. Ajo përvojë e shënuar më ka dhënë një dëshmi të pamohueshme të rëndësisë së të qenit i denjë për të marrë frymëzim të



Nga Plaku Rasëll M. Nelson,
i Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve

tillë dhe më pas t'i besosh atij – dhe ta ndjekësh atë – kur të vjen. Unë e di pa dyshim se Zoti donte, për ata që ishin të pranishëm në atë sesion në dedikimin e tempullit të Frankfurtit, të dëgjorin dëshminë e fuqishme e prekëse të shërbëtorit të Tij, Vëllait Pitër Morek.

Vëllezër dhe motra të mia të dashura, komunikimi me Atin tonë në Qiell – përfshirë lutjet tona ndaj Tij dhe frymëzimin e Tij ndaj nesh – është i nevojshëm në mënyrë që ne t'u shpëtojmë stuhive dhe sprovave të jetës. Zoti na fton: “M'u afroni pranë dhe unë do të afrohem pranë jush; kërkoni me zell dhe do të më gjeni”⁷. Ndërsa e bëjmë këtë, ne do të ndiejmë Shpirtin e Tij në jetën tonë, duke na dhënë dëshirën dhe kurajën për të qëndruar të fortë dhe të qëndrueshëm në drejtësi – për të “qëndruar] . . . në vende të shenjta dhe mos të lëvizim]”⁸.

Ndërsa bota rreth nesh ndryshon dhe ne shohim parimet e moralit të shoqërisë duke u dobësuar, i kujtoqshim premtimet e çmuara të Zotit për ata që besojnë në Të: “Mos ki frikë, sepse unë jam me ty, mos e humb, sepse unë jam Perëndia yt. Unë të forcoj dhe njëkohësisht të ndihmoj dhe të mbaj me dorën e djathtë të drejtësisë sime.”⁹

Çfarë premtimi! Qoftë ky bekimi ynë, unë lutem në emrin e shenjtë të Zotit dhe Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Jonathan Sacks, “Reversing the Decay of London Undone”, *Wall Street Journal*, 20 gusht 2011, online.wsj.com; kursivet shtuar. *Shënim*: Zoti Saks është kryetari i rabinëve në Kongregacionet e Bashkimit të Hebrejve të Komonuelthit.
2. Eksodi 20:3–4, 7–8, 12–17.
3. Moroni 8:18.
4. 1 Korintasve 2:14.
5. Isaia 32:17.
6. 3 Nefi 18:18–20.
7. Doktrina e Besëlidhje 88:63.
8. Doktrina e Besëlidhje 87:8.
9. Isaia 41:10.

Besëlidhjet

Kur kuptojmë se jemi fëmijë të besëlidhjes, ne e dimë cilët jemi dhe çfarë pret Perëndia nga ne.

Një javë pas detyrës së fundit për të krijuar kunjin e parë në Moskë të Rusisë¹, unë mora pjesë në një konferencë distrikti në Shën-Petersburg. Ndërsa po flisja rreth mirënjohjes time për misionarët e hershëm dhe udhëheqësit vendorë që sollën forcë në Kishë në Rusi, unë përmenda emrin e Vjaçesllav Efimovit. Ai ishte rusi i parë i kthyer në besim që u bë president misioni. Ai dhe bashkëshortja e tij e kryen shkëlqyeshëm atë detyrë. Jo shumë kohë pasi ata e patën përfunduar misionin e tyre dhe për hidhërimin tonë të madh, Presidenti Efimov befas ndërroi jetë.² Ai ishte vetëm 52 vjeç.

Ndërsa flisja për këtë çift, që ishin si pionerë, unë ndjeva nxitjen nga Fryma e Shenjtë për të pyetur kongregacionin nëse Motra Efimov ishte e pranishme. Larg në fund të sallës një grua u ngrit. Unë e ftova atë të vinte te mikrofoni. Po, ajo ishte Motra Galina Efimov. Ajo foli me bindje dhe dha një dëshmi të fuqishme për Zotin, ungjillin e Tij dhe Kishën e Tij të rivendosur. Ajo dhe bashkëshorti i saj patën qenë vulosur në tempullin e shenjtë. Ajo tha se ata ishin bashkuar përgjithmonë. Ata ishin ende shokë misionarë, ajo ishte në këtë anë të velit dhe ai në tjetrën anë³.

Me lotë gëzimi, ajo falënderoi Zotin për besëlidhjet e shenjta të tempullit. Unë qava gjithashtu, duke kuptuar plotësisht se bashkimi i përjetshëm i këtij çifti besnik ishte rezultati i drejtë i bërjes, mbajtjes dhe respektimit të besëlidhjeve të shenjta.

Një nga konceptet më të rëndësishme të fesë së vërtetë, është ai i një besëlidhjeje të shenjtë. Në gjuhën ligjore, një besëlidhje në përgjithësi është marrëveshje midis dy ose më shumë palëve. Por në një kontekst fetar, një besëlidhje është shumë më tepër e rëndësishme. Ajo është një premtim i shenjtë me Perëndinë. Ai i vendos kushtet. Çdo person mund të zgjedhë t'i pranojë ato kushte. Nëse një person i pranon kushtet e besëlidhjes dhe i bindet ligjit të Perëndisë, ai ose ajo pranon bekimet që shoqërojnë atë besëlidhje. Ne e dimë se “kur ne fitojmë ndonjë bekim nga Perëndia, është me anë të bindjes ndaj atij ligji mbi të cilin ai bazohet”⁴.

Gjatë gjithë historisë së botës, Perëndia ka bërë besëlidhje me fëmijët e Tij.⁵ Besëlidhjet e Tij veprojnë gjatë gjithë planit të shpëtimit dhe prandaj janë pjesë e plotësisë së ungjillit të Tij.⁶ Për shembull, Perëndia premtoi të dërgonte një Shpëtimtar për fëmijët e



Tij⁷, duke kërkuar prej tyre bindje ndaj ligjit të Tij.⁸

Në Bibël ne lexojmë për burra dhe gra në botën dhe kohën e ngjarjeve të saj, të cilët identifikohen si fëmijë të besëlidhjes. Të çfarë besëlidhjeje? “Të besëlidhjes që bëri Perëndia me etërit tanë, duke i thënë Abrahamit: ‘Dhe në pasardhësit e tu do të bekohen të gjitha kombet e dheut.’”⁹

Në Librin e Mormonit ne lexojmë për njerëzit në kontinentin amerikan, të cilët gjithashtu identifikohen si

fëmijë të besëlidhjes.¹⁰ Zoti i ringjallur i informoi kështu ata: “Dhe vini re, jeni fëmijët e profetëve; dhe jeni nga shtëpia e Izraelit dhe jeni nga besëlidhja që Ati bëri me etërit tuaj, duke i thënë Abrahamit: Dhe në farën tënde do të bekohen të gjitha fiset e tokës”¹¹.

Shpëtimtari shpjegoi përse ishte e rëndësishme që ata ishin identifikuar për të qenë fëmijë të besëlidhjes. Ai tha: “Së pari, Ati, më ngriti për ju . . . më dërgoi që t’ju bekoj, kështu që secili prej jush të largohet nga

paudhësitë e tij; dhe kjo, sepse ju jeni fëmijët e besëlidhjes”¹².

Besëlidhja e Perëndisë me Abrahamin¹³ dhe më vonë e përsëritur me Isakun¹⁴ dhe Jakobin¹⁵ është e një rëndësie të jashtëzakonshme. Ajo përmbante disa premtime, përfshirë:

- Jezusi, Krishti do të lindë nëpërmjet pasardhësve të Abrahamit.
- Pasardhësit e Abrahamit do të jenë të shumtë, me të drejtën që të shtohen përjetësisht dhe gjithashtu me të drejtën që të mbajnë priftërinë.
- Abrahami do të bëhet ati i shumë kombeve.
- Disa vende do të trashëgohen nga pasardhësit e tij.
- Të gjitha kombet e tokës do të bekohen nga pasardhësit e tij.¹⁶
- Dhe ajo besëlidhje do të jetë e përjetshme madje nëpër “një mijë breza”¹⁷.

Disa nga këto premtime janë përmbushur; të tjera presin të përmbushen. Po citoj nga një profeci e hershme e Librit të Mormonit: “Ati ynë [Lehi] nuk ka folur vetëm për farën tonë, por edhe për gjithë shtëpinë e Izraelit; duke vënë në dukje besëlidhjen që do të përmbushet *në ditët e mëvonshme*; besëlidhje të cilën Zoti ia bëri atit tonë Abrahamit”¹⁸. A nuk është mahnitëse kjo? Rreth 600 vjet *përpara* se Jezusi të lindte në Betlehem, profetët e dinin se besëlidhja e Abrahamit, së fundi do të përmbushet vetëm *në ditët e mëvonshme*.

Për të ndihmuar në përmbushjen e atij premtimi, Zoti u shfaq në këto ditë të mëvonshme për të përsëritur besëlidhjen e Abrahamit. Mësuesi i tha Profetit Jozef Smith:

“Abrahami mori premtime lidhur me farën e tij dhe me frytin e ijeve të tij—nga ijët e të cilit ti je, . . . shërbëtori im Joseph. nb. . .



Stokholm në Suedi

Ky premtim është i juaji gjithashtu, pasi ju jeni të Abrahamit.¹⁹

Me përsëritjen e këtij premtimi, ne kemi marrë, siç bënë njerëzit e kohëve të vjetra, priftërinë e shenjtë dhe ungjillin e përjetshëm. Ne kemi të drejtën të marrim plotësinë e ungjillit, të gëzojmë bekimet e priftërisë dhe të kualifikohemi për bekimin më të madh të Perëndisë – që është jeta e përjetshme.²⁰

Disa nga ne janë farë e mirëfilltë e Abrahamit, të tjerë janë mbledhur në familjen e tij nëpërmjet adoptimit. Zoti nuk bën dallim.²¹ Së bashku ne marrim këto bekime të premtuara – nëse ne kërkojmë Zotin dhe u bindemi urdhërimeve të Tij.²² Por nëse ne nuk e bëjmë këtë, ne humbasim bekimet e besëlidhjes.²³ Për të na ndihmuar ne, Kisha e Tij jep bekime patriarkale për t'i dhënë çdo marrësi një kuptim për të ardhmen e tij apo të saj, si dhe një lidhje me të kaluarën, madje një deklaram të linjës mbrapa deri tek Abrahami, Isaku dhe Jakobi.²⁴

Vëllezërit e besëlidhjes kanë të drejtën të kualifikohen për betim dhe besëlidhje të priftërisë.²⁵ Nëse jeni “bensnikë në marrjen e këtyre dy priftërive . . . dhe në lartësimin e thirrjes [tuaj], shenjtërohen[i] me anë të Shpirtit në ripërtëritjen e trupave [tuaj]”²⁶. Kjo nuk është e gjitha. Burrat që denjësisht pranojnë priftërinë, pranojnë Zotin

Jezu Krisht dhe ata që pranojnë Zotin, pranojnë Perëndinë Atin.²⁷ Dhe ata që pranojnë Atin, pranojnë gjithçka Ai ka.²⁸ Bekime të jashtëzakonshme vijnë nga ky betim dhe besëlidhje te burrat, gratë dhe fëmijët e denjë kudo në botë.

Ne kemi përgjegjësi për t'i ndihmuar që të plotësojnë besëlidhjen e Abrahamit. Pasardhësit tanë janë të parashuguruar dhe të përgatitur që të bekojnë të gjithë popujt e botës.²⁹ Kjo është arsyeja përse detyra e priftërisë përfshin punën misionare. Pas rreth 4.000 vjetësh parashikimi dhe përgatitjeje, kjo është koha e caktuar kur ungjilli duhet të çohet tek faqeset e tokës. Kjo është koha e mbledhjes së premtuar të Izraelit. Dhe ne kemi për të marrë pjesë! A nuk është kjo emocionuese? Zoti po mbështetet te ne dhe te bijtë tanë – dhe Ai është thellësisht mirënjohës për bijat tona – që denjësisht shërbejnë si misionare në këtë kohë të madhe të mbledhjes së Izraelit.

Libri i Mormonit është një provë fizike që Zoti është angazhuar të mbledhë fëmijët e besëlidhjes së Tij me Izraelin.³⁰ Ky libër, shkruar për kohën tonë, shpall si një nga qëllimet e tij se “ju mund të dini se besëlidhja që Ati bëri me fëmijët e Izraelit. . . ka filluar tanimë të plotësohet. . . pasi vini re, Zoti do ta kujtojë besëlidhjen e tij që

ka bërë me popullin e tij të shtëpisë së Izraelit”³¹.

Vërtet, Zoti nuk ka harruar! Ai na ka bekuar ne dhe të tjerë kudo në botë me Librin e Mormonit. Një nga qëllimet e tij është për “bindjen e Jundenjve dhe Johebrenjve se Jezusi është Krishti”³². Ai na ndihmon të bëjmë besëlidhje me Perëndinë. Ai na fton ta kujtojmë Atë dhe të njohim Birin e Tij të Dashur. Ai është një dëshmi tjetër e Jezu Krishtit.

Fëmijët e besëlidhjes kanë të drejtën ta marrin doktrinën e Tij dhe të dinë planin e shpëtimit. Ata e kërkojnë atë duke bërë besëlidhje të një rëndësie të shenjtë. Brigam Jangu ka thënë: Të gjithë shenjtorët e ditëve të mëvonshme hyjnë në një besëlidhje të re dhe të përjetshme kur hyjnë në këtë Kishë. . . . Ata hyjnë në besëlidhjen e re dhe të përjetshme për të mbështetur dhe forcuar Mbretërinë e Perëndisë.”³³ Ata mbajnë besëlidhjen duke iu bindur urdhërimeve të Tij.

Në pagëzim ne bëjmë besëlidhje për t'i shërbyer Zotit dhe për t'i mbajtur urdhërimet e Tij.³⁴ Kur ne marrim pjesë në sakrament, ne përtërijmë atë besëlidhje dhe shpallim vullnetin tonë për të marrë mbi vete emrin e Jezu Krishtit. Në këtë mënyrë ne jemi adoptuar si bij dhe bija të Tij dhe njihemi si vëllezër dhe motra. Ai është ati i jetës sonë të re.³⁵ Së fundi, në tempullin e shenjtë, ne mund të bëhemi bashkë-trashëgimtarë të bekimeve të pasjes së një familjeje të përjetshme, siç iu premtua dikur Abrahamit, Isakut, Jakobit dhe pasardhësve të tyre.³⁶ Kështu, martesat celestiale është besëlidhja e ekzaltimit.

Kur kuptojmë se jemi fëmijë të besëlidhjes, ne e dimë cilët jemi dhe çfarë pret Perëndia nga ne.³⁷ Ne e kemi bërë ligjin e Tij një pjesë tonën.³⁸ Ai është Perëndia ynë dhe ne jemi populli i Tij.³⁹ Fëmijët e angazhuar të



besëlidhjes qëndrojnë të patundur, gjatë kohëve të vështirësive. Kur ajo doktrinë është bërë pjesë e jona, edhe gjembat e vdekjes lehtësohen dhe qëndresa jonë shpirtërore forcohet.

Komplimenti më i madh që mund të arrihet këtu në këtë jetë, është të njihesh si mbajtës i besëlidhjes. Shpërblimet për një mbajtës të besëlidhjes do të merren edhe në këtë jetë edhe pas kësaj jete. Shkrimi i shenjtë shpall se “ju të keni parasysh gjendjen e bekuar dhe të lumtur të atyre që zbatojnë urdhërimet e Perëndisë. Pasi vini re, ata janë të bekuar në të gjitha gjërat, . . . dhe nëse qëndrojnë besnikë deri në fund, ata janë marrë në qiell . . . [dhe] jetojnë me Perëndinë, në një gjendje lumturie të pafund.”⁴⁰

Perëndia jeton. Jezusi është Krishti. Kisha e Tij është rivendosur për të bekuar të gjithë popujt. Presidenti Thomas S. Monson është profeti i Tij sot. Dhe ne, si fëmijë *besnikë* të besëlidhjes, do të bekohemi tani dhe përgjithmonë. Unë dëshmoj kështu në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME


1. Kunji i Moskës në Rusi u krijua të dielën më 5 qershor 2011.
2. Ai ishte president i Misionit të Rusisë në Ekaterinburg nga 1995-sa deri në 1998-ën. Ai vdiq më 25 shkurt 2000.
3. Shih Doktrina e Besëlidhje 138:57.
4. Doktrina e Besëlidhje 130:21.
5. Për shembull, pas Përmbytjes së madhe, Ai shpalli se “harku të shfaqet në retë; dhe

unë do të kujtohem për besëlidhjen time midis meje dhe jush . . . ; dhe ujërat nuk do të shndërrohen më në një përmbytje për të shkatërruar çfarëdo lloj mishi” (Zanafilla 9:14–15, shënim fundfaqe 15b; nga Përkthimi prej Joseph Smith-it, Zanafilla 9:20).

6. Shih Doktrina e Besëlidhje 66:2; 133:58.
7. Shih Gjoni 3:16.
8. Shih Abrahami 3:25.
9. Veprat e Apostujve 3:25.
10. Shih 2 Nefi 20:26.
11. 3 Nefi 20:25.
12. 3 Nefi 20:26.
13. Shih Zanafilla 17:1–10, 19; Levitiku 26:42; Veprat e Apostujve 3:25; Bible Dictionary, “Abraham, Covenant of”.
14. Shih Zanafilla 26:1–5, 24.
15. Shih Zanafilla 28:1–4, 10–14; 35:9–13; 48:3–4.
16. Shih referencat e renditura sipër në shënimet fundore 13–15.
17. Ligji i Përtërirë 7:9; 1 Kronikave 16:15; Psalmet 105:8.
18. 1 Nefi 15:18; theksimi i shtuar.
19. Doktrina e Besëlidhje 132:30–31. Zoti i tha gjithashtu Profetit Jozef Smith: “Dhe sikurse i thashë Abrahamit lidhur me fiset e tokës, madje kështu i them shërbëtorit tim Joseph: Në ty dhe në farën tënde do të bekohet fisi i tokës” (Doktrina e Besëlidhje 124:58).
20. Shih Doktrina e Besëlidhje 14:7.
21. Shih Veprat e Apostujve 10:34–35.
22. Shih Eksodi 19:5.
23. Shkrimi i shenjtë shpall: “Unë, Zoti, lidhem kur ju bëni çfarë ju them; por kur nuk e bëni çfarë ju them, ju nuk keni premtim” (Doktrina e Besëlidhje 82:10).
24. Më 21 shtator 1823, ky koncept besëlidhjeje iu zbulua për herë të parë Profetit Jozef Smith. Atëherë engjëlli Moroni deklaroi se Profeti Elija do të vinte si lajmëtar nga qielli për të mbjellë në zemrat e fëmijëve një njohuri të premtimeve që u ishin bërë dikur etërve

të shtëpisë së Izraelit (shih Doktrina e Besëlidhje 2:1–3).

25. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:33–34, 39–40.
26. Doktrina e Besëlidhje 84:33.
27. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:35, 37.
28. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:38.
29. Shih Alma 13:1–9.
30. Shih 3 Nefi 29.
31. 3 Nefi 29:1, 3.
32. Faqja e titullit e Librit të Mormonit. Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit.
33. *Teachings of Presidents of the Church: Brigham Young* (1997), f. 62.
34. Shih Doktrina e Besëlidhje 20:37.
35. “Ne flasim për Krishtin, ne gëzohemi në Krishtin, ne predikojmë për Krishtin, ne profetizojmë mbi Krishtin, . . . që fëmijët tanë të mund të dinë se cilit burim t’i drejtohen për heqjen e mëkateve të tyre” (2 Nefi 25:26).
36. Shih Doktrina e Besëlidhje 3:29; Doktrina e Besëlidhje 86:8–11.
37. Ky koncept lidhet me ne: “Shumë breza pasi Mesia do t’u shfaqet në trup fëmijëve të njerëzve, atëherë plotësia e unguillit të Mesisë do t’u vijë Johebrenjve dhe nga Johebrenjtë mbetjes së farës sonë – Dhe atë ditë, mbetja e farës sonë do të dijë se ajo është nga shtëpia e Izraelit dhe se ata janë populli i besëlidhjes së Zotit; dhe atëherë ata do të dinë dhe do të vijnë në njohurinë e paraardhësve të tyre dhe gjithashtu në njohurinë e unguillit të Shëlbuesit të tyre, i cili u ishte shërbyer etërve të tyre nga ai; prandaj ata do të vijnë në njohurinë e Shëlbuesit të tyre dhe të pikave kryesore të doktrinës së tij, që ata mund të dinë si të vijnë tek ai dhe të shpëtohen” (1 Nefi 15:13–14).
38. Shih Isaia 55:3; Jeremia 31:33; Romakëve 2:15; 2 Korintasve 3:2–3; Hebrenjve 10:16.
39. Shih Psalmet 95:7; 100:3; Jeremia 24:7; 31:33; 32:38; Ezekieli 11:20; 37:23, 27; Zakaria 8:8; 2 Korintasve 6:16; Hebrenjve 8:10.
40. Mosia 2:41.



Nga Plaku Dallin H. Oaks,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Mësimet e Jezusit

Jezu Krishti është Biri i Vetëmlindur dhe i Dashur i Perëndisë. . . . Ai është Shpëtimtari ynë nga mëkati dhe vdekja. Kjo është njohuria më e rëndësishme mbi tokë.

“Ç’u duket juve për Krishtin?” (Mateu 22:42). Me këto fjalë Jezusi hutoi farisenjtë e kohës së Tij. Me të njëjtat fjalë unë pyes miqtë e mi shenjtorë të ditëve të mëvonshme dhe të krishterë të tjerë se çfarë ju vërtet besoni rreth Jezu Krishtit dhe çfarë jeni duke bërë për shkak të këtij besimi.

Shumica e citimeve të mia nga shkri- met e shenjta do të gjenden në Bibël, sepse ajo është e njohur për shumicën e të krishterëve. Shpjegimet e mia natyrisht që do të vijnë nga ato çfarë na mësojnë shkrimet e shenjta bashkëkohore, sidomos Libri i Mormonit, në lidhje me kuptimin kaq të errët të shkrimeve të Biblës, që të krishterë të ndryshëm nuk bien dakord mbi domethënien e tyre. Unë po u flas besimtarëve, por edhe të tjerëve. Sikurse Plaku Ted R. Kelister na mësoi këtë mëngjes, disa që e quajnë veten të krishterë e lavdërojnë Jezusin si një mësues të madh, por shmangen nga pohimi i karakterit të Tij hyjnor. Kam përdorur fjalët e Vetë Jezusit për t’u drejtuar atyre. Ne të gjithë duhet të marrim parasysh atë që Ai Vetë na mësoi se kush ishte dhe për çfarë u dërgua për të bërë në tokë.

Biri i Vetëmlindur

Jezusi na mësoi se Ai ishte Biri i Vetëmlindur. Ai tha:

“Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme.

Sepse Perëndia nuk e dërgoi Birin e vet në botë që ta dënojë botën, por që bota të shpëtohet prej tij” (Gjoni 3:16–17).

Perëndia, Ati e pohoi këtë. Në kulmin e përvojës së shenjtë në malin e Shpërfytyrimit, Ai shpalli nga qielli: “Ky është Biri im i dashur, në të jam kënaqur: dëgjojeni” (Mateu 17:5).

Jezusi, gjithashtu na mësoi se paraqitja e Tij ishte e njëjtë si e Atit të Tij. Ai u tha apostujve të Tij:

“Po të më kishit njohur, do të kishit njohur edhe Atin tim; qysh tani e njihni dhe e keni parë”.

Filipi i tha: “Zot, na e trego Atin, dhe na mjafton”.

Jezusi i tha: “Ka kaq kohë që unë jam me ju dhe ti nuk më ke njohur akoma, o Filip? Kush më ka parë mua, ka parë Atin” (Gjoni 14:7–9).

Si rrjedhim, apostulli Pal e përshkroi Birin si “vula e qenies së [Perëndisë, Atit]” (Hebrenjve 1:3; shih edhe 2 Korintasve 4:4).

Krijuesi

Apostulli Gjon shkroi se Jezusi, të cilin ai e quajti “Fjala”, “ishte në fillim

me Perëndinë. Të gjitha gjërat u bënë me anë të tij (fjala), dhe pa atë nuk u bë asnjë nga ato që u bënë” (Gjoni 1:2–3). Pra, sipas planit të Atit, Jezu Krishti ishte Krijuesi i të gjitha gjërave.

Zoti, Perëndia i Izraelit

Gjatë shërbesës ndaj njerëzve të Tij në Palestinë, Jezusi deklaroi se Ai ishte Jehovah, Zoti Perëndi i Izraelit (shih Gjoni 8:58). Më vonë, si Zot i ringjallur, Ai i shërbeu popullit të Tij në kontinentin amerikan. Atje Ai shpalli:

“Vini re, unë jam Jezu Krishti, për të cilin profetët dëshmuan se do të vinte në botë. . . .

. . . unë jam Perëndia i Izraelit dhe Perëndia i tërë tokës” (3 Nefi 11:10, 14).

Ajo që Ai Ka Bërë për Ne

Shumë vite më parë, në një konferencë kunji takova një grua që tha se i ishte kërkuar që të kthehej në kishë pas shumë vitesh largimi, por nuk mund të mendonte për ndonjë arsye se përse duhet të vinte. Për ta inkurajuar i thashë: “Kur mendoni për të gjitha gjërat që Shpëtimtari ka bërë për ne, a nuk keni shumë arsye të ktheheni në kishë për ta adhuruar e për t’i shërbyer Atij?” U çudita nga përgjigja e saj: “Çfarë ka bërë Ai për mua?” Për ata që nuk e kuptojnë se çfarë ka bërë Shpëtimtari ynë për ne, do t’i përgjigjem kësaj pyetje me vetë fjalët e Tij dhe me dëshminë time.

Jeta e Botës

Bibla shënon mësimin e Jezusit: “Unë kam ardhur që të kenë jetë e ta kenë me bollëk” (Gjoni 10:10). Më vonë, në Botën e Re, Ai shpalli: “Unë jam drita dhe jeta e botës” (3 Nefi 11:11). Ai është jeta e botës sepse Ai është Krijuesi ynë dhe se, nëpërmjet ringjalljes të Tij, ne të gjithë jemi të sigurt se do të jetojmë përsëri. Dhe



jeta që Ai na jep nuk është thjesht jeta e vdekshme. Ai na mësoi: “Unë u jap atyre jetën e përjetshme dhe nuk do të humbasin kurrë, e askush nuk do t’i rrëmbejë nga dora ime” (Gjoni 10:28; shih edhe Gjoni 17:2).

Drita e Botës

Jezusi gjithashtu na mësoi: “Unë jam drita e botës; kush më ndjek nuk do të ecë në errësirë” (Gjoni 8:12). Ai gjithashtu shpalli: “Unë jam udha, e vërteta dhe jeta” (Gjoni 14:6). Ai është udha dhe Ai është drita sepse mësimet e Tij ndriçojnë rrugën tonë në jetën e vdekshme dhe na tregojnë rrugën e kthimit për tek Ati.

Duke Bërë Vullnetin e Atit

Jezusi gjithmonë e nderoi Atin dhe e ndoqi Atë. Edhe kur ishte i ri Ai u shpalli prindërve të Tij tokësorë: “A nuk e dinit se më duhet të merrem me punët e Atit tim?” (Lluka 2:49). Më vonë Ai u mësoi: “Sepse unë kam zbritur nga qielli jo për të bërë vullnetin tim, por vullnetin e atij që më ka dërguar” (Gjoni 6:38; shih edhe Gjoni 5:19). Dhe Shpëtimtari na mësoi: “Askush nuk vjen tek Ai përveçse nëpërmjet meje” (Gjoni 14:6; shih edhe Mateu 11:27).

Ne kthehemi tek Ati duke bërë vullnetin e Tij. Jezusi na mësoi: “Jo çdo njeri që më thotë: ‘Zot, Zot’ do

të hyjë në mbretërinë e qiejve, por do të hyjë ai që kryen vullnetin e Atit tim që është në qiej” (Mateu 7:21). Ai shpjegoi:

“Shumë do të më thonë atë ditë: ‘O Zot, o Zot, a nuk profetizuan ne në emrin tënd, a nuk i dëbuam demonët në emrin tënd, a nuk kemi bërë shumë vepra të fuqishme në emrin tënd?’

Dhe atëherë unë do t’u sqaroj atyre: ‘Unë s’ju kam njohur kurrë; largohuni nga unë, ju të gjithë, që keni bërë paudhësi’” (Mateu 7:22–23).

Atëherë, kush do të hyjë në mbretërinë e qiejve? Jo ata të cilët thjesht bëjnë vepra të fuqishme duke përdorur emrin e Zotit, Jezusi na mësoi “[por vetëm] ai që kryen vullnetin e Atit tim që është në qiej”.

Shembulli i Madh

Jezusi na e tregoi se si ta bënim këtë. Ai na ftoi vazhdimisht për ta ndjekur Atë: “Delet e mia e dëgjojnë zërin tim, unë i njoh dhe ato më ndjekin” (Gjoni 10:27).

Fuqia e Priftërisë

Ai u dha fuqinë e priftërisë dishepujve të Tij (shih Mateu 10:1) dhe të tjerëve. Ai i tha Pjetrit, apostullit më të vjetër: “Dhe unë do të të jap çelësat e mbretërisë së qiejve; gjithçka që të kesh lidhur mbi tokë, do të jetë lidhur në qiej, dhe gjithçka që të kesh zgjidhur mbi tokë, do të jetë zgjidhur në qiej” (Mateu 16:19; shih edhe Mateu 18:18).

Lluka shënoi se: “Zoti caktoi shtatëdhjetë të tjerë dhe i nisi dy nga dy përpara tij, në çdo qytet dhe vend, ku ai do të shkonte” (Lluka 10:1). Më vonë këta të shtatëdhjetë me gëzim i thanë Jezusit: “Edhe demonët na nënshtrohen në emrin tënd” (Lluka 10:17). Unë jam një dëshmitar i asaj fuqie priftërie.



Gjon Pagëzori profetizoi këtë kur tha: “Ja, Qengji i Perëndisë, që heq mëkatën e botës” (Gjoni 1:29). Më pas, Jezusi na mësoi se: “Biri i njeriut . . . erdhi . . . për të shërbyer për të dhënë jetën e tij si çmim për shpengimin e shumë vetëve” (Mateu 20:28). Në Darkën e Fundit, sipas rrëfimit të Mateut, Jezusi shpjegoi se vera që Ai kishte bekuar, ishte “gjaku i besëlidhjes së re, i cili është derdhur për shumë për faljen e mëkateve” (Mateu 26:28).

Pasi iu shfaq nefitëve, Zoti i ringjallur i ftoi ata që të afroreshin për të ndier plagën në anën e Tij dhe gjurmën e gozhdëve në duart dhe këmbët e Tij. Ai shpjegoi, se e bëri këtë “që ju të dini se unë jam Perëndia i Izraelit dhe Perëndia i tërë tokës dhe se u vrava për mëkatet e botës” (3 Nefi 11:14). Dhe rrëfimi vazhdon, turma “[ra] te këmbët e Jezusit dhe e adhur[oi] atë” (vargu 17). Në fund të fundit, për shkak të kësaj e gjitha bota do ta adhurojë Atë.

Jezusi na mësoi më tej të vërtetat e çmuara mbi Shlyerjen e Tij. Libri i Mormonit, i cili shtjellon më shumë mësimet e Shpëtimtarit dhe jep shpjegimin më të mirë të misionit



Prijësi nëpërmjet Frymës së Shenjtë

Në përfundim të shërbesës së Tij tokësore, Jezusi i mësoi apostujt e Tij: “Ngushëlluesi, Fryma e Shenjtë, që Ati do ta dërgojë në emrin tim, do t’ju mësojë çdo gjë dhe do t’ju kujtojë të gjitha këto që ju thashë” (Gjoni 14:26) dhe “ai do t’ju prijë në çdo të vërtetë” (Gjoni 16:13).

Prijësi nëpërmjet Urdhërimeve të Tij

Ai gjithashtu na prin ne nëpërmjet urdhërimeve të Tij. Kështu që, Ai i urdhëroi nefitët se ata nuk duhet të kenë mosmarrëveshje në lidhje me çështjet e doktrinës, sepse, u tha:

“Ai që ka shpirtin e grindjes nuk është i imi, por është i djallit i cili është ati i grindjes dhe ai nxit zemrat e njerëzve, që të grinden me zemërim me njëri-tjetrin.

Vini re, kjo nuk është doktrina ime, që të nxis zemrat e njerëzve në zemërim, njëri kundër tjetrit; por, doktrina ime është kjo, që gjëra të tilla duhet të zhduken” (3 Nefi 11:29–30).

Përqendrimi në Jetën e Përvetshme

Ai gjithashtu na sfidon që të përqendrohemi në Të, jo në gjërat e botës. Në predikimin e Tij të madh mbi bukën e jetës, Jezusi shpjegoi ndryshimin midis ushqimit të vdekshëm dhe të përjetshëm. Ai tha: “Mos punoni për ushqimin që prishet, por për ushqimin

që mbetet për jetë të përjetshme, të cilin do t’ju japë Biri i njeriut” (Gjoni 6:27). Shpëtimtari na mësoi se Ai ishte Buka e Jetës, burimi i ushqimit të përjetshëm. Duke folur për ushqimin e vdekshëm që bota të ofron, përfshirë manat që Jehovahi kishte dërguar për të ushqyer bijtë e Izraelit në shkretëtirë, Jezusi na mësoi se ata që u mbështetën në këtë bukë tani janë të vdekur (shih Gjoni 6:49). Në të kundërt, ushqimi që ofroi Ai ishte “buka e gjallë që zbriti nga qielli”, dhe Jezusi na mësoi: “Nëse një ha nga kjo bukë do të jetojë përjetë” (Gjoni 6:51).

Disa nga dishepujt e Tij thanë se kjo ishte “e folur e rëndë” dhe nga ai moment shumë nga dishepujt e Tij “u tërhoqën dhe nuk shkuan më me të” (Gjoni 6:60, 66). Me sa duket ata nuk e pranuan mësimin e Tij të mëparshëm se ata duhet të “kërkonin[n] . . . para së gjithash mbretërinë e Perëndisë” (Mateu 6:33). Edhe sot disa që pretendojnë krishtërim joshen më shumë nga gjërat e botës – gjëra që mbështesin jetën në tokë, por nuk japin ushqim drejt jetës të përjetshme. Për disa, “e folura e Tij e rëndë” është ende një arsye që të mos ndjekin Krishtin.

Shlyerja

Pika kulmore e shërbesës së vdekshme të Shpëtimtarit ishte Ringjallja dhe Shlyerja e Tij për mëkatet e botës.

të Tij, paraqet këtë mësim:

“Ati im më dërgoi që të mund të ngrihesha në kryq . . . , që t’i tërheq të gjithë njerëzit tek unë, . . .

. . . që të qëndrojnë para meje për t’u gjykuar për veprat e tyre.

Dhe . . . kushdo që pendohet dhe pagëzohet në emrin tim, do të mbushet; dhe në qoftë se duron gjer në fund, vini re, atë do ta konsideroj të pafajshëm para Atit tim, në atë ditë kur do të qëndroj të gjykoj botën. . . .

Dhe asgjë e papastër nuk mund të hyjë në mbretërinë e [Atit]; prandaj asgjë nuk hyn në pushimin e tij, vetëm ata që kanë larë rrobat e tyre në gjakun tim, për shkak të besimit të tyre dhe të pendimit të të gjithë mëkateve të tyre dhe të besnikërisë së tyre deri në fund” (3 Nefi 27:14–16, 19).

Dhe në këtë mënyrë ne kuptojmë se Shlyerja e Jezu Krishtit na jep mundësinë për të mposhtur vdekjen shpirtërore që vjen nga mëkati dhe, nëpërmjet kryerjes dhe mbajtjes së besëlidhjeve të shenjta, të kemi bekimet e jetës së përjetshme.

Sfida dhe Dëshmia

Jezusi lëshoi sfidën: “Ç’u duket juve për Krishtin?” (Mateu 22:42). Apostulli Pal sfidoi korintasit “[për të] analiz[uar] veten [e tyre] a [janë] në besim” (2 Korintasve 13:5). Secili prej nesh duhet t’u përgjigjet këtyre sfidave për vete. Ku është besnikëria jonë përfundimtare? A jemi ne si të krishterët në përshkrimin e paharrueshëm të Plakut Nil A. Maksuell, që bëjmë shtëpitë tona të përershme në Sion dhe nuk mbajmë një shtëpi për pushime të pjesshme në Babiloni?¹

Nuk ka rrugë të mesme. Ne jemi ndjekës të Jezu Krishtit. Shtetësia jonë është në Kishën e ungjillin e Tij dhe ne nuk duhet të përdorim vizën për të vizituar Babiloninë ose për të vepruar si një nga shtetasit e saj.



Ne duhet ta nderojmë emrin e Tij, të mbajmë urdhërimet e Tij dhe “të mos kërkojmë] gjërat e kësaj botës, . . . para së gjithash [të] kërkojmë] të ndërtojmë] mbretërinë e Perëndisë dhe të vendos[im] drejtësinë e tij” (Mateu 6:33, nga Përkthimi prej Joseph Smith-it, Mateu 6:38).

Jezu Krishti është Biri i Vetëmlindur dhe i Dashur i Perëndisë. Ai është Krijuesi ynë. Ai është Drita e Botës. Ai është Shpëtimtari ynë nga mëkati dhe vdekja. Kjo është njohuria më e rëndësishme mbi tokë, dhe ju mund ta dini këtë për veten tuaj, siç unë e di për vete. Fryma e Shenjtë, që dëshmon për Atin dhe Birin e na drejton për tek

e vërteta, m’i ka zbuluar këto të vërteta dhe Ai do t’ju zbulojë ato juve. Mënyra është dëshira dhe bindja. Në lidhje me dëshirën, Jezusi na mësoi: “Lypni dhe do t’ju jepet; kërkoni dhe do të gjeni; trokitni dhe do t’ju çelet” (Mateu 7:7). Në lidhje me bindjen, Ai na mësoi: “Në qoftë se dikush don të bëjë vullnetin e tij, do ta njohë nëse kjo doktrinë vjen nga Perëndia apo që unë flas nga vetja ime” (Gjoni 7:17). Unë dëshmoj për të vërtetën e këtyre gjërave, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIM

1. Shih Neal A. Maxwell, *A Wonderful Flood of Light* (1990), f. 47.



Nga Methju O. Riçardson,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Përgjithshme
të Shkollës të së Dielës

Mësimdhënia sipas Mënyrës së Shpirtit

Ndonëse ne jemi të gjithë mësues/e, ne duhet të kuptojmë plotësisht se është Fryma e Shenjtë mësuesi dhe dëshmitari real i gjithë të vërtetave.

Shumë vite më parë, unë isha me shokun tim të misionit në qendrën e trajnimit misionar kur dëgjoja zërin e një fëmije të thotë: “Gjyshe, a janë këta misionarë të vërtetë?” U ktheva dhe pashë një vajzë të vogël duke mbajtur dorën e gjyshes së saj dhe duke treguar me gisht nga unë dhe shoku im. Unë buzëqesha, i zgjata dorën, e pashë atë drejt e në sy dhe thashë: “Përshëndetje, unë jam Plaku Riçardson dhe ne jemi misionarë të vërtetë”. Ndërsa ktheu kokën pas nga unë, ajo buzëqeshi, e ngazëllyer që ishte në prani të misionarëve të vërtetë.

U largova nga ajo përvojë me devotshmëri të përtërirë. Unë dëshiroja të isha modeli i misionarit që Shpëtimtari, familja ime dhe kjo vajzë e vogël prisnin që unë të isha. Gjatë dy viteve të ardhshme, unë punova shumë për të ngjarë, për të menduar, për të vepruar dhe sidomos për të dhënë mësim si një misionar i vërtetë.

Pas kthimit në shtëpi, u bë gjithnjë e më shumë e dukshme që edhe pse kisha mbaruar misionin, ndikimi i misionit tim mbeti në mua. Faktikisht, edhe pas gjithë këtyre viteve, unë

ende e ndiej se dy vitet e misionit tim ishin më të mirat për jetën time. Një mësim i paparashikuar nga misioni im ishte zëri i asaj vajze të vogël. Edhe tani po dëgjoja në mendjen time: “Gjyshe, a është ai një mbajtës priftërie i vërtetë?”, “Gjyshe, a është ai një bashkëshort i vërtetë ose një baba i vërtetë?” apo “Gjyshe, a është ai një anëtar Kise i vërtetë?”

Unë kam mësuar se çelësi për t’u bërë i vërtetë në çdo aspekt të jetës sonë është aftësia jonë për të dhënë mësim në një mënyrë që nuk kufizon të mësuarin. Ju e shihni se, një jetë e vërtetë kërkon të mësuarin e vërtetë, i cili varet në mësimdhënien e vërtetë. “Përgjegjësia për të dhënë mësim [në mënyrë efektive] nuk është e kufizuar ndaj atyre që kanë thirrje zyrtarisht si mësues/e.”¹ Në fakt, çdo pjesëtar i familjes, udhëheqës i Kishës dhe anëtar i Kishës (përfshirë të rinjtë dhe fëmijët) ka përgjegjësinë për të dhënë mësim.

Ndonëse ne jemi të gjithë mësues/e, ne duhet të kuptojmë plotësisht se është Fryma e Shenjtë mësuesi i vërtetë dhe dëshmitari i gjithë të vërtetave. Ata të cilët nuk e kuptojnë

plotësisht këtë dhe as nuk përpiqen të marrin nga Fryma e Shenjtë, dhe e bëjnë çdo gjë vetë, në mënyrë të sjellshme e ftojnë Shpirtin të jetë me ta por vetëm si një ndihmës, ose mendojnë se po ia kalojnë të gjithë mësimin Shpirtit kur, në fakt, ata thjesht po prezantojnë mësimin pa studiuar. Të gjithë prindërit, udhëheqësit dhe mësuesit kanë përgjegjësinë për të dhënë mësim “me anë të Shpirtit”.² Ata nuk duhet të japin mësim pa praninë e Shpirtit ose kur nuk e kanë Shpirtin, por sipas mënyrave të Shpirtit, në mënyrë që Shpirti të mund t’i mësojë të vërtetën e pakufizuar.

Moroni na ndihmon të kuptojmë se si mund të japim mësim me anë të Shpirtit pa zëvendësuar, dobësuar ose larguar Frymën e Shenjtë si mësuesin e vërtetë. Moroni tha se shenjtorët sjellin përvojat e tyre “sipas mënyrës së shfaqjes së Shpirtit”.³ Kjo kërkon më shumë se sa thjesht të paturit e Shpirtit me ne. Të sillësh “sipas mënyrës” së Frymës së Shenjtë do të thotë se ne mund të na duhet të ndryshojmë mënyrën tonë të mësimdhënies, për të ndjekur shembullin e mënyrës që Fryma e Shenjtë të mëson. Ndërsa bashkojmë mënyrën tonë me mënyrën e Frymës së Shenjtë, atëherë Fryma e Shenjtë mund të na mësojë dhe dëshmojë pa kufizim. Ky bashkim i rëndësishëm mund të tregohet nga shembulli i mëposhtëm.

Shumë vite më parë, unë dhe fëmijët e mi ecëm më këmbë në majë të South Sistër, një mal 10.358 fut [3.157 m] në Oregon. Pas disa orësh ne ndeshëm një malore të lartë 45 gradë me guriçka të formuara në lashtësi nga një vullkan. Me shikimin nga maja, ne vazhduam të ecnim para dhe kuptuam se në çdo hap këmba jonë do të zhytej në guriçka, duke na shkaktuar rrëshqitje prapa disa centimetra. Ndërsa unë qëndroja me vajzën time 8-vjeçare,



djali im 12-vjeçar ecte përpara në anë të malit. Lodhja dhe dekurajimi shpejt filluan dhe asaj iu thye zemra, duke menduar se nuk do mund të bashkohen me të vëllanë në majë. Impulsi im i parë ishte ta mbaja në krahë. Fryma ime ishte gati, por fatkeqësisht mishi ishte i dobët. Ne u ulëm në shkëmbinj, vlerësuam situatën tonë dhe krijuam një plan të ri. I thashë asaj t'i vendoste duart në xhepat e prapëm të pantallonave të mia, të mbahej fort, dhe – më e rëndësishmja – sapo unë të ngrija këmbën për të bërë një hap, ajo shpejt duhet ta vendoste këmbën e saj në të njëjtin vend. Ajo imitoi çdo lëvizje që unë bëra dhe u mbështet në ngjitjen që erdhi nga mbajtja në xhepat e mi. Pas asaj që dukej si përjetësi, ne arritëm në majë të malit. Shprehja e saj e ngadhënjimit dhe e kënaqësisë ishte e paçmueshme. Dhe po, sipas mendimit tim, ajo dhe vëllai i saj ishin alpinistë të vërtetë.

Arritja e vajzës time ishte rezultat i përpjekjes së saj të zellshme dhe se sa mirë ajo ngjitej *sipas mënyrës* që unë ngjitesha. Ndërsa ajo sinkronizonte lëvizjet e saj me të miat, ne arritëm një ritëm së bashku, duke më lejuar mua të shfrytëzoja gjithë energjitë e mia. E tillë është situata ku ne japim mësim “sipas mënyrës së shfaqjes së Shpirtit”. Ndërsa ne bashkojmë mënyrën e mësimdhënies tonë që të harmonizohet me atë të Frymës së Shenjtë, Shpirti na forcon dhe në të njëjtën kohë, nuk është i kufizuar. Me këtë në mendje, ju lutem merrni parasysh dy “shfaqjet themelore të Shpirtit” që ne duhet të ndjekim.

Së pari, Fryma e Shenjtë i mëson individët në një mënyrë shumë personale. Kjo bën të mundur për ne që të dimë ngushtë të vërtetën për veten tonë. Për shkak të nevojave, rrethanave dhe përparimit tonë të ndryshëm, Fryma e Shenjtë na mëson atë që duhet të dimë dhe bëjmë në mënyrë që të mund të bëhemi ata që duhet të bëhemi. Ju lutem, vini re se kur Fryma e Shenjtë na mëson “të vërtetën e të gjitha gjërave”⁴, Ai nuk na e mëson çdo të vërtetë përnjëherësh. Shpirti na mëson të vërtetën “rresht pas rreshti, parim pas parimi, pak këtu dhe pak atje”⁵.

Ata që japin mësim sipas mënyrës së Shpirtit, e kuptojnë se ata po mësojnë njerëzit, jo thjesht po paraqesin mësimin. Si të tillë, ata mposhtin dëshirën për të ndarë çdo gjë në një manual ose për të dhënë mësim gjithçka që ata kanë mësuar mbi temën dhe përqendrohen më mirë në ato gjëra që familja e tyre ose anëtarët e klasës duhet të dinë dhe bëjnë. Prindërit, udhëheqësit dhe mësuesit që ndjekin shembullin e mënyrës se si Shpirti të mëson, mësojnë shpejt se mësimdhënia e vërtetë përfshin shumë më tepër se sa të folurim dhe të treguarim. Si rezultat, ata qëllimisht ndalojnë që të dëgjojnë, të vëzhgojnë me kujdes dhe pastaj të shohin se çfarë të bëjnë tjetër⁶. Kur ata e bëjnë këtë, Fryma e Shenjtë është në një gjendje që t'u mësojë si nxënësve edhe mësuesve se çfarë duhet të bëjnë dhe ç'duhet të thonë.⁷

Së dyti, Fryma e Shenjtë na mëson

duke na ftuar, nxitur, inkurajuar dhe frymëzuar për të vepruar. Krishti na siguroi se do ta dimë të vërtetën kur ta jetojmë doktrinën dhe të veprojmë siç duhet.⁸ Shpirti na drejton, udhëzon dhe tregon se çfarë të bëjmë.⁹ Megjithatë, ai nuk do të bëjë për ne atë që vetëm ne mund ta bëjmë për veten tonë. Ju e shihni se, Fryma e Shenjtë nuk mund të mësojë *për* ne, nuk mund të ndiejë *për* ne, ose të veprojë *për* ne sepse kjo do të ishte në kundërshtim me doktrinën e lirisë së zgjedhjes. Ajo mund të na ndihmojë me mundësitë e të na ftojë për të mësuar, ndier dhe vepruar.

Ata që japin mësim sipas kësaj mënyre të Shpirtit, i ndihmojnë të tjerët duke i ftuar, inkurajuar dhe ofruar mundësi për të përdorur lirinë e tyre të zgjedhjes. Prindërit, udhëheqësit dhe mësuesit e kuptojnë se ata nuk mund të ndiejnë, mësojnë apo edhe të pendohen, *për*, familjen, kongregacionin ose anëtarët e tyre të klasës. Në vend që të pyesin: “Çfarë mund të bëj unë për fëmijët e mi, pjesëtarët e klasës ose të tjerët?” ata pyesin: “Si t'i ftoj e ndihmoj ata përreth meje për të mësuar për veten e tyre?” Prindërit të cilët pasqyrojnë shfaqjet e Frymës së Shenjtë, krijojnë shtëpi ku familjet mësojnë të kuptojnë parimet në vend që thjesht të mësojnë parimet. Në të njëjtën mënyrë, në vend që thjesht të flasin mbi doktrinën, mësuesit ndihmojnë nxënësit të kuptojnë dhe jetojnë doktrinën e ungjillit. Fryma e Shenjtë nuk është i kufizuar ndërsa individët ushtrojnë siç duhet lirinë e tyre të zgjedhjes.

Me gjendjen e tanishme të botës, ne kemi nevojë më të madhe për të mësuarin dhe mësimdhënien e vërtetë në shtëpinë, mbledhjet dhe klasat tona të ungjillit. E di se përpjekja juaj për t'u përmirësuar ndonjëherë mund të duket dërrmuese. Ju lutem mos u

shkurajoni lidhur me përparimin tuaj. Unë mendoj përsëri për përvojën time të ngjitjes me fëmijët e mi. Ne ramë dakord se çdo herë që do të ndalonim për të pushuar, në vend që të përquendroheshim vetëm se sa lart duhet të shkonim, ne menjëherë do të ktheheshim mbrapsht dhe do të shihnim poshtë malit. Do të shihnim pamjen dhe do t'i thonim njërit-tjetrit: "Shikoni se sa larg kemi arritur". Më pas do të merrnim frymë thellë, do të ktheheshim shpejt, do të shihnim përpjetë dhe do të fillonim të ngjiteshim përsëri avash. Vëllezër dhe motra, ju mund të jeni prind veprues, mund të drejtoni dhe të jepni mësim sipas mënyrës së shfaqjes së Shpirtit. Unë e di që ju mund ta bëni këtë. Unë dëshmoj se ju mund ta bëni këtë dhe jetët do të ndryshojnë.

Jeta ime ka qenë e bekuar nga *mësues të vërtetë*, që më kanë mësuar me Shpirtin dhe sidomos me anë të Shpirtit. Unë ju ftoj juve që në çdo gjë që bëni, të bashkoni mënyrën e mësimdhënies tuaj me atë sipas mënyrës së Frymës së Shenjtë. Unë dëshmoj se Jezu Krishti është Shpëtimtari ynë dhe se ungjilli i Tij është rivendosur. Për shkak të kësaj ne duhet të jemi prindër të vërtetë, udhëheqës/e të vërtetë/a, mësues/e të vërtetë/a dhe nxënës/e të vërtetë/a. Unë dëshmoj se Perëndia do t'ju ndihmojë në përpjekjet tuaja, në emrin e shenjtë të Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. *Teaching, No Greater Call: A Resource Guide for Gospel Teaching* (1999), f. 3.
2. Doktrina e Besëlidhje 50:14.
3. Moroni 6:9.
4. Moroni 10:5; shih gjithashtu Doktrina e Besëlidhje 50:14; *Të Vërtetë ndaj Besimit: Një Referim për Ungjillin* (2004), f. 56.
5. 2 Nefi 28:30.
6. Shih David A. Bednar, "Seek Learning by Faith", *Liahona*, shtator 2007, f. 16–24.
7. Shih Lluka 12:12.
8. Shih Gjoni 7:17.
9. Shih 2 Nefi 32:1–5.



Nga Plaku Kazuhiko Jamashita,
i Të Shtatëdhjetëve

Misionarët Janë një Thesar i Kishës

Jam mirënjohës që misionarët thirren nga Zoti, që ata i përgjigjen asaj thirrjeje dhe që ata po shërbejnë në mbarë botën.

Një natë shumë vite më parë, një misionar i sapothirur që quhej Plaku [Eldër] Suan, dhe shoku i tij më i vjetër japonez erdhën për të na vizituar në shtëpinë tonë. Për fat të mirë, isha në shtëpi, kështu që i ftova të hynin. Kur i përshëndeta tek dera, sytë më shkuan tek xhaketa që kishte veshur Plaku [Eldër] Suan. Pa menduar, i thashë atij: "Sigurisht, është e këndshme xhaketa që ke veshur!" Megjithatë, ajo nuk ishte një xhakete e re dhe ishte disi e vjetëruar. Hamendësova se ndonjë misionar i mëparshëm e kishte lënë xhaketen tek apartamenti i misionarëve.

Plaku [Eldër] Suan iu përgjigj menjëherë fjalëve të mia dhe ishte plotësisht e kundërta e asaj që po mendoja. Me një japonishte të çalë ai u përgjigj: "Po, kjo është një xhakete e mirë. Babai im e veshi këtë xhakete kur shërbeu si misionar në Japoni më tepër se 20 vite më parë."

Babai i tij kishte shërbyer në Misionin e Japonisë, Okajama. Dhe kur biri i tij po largohej për të shërbyer një mision në Japoni, ai ia kishte dhënë atij xhaketen e vet. Kjo fotografi tregon atë xhakete që kanë veshur në Japoni dy breza të Pleqve [Eldërve] Suan.

U preka kur dëgjova fjalët e Plakut [Eldër] Suan. Dhe tani e kuptova arsyen përse Plaku [Eldër] Saun veshi xhaketen e babait të tij ndërsa po bënte punë misionare. Plaku [Eldër] Suan e kishte nisur misionin e tij duke trashëguar dashurinë e babait të tij për Japoninë dhe popullin e saj.

Jam i sigurt se disa prej jush këtu kanë përjetuar diçka të ngjashme me këtë. Një numër misionarësh që shërbejnë në Japoni, më kanë treguar se etërit e tyre, nënat e tyre, gjyshërit e tyre apo xhaxhallarët e tyre gjithashtu kanë shërbyer në misione në Japoni.

Dëshiroj të shpreh dashurinë, respektin tim të sinqertë dhe ndjenjat e mirënjohjes për të gjithë misionarët e kthyer, që kanë shërbyer nëpër botë. Jam i sigurt se ata që keni ndihmuar të kthehen në besim, nuk ju kanë harruar ju. "Sa të bukura janë mbi malet këmbët e lajmëtarit që sjell lajme të mira . . . !"¹

Unë jam një prej atyre të kthyerve në besim. Unë u ktheva në besim në moshën 17-vjeçare, kur isha nxënës i shkollës së mesme. Misionari që kreu pagëzimin tim, ishte Plaku [Eldër] Rap nga Ajdaho. Ai u lirua së fundi nga thirrja si president kunji në Ajdaho.



Nuk e kam parë qëkur sapo isha pagëzuar, por kam shkëmbyer mesazhe elektronike me të dhe kam folur në telefon. Nuk e kam harruar kurrë atë. Fytyra e tij e këndshme, e qeshur, është e gdhendur në kujtesën time. Ai qe shumë i lumtur kur mësoi se unë po shkoja mirë.

Kur isha 17 vjeç, nuk kisha vërtet një kuptueshmëri të mirë të mesazheve që misionarët po më mësonin. Megjithatë, unë kisha një ndjenjë të veçantë për misionarët dhe dëshiroja të bëhesha si ata. Dhe unë e ndieja dashurinë e tyre të thellë e të qëndrueshme.

Më lejoni t'ju tregoj për ditën kur u pagëzova. Ishte 15 korrik dhe ishte një ditë shumë e nxehtë. Një grua u pagëzua gjithashtu atë ditë. Vaska e pagëzimit ishte përgatitur me dorë nga misionarët dhe nuk ishte shumë mbresëlënëse.

Ne u konfirmuam menjëherë pasi u pagëzuam. Së pari, u konfirmua motra nga Plaku [Eldër] Llojd. Unë u ula me anëtarët e tjerë, mbylla sytë dhe dëgjova në qetësi. Plaku [Eldër] Llojd e konfirmoi atë dhe pastaj filloi të shqiptojë një bekim mbi të. Megjithatë,

Plaku [Eldër] Llojd pushoi së foluri, kë-shtu që unë hapa sytë dhe e vështrova ngultas.

Edhe sot mund ta kujtoj qartë atë skenë. Sytë e Plakut [Eldër] Llojd ishin mbushur me lotë. Dhe për herë të parë në jetën time, unë përjetova të qenit i mbështjellë nga Shpirti i Shenjtë. Dhe nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë unë fitova një njohuri të sigurt se Plaku [Eldër] Llojd na donte dhe se Perëndia na donte.

Pastaj qe radha ime që të konfirmohesha. Qe përsëri Plaku [Eldër] Llojd. Ai i vuri duart mbi kokën time dhe më konfirmoi një anëtar të Kishës, më dha dhuratën e Frymës së Shenjtë dhe pastaj, filloi të shqiptojë një bekim. Dhe përsëri pushoi së foluri. Megjithatë, tani unë e kuptova se çfarë po ndodhte. Unë vërtet e dija nëpërmjet Frymës së Shenjtë se misionarët më donin dhe se Perëndia më donte.

Do të dëshiroja tani t'ju thoja disa fjalë misionarëve që aktualisht po shërbejnë në misione nëpër botë. Qëndrimet tuaja dhe dashuria që shfaqni kundrejt të tjerëve janë mesazhe shumë domethënëse. Edhe pse nuk

i rroka menjëherë të gjitha doktrinat që misionarët më mësuuan, unë e ndieja dashurinë e tyre të madhe dhe veprimet e shumta të tyre të shpirtmërisë së më dhanë mësim të rëndësishme. Mesazhi juaj është një mesazh dashurie, një mesazh shprese dhe një mesazh besimi. Qëndrimi juaj dhe veprimet tuaja ftojnë Shpirtin dhe është Shpirti që na mundëson neve të kuptojmë gjërat që janë të rëndësishme. Ajo që dua t'ju përçoj është se nëpërmjet dashurisë suaj, ju në të vërtetë po jepni dashurinë e Perëndisë. Ju jeni një thesar i kësaj Kise. Unë ju jam mirënjohës të gjithëve ju për sakrificën tuaj dhe për përkushtimin tuaj.

Do të dëshiroja t'ju flisja gjithashtu ju, misionarëve të ardhshëm. Në vetë familjen time, katër nga fëmijët tanë kanë shërbyer në misione dhe, në fund të këtij muaji, misionari ynë i pestë do të hyjë në Qendrën për Trajnimin e Misionarëve në Provo. Vitin tjetër, fëmija ynë më i vogël po planifikon të shërbejë në një mision pasi të diplomohet nga shkolla e mesme.

Kështu, unë u flas bijve të mi dhe të gjithëve ju që po përgatiteni të

shërbeni në misione. Është e domosdoshme të sillni tri gjëra me vete në misionin tuaj:

1. Një dëshirë për të predikuar ungjillin. Zoti dëshiron që ju të kërkonit delet e Tij dhe të kujdeseni për to.² Njerëz në mbarë botën po presin për ju. Ju lutem, shkoni shpejt atje ku janë ata. Askush nuk përpiqet më fort sesa misionarët për të shkuar që të shpëtojë të tjerët. Unë jam një nga ata të shpëtuar.
2. Zhvilloni dëshminë tuaj. Zoti kërkon nga ju “zemrën dhe një mendje të gatshme”³.
3. Duajini të tjerët, tamam ashtu si Plaku [Eldër] Suan, që solli me vete në mision xhaketën e babait të tij dhe dashurinë e babait të tij për Japoninë dhe njerëzit e saj.

Dhe për ata prej jush që nuk e dinë se si duhet të përgatiten që të shërbejnë në mision, ju lutem, shkoni dhe takohuni me peshkopin tuaj. Unë e di se ai do t’ju ndihmojë.

Jam mirënjohës që misionarët thirren nga Zoti, që ata i përgjigjen asaj thirrjeje dhe që ata po shërbejnë në mbarë botën. Më lejoni t’ju them të gjithëve ju misionarë të dashur të kthyer: Jam vërtet mirënjohës për të gjitha përpjekjet tuaja. Ju jeni një thesar i kësaj Kishe. Dhe vazhdofti ju gjithmonë të jeni misionarë dhe të veproni si dishepuj të Krishtit.

Unë dëshmoj se ne jemi fëmijët e Atit tonë në Qiell, se Ai na do dhe se Ai dërgoi Birin e Tij të Dashur, Jezu Krishtin, që ne të mund të kthehemi përsëri në prani të Tij. Unë i them këto gjëra në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Isaia 52:7.
2. Ezekieli 34:11.
3. Doktrina e Besëlidhje 64:34.



Nga Plaku Randall K. Benet,
i Të Shtatëdhjetëve

Zgjidhni Jetën e Përjetshme

Destinacioni juaj i përjetshëm nuk do të jetë rezultat i rastit por i zgjedhjes. Nuk është kurrë tepër vonë të filloni të zgjidhni jetën e përjetshme!

Vite përpara, kur isha në plazh me familjen, vura re shenja dhe flamurë që na paralajmëronin për një rrymë të fortë që shkonte nga bregu në ujëra të thella, të trazuara. E padukshme për sytë e mi të pastërvitur, por që pikasej lehtësisht nga rojat e shpëtimit në një kullë vrojtimi pranë, rryma e fuqishme përbënte rrezik për të gjithë ata që linin sigurinë e bregut dhe futeshin në ujë. Unë kujtoj që arsyetoja: “Unë jam notar i zoti. Notimi do të jetë një stërvitje e shkëlqyer. Unë do të jem i sigurt në ujërat e cekta.”

Duke shpërfillur paralajmërimet dhe duke u ndier i sigurt në gjykimin tim, unë u futa në ujë për të shijuar një not “freskues”. Pas pak minutash, unë ngrita shikimin për të gjetur familjen time në plazhin pranë, por plazhi nuk ishte më pranë! Rryma mashtruese, për të cilën isha paralajmëruar, më pati kapur dhe po më tërhiqte me shpejtësi larg familjes sime.

I sigurt në fillim dhe pastaj me dëshpërim, unë u përpoqa të notoj drejt bregut, por rryma e pamëshirshme më tërhiqte më tej në ujëra më të thella dhe më të trazuara. Unë u

rraskapita dhe fillova të mbytem në ujën që thithja. Fundosja u bë një mundësi reale. Më në fund, kur energjitë më patën shteruar, unë me furi thirra për ndihmë.

Mrekullisht, dukej, një rojë shpëtimi u gjend menjëherë pranë meje. Unë nuk e dija se ai më pati vënë re të futesha në ujë. Ai e dinte se rryma do të më mbërthente dhe ai e dinte ku do të më çonte. Duke iu shmangur rrymës, ai notoi përreth dhe pikërisht përtej vendit ku unë po luftoja, pastaj me durim priti që unë të thërrisja për ndihmë. Tepër i dobët për të notuar vetëm drejt bregut, unë isha dhe ende jam mirënjohës për shpëtimin nga ai. Pa ndihmën e tij unë kurrë nuk do mund të kthehesha përsëri te familja ime.

Atë ditë unë bëra një zgjedhje të dobët që krijoi pasoja serioze të mundshme për mua dhe për familjen time. Ndërsa ne shqyrtojmë tani së bashku dhuratën e zgjedhjes, unë lutem që Fryma e Shenjtë të ndihmojë secilin prej nesh individualisht që të vlerësojmë zgjedhjet që po bëjmë.

Profeti ynë i dashur, Presidenti Tomas S. Monson, na ka mësuar:

“Sado fort nuk është tepri të theksoj se vendimet përcaktojnë destinacionin. Ju nuk mund të merrni vendime të përjetshme pa rrjedhime të përjetshme.”¹

Secili – siç na është mësuar në këtë konferencë – është një bir apo bijë shpirtërore e dashur e prindërve qiellorë. Ju keni një natyrë dhe destinacion hyjnor². Gjatë jetës suaj para lindjes, ju mësuat të doni të vërtetën. Ju bëtë zgjedhje të drejta të përjetshme. Ju e dinit se këtu në vdekshmëri, do të ketë fatkeqësi dhe vështirësi, dëshpërim dhe vuajtje, prova dhe sprova për t’ju ndihmuar të rriteni dhe të përparoni. Ju gjithashtu e dinit se mund të vazhdonit të bënit zgjedhje të drejta, të pendoheshit për zgjedhjet e gabuara dhe nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit, të trashëgoni jetë të përjetshme.

Çfarë na mësoi profeti Lehi rreth zgjedhjes? Ai këshilloi se ne jemi “të lirë të zgjedhi[m] lirinë dhe jetën e përjetshme, nëpërmjet Ndërmjetësit të madh të të gjithë njerëzve, ose të zgjedhi[m] robërinë dhe vdekjen, sipas robërisë dhe fuqisë së djallit”. Ai udhëzoi më pas: “Ju të shikoni te Ndërmjetësi i madh dhe t’i dëgjoni urdhërimet e tij të mëdha; dhe të jeni besnik[ë] ndaj fjalëve të tij dhe të zgjidhni jetën e përjetshme”³.

Vëllezër dhe motra, në atë rreth së cilës zgjedhim të mendojmë, ndiejmë dhe bëjmë, a po zgjedhim ju dhe unë jetën e përjetshme?

Nipërit dhe mbesat tonë po mësojnë se, kur ata bëjnë një zgjedhje, ata gjithashtu zgjedhin pasojat e saj. Kohët e fundit, një nga mbesat tona trevjeçare kundërshtoi ta hante darkën e saj. Mamaja e saj shpjegoi: “Është thuar se koha për gjumë. Nëse zgjedh të hash darkë, ti po zgjedh një akulllore si ëmbëlsirë. Nëse zgjedh të mos hash darkë, ti po zgjedh të shkosh tani



Montreal, Kebek në Kanada

në krevat, pa akulllore.” Mbesa jonë mendoi rreth dy zgjedhjeve të saj dhe më pas tha me forcë: “Unë dua *këtë* zgjedhje – të luaj *dhe* të ha vetëm akulllore *dhe* të mos shkoj në krevat”.

Vëllezër dhe motra, a urojmë ne që të mund të luajmë, të hamë vetëm akulllore, kurrë të mos shkojmë në krevat dhe në një mënyrë të shmanjim pasojat si kequshqyerja dhe rraskapitja?

Në të vërtetë ne kemi vetëm dy zgjedhje të përjetshme, secila me pasojat e përjetshme: të zgjedhim të ndjekim Shpëtimtarin e botës dhe kështu zgjedhim jetën e përjetshme me Atin tonë Qiellor ose të zgjedhim të ndjekim botën dhe kështu zgjedhim ta ndajmë veten nga Ati Qiellor përjetësisht.

Ne nuk mund t’i zgjedhim me sukses edhe sigurinë e drejtësisë edhe rreziqet e botësisë. Të çash ose të merresh nga pak në botësi mund të duket e padëmshme, por kështu bëri noti im “freskues”!

Si rryma që mund të kishte ndryshuar drejtimin e jetës së familjes sime, rrymat e sotme të botësisë, filozofitë mashtruese, mësimet e gënjeshtërtë dhe imoraliteti i shfrenuar kërkojnë të na tërheqin larg dhe të na ndajnë përjetësisht nga familjet tona dhe nga Ati ynë Qiellor.

Profetët, shikuesit dhe zbuluesit tanë të gjallë shohin dhe përpiqen të na paralajmërojnë ne mbi rrymat shpesh të lehta por të rrezikshme të botës që na kërcënojnë. Ata na ftojnë, na nxisin, na mësojnë, na kujtojnë dhe na paralajmërojnë me dashuri. Ata e dinë se siguria jonë varet nga zgjedhja për të ndjekur 1) tejshtikimin që fitojmë gjatë studimit të shkrimeve të shenjta, medimit dhe lutjes së përditshme; 2) drejtimin e Frymës së Shenjtë; dhe 3) këshillën e tyre profetike. Ata e dinë se ka siguri dhe gëzim përfundimtar vetëm në dhe nëpërmjet Shpëtimtarit, Jezu Krishtit dhe ungjillit të Tij të gjallë. Siç sapo na mësoi Plaku Dallin H. Ouks, Shpëtimtari deklaroi: “Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje”⁴.

Gjatë vështirësive dhe vuajtjeve në Rusinë pas sovjetike, Anatoli dhe Svjetllana Reshetnikov zgjodhën drejtësinë në vend të botësisë. Pas bashkimit me Kishën, ata u përndoqën. Ai u ul në pozitën e tij në punë. Besnikërisht ata menduan: “Tani kemi më shumë kohë për t’i shërbyer Perëndisë!” Ata vazhdimisht morën kërcënime, por prapë ata zgjodhën ta jetojnë jetën të përqendruar në ungjill. Plaku Anatoli Reshetnikov u thirr si i pari

rus I Shtatëdhjetë Zonal. Nëpërmjet zgjedhjeve të tyre, Reshetnikovët vazhdojnë të zgjedhin jetën e përjetshme.

Ne të gjithë ndeshim vështirësi. Ne të gjithë kemi tundime. Ne të gjithë kemi bërë gabime. Nuk është kurrë tepër e vështirë apo tepër vonë të bëjmë zgjedhje korrekte. Pendesa është një nga ato zgjedhje korrekte të rëndësishme.

Presidenti Diter F. Uhtdorf na ka mësuar:

“Gabime dhe shmangie të vogla nga doktrina e ungjillit të Jezu Krishtit mund të sjellin pasoja të dhembshme në jetën tonë. Prandaj është me rëndësi vendimtare që të bëhemi aq të vetëdisiplinuar sa të bëjmë në kohë korrigjime vendimtare për t’u kthyer në rrugë të drejtë dhe jo të presim apo të shpresojmë që gabimet në një farë mënyre do të rregullohen vetë.

Sa më shumë të vonojmë veprimin korrigjues, aq më të mëdha bëhen ndryshimet e nevojshme dhe aq më shumë kohë duhet për t’u kthyer në rrugën e drejtë – qoftë edhe në pikën ku shkatërrimi mund të jetë te pragu.”⁵

Krahët e mëshirës së Shpëtimtarit janë gjithmonë shtrirë drejt secilit prej nesh⁶. Kur pendo kemi sinqerisht dhe plotësisht, ne mund të jemi tërësisht të falur për mëkatet tona dhe Shpëtimtari nuk do t’i kujtojë më ato⁷.

Në vlerësimin e zgjedhjeve tuaja dhe të pasojave të tyre, ju mund të pyesni veten:

- A po kërkoj drejtim hyjnor nëpërmjet studimit të shkrimeve të shenjta, meditimit dhe lutjes së përditshme, apo kam zgjedhur të jem aq i zënë apo shpërfillës sa që nuk gjej kohë për t’i studiuar fjalët e Krishtit, për t’i medituuar ato dhe për të biseduar me Atin tim Qiellor?



- A po zgjedh të ndjek këshillën e profetëve të gjallë të Perëndisë apo po ndjek mënyrat e botës dhe po kundërshtoj opinionet e të tjerëve?
- A po kërkoj drejtim nga Fryma e Shenjtë çdo ditë për atë rreth së cilës zgjedh të mendoj, ndiej dhe bëj?
- A po përpiqem vazhdimisht që të marrë pjesë, t’u shërbej ose të ndihmoj për t’i shpëtuar të tjerët?

Vëllezër dhe motra të mia të dashura, destinacioni juaj i përjetshëm nuk do të jetë rezultat i rastit por i zgjedhjes. Nuk është kurrë tepër vonë të filloni të zgjedhni jetën e përjetshme!

Unë sjell dëshminë time se në sajë të planit të madh të lumturisë të Atit

Qiellor, secili prej nesh mund të përsoset nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit. Me familjet tona, ne mund të jetojmë me Atin tonë Qiellor përjetësisht dhe të marrim një plotësi të gëzimit. Për këto gjëra, unë dëshmoj në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Thomas S. Monson, “Decisions Determine Destiny” (Church Educational System fireside for young adults, 6 nëntor 2005), institute.lds.org.
2. Shih “Familja: Një Proklamata Drejtuar Botës”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.
3. 2 Nefi 2:27, 28; theksimi i shtuar.
4. Gjoni 14:6.
5. Diter F. Uhtdorf, “Një Çështje Pak Gradësh”, *Liahona*, maj 2008, f. 59.
6. Shih Alma 5:33.
7. Shih Doktrina e Besëlidhje 58:42.



Nga Plaku J. Devn Kornish,
i Të Shtatëdhjetëve

Privilegji i Lutjes

Lutja është një nga dhuratat më të çmuara të Perëndisë për njeriun.

Motrat dhe vëllezërit e mi të dashur, Perëndia Ati ynë nuk është një ndjenjë apo një ide, apo një forcë. Ai është një person i shenjtë, që, siç na mësojnë shkrimet e shenjta, ka një fytyrë e duar dhe një trup të pavdekshëm të përlëvdur. Ai është i vërtetë, Ai njuh secilin prej nesh personalisht dhe Ai na do ne, çdonjërin. Ai dëshiron të na bekojë.

Jezusi tha:

“A ka midis jush ndonjë njeri që, po t’i kërkojë i biri bukë, t’i japë një gur?”

Ose po t’i kërkojë një peshk, t’i japë një gjarpër?”

Në qoftë se ju, që jeni të këqij, dini t’u jepni dhurata të mira bijve tuaj, aq më tepër Ati juaj, që është në qiej, do t’u japë gjëra të mira atyre që ia kërkojnë” (Mateu 7:9–11).

Ndoshta një përvojë vetjake do të jetë një shembull i mirë për këtë parim. Kur isha mjek i ri në trajnim në Spitalin e Fëmijëve në Boston, unë punoja për shumë orë dhe shumicën e kohës udhëtoja nga spitali për në shtëpinë tonë në Uotërtaun të Masaçusetsit dhe anasjelltas, kryesisht me biçikletë pasi bashkëshortja dhe familja ime e re kishte nevojë për makinë tonë. Një mbrëmje, unë po shkoja me biçikletë për në shtëpi pas shumë orësh qëndrimi në spital, duke u ndier shumë i lodhur e i uritur dhe paksa

i shkurajuar. Unë e dija se duhej t’u jepja bashkëshortes dhe katër fëmijëve të mi të vegjël jo vetëm kohën dhe energjitë e mia kur të shkoja në shtëpi por gjithashtu një qëndrim gazmor. Sinqerisht, po e shihja të vështirë thjesht të vazhdoja ta ngisja biçikletën.

Itinerari im kalonte nga një restorant që shërbente pula të skuqura dhe e ndjeva se do të isha shumë më pak i uritur dhe i lodhur po të ndalesha pak për të ngrënë një porcion pule gjatë rrugës për në shtëpi. Unë e dija se ata kishin në shitje kofshë ose këmbë pule për 29 cent secila, por kur kontrollova portofolin, gjithë çfarë kisha ishin pesë cent. Ndërsa vazhdova më tej, unë i tregova Zotit gjendjen time dhe i kërkoja nëse, me mëshirën e Tij, Ai do të më lejonte të gjeja një çerek dollari në anë të rrugës. Unë i thashë atij se nuk e doja këtë si një shenjë por sepse do të isha vërtet mirënjohës nëse Ai do të ndjente të ma dhuronte këtë lloj bekimi.

Unë fillova të vërej tokën më pikësnyues por nuk pashë gjë. Duke u përpjekur të mbaj një qëndrim plot besim por të nënshtruar ndërsa ngisja biçikletën, unë iu afrova dyqanit. Pastaj, thujse matanë rrugës nga vendi i pulave, unë pashë një çerek dollarësh në tokë. Me mirënjohje dhe lehtësim, unë e mora, bleva pulën,

shijova çdo grimcë dhe ngava i lumtur biçikletën për në shtëpi.

Në mëshirën e Tij, Perëndia i qiellit, Krijuesi dhe Sunduesi i të gjitha gjërave kudo, pati dëgjuar një lutje për një gjë shumë të vogël. Njeriu mundet mirë të pyesë përse Ai do të shqetësohej me diçka kaq të vogël. Unë dua të besoj se Ati ynë Qiellor na do neve aq shumë saqë gjërat që janë të rëndësishme për ne bëhen të rëndësishme për Të, thjesht sepse Ai na do ne. Sa shumë më shumë do të donte Ai të na ndihmonte në gjërat e mëdha që kërkojmë, që janë të drejta (shih 3 Nefi 18:20)?

Fëmijë të vegjël, të rinj dhe po ashtu të rritur, ju lutem besoni sa shumë Ati juaj i dashur Qiellor do që t’ju bekojëju. Por për shkak se Ai nuk do të cënojë lirinë tonë të zgjedhjes, ne duhet ta kërkojmë ndihmën e Tij. Kjo në përgjithësi bëhet nëpërmjet lutjes. Lutja është një nga dhuratat më të çmuara të Perëndisë për njeriun.

Në një rast, dishepujt e Jezusit pyetën: “Zot, na mëso të lutemi” (Lluka 11:1). Në përgjigje Jezusi na dha neve një shembull që mund të shërbejë si një udhërrëfyes për te parimet bazë të lutjes (shih Rasëll M. Nelson, “Mësim nga Lutjet e Zotit”, *Liahona*, maj 2009, f. 46–49; shih gjithashtu Mateu 6:9–13; Lluka 11:1–4). Sipas shembullit të Jezusit:

Ne fillojmë duke i thënë Atit tonë Qiellor: “Ati ynë që je në qiell” (Mateu 6:9; Lluka 11:2). Është privilegji ynë që t’i flasim Atit tonë drejtpërdrejt. Ne nuk i lutemi ndonjë qenieje tjetër. Kujtoni se ne jemi këshilluar të shmangim përsëritjet e kota, përfshirë përdorimin e emrit të Atit tepër shpesh në lutje.¹

“U shenjtëroftë emri yt” (Mateu 6:9; Lluka 11:2). Jezusi i foli Atit të Tij me një qëndrim adhurues, duke njohur madhësinë e Tij dhe duke i dhënë Atij lavd dhe falënderime. Sigurisht kjo



çështje e nderimit të Perëndisë dhe dhënies së falënderimeve të sinqerta dhe të veçanta është një nga pjesët jetike për lutje të efektshme.

“Ardhtë mbretëria jote. U bëftë vullneti yt” (Mateu 6:10; Lluca 11:2). Ne e njohim lirisht vartësinë tonë nga Zoti dhe shprehim dëshirën tonë që të bëhet vullneti i Tij, edhe nëse nuk është i njëjtë me vullnetin tonë. Fjalori i Biblës tonë në anglisht shpjegon: “Lutja është akti me anën e të cilit vullneti i Atit dhe vullneti i fëmijës vijnë në marrëveshje me njëri-tjetrin. Qëllimi i lutjes nuk është të ndryshohet vullneti i Perëndisë, por të arrijmë për veten dhe për të tjerët bekime që Perëndia tashmë dëshiron t’i dhurojë, por që janë bërë të kushtëzuara nga kërkimi ynë për to” (Bible Dictionary, “Prayer”).

“Bukën tonë të përditshme na e jep sot” (Mateu 6:11; shih gjithashtu Lluca 11:3). Ne kërkojmë ato gjëra që duam nga Zoti. Ndershmëria është thelbësore në kërkimin e gjërave nga Perëndia. Nuk do të ishte plotësisht e ndershme, për shembull, t’i kërkoja Zotit për ndihmë në një provim në shkollë nëse nuk kam pasur vëmendjen në klasë, nuk kam bërë detyrën e shtëpisë apo studiuar për provimin. Shpesh ndërsa lutem, Shpirti më nxit lehtësisht të pranoj se ka më shumë që duhet të bëj që të marr ndihmën

që po kërkoj nga Zoti. Pastaj unë duhet të marr përsipër dhe të bëj pjesën time. Është në kundërshtim me planin e Perëndisë që Zoti të bëjë për ne atë që ne mund ta bëjmë vetë.

“Dhe na i fal fajet tona” (Mateu 6:12) ose, në një variant tjetër, “Dhe na i fal mëkatet tona” (Lluca 11:4). Një pjesë thelbësore dhe nganjëherë e harruar e lutjes vetjake është pendesa. Që pendesa të ketë rezultat, duhet të jetë e posaçme, e sinqertë dhe e përhershme.

“Ashtu siç ua falim ne fajtorëve tanë” (Mateu 6:12; shih gjithashtu Lluca 11:4). Shpëtimtari e bëri të qartë lidhjen midis të qenit të falur nga mëkatet tona dhe të falurit e të tjerëve që kanë gabuar ndaj nesh. Ndonjëherë gabimet që të tjerët kanë bërë ndaj nesh janë shumë, shumë të dhembshme dhe shumë të vështira qoftë për t’i falur apo për t’i harruar. Unë jam kaq mirënjohës për qetësinë dhe shërimin që kam gjetur në ftesën e Zotit për t’i lënë të largohen plagët tona dhe për t’i kaluar ato tek Ai. Te Doktrina e Besëlidhje, seksioni 64, Ai tha:

“Unë, Zoti, do të fal kë do të fal, por nga ju kërkohet t’i falni të gjithë njerëzit.

Dhe ju duhet të thoni në zemrat tuaja—Perëndia duhet të gjykojë midis meje dhe teje dhe të të shpërblejë

sipas veprave të tua” (vargjet 10–11).

Pastaj ne duhet ta harrojmë çështjen tërësisht, duke e lënë Zotin ta trajtojë pas kësaj, nëse duam të shërohemi.

“Dhe mos lejo të biem në tundim, por na çliro nga ligësia” (Mateu 6:13, shënim fundfaqeje a; nga Përkthimi prej Jozef Smithit, Mateu 6:14; shih gjithashtu Lluca 11:4, shënim fundfaqeje c; nga Përkthimi prej Jozef Smithit). Kështu, në lutjet tona ne mund të fillojmë me procesin mbrojtës të veshjes së gjithë armatimit të Perëndisë (shih Efesianëve 6:11; DeB 27:15) duke parë përpara te dita që vjen dhe duke kërkuar për ndihmë për gjëra ndonjëherë frikësuese që mund të ndeshim. Ju lutem, miq të mi, mos harroni t’i kërkonit Zotit t’ju mbrojë dhe të jetë me ju.

“Sepse jotja është mbretëria dhe fuqia dhe lavdia përjetë” (Mateu 6:13). Sa udhëzuese është që Jezusi e përfundoi këtë lutje duke lëvdur Perëndinë përsëri dhe duke shprehur nderimin e tij për Atin dhe përu-ljen ndaj Tij. Kur vërtet besojmë se Perëndia sundon mbretërinë e Tij dhe se Ai ka të gjithë fuqinë dhe të gjithë lavdinë, ne po njohim se Ai vërtet është në fuqi, sepse Ai na do me një dashuri të përsosur dhe sepse Ai do që të jemi të lumtur. Unë kam gjetur se një nga sekretet për jetë të gëzuar është të njohësh se të bërit e gjërave

sipas mënyrës së Zotit do të më bëjë më të lumtur sesa t'i bëj gjërat sipas mënyrës sime.

Ka një rrezik që një person mund të mos ndihet sa duhet i denjë për t'u lutur. Kjo ide vjen nga ai shpirt i keq, që është ai që na mëson neve të mos lutemi (shih 2 Nefi 32:8). Është po aq tragjike të mendosh se jemi tepër mëkatarë për t'u lutur siç është për një person shumë të sëmurë që të besojë se është tepër i sëmurë për të shkuar te doktori!

Ne nuk duhet të mendojmë se çfarëdo lloj lutjeje, pavarësisht sa e sinqertë, do të jetë e efektshme nëse ne gjithçka që bëjmë është të themi lutjen. Ne duhet jo vetëm t'i themi lutjet tona, ne duhet t'i jetojmë ato. Zoti është shumë më tepër i kënaqur me personin që lutet dhe pastaj shkon të punojë sesa me personin që vetëm lutet. Shumë ngjashëm me ilaçin, lutja ndikon vetëm kur ne e përdorim siç udhëzohet.

Kur them se lutja është një privilegj



i ëmbël, kjo nuk është thjesht sepse jam mirënjohës të kem mundësi t'i flas Atit Qiellor dhe të ndiej Shpirtin e Tij kur lutem. Ajo është gjithashtu sepse Ai në të vërtetë na përgjigjet dhe na flet neve. Patjetër, mënyra që Ai na flet neve është zakonisht jo me zë që e dëgjojmë. Presidenti Bojd K. Parker shpjegoi: "Ai zë i ëmbël e i qetë frymëzimi vjen më shumë si një ndjesi sesa si një tingull. Inteligjencë e pastër mund t'i flitet mendjes. . . . Kjo udhëheqje vjen si mendime, si ndjenja përmes nxitjeve dhe mbresave" ("Lutjet dhe Nxitjet", *Liahona*, nëntor 2009, f. 44).

Ndonjëherë ne duket të mos marrim përgjigje për lutjet tona të sinqerta dhe të vendosura. Kërkon besim që të kujtosh se Zoti përgjigjet në kohën e Tij dhe në mënyrën e Tij që të na bekojë në mënyrën më të mirë të mundshme. Ose, duke menduar më shumë, ne shpesh do të kuptojmë se tashmë e dimë tërësisht mirë çfarë duhet të bëjmë.

Lutem, mos u shkurajoni nëse kjo nuk rezulton kështu për të gjithë ju menjëherë. Si të mësuarit e një gjuhe të huaj, ajo kërkon praktikë dhe përpjekje. Ju lutemi dijeni, megjithatë, se ju mund të mësoni gjuhën e Shpirtit dhe, kur ju e bëni, ajo do t'ju japë besim dhe fuqi të madhe në drejtësi.

Unë e dua fort këshillën e profetit tonë të dashur, Presidentit Tomas S. Monson, që tha: "Atyre që dëgjojnë

zërin tim, të cilët po ndeshen me sfida dhe vështirësi, të mëdha e të vogla, lutja është furnizuesja e forcës shpirtërore; ajo është pasaporta drejt paqes. Lutja është mjeti me anë të së cilës i qasemi Atit tonë në Qiell, që na do. I flisni Atij në lutje dhe pastaj dëgjoni përgjigjen. Mrekullitë janë shkruar përmes lutjes" ("Të Jini më i Miri që Mundeni", *Liahona*, maj 2009, f. 68).

Unë jam thellësisht mirënjohës për privilegjin e të shkuarit tek Ati i shenjtë Qiellor në lutje. Unë jam mirënjohës për herët e shumta që Ai më ka dëgjuar dhe më është përgjigjur. Për shkak se Ai më përgjigjet, përfshirë ndonjëherë në mënyra të parashikueshme dhe të mrekullueshme, unë e di se Ai jeton. Unë gjithashtu përlulisht dëshmoj se Jezusi, Biri i Tij i shenjtë, është Shpëtimtari ynë që jeton. Kjo është Kisha dhe mbretëria e Tij mbi tokë; kjo punë është e vërtetë. Tomas S. Monsoni, për të cilin ne lutemi me zjarr, është profeti i Tij. Për këto unë dëshmoj me siguri të plotë në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIM

1. Shih Francis M. Lyman, "Proprieties in Prayer", në Brian H. Stuy, përmb., *Collected Discourses Delivered by President Wilford Woodruff, His Two Counselors, the Twelve Apostles, and Others*, 5 vëllime. (1987–1992), 3:76–79; B. H. Roberts, përmb., *The Seventy's Course in Theology*, 5 vëllime. (1907–1912), 4:120; *Encyclopedia of Mormonism* (1992), "Prayer", 1118–1119; Bruce R. McConkie, *Mormon Doctrine*, botimi i 2-të (1966), f. 583.



Nga Plaku Kuentin L. Kuk,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Këngët që Ata Nuk Mundën t'i Këndonin

Ndërsa ne nuk i dimë të gjitha përgjigjet, ne njohim parime të rëndësishme që na lejojnë të përballemi me tragjeditë me besim dhe siguri.

Shumë njerëz ndeshin probleme të mëdha ose edhe tragjedi gjatë kësaj jete të vdekshme. Kudo në botë ne shohim shembuj të sprovave dhe mundimeve.¹ Ne prekemi në shpirt nga pamjet televizive të vdekjes, vuajtjeve të dhembshme dhe dëshpërimit. Ne shohim japonezët të luftojnë heroikisht kundër shkatërrimit nga një tërmet dhe cunami. Skenat shqetësuese nga shkatërrimi i kullave të Qendrës Botërore të Tregtisë ishin të dhembshme t'i rijetoje. Diçka na trondit shpirtërisht kur mësojmë mbi një tragjedi të tillë, veçanërisht kur e vuajnë njerëz të pafajshëm.

Ndonjëherë tragjeditë janë shumë vetjake. Një bir apo bijë vdes i ri/e re ose bëhet viktimë e një sëmundjeje shkatërruese. Jeta e një prindi të dashur merret për shkak të një veprimi të pamend apo aksidenti. Kurdo që ndodh tragjedia, ne vajtojmë dhe përpiqemi të mbajmë barrat e njëri-tjetrit.² Ne dëshpërohemi për gjërat që nuk do të plotësohen dhe këngët që nuk do të këndohen.

Ndër pyetjet që u bëhen më shpesh udhëheqësve të Kishës janë: Përse një Perëndi i drejtë lejon që gjëra të këqija

të ndodhin, sidomos te njerëzit e mirë? Përse ata që janë të drejtë dhe në shërbim të Zotit, nuk janë të mbrojtur nga tragjedi të tilla?

Ndërsa nuk i dimë të gjitha përgjigjet, ne njohim parime të rëndësishme që na lejojnë të përballemi me tragjeditë me besim dhe siguri se ka një të ardhme plot shpresë të planifikuar për secilin prej nesh. Disa nga parimet më të rëndësishme janë:

Së pari, ne kemi një Atë në Qiell, që na njeh e na do personalisht dhe e kupton vuajtjen tonë plotësisht.

Së dyti, Biri i Tij, Jezu Krishti, është Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë, Shlyerja e të cilit jo vetëm siguron për shpëtim dhe ekzaltim, por do të dëmshpërblejë për të gjitha padrejtësitë e jetës.

Së treti, plani i Atit për lumturinë e fëmijëve të Tij përfshin jo vetëm një jetë para lindjes dhe atë të vdekshme, por edhe një jetë të përjetshme gjithashtu, duke përfshirë një ribashkim madhështor dhe të lavdishëm me të gjithë ata që kanë humbur. Të gjitha gabimet do të korrigojen dhe ne do të shohim me qartësi të përsosur dhe këndvështrim e kuptim të patëmetë.

Nga këndvështrimi i kufizuar i atyre

që nuk kanë njohuri, kuptim apo besim në planin e Atit – që vetëm e shohin botën përmes lentes së vdekshmerisë me luftërat, dhunën, sëmundjet dhe të keqen e saj – kjo jetë mund të duket dëshpëruese, kaotike, e padrejtë dhe e pakuptimtë. Udhëheqësit e Kishës e kanë krahasuar këtë këndvështrim me dikë që ecën në mes të një drame me tre akte.³ Ata që nuk kanë njohuri për planin e Atit, nuk e kuptojnë atë që ka ndodhur në aktin e parë, që është ekzistenca para lindjes dhe qëllimet e përcaktuara atje; as nuk kuptojnë sqarimin dhe zgjidhjen që vjen në aktin e tretë, që është përmbushja e lavdishme e planit të Atit.

Shumë njerëz nuk e vlerësojnë se, sipas planit të Tij të dashur dhe tërësor, ata që duken të dëmtuar pa ndonjë faj të vetin, në fund të fundit nuk ndëshkohen.⁴

Pas rreth gjashtë muajsh do të mbushen 100 vjet nga fundosja tragjike e anijes oqeanike të pasagjerëve *Titanik*. Rrethanat shkatërruese të kësaj ngjarjeje të tmerrshme kanë ndikuar fort te njerëzit gjatë gjithë shekullit, qysh kur ndodhi. Reklamuesit e anijes së re luksoze të pasagjerëve, që ishte 11 kate e lartë dhe 270 metra e gjatë⁵, shprehën pretendime të tepruara dhe të pajustificuara rreth paprekshmërisë së *Titanikut* nga ujërat e dimrit plot ajsbergë. Kjo anije mendohej si e pafundosshme; por kur u fundos nën sipërfaqen e Oqeanit të akullit Atlantik, mbi 1.500 shpirtëra vdiqën.⁶

Në shumë mënyra fundosja e *Titanikut* është një metaforë për jetën dhe shumë parime të ungjillit. Ajo është një shembull i përsosur i vështirësisë së të parit vetëm nëpërmjet lenteve të kësaj jete të vdekshme. Humbja e jetës ishte katastrofike në pasojat e saj, por ishte e një natyre rastësore. Me morinë e vdekjeve të dy luftërave botërore dhe kur sapo kaloi 10-vjetori

i shkatërrimit të kullave të Qendrës Botërore të Tregtisë, ne kemi parë në vetë kohën tonë një pamje tronditjeje, agonie dhe çështjesh morale rreth ngjarjesh që vijnë si pasojë e ushtrimit të keq të lirisë së zgjedhjes. Ka ndikime të tmerrshme te familja, miqtë dhe kombet si rezultat i këtyre tragjeditive, pavarësisht nga shkaku.

Në lidhje me *Titanikun*, u nxorën mësimet rreth rreziqeve prej krenarisë dhe udhëtimit në ujëra të turbullta dhe “se Perëndia nuk tregohet i anshëm”⁷. Ata që u përfshinë ishin nga të gjitha nivelet shoqërore. Disa ishin të pasur dhe të famshëm, të tillë si Xhon Xheikob Astor; por kishte gjithashtu edhe punëtorë, emigrantë, gra, fëmijë dhe anëtarë të ekuipazhit.⁸

Kishte të paktën dy lidhje të shenjtoreve të ditëve të mëvonshme me *Titanikun*. Që të dyja ilustronin sfidën tonë në të kuptuarit e sprovave, mundimeve e tragjeditive dhe japin një depërtim në atë se si mund t'i përballojmë ato. I pari është një shembull i të qenit vlerësues për bekimet që marrim dhe sfidat që shmangim. Ai përfshin Alma Sonin, që më vonë shërbeu si Autoritet i Përgjithshëm.⁹ Ai ishte presidenti im i kunjtit kur unë lindi në Logan të Jutas. Unë pata intervistën time para misionit me Plakun Soni. Në atë kohë të gjithë misionarët e ardhshëm intervistoheshin nga një Autoritet i Përgjithshëm. Ai ishte një ndikim i shkëlqyer në jetën time.

Kur Alma ishte i ri, ai pati një mik që ishte më pak aktiv në Kishë, i quajtur Fred. Ata patën diskutime të shumta rreth të shërbyerit në mision dhe më në fund Alma Soni e bindi Fredin që të përgatitej dhe të shërbeente. Ata që të dy u thirrën në Misionin Britanik. Në mbarim të misionit të tyre, Plaku Soni, sekretar misioni, bëri rregullimet e udhëtimit për kthimin e tyre në Shtetet e Bashkuara. Ai bleu



biletat e udhëtimit me *Titanikun* për vetë, Fredin dhe katër misionarë të tjerë që patën mbaruar misionin e tyre gjithashtu.¹⁰

Kur erdhi koha e udhëtimit, për disa arsye Fredi ishte vonuar. Plaku Soni i anuloi të gjashtë biletat për të lundruar me një anije të re luksoze pasagjerësh në udhëtimin e saj të parë dhe bleu bileta për një anije që lundronte ditën tjetër.¹¹ Të katër misionarët që qenë të emocionuar për udhëtimin me *Titanikun*, shprehën zhgënjimin e tyre. Përgjigjja e Plakut Soni parafrizonte tregimin e Jozefit dhe të vëllezërve të tij në Egjipt shkruar te Zanafilla: “Si mund të rikthehemi te familjet tona në qoftë se fëmija nuk është me ne?”¹² Ai u shpjegoi shokëve të tij se ata të gjithë erdhën në Angli së bashku dhe ata të gjithë duhej të ktheheshin në shtëpi së bashku. Plaku Soni më pas mësoi për fundosjen e *Titanikut* dhe me mirënjohje i tha mikut të tij, Fredit: “Ti më shpëtove jetën”. Fredi iu përgjigj: “Jo, duke më bindur të shkoj në mision, ti më shpëtove jetën”¹³. Të gjithë misionarët e falënderuan Zotin që i ruajti.¹⁴

Ndonjëherë, siç ishte rasti me Plakun Soni dhe shokët e tij misionarë, bekime të mëdha u shkojnë atyre që janë besnikë. Ne duhet të

jemi mirënjohës për të gjitha mëshirat e dhembshura që vijnë në jetën tonë.¹⁵ Ne nuk jemi të vetëdijshëm për bekimet e shumta që marrim nga dita në ditë. Është tepër e rëndësishme që ne të kemi një qëndrim mirënjohës në zemrën tonë.¹⁶

Shkrimet e shenjta janë të qarta: ata që janë të drejtë, që ndjekin Shpëtimtarin dhe mbajnë urdhërimet e Tij, do të përparojnë në tokë.¹⁷ Një element thelbësor i përparimit është të kemi Shpirtin në jetën tonë.

Sidoqoftë, drejtësia, lutja dhe besnikëria jo gjithmonë do të rezultojnë në përfundime të lumtura në vdekshmëri. Shumë do të përjetojnë sprovat e ashpra. Kur kjo ndodh, vetë të pasurit besim dhe kërkimi i bekimeve të priftërisë miratohen nga Perëndia. Zoti ka thënë: “Dhe pleqtë . . . duhet të thirren e duhet të luten për ta dhe duhet t'i vënë duart mbi ta në emrin tim; dhe nëse ata vdesin, do të vdesin në mua dhe nëse jetojnë, do të jetojnë në mua”¹⁸.

Është mësimdhënëse që lidhja e dytë e shenjtoreve të ditëve të mëvonshme me *Titanikun* nuk pati një përfundim të lumtur në vdekshmëri. Irene Korbet ishte 30 vjeçe. Ajo ishte bashkëshorte dhe nënë e re nga Provo e Jutas. Ajo pati talente të

rëndësishme si artiste dhe muzikante; ajo ishte gjithashtu mësuese dhe infermiere. Me këshillën e profesionistëve të mjekësisë në Provo, ajo mori pjesë në një kurs gjashtëmuor studimesh për teknikën e mamisë në Londër. Ishte dëshira e saj e madhe që të sillte një ndryshim në botë. Ajo ishte e kujdesshme, e vëmendshme, plot lutje dhe e guximshme. Një nga arsytet që ajo zgjodhi *Titanikun* për t'u rikthyer në SHBA ishte sepse mendoi që misionarët do të udhëtonin me të dhe se kjo do t'i jepte një siguri shtesë. Irene ishte një nga gratë e pakta që nuk i mbijetuan kësaj tragjedie të tmerrshme. Shumë nga gratë dhe fëmijët u vendosën në barkat e shpëtimit dhe përfundimisht shpëtuan. Nuk kishte mjaft barka shpëtimi për të gjithë. Por besohet se ajo nuk shkoi te barkat e shpëtimit sepse, me trajnimin e saj të posaçëm, ajo po ndihmonte për nevojat e pasagjerëve të shumtë që ishin plagosur nga përplasja me ajsbergun.¹⁹

Ka shumë lloje sfidash. Disa na japin neve përvoja të nevojshme. Rezultatet negative në këtë jetë të vdekshme nuk janë prova të mungesës së besimit apo të ndonjë papërsosmërie në planin e përgjithshëm të Atit tonë në Qiell. Zjarri i rafinuesit është i vërtetë dhe cilësitë e karakterit e të drejtësisë që janë farkëtuar në furrën e fatkeqësive, na përsosin dhe pastrojnë, dhe na përgatisin të takojmë Perëndinë.

Kur Profeti Jozef Smith ishte i burgosur në burgun e Libertisë, Zoti i tha atij se shkatërrime të shumëfishta mund ta pllakosin njerëzimin. Shpëtimtari deklaroi ndër të tjera: "Në qoftë se do të hidhesh në thellësi, në qoftë se dallgët e trazuara komplotojnë kundër teje, në qoftë se erërat e forta bëhen armiku yt; . . . dhe gjithë elementët ndërthuren për të penguar rrugën;



. . . këto gjëra do të të japin përvojë dhe do të jenë për të mirën tënde"²⁰. Shpëtimtari e mbylli këshillën e Tij: "Ditët e tua njihen dhe vitet e tua s'do të numërohen më pak; si rrjedhim, mos ki frikë . . . , sepse Perëndia do të jetë me ty përherë e përgjithmonë"²¹.

Disa sfida vijnë nga liria e zgjedhjes së të tjerëve. Liria e zgjedhjes është thelbësore për rritjen dhe zhvillimin shpirtëror vetjak. Sjellja e keqe është element i lirisë së zgjedhjes. Kapiten Moroni shpjegoi këtë doktrinë shumë të rëndësishme: "Zoti lejon që të drejtët të vriten, që drejtësia dhe gjykimi i tij të bien mbi të ligjtë". Ai e bëri të qartë që të drejtët nuk kanë humbur, por "hyjnë në prehjen e Zotit, Perëndisë së tyre"²². Të ligjtë do të mbahen përgjegjës për mizoritë që kryejnë.²³

Disa sfida vijnë nga mosbindja ndaj ligjeve të Perëndisë. Problemet e shëndetit që vijnë nga abuzimi me duhanin, alkoolin dhe drogat, janë tronditëse. Burgosja në paraburgime dhe burgje si pasojë e krimit lidhur me alkoolin dhe drogën është gjithashtu shumë e zakonshme.²⁴

Shpeshtësia e prishjeve të martesës për shkak të mosbesnikërisë është gjithashtu e madhe. Shumë nga këto sprova dhe mundime mund të

shmangeshin me anë të bindjes ndaj ligjeve të Perëndisë.²⁵

Presidenti im i dashur i misionit, Plaku Marion D. Hanks (që u nda nga jeta në gusht), na kërkonte neve si misionarë që të mësonim përmendësh një thënie për t'u rezistuar vështirësive të jetës së vdekshme: "Nuk ka shans, as të ardhme, as fat që mund të shmangë apo ndalojë, apo kontrollojë përkushtimin e patundur të një njeriu të vendosur"²⁶.

Ai pranonte se kjo nuk i përshtatej të gjitha sfidave që ne ndeshim, por është e vërtetë në gjërat shpirtërore. Unë e kam vlerësuar këshillën e tij në jetën time.

Një nga arsytet për humbjen e tmerrshme të jetës në *Titanik* është se nuk pati mjaft barka shpëtimi. Pavarësisht nga sprovat që ndeshim në këtë jetë, Shlyerja e Shpëtimtarit siguron barka shpëtimi për cilindo. Për ata që mendojnë se sprovat që ndeshin janë të padrejta, Shlyerja i mbulon të gjitha padrejtësitë e jetës.²⁷

Një sfidë unike për ata që kanë humbur të dashurit e tyre është të shmangin të menduarit shumë për mundësitë e humbura në këtë jetë. Shpesh ata që vdesin herët kanë demonstruar aftësi, interesa dhe talente të mëdha. Me kuptueshmërinë tonë të kufizuar, ne mbajmë zi për gjërat që nuk do të përmbushen dhe këngët që nuk do të këndohen. Kjo është përshkruar si të vdesësh me muzikën tënde ende brenda teje. Muzika në këtë rast është një shëmbëlltyrë për çfarëdolloj mundësish të parea-lizuara. Ndonjëherë njerëzit kanë bërë përgatitje të madhe, por nuk kanë pasur mundësinë ta shfaqin në vdekshmëri.²⁸ Një nga poemat klasike më të cituara, "Elegji e Shkruar në Oborrin e Një Kishe Fshati" nga Tomas Grej, arsyeton mbi mundësi të tilla të humbura:

Shumë lule lulëzojnë pa u parë,
Dhe në ajrin e shkretëtirës bukuria
e tyre është vrarë.²⁹

Mundësia e humbur mund të lidhet me familjen, punësimin, talentet, përvojat apo të tjera. Të gjitha këto u ndërprejnë shpejt në rastin e Motrës Korbet. Pati këngë që ajo nuk i këndoi dhe mundësi që ajo nuk i përmbushi në këtë jetë të vdekshme. Por parë përmes lentes së gjerë dhe të qartë të ungjillit, në vend të lenteve të kufizuara të një ekzistence të thjeshtë të vdekshme, ne njohim shpërblimin e madh e të përjetshëm të premtuar nga një Atë i dashur në planin e Tij. Siç na mësoi Apostulli Pal: “Ato gjëra që syri nuk i ka parë dhe veshi nuk i ka dëgjuar dhe nuk kanë hyrë në zemër të njeriut, janë ato që Perëndia ka përgatitur për ata që e duan atë”³⁰. Një varg nga një himn i dashur siguron ngushëllim, lehtësim dhe lente të qartë: “Dhe Jezusi mund t’i dëgjojë këngët që unë nuk mund t’i këndoj”³¹.

Shpëtimtari ka thënë: “Si rrjedhim, zemrat tuaja duhet të ngushëllohen. . . . Rrini të qetë dhe dini se unë jam Perëndi.”³² Ne kemi premtimin e Tij se ne me fëmijët tanë do të këndojmë “këngë gëzimi të përhershëm”³³. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Gjoni 16:33.
2. Shih Mosia 18:8–9; shih edhe 2 Nefi 32:7.
3. Shih Boyd K. Packer, “The Play and the Plan” (Mbrëmje rreth vatrës e Sistemit Arsimor të Kishës për të rinjtë në moshë madhore, 7 maj 1995), f. 3: “Në vdekshmëri, ne jemi si një njeri që hyn në një teatër pikërisht kur perdia ngrihet për aktin e dytë. Ne kemi humbur Aktin e 1-rë . . . dhe të gjithë jetuan të lumtur përgjithmonë nuk është shkruar kurrë në aktin e dytë. Ai rresht i përket aktit të tretë rregull misteret zgjidhen dhe çdo gjë vihet në rregull.” Shih gjithashtu Neal A. Maxwell, *All These Things Shall Give Thee Experience* (1979), f. 37: “Perëndia . . . i sheh edhe fillimin edhe fundin. . . . Aritmetika. . . është



diçka që ne të vdekshmit nuk mund ta kuptojmë. Ne nuk mund të bëjmë shumë sepse ne nuk i kemi të gjithë numrat. Ne kemi ngecur në kohë dhe kufizohemi nga perspektiva e kësaj jete të vdekshme.”

4. Ata që vdesin përpara se të arrijnë moshën e përgjegjshmërisë shpëtohen në mbretërinë celestiale (shih Doktrina e Besëlidhje 137:10). Ata që vdiqën pa ditur për ungjillin dhe do ta kishin pranuar atë, nëse do t’u ishte dhënë mundësia, do të jenë gjithashtu trashëgimtarë të Mbretërisë Celestiale (shih Doktrina e Besëlidhje 137:7). Përveç këtyre, edhe ata të cilët nuk kanë jetuar shumë ndershmërisht do të bekohen në kohën e duhur me një jetë më të mirë se kjo jetë (shih Doktrina e Besëlidhje 76:89).
5. Shih Conway B. Sonne, *A Man Named Alma: The World of Alma Sonne* (1988), f. 83.
6. Shih Sonne, *A Man Named Alma*, f. 84.
7. Veprat e Apostujve 10:34; shih “The Sinking of the World’s Greatest Liner”, *Millennial Star*, 18 prill 1912, f. 250.
8. Shih *Millennial Star*, 18 prill 1912, f. 250.
9. Vëllai Soni është ungj i Plakut L. Tom Peri.
10. Shih Sonne, *A Man Named Alma*, f. 83.
11. Shih Sonne, *A Man Named Alma*, f. 83–84; shih gjithashtu “From the Mission Field”, *Millennial Star*, 18 prill 1912, f. 254: “Lirime dhe Nisje. – Misionarët me emrat e mëposhtëm janë liruar me nderime dhe filluan lundrimin për në shtëpi më 13 prill 1912 me anijen *Mauretania*. Nga Britania e Madhe – Alma Sonne, George B. Chambers, Willard Richards, John R. Sayer, F. A. [Fred] Dahle. Nga Holanda – L. J. Shurtliff.”
12. Shih Zanafilla 44:30–31, 34.
13. Në Frank Millward, “Eight Elders Missed Voyage on Titanic”, *Deseret News*, 24 korrik 2008.
14. Shih “Friend to Friend”, *Friend*, mars 1977, f. 39.

15. Shih David A. Bednar, “The Tender Mercies of the Lord”, *Liahona*, maj 2005, f. 99–102.
16. Shih Doktrina e Besëlidhje 59:21.
17. Shih Alma 36:30.
18. Doktrina e Besëlidhje 42:44.
19. Intervistë me nipin e Irene Korbet-it Donald C. Corbett, 30 tetor 2010, nga Gary H. Cook.
20. Doktrina e Besëlidhje 122:7.
21. Doktrina e Besëlidhje 122:9.
22. Alma 60:13.
23. Shpëtimtari ishte i qartë se “ndodhin skandale; por mjerë ai për faj të të cilit vijnë!” (Lluka 17:1).
24. Seksioni 89 i Doktrinës e Besëlidhjeve – “[Rregulli dhe vullneti i] Perëndisë për shpëtimin e përkohshëm të gjithë shenjtorëve në ditë e fundit” (vargu 2) – i bekon shumë shenjtoret e ditëve të mëvonshme.
25. Shih Doktrina e Besëlidhje 42:22–24.
26. Shih “Will”, *Poetical Works of Ella Wheeler Wilcox* (1917), f. 129.
27. Shih *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* (2004), f. 51–52.
28. Shih “The Song That I Came to Sing”, në *The Complete Poems of Rabrindranath Tagore’s Gitanjali*, botim S. K. Paul (2006), f. 64: “The song that I came to sing remains unsung to this day. / I have spent my days in stringing and in unstringing my instrument.”
29. Thomas Gray, “Elegy Written in a Country Church Yard”, në *The Oxford Book of English Verse*, botim i Christopher Ricks (1999), f. 279.
30. 1 Korintasve 2:9.
31. “There Is Sunshine in My Soul Today”, *Hymns*, nr. 227.
32. Doktrina e Besëlidhje 101:16; shih gjithashtu 46:10.
33. Doktrina e Besëlidhje 101:18; shih gjithashtu Doktrina e Besëlidhje 45:71.



Nga Presidenti Tomas S. Monson

Kur Prapë të Takohemi

Shpirti që ndiem këtu qoftë dhe banoftë me ne ndërsa shkojmë te ato gjëra që na angazhojnë çdo ditë.

Vëllezër dhe motra të mia, unë e di se ju do të bini dakord me mua se kjo ka qenë një konferencë shumë frymëzuese. Ne e kemi ndier Shpirtin e Zotit me bollëk të madh këto dy ditët e fundit ndërsa zemrat tona janë prekur dhe dëshmitë tona të kësaj pune hyjnore janë forcuar. Ne i shprehim falënderime secilit që ka marrë pjesë, përfshirë ata Vëllezër që ofruan lutjet.

Ne të gjithë jemi këtu sepse e duam Zotin dhe dëshirojmë t'i shërbejmë Atij. Unë ju dëshmoj se Ati ynë Qiellor kujtohet për ne. Unë e pohoj dorën e Tij në gjithçka.

Edhe një herë, muzika ka qenë e mrekullueshme dhe unë shpreh mirënjohjen time personale dhe atë të gjithë Kishës për ata që janë të gatshëm të ndajnë me ne talentet e tyre në këtë drejtim.

Ne shprehim mirënjohjen tonë të thellë për ata Vëllezër që janë liruar [nga thirrjet] gjatë kësaj konference. Ata kanë shërbyer me besnikëri e mjaft mirë dhe kanë dhënë shumë kontribut për punën e Zotit.

Unë shpreh vlerësimin e thellë për këshilltarët e mi besnikë e të përkushtuar dhe i falënderoj ata publikisht për mbështetjen dhe ndihmesën që ata më ofrojnë. Ata janë me të vërtetë burra të urtësisë e të mirëkuptimit dhe

shërbimi i tyre është i paçmueshëm.

Falënderoj vëllezërit e mi të Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve për shërbimin e tyre të devotshëm dhe të vazhdueshëm në punën e Zotit. Në të njëjtën mënyrë, unë shpreh mirënjohjen time për anëtarët e Kuorumeve të Të Shtatëdhjetëve dhe Peshkopatës Kryesuese për shërbimin e tyre vetëmohues dhe të dobishëm. Në mënyrë të ngjashme, unë shpreh vlerësimin tim për gratë dhe burrat që shërbejnë si drejtues të përgjithshëm të organizatave ndihmëse.

Vëllezër dhe motra, unë ju siguroj

se Ati ynë Qiellor është i vetëdijshëm për sfidat me të cilat përballemi sot në botë. Ai e do secilin prej nesh dhe do të na bekojë ndërsa përpiqemi të mbajmë urdhërimet e Tij dhe e kërkohet Atë nëpërmjet lutjes.

Sa të bekuar jemi që kemi ungjillin e rivendosur të Jezu Krishtit! Ai ofron përgjigje për pyetjet në lidhje me atë se nga kemi ardhur, përse jemi këtu dhe ku do të shkojmë kur të largohemi nga kjo jetë. Ai i jep jetës tonë kuptim dhe qëllim, dhe shpresë.

Ju falënderoj për shërbimin që me kaq gatishmëri ia jepni njëri-tjetrit. Ne jemi agjentët e Perëndisë këtu në tokë, me një urdhër për të dashur dhe për t'u shërbyer fëmijëve të Tij.

Unë ju falënderoj për gjithçka që bëni në lagjet dhe degët tuaja. Unë shpreh mirënjohjen time për gatishmërinë tuaj për të shërbyer në pozicionet ku ju jeni thirrur, çfarëdo qofshin ato. Çdonjëri është i rëndësishëm në çuarjen përpara të punës së Zotit.

Konferenca tani përfundoi. Ndërsa kthehemi në shtëpitë tona, e bëfshim këtë të sigurt. E gjetshim se gjithçka ka qenë mirë gjatë mungesës tonë.





Nga Xhuli B. Bek,
Presidente e Përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës

Shpirti që ndiem këtu qoftë dhe banoftë me ne ndërsa shkojmë te ato gjëra që na angazhojnë çdo ditë. Tregofshim mirësi më të madhe njëri ndaj tjetrit. U gjetshim gjithmonë duke bërë punën e Zotit.

Bekimet e qiellit qofshin me ju. Shtëpitë tuaja qofshin të mbushura me harmoni dhe dashuri. I ushqefshi vazhdimisht dëshmitë tuaja, që ato të mund të jenë një mbrojtje për ju nga kundërshtari.

Si shërbëtori juaj i përlur, unë dëshiroj me gjithë zemrën time që të bëj vullnetin e Perëndisë dhe që t'i shërbej Atij e t'ju shërbej juve.

Ju dua; unë lutem për ju. Unë do t'ju kërkoj edhe një herë që të më kujtoni mua dhe të gjithë Autoritetet e Përgjithshme në lutjet tuaja. Ne jemi një me ju në çuarjen përpara të kësaj veprë të mrekullueshme. Unë ju dëshmoj se ne jemi të gjithë së bashku në këtë gjë dhe se çdo burrë, grua dhe fëmijë ka një pjesë për të luajtur. Perëndia na dhëntë forcë e aftësi, dhe vendosmëri për ta luajtur mirë pjesën tonë.

Unë ndaj dëshminë time te ju se kjo punë është e vërtetë, se Shpëtimtari ynë jeton dhe se Ai udhëzon e drejton Kishën e Tij këtu mbi tokë. Unë po ju lë pohimin dhe dëshminë time se Perëndia, Ati ynë i Përrjetshëm jeton dhe na do. Ai është me të vërtetë Ati ynë dhe Ai është personal dhe i vërtetë. E dallofshim dhe kuptofshim se sa afër nesh është i gatshëm të vijë Ai, sa larg është i gatshëm të shkojë Ai për të na ndihmuar, se sa shumë na do Ai dhe sa shumë bën Ai dhe është i gatshëm të bëjë për ne.

Ai ju bekoftë. Paqja e Tij e premtuar qoftë me ju tani dhe gjithmonë.

Ju them lamtumirë derisa prapë të takohemi pas gjashtë muajsh dhe e bëj këtë në emrin e Jezu Krishtit, Shpëtimtarit dhe Shëlbuesit tonë, amen. ■

Ajo Ç'Ka Unë Shpresoj se Mbesat e Mia (dhe Nipërit e Mi) do të Kuptojnë rreth Shoqatës së Ndihmës

Që nga dita që ungjilli filloi të rivendosej në këtë periudhë ungjillore, Zoti kishte nevojë për gra besnike për të marrë pjesë si pasuese të Tij.

Është një privilegj t'ju drejtohem juve në këtë mbledhje historike. Është një bekim për ne që të jemi së bashku. Gjatë shërbimit tim si presidente e përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës, unë kam zhvilluar një dashuri të thellë për motrat e Shoqatës së Ndihmës të kësaj Kisha dhe Zoti ka zgjeruar kuptimin tim për mënyrën se si Ai ndihet për ne dhe çfarë pret Ai prej nesh.

E kam titulluar këtë mesazh: "Ajo Ç'Ka Unë Shpresoj se Mbesat e Mia (dhe Nipërit e Mi) do të Kuptojnë rreth Shoqatës së Ndihmës". Mbesat e mia më të mëdha janë duke punuar me vrull për Përparimin Personal dhe po zhvillojnë zakone dhe tipare të drejta

të natyrës femërore. Së shpejti, ato dhe shoqet e tyre do të mbajnë përgjegjësi për këtë motëri të mrekullueshme në mbarë botën.

Unë shpresoj se ajo që do të them në këtë mesazh do t'u japë atyre dhe të gjithave që e dëgjojnë ose lexojnë, një kuptim më të qartë të asaj që Zoti synonte për bijat e Tij, kur u organizua Shoqata e Ndihmës.

Një Model i Lashtë Dishepullimi

Unë shpresoj se mbesat e mia do ta kuptojnë se Shoqata e Ndihmës sot, është organizuar sipas një modeli dishepullimi që ka ekzistuar në Kishën e dikurshme. Kur Shpëtimtari e organizoi Kishën e Tij në kohët e Dhiatës së



Re, “gratë ishin pjesëmarrëse të rëndësishme në shërbesën e [Tij]”¹. Ai vizitoi Martën dhe Marien, dy prej pasueseve të Tij më të devotshme, në shtëpinë e Martës. Ndërsa Marta e dëgjoji Atë dhe i shërbeu Atij sipas zakonisht të kohës së tyre, Ai e ndihmoi atë të kuptonte se ajo mund të bënte më shumë se kaq. Ai i ndihmoi Martën dhe Marien të kuptonin se mund të zgjidhnin “pjesën më të mirë”, që atyre nuk do t’u hiqej.² Kjo vërejtje e ëmbël shërbeu si një ftesë për të marrë pjesë në shërbesën e Zotit. Dhe më vonë në Dhiatën e Re, dëshmia e fortë e Martës për hyjninë e Shpëtimtarit na jep kuptueshmëri për besimin dhe dishepullimin e saj.³

Ndërsa lexojmë më tej në Dhiatën e Re, ne mësojmë se apostujt vazhduan të krijonin Kishën e Zotit. Gjithashtu ne mësojmë rreth grave besnike, dishepullimi i të cilave ndihmoi në rritjen e Kishës. Pali foli për pasueset femra në vende të tilla si Efes⁴ dhe Filipi⁵. Por kur Kisha e vërtetë e Zotit humbi në braktisje, ky model dishepullimi humbi gjithashtu.

Kur Zoti filloi të rivendoste Kishën e Tij me anë të Profetit Jozef Smith, Ai përsëri përfshiu gra në modelin e dishepullimit. Pak muaj pasi Kisha u organizua zyrtarisht, Zoti dha zbuluesë se Ema Smithi do të veçohet si një udhëheqëse dhe mësuese në Kishë dhe si një ndihmëse zyrtare për burrin e saj, Profetin⁶. Në thirrjen e saj për të

ndihmuar Zotin në ndërtimin e mbretërisë së Tij, asaj iu dhanë udhëzime se si të rriste besimin e saj dhe drejtësinë vetjake, si të forconte familjen e shtëpinë e saj dhe si t’u shërbente të tjerëve.

Unë shpresoj se mbesat e mia do ta kuptojnë se që nga dita që ungjilli filloi të rivendosej në këtë periudhë ungjillore, Zoti kishte nevojë për gra besnike për të marrë pjesë si pasuese të Tij.

Vetëm një nga shembujt e kontributit të tyre të jashtëzakonshëm ishte në punën misionare. Rritja e madhe e Kishës së hershme u bë e mundur sepse burra besnikë qenë të gatshëm të linin familjet e tyre për të udhëtuar në vende të panjohura dhe të vuanin mungesën e kushteve të jetesës e vështirësi për të dhënë mësim ungjiljin. Megjithatë, këta burra e kuptuan se misionet e tyre nuk do të ishin bërë të mundura pa besimin e plotë dhe bashkëpjesëmarrjen e grave në jetën e tyre, të cilat mbajtën financiarisht shtëpitë e bizneset dhe siguruan të ardhura për familjet e tyre e misionarët. Motrat u kujdesën gjithashtu për mijëra të kthyer në besim që u mblodhën në komunitetet e tyre. Ato ishin thellësisht të angazhuara në një mënyrë të re jete, duke ndihmuar në ndërtimin e mbretërisë së Zotit e duke marrë pjesë në punën e Tij të shpëtimit.

Të Lidhura me Priftërinë

Unë shpresoj se mbesat e mia do ta kuptojnë se Zoti e frymëzoi Profetin Jozef Smith për t’i organizuar gratë e Kishës “me priftërinë sipas modelit të priftërisë”⁷ dhe për t’i mësuar ato “se si do t’i zotëronin [ato] privilegjet, bekimet dhe dhuratat e Priftërisë”⁸.

Kur Shoqata e Ndhmës u organizua zyrtarisht, Ema Smithi vazhdoi në thirrjen e saj si udhëheqëse. Ajo u emërua si presidente e organizatës, me dy këshilltarë për të shërbyer me të në presidencë. Në vend që të zgjidhej nga vota e popullit, siç ishte e zakonshme në organizatat jashtë Kishës, kjo presidencë u thirr nëpërmjet zbuluesës, e mbështetur nga gratë që ato do të drejtonin dhe veçonin përmes udhëheqësve të priftërisë për të shërbyer në thirrjet e tyre, duke qenë të “thirr[ura] nga Perëndia, me anë të profesisë dhe me anë të vënies së duarve prej atyre që janë në autoritet”⁹. Të qenit e organizuar sipas priftërisë bëri të mundur që presidenca të merrte drejtim nga Zoti dhe profeti i Tij për një punë të veçantë. Organizata e Shoqatës së Ndhmës mundësoi “depon” e Zotit për talentin, kohën dhe pasuritë që do të administroheshin në urtësi dhe rregull.

Gratë, të cilat i përkisnin atij grupi të parë të Shoqatës së Ndhmës e kuptuan se u ishte dhënë autoriteti për të dhënë mësim, për të frymëzuar dhe organizuar motrat si pasuese për të ndihmuar në punën e Zotit për shpëtim. Në mbledhjet e tyre të para motrave iu mësuan qëllimet udhëzuese të Shoqatës së Ndhmës: për të rritur besimin e drejtësinë vetjake, për të forcuar familjen e shtëpinë dhe për të kërkuar e ndihmuar ata në nevojë.

Unë shpresoj se mbesat e mia do ta kuptojnë se organizimi i Shoqatës së Ndhmës ishte një pjesë thelbësore e përgatitjes së shenjtorëve për

privilegjet, bekimet dhe dhuratat që gjenden vetëm në tempull. Presidenti Jozef Filding Smith dha mësim se Shoqata e Ndihmës “është një pjesë jetike e mbretërisë së Perëndisë në tokë” dhe “është e organizuar dhe e drejtuar në mënyrë të tillë që të ndihmojë anëtarët e saj besnike për të fituar jetën e përjetshme në mbretërinë e Atit tonë”¹⁰. Ne mund ta imagjinojmë se si mund t’u jetë dukur motrave, në ato mbledhje të para të Shoqatës së Ndihmës, të ishin në “Dyqanin me Tulla të Kuqe” të Jozef Smithit, përballë kodrës ku po ndërtohej një tempull, ndërsa Profeti i mësonte ato se “duhet të ketë një shoqatë të veçantë, të veçuar nga të gjitha të këqijat e botës, të përzgjedhur, të drejtë dhe të shenjtë”¹¹.

Unë shpresoj që mbesat e mia ta vlerësojnë tempullin siç bënë motrat e para të Shoqatës së Ndihmës, të cilat besuan se bekimet e tempullit ishin shpërblimi më i madh dhe qëllimi kryesor i çdo gruaje shenjtore të ditëve të mëvonshme. Unë shpresoj se, ashtu si motrat e hershme të Shoqatës së Ndihmës, mbesat e mia do të luftojnë çdo ditë për t’u bërë të pjekura mjaftueshëm për të bërë dhe mbajtur besëlidhjet e shenjta të tempullit dhe se, kur të shkojnë në tempull, ato do t’i kushtojnë vëmendje gjithçkaje që thuhet dhe bëhet. Nëpërmjet bekimeve të tempullit ato do të jenë të armatosura me fuqi¹² dhe të bekuara për të marrë “çelësin e ditorisë së Perëndisë”¹³. Me anë të ordinancave të priftërisë të gjendura vetëm në tempull, ato do të bekohen për të përmbushur përgjegjësitë e tyre hyjnore e të përjetshme dhe ato do të premtojnë të jetojnë si pasues të zotuara. Unë jam mirënjohëse që një nga qëllimet kryesore të Zotit në organizimin e Shoqatës së Ndihmës ishte t’u jepte grave përgjegjësinë për të ndihmuar njëra-tjetrën për t’u përgatitur “për bekimet më të mëdha



të priftërisë që gjenden në ordinancat dhe besëlidhjet e tempullit”¹⁴.

Ngushëllimi dhe Ndikimi i një Motërie Mbarëbotërore

Unë shpresoj se mbesat e mia do të arrijnë të kuptojnë ndikimin e rëndësishëm dhe fuqinë e motërisë së mrekullueshme mbarëbotërore të Shoqatës së Ndihmës. Që nga viti 1842, Kisha është përhapur shumë përtej Navusë dhe tani Shoqata e Ndihmës gjendet në 175 vende, ku motrat flasin mbi 80 gjuhë. Çdo javë organizohen lagje e degë të reja dhe motra të reja të Shoqatës së Ndihmës bëhen pjesë e motërisë gjithnjë në zgerim, “të përhapur në të gjitha kontinentet”¹⁵. Kur Shoqata e Ndihmës ishte relativisht e vogël në numër dhe ishte organizuar kryesisht në Juta, udhëheqëset e saj mund të përqendroheshin më shumë në organizimin dhe dishepullimin e tyre në programet sociale të zonës dhe punën e bashkërenduar të shoqatës. Ato zhvilluan punime të përgatitura në kushte shtëpiake dhe kryen projekte për të ndërtuar spitale dhe për të krijuar rezerva me drithëra. Ato përpjekje të hershme të Shoqatës së Ndihmës ndihmuan në krijimin e modeleve të dishepullimit, të cilat tashmë po zbatohen në të gjithë botën. Ndërsa Kisha është zmadhuar, Shoqata e Ndihmës tani është në gjendje të përmbushë qëllimet e saj në secilën lagje dhe

degë, në secilin kunj dhe distrikt, teksa i përshtatet një bote gjithnjë në ndryshim.

Çdo ditë, motrat e Shoqatës së Ndihmës në mbarë botën përjetojnë një seri të tërë sfidash dhe përvojash tokësore. Gratë dhe familjet e tyre sot përjetojnë vetë pritshmëri të parealizuar; sëmundje mendore, fizike dhe shpirtërore; aksidente dhe vdekje. Disa motra vuajnë vetminë dhe zhgënjimin, sepse nuk kanë familjet e tyre dhe të tjera vuajnë nga pasojat e zgjedhjeve të gabuara të bëra nga anëtarët e familjes. Disa kanë përjetuar luftë ose uri apo fatkeqësi natyrore dhe të tjera janë duke mësuar rreth përleshjes me varësitë, papunësinë ose arsimimin e trajnimin e pamjaftueshëm. Të gjitha këto vështirësi kanë aftësinë për të shkatërruar besimin dhe për t’ia shteruar fuqinë individëve dhe familjeve. Një nga qëllimet e Zotit në organizimin e motrave në dishepullim ishte të siguronte ngushëllim, që do t’i ngrinte mbi “gjithçka që pengon gëzimin dhe përparimin e gruas”¹⁶. Në secilën lagje dhe degë, ka një Shoqatë Ndihme me motra, të cilat mund të kërkojnë e të marrin zbulësë dhe të këshillohen me udhëheqësit e priftërisë për të forcuar njëra-tjetrën dhe për të punuar mbi zgjidhjet që janë të zbatueshme në shtëpitë dhe komunitetet e tyre.

Unë shpresoj se mbesat e mia do ta kuptojnë se, me anë të Shoqatës



së Ndhimës, dishepullimi i tyre është zgjeruar dhe se ato mund të angazhohen me të tjerët në llojin e punës madhështore dhe të jashtëzakonshme që Shpëtimtari ka bërë. Lloji i punës që u është kërkuar motrave të kësaj Kise për të bërë në kohën tonë nuk ka qenë asnjëherë shumë modest në qëllim ose i parëndësishëm për Zotin. Nëpërmjet besnikërisë së tyre, ato mund të ndiejnë pëlqimin e Tij dhe mund të bekohen me shoqërimin e Shpirtit të Tij.

Mbesat e mia duhet të dinë gjithashtu se motëria e Shoqatës së Ndhimës mund t'u ofrojë një vend sigurie, strehimi dhe mbrojtjeje.¹⁷ Ndërsa kohët tona bëhen gjithnjë e më të vështira, motrat besnike të Shoqatës së Ndhimës do të bashkohen për të mbrojtur shtëpitë e Sionit nga zërat e çjerrë të botës dhe ndikimi dëmtues e ngacmues i Satanit. Dhe përmes Shoqatës së Ndhimës, ato do të mësohen e do të forcohen dhe pastaj do të mësohen e do të forcohen më tepër, dhe ndikimi i grave të drejta mund të bekojë shumë më tepër fëmijë të Atit tonë.

Një Dishepullim Përkujdesjeje Vigjilente dhe Shërbese

Unë shpresoj se mbesat e mia do ta kuptojnë se vizita mësimore është një shprehje e dishepullimit të tyre dhe një mënyrë domethënëse për të

nderuar besëlidhjet e tyre. Kjo pjesë e dishepullimit tonë mund t'i përngajë ngushtë shërbesës së Shpëtimtarit tonë. Në ditët e para të Shoqatës së Ndhimës, një komitet vizite nga secila lagje mori një detyrë për të vlerësuar nevojat dhe për të mbledhur dhurimet që do t'u shpërndaheshin njerëzve në nevojë. Përgjatë viteve, motrat dhe udhëheqëset e Shoqatës së Ndhimës kanë mësuar hap pas hapi dhe janë përmirësuar në aftësitë e tyre për t'u kujdesur për të tjerët. Ka pasur kohë kur motrat janë përqendruar më shumë në kryerjen e vizitave, dhënien e mësimave dhe lënien e pusullave kur ndalonin nga shtëpitë e motrave të tyre dhe nuk i gjenin në shtëpi. Këto praktika i kanë ndihmuar motrat për të mësuar modelin e përkujdesjes vigjilente. Ashtu si njerëzit në kohën e Moisiut që përqendroheshin në mbajtjen e listave të gjata të rregullave, nganjëherë motrat e Shoqatës së Ndhimës kanë imponuar shumë rregulla të shkruara dhe të pashkruara në veten e tyre, prej dëshirës për të kuptuar se si ta forconin njëra-tjetrën.

Me qaq shumë nevojë për ndihmë dhe shpëtim në jetën e motrave dhe të familjeve të tyre sot, Ati ynë Qiellor ka nevojë që ne të ndjekim një shteg më të lartë dhe për t'i treguar dishepullimin tonë duke u kujdesur çiltërsisht për

fëmijët e Tij. Me këtë qëllim të rëndësishëm në mendje, drejtuesve iu është mësuar të kërkojnë raporte për mirëqenien shpirtërore e materiale të motrave dhe të familjeve të tyre si dhe rreth shërbimit të dhënë.¹⁸ Tani mësueset vizitore kanë përgjegjësinë “ta njohin dhe ta duan çiltërsisht çdo motër, ta ndihmojnë për të forcuar besimin e saj dhe t'i ofrojnë shërbim”¹⁹.

Si pasuese të zotuarra të Shpëtimtarit, ne jemi përmirësuar në aftësinë tonë për të bërë gjërat që Ai do të bënte nëse do ishte këtu. Ne e dimë se për Të është kujdesi ynë që ka rëndësi dhe që kështu ne po përpiqemi të përqendrohemi tek kujdesi ndaj motrave më shumë se sa te plotësimi i listave me gjërat për t'u bërë. Shërbesa e vërtetë matet më shumë me thellësinë e dashurisë tonë hyjnore se sa nga përsosja e statistikave tona. Ne do ta dimë se jemi të suksesshme në shërbesën tonë si mësuese vizitore kur motrat mund të thonë: “Mësuesja ime vizitore më ndihmon të rritem shpirtërisht” dhe “Unë e di se mësuesja ime vizitore kujdeset fort për mua dhe familjen time” dhe “Nëse kam probleme, unë e di se mësuesja ime vizitore do të veprojë pa prituri që ta ftoj më”. Udhëheqëset që e kuptojnë rëndësinë

Itu në Brazil



e shërbesës ndaj të tjerëve, do të këshillohen së bashku për të kërkuar dhe marrë zbuluesë rreth mënyrës se si t'i lartësojnë mësueset vizitore dhe si të organizojnë e kryejnë një shërbesë të frymëzuar.

Përveç kësaj, vizita mësimore është një shtesë e detyrës së peshkopëve për t'u kujdesur për grigjën e Zotit. Peshkopi dhe presidentja e Shoqatës së Ndhimës kanë nevojë për shërbimin e mësueseve të frymëzuara vizitore që t'u japin atyre ndihmë për përmbushjen e përgjegjësive të tyre. Nëpërmjet shërbesës së mësueseve vizitore, një presidente e Shoqatës së Ndhimës mund të jetë në dijeni për mirëqenien e çdo motre në lagje dhe të raportojë rreth mirëqenies së tyre kur të takohet me peshkopin e saj.

Presidenti Tomas S. Monson na ka mësuar se: “Kur kërkojmë me besim pa ngurruar për asgjë për të përmbushur detyrat që na janë caktuar, kur kërkojmë frymëzimin e të Plotfuqishmit në kryerjen e përgjegjësive tona, ndodhin mrekulli”²⁰. Unë shpresoj se mbesat e mia do të marrin pjesë në mrekullitë ndërsa ndihmojnë që vizitat mësimore të bëhen një model dishepullimi që Zoti do ta njohë kur të vijë përsëri.

Përmbushja e Qëllimeve të Shoqatës së Ndhimës

Këto dhe mësimet e tjera të rëndësishme rreth Shoqatës së Ndhimës tani janë në dispozicion të mbesave të mia për t'u studiuar në *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society [Bija në Mbretërinë Time: Historia dhe Puna e Shoqatës së Ndhimës]*. Ky libër përmban një dokument të trashëgimisë së Shoqatës së Ndhimës dhe të grave të kësaj Kishë. Ai do t'i bashkojë motrat nëpër botë dhe do t'i ndihmojë ato të jetojnë në përputhje me qëllimet e Shoqatës së



Ndhimës dhe privilegjet e modelet e të jetuarit si një pasuese. Ai është një dëshmi e rolit qendror të grave në planin e lumturisë së Atit tonë dhe ofron një standard të palëkundur të asaj se çfarë besojmë, çfarë bëjmë dhe çfarë do të mbrojmë. Presidenca e Parë na ka nxitur që ta “studiojmë këtë libër dhe që t'i lejojmë të vërtetat e tij të përjetshme e shembujt e tij frymëzues që të ndikojnë në jetën [tonë]”²¹.

Duke ditur se organizata e Shoqatës së Ndhimës u krijua hyjnisht, Presidenti Jozef F. Smith u tha motrave të Shoqatës së Ndhimës: “Ju duhet ta drejtoni botën dhe veçanërisht të drejtoni gratë e botës. . . . Ju duhet ta drejtoni”, tha ai, “jo ta ndiqni botën.”²² Ndërsa koha e rikthimit të Zotit afrohet, unë shpresoj se mbesat e mia do të bëhen gra të forta dhe besnike që do t'i zbatojnë parimet dhe modelet e Shoqatës së Ndhimës në jetën e tyre. Ndërsa Shoqata e Ndhimës bëhet një mënyrë jetese për to, unë shpresoj se ato do të shërbejnë të bashkuara me të tjerat për të përmbushur qëllimet e saj hyjnore. Unë kam një dëshmi për Kishën e vërtetë të rivendosur të Jezu Krishtit dhe jam mirënjohëse për modelin e dishepullimit që u rivendos kur Zoti frymëzoi Profetin Jozef Smith për

të organizuar Shoqatën e Ndhimës. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society* (2011), f. 3.
2. Shih Lluca 10:38–42.
3. Shih Gjoni 11:20–27.
4. Shih Veprat e Apostujve 18:24–26; Romakëve 16:3–5.
5. Shih Filipianëve 4:1–4.
6. Shih Doktrina e Besëlidhje 25.
7. Joseph Smith, në *Daughters in My Kingdom*, f. 12.
8. Joseph Smith, në *History of the Church*, 4:602.
9. Nenet e Besimit 1:5.
10. Joseph Fielding Smith, në *Daughters in My Kingdom*, f. 97.
11. Joseph Smith, në *Daughters in My Kingdom*, f. 15.
12. Shih Doktrina e Besëlidhje 109:22; shih edhe Sheri L. Dew, në *Daughters in My Kingdom*, f. 128.
13. Doktrina e Besëlidhje 84:19; shih edhe Ezra Taft Benson, në *Daughters in My Kingdom*, f. 129.
14. *Daughters in My Kingdom*, f. 131.
15. Boyd K. Packer, në *Daughters in My Kingdom*, f. 99.
16. John A. Widtsoe, në *Daughters in My Kingdom*, f. 25.
17. Shih *Daughters in My Kingdom*, f. 86–87.
18. Shih *Handbook 2: Administering the Church* (2010), 9.5.4.
19. *Handbook 2*, 9.5.1.
20. Tomas S. Monson, në *Daughters in My Kingdom*, f. 91.
21. First Presidency, në *Daughters in My Kingdom*, f. ix.
22. Joseph F. Smith, në *Daughters in My Kingdom*, f. 66.



Nga Silvia H. Ollred,
Këshilltare e Parë në Presidencën e Përgjithshme
të Shoqatës së Ndihmës

Dashuria Hyjnore Nuk Ligështohet Kurrë

Lutuni për të pasur dëshirë që të mbusheni me dhuratën e dashurisë hyjnore, dashurinë e pastër të Krishtit.

Bashkëshorti im dhe unë, kemi vizituar së fundmi qytetin e Navusë në Illinois. Kur ishim atje, ne u ulëm në dhomën e sipërme të Red Brick Store-it [Dyqanit me Tulla të Kuqe], atje ku Profeti Jozef Smith kishte një zyrë dhe një biznes. Ne dëgjuaam me vëmendje udhërrëfyesen e cila nënvizoi disa nga ngjarjet historike të Rivendosjes që ndodhën atje.

Unë mendova për krijimin e Shoqatës së Ndihmës dhe për disa nga mësimet që morën motrat e Shoqatës së Ndihmës nga Profeti Jozef po në atë dhomë. Këto mësimet u bënë parimet themeluese mbi të cilat u ngrit Shoqata e Ndihmës. Qëllimet e rritjes së besimit, forcimit të shtëpive të Sionit dhe kërkimi si dhe ndihma ndaj njerëzve në nevojë u vendosën që nga fillimi. Ato kanë qenë gjithmonë në përputhje me mësimet e profetëve tanë.

Në një prej atyre mbledhjeve të fillimit, Profeti Jozef citoi pjesë nga shkrimet e Palit drejtuar korintasve. Në ligjëratën e tij të fuqishme mbi dashurinë hyjnore, Pali i referohet besimit, shpresës dhe dashurisë hyjnore duke e përfunduar me “por më e madhja nga këto është dashuria”¹.

Ai përshkruan cilësitë e mëshiruara të dashuria hyjnore. Ai tha:

“Dashuria është e durueshme; plot mirësi; dashuria nuk ka smirë, nuk vë në dukje, nuk krekoset,

. . . nuk kërkon të sajat, nuk pezmatohet, nuk dyshon për keq;

nuk gëzohet për padrejtësinë, por gëzohet me të vërtetën;

i duron të gjitha, i beson të gjitha, i shpreson të gjitha, i mban çdo gjë.

Dashuria nuk ligështohet kurrë”².

Duke iu drejtuar motrave, Profeti Jozef tha: “Mos u kufizoni në pikëpamjet tuaja lidhur me virtytet e të afërmeve tuaj. . . . Ju duhet ta zgjeroni shpirtin tuaj përkundrejt të tjerëve nëse ju [do të] vepronit si Jezusi. . . . Ndërsa rriteni në pafajësi dhe virtyt, ndërsa rriteni në mirësi, le të gufohen zemrat tuaja, le të rriten ato kundrejt të tjerëve; ju duhet të jeni të durueshme dhe të duroni të metat e gabimet e njerëzimit. Sa të çmuar janë shpirtat e njerëzve!”³

Shpallja e shkrimit të shenjtë “Dashuria hyjnore nuk ligështohet kurrë” u bë motoja e Shoqatës së Ndihmës pasi ajo përmban këto mësimet dhe përgjegjësinë që Profeti Jozef Smith u dha motrave të Shoqatës së Ndihmës për të “lehtësuar të

varfrin” e për të “shpëtuar shpirta”⁴.

Këto parime themelore janë pranuar nga motrat e Shoqatës së Ndihmës në mbarë botën, pasi e tillë është natyra e punës së Shoqatës së Ndihmës.

Çfarë është dashuria hyjnore? Si e fitojmë ne dashurinë hyjnore?

Profeti Mormoni e përkufizon dashurinë hyjnore si “dashuri[në] e pastër të Krishtit”⁵, ndërsa Pali jep mësim se “dashuria hyjnore . . . është lidhja e përsosmërisë”⁶ dhe Nefi na kujton se “Zoti Perëndi ka dhënë urdhër, që të gjithë njerëzit duhet të kenë mirëdashje, mirëdashje e cila është dashuri”⁷.

Gjatë rishikimit të përshkrimit të mëparshëm të Palit për dashurinë hyjnore, ne mësojmë se dashuria hyjnore nuk është veç një veprim i vetëm ose diçka që ne e japim, por një gjendje e të qenit, një gjendje e zemrës, ndjenja mirëdashëse që shkaktojnë vepra dashurie.

Mormoni gjithashtu, jep mësim se dashuria hyjnore u jepet dishepujve të vërtetë të Zotit dhe se dashuria hyjnore i pastron ata që e kanë atë.⁸ Përveç kësaj, ne mësojmë se dashuria hyjnore është një dhuratë qiellore të cilën duhet ta kërkojmë dhe për të cilën duhet të lutemi. Ne duhet të kemi dashuri hyjnore në zemrat tona në mënyrë që të trashëgojmë mbretërinë çelestiale.⁹

Duke ditur se Zoti na ka kërkuar të “vesh[im] [veten tonë] me lidhjen e dashurisë hyjnore”¹⁰, ne duhet të kërkojmë se cilat cilësi do të na ndihmojnë ta zhvillojmë dashurinë hyjnore.

Ne së pari duhet të kemi dëshirën për t’u rritur në dashuri hyjnore dhe për t’u bërë më shumë si Krishti.

Hapi pasues është të lutemi. Mormoni na këshillon t’i “lutemi Atit me gjithë fuqinë e zemrës sonë, që [ne] të mund të mbushemi me këtë dashuri”. Kjo dashuri e perëndishme është dashuria hyjnore dhe kur ne mbushemi

me këtë dashuri, “ne do të jemi si Ai”¹¹.

Leximi i përditshëm i shkrimeve të shenjta mund ta çojë mendjen tonë te Shpëtimtari dhe te një dëshirë për të qenë më shumë si Ai.

Në zyrën time, unë vendosa të varja një pikturë nga Minerva Taihert [Minerva Teichert] të quajtur *Rescue of the Lost Lamb [Shpëtimi i Qengjit të Humbur]*. Ajo paraqet Shpëtimtarin duke qëndruar mes deleve të Tij dhe duke mbajtur me dhimbsuri një qengj të vogël në krahët e Tij. Ajo më ndihmon mua të reflektoj mbi përgjërimitin e Tij: “Kulloti delet e mia”¹², që për mua do të thotë t’u shërbesh atyre që të rrethojnë dhe t’u japësh vëmendje të veçantë atyre që janë në nevojë.

Shpëtimtari është shembulli i përsosur i mënyrës se si ta shprehim dashurinë hyjnore. Gjatë shërbesës së Tij tokësore, Ai tregoi mëshirë për të uriturin, për mëkatarin, për të pikëlluarin dhe për të sëmurin. Ai u shërbeu të varfërve dhe të pasurve; grave, fëmijëve e burrave, familjes së tij, miqve dhe të panjohurve. Ai i fali akuzuesit e Tij dhe vuajti e vdiq për të gjithë njerëzimin.

Gjatë gjithë jetës së tij, Profeti Jozef Smith gjithashtu, e vuri në zbatim dashurinë hyjnore ndërsa tregonte dashuri vëllazërore dhe respekt për të tjerët. Ai shquhej për mirësjelljen, dashurinë, mëshirën dhe shqetësimin e tij për ata që e rrethonin.

Itu në Brazil



Sot, ne jemi të bekur që kemi një profet që është shembull i dashurisë hyjnore. Presidenti Tomas S. Monson është një shembull për ne dhe për botën. Ai vesh mantelin e dashurisë hyjnore. Ai është i sjellshëm, i mëshirshëm dhe bujar; një shërbestar i vërtetë i Zotit Jezu Krisht.

Presidenti Monson jep mësim: “Dashuria hyjnore është të kemi durim me dikë që na ka lënë në baltë. Ajo do të thotë t’i rezistosh nxitjes për t’u fyer me lehtësi. Ajo është të pranosh dobësitë dhe mangësitë. Ajo është t’i pranosh njerëzit ashtu siç janë në të vërtetë. Ajo është të shohësh përtej dukjes fizike për tek cilësitë që nuk do të zbehen me kalimin e kohës. Ajo do të thotë t’i rezistosh nxitjes për t’i gjykuar të tjerët.”¹³

Kur kemi dashuri hyjnore, ne jemi të gatshëm t’u shërbejmë dhe t’u japim ndihmë të tjerëve kur nuk është e vulltshme dhe pa prituri vlerësim ose diçka në këmbim. Ne nuk presim që të caktohem për të dhënë ndihmë pasi dashuria hyjnore bën që ne ta kemi atë në natyrë. Kur ne zgjedhim të jemi të sjellshëm, dashamirës, bujarë, të duruar, pranues, falës, gjithëpërfshirës dhe vetëmohues, ne zbulojmë se jemi mbushur me dashuri hyjnore.

Shoqata e Ndhmës siguron mënyra të panumërta për t’u shërbyer të tjerëve. Një nga mënyrat më të rëndësishme për ta vënë në zbatim dashurinë hyjnore është nëpërmjet vizitave mësimore. Nëpërmjet vizitave të efektshme mësimore, ne kemi shumë mundësira për të dhënë dashuri, për t’u dhënë ndihmë e për t’u shërbyer të

tjerëve. Shprehja e dashurisë hyjnore ose dashurisë, pastron dhe shenjtëron shpirtrat tanë duke na ndihmuar të bëhemi më shumë si Shpëtimtari.

Unë mahnitëm teksa dëshmoj veprat e panumërta të dashurisë hyjnore që kryhen çdo ditë nga mësueset vizitore në mbarë botën, që në mënyrë vetëmohuese, u përgjigjen nevojave të secilës motër dhe familjeve të tyre. Këtyre mësueseve vizitore besnike unë u them: “Nëpërmjet këtyre veprave të vogla të dashurisë hyjnore, ju ndiqni Shpëtimtarin dhe veproni si mjete në duart e Tij kur ndihmoni, kujdeseni, lartësoni, ngushëlloni, dëgjoni, nxisni, ushqeni, mësoni dhe forconi motrat që janë nën kujdesin tuaj”. Më lejoni të tregoj disa shembuj të një shërbese të tillë.

Roza vuan nga diabeti degradues dhe nga sëmundje të tjera. Ajo u bashkua me Kishën pak vite më parë. Ajo është një nënë beqare me një djalë adoleshent. Asaj i duhet të shtrohet në spital vazhdimisht për disa ditë çdo herë. Mësueset e saj të mira vizitore, jo vetëm që e çojnë atë në spital, por ato e vizitojnë dhe e ngushëllojnë atë në spital ndërkohë që kujdesen edhe për djalin e saj në shtëpi dhe në shkollë. Mësueset e saj vizitore janë miket dhe familja e saj.

Pas vizitave të para te një motër e veçantë, Kethi zbuloi se kjo motër nuk dinte të lexonte, por dëshironte të mësonte. Kethi doli vullnetare për ta ndihmuar atë megjithëse e dinte që kjo do të kërkonte kohë, durim dhe vendosmëri.

Emilia është një bashkëshorte e



re, që është në kërkim të së vërtetës. Bashkëshorti i saj, Majkëlli, ishte më pak i interesuar për fenë. Kur Emilia u sëmur dhe kaloi pak kohë në spital, Keli, një motër e Shoqatës së Ndihmës që është edhe fqinja e saj, i çoi familjes vakte ushqimore, u kujdes për foshnjën e tyre, pastroi shtëpinë dhe organizoi gjërat që Emilia të merrte një bekim priftërie. Këto vepra dashurie hyjnore e zbutën zemrën e Majkëllit. Ai vendosi të frekuentonte mbledhjet e Kishës dhe të takohej me misionarët. Emilia dhe Majkëlli kanë pak kohë që janë pagëzuar.

“Dashuria nuk ligshohet kurrë. Dashuria hyjnore . . . është e mirë, . . . nuk kërkon të sajat, . . . i duron të gjitha, i mban çdo gjë.”¹⁴

Presidenti Henri B. Ajring tha:

“Historia e Shoqatës së Ndihmës është e mbushur me përshkrime të një shërbese të tillë të shquar vetëmohuese. . . .

Kjo shoqatë përbëhet nga gra, ndjenjat e dashurisë hyjnore të të cilave, burojnë nga zemra të ndryshuara nëpërmjet cilësimit për besëlidhjet dhe mbajtjes së besëlidhjeve të ofruara vetëm në Kishën e vërtetë të Zotit. Ndjenjat e tyre të dashurisë hyjnore vijnë nga Ai, nëpërmjet Shlyerjes së Tij. Veprat e tyre të dashurisë hyjnore drejtohen nga shembulli i Tij – dhe vijnë si rezultat i mirënjohjes për dhuratën e Tij të pafundme të mëshirës – dhe nga Shpirti i Shenjtë, të cilin Ai e dërgon

për t'i bërë shoqëri shërbëtorëve të Tij në misionet e tyre të mëshirës. Për pasojë, ato kanë bërë dhe janë në gjendje të bëjnë gjëra të pazakonshme për të tjerët dhe të gjejnë gëzim edhe kur nevojat e tyre të papërbushura janë të mëdha.”¹⁵

Sigurimi i shërbimit dhe dhënia e dashurisë hyjnore ndaj të tjerëve na ndihmon të kapërcejmë vetë vështirësitë tona dhe i bën ato të duken më pak sfiduese.

Unë tani u kthehem mësimëve që Profeti Jozef Smith u dha motrave në ditët e fillimit të Rivendosjes. Duke nxitur zbatimin e dashurisë hyjnore dhe dashamirësisë, ai tha: “Nëse jetoni denjësisht sipas këtyre parimeve, sa i shkëlqyer e i lavdishëm do të jetë shpërblimi juaj në mbretërinë çelestiale! “Nëse shkoni baras me privilegjet tuaja, engjëjt nuk do të ngurrojnë të bëhen shoqëruesit tuaj.”¹⁶

Njësoj si në ditët e fillimit në Navu ku motrat shkuan andej-këtej duke kërkuar dhe ndihmuar njerëzit në nevojë, kështu është edhe sot. Motrat në mbretëri janë një mbështetje e madhe e themeleve të forcës shpirtërore, shërbimit të dhembshur dhe përkushtimit. Mësueset vizitore të përkushtuara e vizitojnë dhe kujdesen për njëra-tjetrën. Ato ndjekin shembullin e Shpëtimtarit dhe veprojnë siç veproi Ai.

Të gjitha gratë në Shoqatën e Ndihmës mund të mbushen me dashuri

duke e ditur se veprat e tyre të vogla të dashurisë hyjnore kanë një fuqi shëruese mbi të tjerët dhe mbi veten e tyre. Ato arrijnë ta dinë me siguri se dashuria hyjnore është dashuria e pastër e Krishtit dhe nuk dështon kurrë.

Kur ju të lexoni historinë e Shoqatës së Ndihmës, ajo do t'ju ndihmojë të zbuloni se ky parim i rëndësishëm i ungjillit është temë e përsëritur nëpër të gjithë librin.

Unë e përfundoj me një ftesë për të gjitha gratë në Kishë që të luten për të pasur dëshirë që të mbushen me dhuratën e dashurisë hyjnore, dashurisë së pastër të Krishtit. Përdorini të gjitha rezervat tuaja për të bërë mirë, për të sjellë lehtësim dhe shpëtim ndaj atyre që ju rrethojnë, duke përfshirë edhe vetë familjen tuaj. Zoti do t'i shpërblejë përpjekjet tuaja me sukses.

Na nxittë njohuria jonë për dashurinë e madhe që Ati dhe Biri kanë për ne dhe besimi e mirënjohja për Shlyerjen, që ta zhvillojmë dhe ta ushtrojmë dashurinë hyjnore ndaj të gjithë atyre që na rrethojnë. Kjo është lutja ime, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

- 1 Korintasve 13:13.
- 1 Korintasve 13:4–8.
- Joseph Smith, në *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society* (2011) f. 23.
- Joseph Smith, në *Daughters in My Kingdom*, f. 17.
- Moroni 7:47.
- Kolosianëve 3:14.
- 2 Nefi 26:30.
- Shih Moroni 7:48.
- Shih Ethëri 12:34; Moroni 10:21.
- Doktrina e Besëlidhje 88:125.
- Moroni 7:48.
- Shih Gjoni 21:16–17.
- Tomas S. Monson, “Dashuria Nuk Ligshohet Kurrë”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 124.
- 1 Korintasve 13:4, 5, 7, 8.
- Henri B. Ajring, “Trashëgimia e Qëndrueshme e Shoqatës së Ndihmës”, *Liahona*, nëntor 2009, f. 121.
- Teachings of Presidents of the Church: Joseph Smith* (2007), f. 454.



Nga Barbara Tompson,

Këshilltare e Dytë në Presidencën
e Përgjithshme të Shoqatës së Ndhmës

Qëndrojuni Besnike Besëlidhjeve

Ndërsa ne kemi besim në Krisht dhe u qëndrojmë besnike besëlidhjeve tona, ne do të marrim gëzimin për të cilin flitet në shkrimet e shenjta dhe që premtohet nga profetët tanë të ditëve të mëvonshme.

Prandaj, gëzohu në zemrën tënde e ngazëllehu dhe kapu pas besëlidhjeve që ke bërë¹. Unë nuk mund ta lexoj këtë shkrim të shenjtë pa ndier gëzim. Zemra ime gëzohet ndërsa mendoj për premtimet dhe bekimet e shumta që kanë qenë pjesë e jetës sime kur unë kam kërkuar të qëndroj besnike ndaj besëlidhjeve që kam bërë me Atin tim Qiellor.

Duke qenë se të dy prindërit e mi kanë ndërruar jetë, u bë e nevojshme këtë vit që të pastroja shtëpinë e tyre dhe ta bëja gati për t'u shitur. Gjatë këtyre muajve të kaluar, ndërsa vëllezërit e motrat e mia dhe unë kemi pastruar dhe vënë në rregull shtëpinë e prindërve të mi, ne gjetëm tregime familjare dhe shumë letra e dokumente të rëndësishme. Ka qenë magjepsëse të lexoje nga historitë vetjake dhe bekimet patriarkale të prindërve dhe gjyshërve të mi. Unë u kujtova për besëlidhjet që ata bënë dhe mbajtën.

Gjyshja ime Elen Henks Rajmer ishte një nënë e re në vitin 1912, kur ajo mori bekimin e saj patriarkal. Ndërsa lexova bekimin e saj, këto rreshta

lanë mbresa tek unë dhe qëndruan në mendjen time: "Ti je zgjedhur që përpara krijimit të tokës dhe je një shpirt i zgjedhur për të ardhur në këtë ditë. . . . Dëshmia jote do të lartësohet dhe ti do të jesh në gjendje të dëshmosh. . . . Shkatërruesi ka kërkuar të të shkatërrojë ty, por nëse ti do t'i qëndrosh besnike Perëndisë, ai [Shkatërruesi] nuk do të ketë fuqi të të dëmtojë ty. Përmes besnikërisë sate ti do të kesh fuqi të madhe dhe shkatërruesi do të zhduket përpara teje për shkak të drejtësisë sate. . . . Kur të vijë mbi ty ora e frikës dhe e sprovave, nëse ti do të shkosh në dollapin tënd të fshehtë në lutje, zemra jote do të ngushëllohet dhe pengesat do të hiqen."²

Gjyshes sime iu premtua se nëse ajo do t'i mbante besëlidhjet e saj dhe do të qëndronte pranë Perëndisë, Satani nuk do të kishte fuqi mbi të. Ajo do të gjente ngushëllim dhe ndihmë në sprovat e saj. Këto premtime u përmbushën në jetën e saj.

Sot, unë dëshiroj të flas rreth 1) rëndësisë së të qëndruarit besnike ndaj besëlidhjeve dhe 2) gëzimit dhe

mbrojtjes që vijnë nga mbajtja e besëlidhjeve.

Disa nga shembujt që unë do të përdor vijnë nga libri *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society [Bija në Mbretërinë Time: Historia dhe Puna e Shoqatës së Ndhmës]*. Libri është i mbushur me shembuj të grave që kanë gjetur gëzim të madh në mbajtjen e besëlidhjeve.

Rëndësia e Të Qëndruarit Besnike ndaj Besëlidhjeve

Fjalori Biblik na thotë se një besëlidhje është një marrëveshje e bërë mes Perëndisë dhe njeriut. "Perëndia sipas dëshirës së tij të mirë, vendos kushtet të cilat njeriu i pranon. . . . Ungjilli është i organizuar në mënyrë të tillë që parimet dhe ordinancat të merren nëpërmjet besëlidhjes duke e vendosur atë që bën besëlidhje nën një detyrim dhe përgjegjësi të fortë për ta respektuar zotimin."³ Në frazën "qëndrojuni besnikë besëlidhjeve", fjalët *qëndrojuni besnikë* nënkuptojnë "t'i përmbahesh vendosmërisht dhe në mënyrë të ngushtë" diçkaje.⁴

Në shkrimet e shenjta ne mësojmë rreth burrave dhe grave që kanë bërë besëlidhje me Perëndinë. Perëndia ka dhënë udhëzime se çfarë duhej bërë për t'i respektuar ato besëlidhje dhe pasi ato besëlidhje u mbajtën, erdhën bekimet e premtuara.

Për shembull, nëpërmjet ordinancës së pagëzimit, ne bëjmë një besëlidhje me Atin tonë Qiellor. Ne përgatitim veten për pagëzim duke pasur besim në Zotin Jezu Krisht, duke u penduar për mëkatet tona dhe duke qenë të gatshëm të marrim mbi vete emrin e Krishtit. Ne bëjmë një zotim që të mbajmë urdhërimet e Perëndisë dhe ta kujtojmë gjithmonë Shpëtimtarin. Ne besëlidhim që të "[mbajmë] barrat e njëri-tjetrit, që ato të mund të jenë të lehta". Ne tregojmë se jemi të gatshëm



të vajtojmë me ata që vajtojnë dhe të ngushëllojmë ata që kanë nevojë të ngushëllohen.⁵

Në tempujt e shenjtë, merren ordianca të tjera të shenjta dhe bëhen të tjera besëlidhje. Në ditët e hershme të Rivendosjes, Profeti Jozef Smith, mezi priste që shenjtoret të kishin bekimet e premtuara të tempullit. Zoti tha: “Kjo shtëpi duhet të ndërtohet për emrin tim, që unë të mund t’ia zbuloj ordiancat e mia popullit në të.”⁶

“Një nga qëllimet e Zotit në organizimin e Shoqatës së Ndihmës, ishte që të përgatiste bijat e Tij për bekimet më të mëdha të priftërisë që gjenden në ordiancat dhe besëlidhjet e tempullit. Motrat në Navu e përshpejtuan përfundimin e tempullit me entuziazëm të madh, pasi ato e dinin, siç i premtoi Profeti Jozef Smith Mërsi Fillding Tompsonit, se indaumenti do t’i nxirrte ato ‘jashtë errësirës për te një dritë e mrekullueshme’.”⁷

“Mbi 5.000 shenjtore u mblodhën në Tempullin e Navusë pas dedikimit të tij, që të mund të merrnin indaumentin dhe ordiancën e vulosjes përpara se të nisnin udhëtimin e tyre” për në Luginën e Solt-Lejcut⁸. Presidenti Brigam Jang dhe shumë udhëheqës të Kishës e punonjës të tempullit shpenzuan kohën e tyre, ditë e natë duke shërbyer në tempull në mënyrë që kjo punë e rëndësishme të mund të kryhej për shenjtoret.

Besëlidhjet tona na mbajnë ne fort qoftë në kohë të mira qoftë në kohë

të vështira. Presidenti Bojd K. Paker na kujton se “ne jemi një popull i besëlidhjes. Ne besëlidhim që të japim nga burimet tona në kohë, para dhe talente – gjithçka jemi dhe gjithçka kemi – për të mirën e mbretërisë së Perëndisë mbi tokë. Me fjalë të thjeshta, ne besëlidhim që të bëjmë mirë. Ne jemi një popull i besëlidhjes dhe tempulli është qendra e besëlidhjeve tona. Ai është origjina e besëlidhjes.”⁹

Shkrimet e shenjta na kujtojnë: “Dhe kjo do të jetë besëlidhja jonë – që ne do të ecim në të gjitha ordiancat e Zotit”¹⁰.

Ne marrim bekime të mëdha kur qëndrojmë besnike ndaj besëlidhjeve tona.

Gëzim dhe Mbrojtje Vijnë nga Mbajtja e Besëlidhjeve Tona

Në Librin e Mormonit ne lexojmë për fjalimin e mbretit Benjamin. Ai u mësoi njerëzve për Jezu Krishtin, që Ai do të vinte në tokë dhe do të vuante të gjitha llojet e vuajtjeve. Ai u mësoi njerëzve se Krishti do të shlyente për mëkatet e të gjithë njerëzimit dhe se emri i Tij do të ishte i vetmi emër nëpërmjet të cilit njeriu mund të shpëtohej.¹¹

Pasi i dëgjuan këto mësimet të mrekullueshme, njerëzit u përlulën dhe dëshiruan me gjithë zemër që të ishin të lirë nga mëkati dhe të pastroheshin. Ata u penduan dhe e shpallën besimin e tyre në Jezu Krisht. Ata bënë besëlidhje me Perëndinë që ata do t’i mbanin urdhërimet e Tij.¹²

“Shpirti i Zotit erdhi mbi ta dhe ata u mbushën me gëzim, pasi kishin marrë një heqje të mëkateve të tyre dhe pasi kishin paqe të ndërgjegjes, për shkak të besimit të jashtëzakonshëm që ata kishin në Jezu Krishtin.”¹³

Një shembull tjetër i gëzimit që vjen nga besnikëria në mbajtjen e urdhërimeve të Perëndisë dhe ndarjes së ungjillit të Tij me të tjerët, tregohet nga Amoni. Amoni dhe vëllezërit e tij qenë mjete për të ndihmuar mijëra njerëz të vinin tek Krishti. Ka disa fjalë që Amoni i përdori për të përshkruar ndjenjat e tij kur kaq shumë njerëz u pagëzuan dhe bënë besëlidhje me Perëndinë:

“Çarsye të madhe kemi për t’u gëzuar.”¹⁴

“Gëzimi im është i plotë, po, zemra ime është plot e përplot me gëzim dhe unë do të ngazëllem në Perëndinë tim.”¹⁵

“Unë nuk mund të tregoj as pjesën më të vogël të asaj që ndiej.”¹⁶

“Nuk pati kurrë njerëz që të kishin shkak kaq të madh të gëzoheshin sa ne.”¹⁷

Kryerja dhe mbajtja e besëlidhjeve të shenjta na bën të mundur që të kemi Shpirtin e Shenjtë me ne. Ky është Shpirti që “e mbush shpirtin tuaj me gëzim”¹⁸.

Lufta II Botërore shkaktoi shumë vuajtje për shumë njerëz anekënd botës. Shenjtoret në Gjermani duruan shumë sprova. Në Gjermani, ishte një presidente besnike e Shoqatës së Ndihmës, motra Maria Shpajdel. Duke folur për sprovat e saj, ajo tha: “Mirëbesimi ynë te Zoti dhe dëshmia jonë për Kishën e Tij kanë qenë shtylla jonë e forcës. . . . Me gëzim ne këndojmë këngët e Sionit dhe e vendosim mirëbesimin tonë te Zoti. Ai e bën gjithçka mirë.”¹⁹

Sërish, kur anëtarët i mbajtën besëlidhjet e tyre, ata ndien gëzim madje

edhe përpara sfidave të llahtarshme.

Sara Riç ishte një grua e drejtë që jetonte në Navu, e cila u thirr për të shërbyer në tempull përpara se të dëboheshin shenjtoret nga qyteti. Këto janë fjalët e saj për bekimet e besëlidhjeve të tempullit: “Ne kemi marrë shumë bekime në shtëpinë e Zotit, që na kanë sjellë gëzim dhe ngushëllim në mes të të gjitha hidhërimeve tona dhe bënë të mundur që ne të kemi besim në Perëndi, duke e ditur se Ai do të na drejtonte dhe do të na mbështeste ne në rrugëtimin e panjohur që shtrihej përpara nesh”²⁰.

Më parë, shenjtoret kishin përfunduar Tempullin e Kirtlandit dhe shumë morën pjesë në dedikim. Pas dedikimit, tempulli u pranua nga Zoti. Zoti u tha atyre të “gëzohen së tepërmi si pasojë e bekimeve që do të derdhen . . . mbi kokat e popullit të [Tij]”²¹.

Ndërkohë që sa vjen e më shumë tempuj po ndërtohen në tokë, unë kam parë bekimet që vijnë në jetën e anëtarëve. Në vitin 2008, unë isha dëshmitare e gëzimit të fytyrave të një çifti nga Ukraina ndërsa ata më tregonin rreth udhëtimit të tyre për në Frajberg të Gjermanisë për të marrë ordinancat e tyre të tempullit. Udhëtimi për në tempull zgjaste 27 orë me autobus në secilin drejtim për këta anëtarë të përkushtuar dhe ata nuk kishin mundësi të shkonin shpesh. Ata ishin të emocionuar që Tempulli i Kievit në Ukrainë do të përfundonte së shpejti dhe ata do të mund ta frekuentonin më shpesh. Ai tempull tashmë është hapur dhe mijëra vetë gëzojnë bekimet atje.

Duke lexuar nga historia vetjake e gjyshes sime, unë mësova rreth gëzimit të saj të madh prej besëlidhjeve të saj. Asaj i pëlqente shumë të shkonte në tempull dhe të kryente ordinancat për mijëra prej atyre që kishin vdekur. Ai ishte misioni i jetës së saj. Ajo



shërbeu si punonjëse tempulli për mbi 20 vjet në Tempullin e Mantisë në Juta. Ajo shkroi se kishte përjetuar shumë shërime të mrekullueshme në mënyrë që të rriste fëmijët e saj dhe t'u shërbente të tjerëve duke bërë punën e tyre në tempull. Duke qenë nipërit dhe mbesat e saj, nëse ne dinim diçka për Gjyshe Rajmerin, kjo ishte që ajo qe një grua e drejtë që i mbajti besëlidhjet e saj dhe dëshironte që ne të bënim të njëjtën gjë. Kur njerëzit të kontrollojnë zotërimet tona pasi ne të kemi vdekur, a do të gjejnë ata fakte që ne i kemi mbajtur besëlidhjet tona?

Profeti ynë i dashur, Presidenti Tomas S. Monson, na tha në konferencën e fundit të përgjithshme: “Kur ju dhe unë shkojmë në shtëpitë e shenjta të Perëndisë, kur ne kujtojmë besëlidhjet që bëjmë së brendshmi, ne do të jemi më shumë në gjendje që të durojmë çdo sprovë dhe të mposhtim çdo tundim. Në këtë faltore të shenjtë ne do të gëjmë paqe; ne do të përtërihemi dhe do të forcohemi.”²²

Edhe njëherë: “Prandaj, gëzohu në zemrën tënde e ngazëllehu dhe kapu pas besëlidhjeve që ke bërë”²³. Mbajtja e besëlidhjeve është gëzim dhe lumturi e vërtetë. Ky është ngushëllimi dhe paqja. Kjo është mbrojtja nga ligësitë e botës. Mbajtja e besëlidhjeve tona do të na ndihmojë në kohë sprovash.

Unë dëshmoj se ndërsa ne kemi besim në Krisht dhe u qëndrojmë

besnike besëlidhjeve tona, ne do të marrim gëzimin për të cilin flitet në shkrimet e shenjta dhe që premtohet nga profetët tanë të ditëve të mëvonshme.

Motra të dashura, unë ju dua dhe shpresoj se ju do ta përjetoni këtë gëzim të madh në jetën tuaj. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 25:13.
2. Bekimi patriarkal dhënë nga Walter E. Hanks, 25 tetor 1912 në Lyman, Wayne, County, Utah.
3. Bible Dictionary, “Covenant”.
4. Merriam-Webster's Collegiate Dictionary, botimi i 11-të, (2003), “cleave”.
5. Shih Mosia 18:8–9; shih edhe Tomas S. Monson, “Çfarë Kam Bërë për Dikë Sot?” *Liahona*, nëntor 2009, f. 85–87.
6. Doktrina e Besëlidhje 124:40.
7. *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society* (2011), f. 131–132.
8. *Daughters in My Kingdom*, f. 29.
9. Boyd K. Packer, *The Holy Temple* (1980), f. 170.
10. Doktrina e Besëlidhje 136:4.
11. Shih Mosia 3:5–18.
12. Shih Mosia 4:2; 5:5.
13. Mosia 4:3.
14. Alma 26:1.
15. Alma 26:11.
16. Alma 26:16.
17. Alma 26:35.
18. Doktrina e Besëlidhje 11:13.
19. Maria Speidel, në *Daughters in My Kingdom*, f. 76.
20. Sarah Rich, në *Daughters in My Kingdom*, f. 30.
21. Doktrina e Besëlidhje 110:9–10.
22. Tomas S. Monson, “Tempulli i Shenjtë – Një Fener për Botën”, *Liahona*, maj 2011, f. 93.
23. Doktrina e Besëlidhje 25:13.



Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Mosmëharro

Është lutja dhe bekimi im që ju kurrë të mos harroni se jeni vërtet bija të çmuara në mbretërinë e Perëndisë.

Të dashura motrat e mia, çfarë gëzimi është të jem me ju sot. Gjithmonë mezi e pres këtë mbledhje të përgjithshme vjetore të Shoqatës së Ndihmës dhe mesazhet e shkëlqyera që jepen këtu. Faleminderit, motra. Është një nder i vyer për mua që u caktova nga Presidenti Tomas S. Monson për të folur sot dhe që të shtoj disa mendime duke iu drejtuar motrave të Kishës.

Disa kohë më parë, po ecja nëpër një kopsht të bukur bashkë me gruan dhe bijën time. Mahnitesha nga lavdia dhe bukuria e krijimit të Perëndisë. Dhe pastaj vura re, mes gjithë lulëzimeve të shkëlqyera, lulen më të imët. E dija emrin e kësaj luleje sepse, që kur isha fëmijë, kisha një lidhje të ëmbël me të. Lulja quhet mosmëharro.

Nuk jam krejt i sigurt se përse kjo lule e imët ka pasur kaq shumë kuptim për mua gjatë viteve. Ajo nuk e tërheq menjëherë vëmendjen; është e lehtë të mos ta vësh re mes luleve më të mëdha e gjithë ngjyra; por përsëri është po aq e bukur, me ngjyrën e saj të gjallë që pasqyron atë të qiellit më të kaltër – ndoshta një arsye tjetër se përse e pëlqej kaq shumë.

Dhe është kërkesa e vazhdueshme e emrit të saj. Ka një legjendë gjermane se, kur Perëndia sapo kishte mbaruar së vëni emrat gjithë bimëve,

njëra kishte mbetur pa emër. Një zë i vocërr foli: “Mos më harro, o Zot!” Dhe Perëndia u përgjigj se ky do të ishte emri i saj.

Sonte do të dëshiroja ta përdorja këtë lule të vogël si një metaforë. Pesë petalet e lules së vogël mosmëharro më nxisin të marr parasysh pesë gjëra që do të ishte e urtë të mos i harronim kurrë.

Së pari, mos harroni të jeni të duruara me veten tuaj.

Dëshiroj t’ju them diçka që shpresoj se do ta kuptoni në mënyrën e saktë: Perëndia është plotësisht i vetëdijshëm se ju dhe unë nuk jemi të përkryer.

Më lejoni të shtoj: Perëndia është plotësisht i vetëdijshëm se njerëzit që ju mendoni se janë të përkryer, nuk janë.

Dhe përsëri ne shpenzojmë kaq shumë kohë dhe energji duke e krahasuar veten me të tjerët – zakonisht duke krahasuar dobësitë tona me pikat e tyre të forta. Kjo na çon të krijojmë pritshmëri për veten që janë të pamundura për t’u përmbushur. Si rezultat, ne kurrë nuk kremtojmë përpjekjet tona të mira, sepse duket sikur ato janë më pak se çfarë bën dikush tjetër.

Çdo njeri ka pika të forta dhe dobësi.

Është e mrekullueshme që ju keni pika të forta.

Është pjesë e përvojës tuaj në vdekshmëri që ju të keni dobësi.

Perëndia dëshiron të na ndihmojë që përfundimisht të shndërrojmë gjithë dobësitë tona në pika të forta¹, por Ai e di se ky është një synim afatgjatë. Ai dëshiron që ne të bëhemi të përkryer ashtu si është Ai² dhe nëse do të qëndrojmë në shtegun e dishepullimit, një ditë do të bëhemi. Është OK që nuk jeni të përkryera ende. Vazhdoni të punoni, por pushoni së ndëshkuari veten.

Motra të dashura, shumë prej jush janë pafundësisht zemërdhembshura dhe të duruara me dobësitë e të tjerëve. Ju lutem, kujtohuni gjithashtu që të jeni zemërdhembshura dhe të duruara me veten tuaj.

Ndërkohë, jini mirënjohëse për gjithë sukseset e vogla në shtëpinë tuaj, marrëdhëniet tuaja familjare, arsimimin dhe jetesën tuaj, pjesëmarrjen tuaj në Kishë dhe përmirësimin vetjak. Ashtu si lulet mosmëharro, këto suksese mund t’ju duken të vogla juve dhe mund të mos vihen re nga të tjerët, por Perëndia i vë re ato dhe ato nuk janë të vogla për Të. Nëse e mendoni suksesin sikur të jetë vetëm trëndafil më i përkryer apo orkidea më verbuese, mund të humbisni disa nga përvojat më të ëmbla të jetës.

Për shembull, këmbëngulja që të keni një mbrëmje familjare “të përkryer si një pikaturë” çdo javë – edhe pse bërja e kësaj ju bën të mjerë ju dhe gjithkënd rreth jush – mund të mos jetë zgjedhja më e mirë. Përkundrazi, pyeteni veten: “Çfarë mund të bëjmë ne si familje që do të jetë e gëzueshme e shpirtërore dhe do të na afrojë së bashku?” Ajo lloj mbrëmjeje familjare – edhe pse mund të jetë e thjeshtë në qëllim e zbatim – mund të ketë rezultate afatgjata shumë më pozitive.

Udhëtimi ynë drejt përkryerjes është i gjatë, por mund të gjejmë mrekulli dhe kënaqësi madje edhe në hapat më të veckël në atë udhëtim.

Së dyti, mos harroni dallimin midis një sakrifice të mirë dhe një sakrifice të pamend.

Një sakrificë e pranueshme është kur heqim dorë nga diçka e mirë për diçka që ka vlerë shumë më të madhe.

Të heqësh dorë nga pak gjumë për të ndihmuar një fëmijë që ka një makth, është një sakrificë e mirë. Të gjithë e dimë këtë. Të rrish zgjuar gjithë natën, duke vënë në rrezik vetë shëndetin tënd, për të përgatitur ornamentin e përkryer për veshjen e së dielës së një baje, mund të mos jetë një sakrificë kaq e mirë.

Përkushtimi i një pjese nga koha jonë studimit të shkrimeve të shenjta ose përgatitjes për të dhënë një mësim, është një sakrificë e mirë. Shpenzimi i shumë orëve për të thurur titullin e mësimin në mbajtëse vazosh të bëra me dorë për secilën anëtare të klasës tuaj, ndoshta mund të mos jetë.

Çdo njeri dhe situatë është e ndryshme dhe, një sakrificë e mirë në një rast mund të jetë një sakrificë e pamend në një tjetër.

Si mund ta dallojmë ndryshimin për vetë situatën tonë? Ne mund të pyesim veten: "A po ua kushtoj kohën dhe energjitë e mia gjërave që kanë më tepër rëndësi?" Ka kaq shumë gjëra të mira për të bërë, por ne nuk mund t'i bëjmë të gjitha ato. Ati ynë Qielor është më i kënaqur kur sakrifikojmë diçka të mirë për diçka shumë më të mirë nga këndvështrimi i perjetësisë. Nganjëherë, kjo madje mund të ketë kuptimin që të ushqejmë lule mosmëharro, të vogla por të bukura, në vend të një kopshti të madh me lule ekzotike.



Së treti, mos harroni të jeni të lumtura tani.

Në novelën e dashur për fëmijët, *Çarli dhe Fabrika e Çokollatave*, prodhuesi misterioz i çokollatave Uilli Uonka fsheh nga një biletë të artë në pesë prej pafkave prej çokollate të tij dhe shpall se kushdo që gjen një nga biletat, fiton një tur tek fabrika e tij dhe një furnizim me çokollata për të gjithë jetën.

Shkruar në secilën biletë të artë është ky mesazh: "Përhëndetje, gjetës fatlum i kësaj Bilete të Artë . . . ! Gjëra të mrekullueshme janë gati për ty! Shumë befasi të çuditshme të presin! . . . Befasi të mistershme dhe të mrekullueshme . . . do të të . . . magjepsin, . . . habisin dhe hutojnë."³

Në këtë novelë klasike për fëmijë, njerëzit në mbarë botën kërkojnë me dëshpërim që të gjejnë një biletë të artë. Disa e ndiejnë sikur e gjithë lumturia e tyre e ardhme varet nga fakti nëse një biletë e artë do të bjerë në duart e tyre ose jo. Në merakun e tyre, njerëzit fillojnë të harrojnë gëzimin e thjeshtë që gjenin tek një çokollatë. Vetë çokollata bëhet një zhgënjim i plotë nëse nuk përmban një biletë të artë.

Kaq shumë njerëz sot po presin për biletën e tyre të artë – biletën që ata besojnë se mban çelësin për lumturinë

për të cilën kanë ëndërruar gjithmonë. Për disa, bileta e artë mund të jetë një martesë e përkryer; për të tjerë, një shtëpi e denjë për një kopertinë reviste ose ndoshta, çlirimi nga stresi apo shqetësimi.

Nuk ka asgjë të gabuar lidhur me dëshirat e zjarra të drejta – ne shpresojmë dhe kërkojmë gjëra që janë "të virtytshme, të dashur[a] ose me famë të mirë apo të denj[a] për t'u lavdëruar"⁴. Problemi vjen kur ne e shtyjmë lumturinë tonë ndërsa presim që të shfaqet ndonjë ngjarje e ardhshme – bileta jonë e artë.

Një grua dëshironte më shumë se gjithçka tjetër që të martohej në tempull me një mbajtës priftërie të drejtë dhe që të ishte nënë dhe bashkëshorte. Ajo kishte ëndërruar për këtë të gjithë jetën e saj dhe, oh, çfarë nëne e mrekullueshme dhe bashkëshorte e dashur që do të ishte. Shtëpia e saj do të ishte e mbushur me dashuri e shpirtmirësi. Nuk do të flitej kurrë një fjalë e hidhur. Gjella nuk do të digej kurrë. Dhe fëmijët e saj, në vend që ta kalonin kohën me shoqërinë, do të parapëlqenin t'i kalonin mbrëmjet dhe fundjavët me Mamin dhe Babin.

Kjo ishte bileta e saj e artë. Ishte e vetmja gjë për të cilën ajo ndiente se aty varej gjithë të qenit e saj. Ishte e vetmja gjë në të gjithë botën

që ajo dëshironte më me zjarr dhe dëshpërim.

Por nuk ndodhi kurrë. Dhe, ndërsa vitet kalonin, ajo u bë gjithmonë e më e mbyllur, e hidhëruar dhe madje e inatosur. Ajo nuk mund ta kuptonte se përse Perëndia nuk do t'ia plotësonte asaj këtë dëshirë të drejtë.

Ajo punonte si mësuese në shkollë fillore dhe, të qenit me fëmijë gjatë gjithë ditës thjesht i kujtonte se bileta e saj e artë nuk ishte shfaqur kurrë. Ndërsa vitet kalonin, ajo u bë më e zhgënjyer dhe më e mbyllur. Njerëzve nuk u pëlqente të rrinin me të dhe e shmangnin kurdoherë që mundeshin. Ajo madje e shfryu pakënaqësinë e saj tek nxënësit në shkollë. Ajo filloi ta humbiste vetëkontrollin dhe të kalonte nga shpërthime të inatit tek vetmia e dëshpëruar dhe anasjelltas.

Tragjedia e kësaj ndodhie është se kjo grua e dashur, në gjithë zhgënjimin për biletën e saj të artë, nuk arriti të vinte re bekimet që ajo *vërtet* i kishte. Ajo nuk kishte fëmijë në shtëpi, por ishte e rrethuar nga ata në klasën e saj. Ajo nuk qe e bekuar me një familje, por Zoti i kishte dhënë asaj një mundësi që pak njerëz e kanë – shansin për të ndikuar për mirë si mësuese jetën e qindra fëmijëve dhe familjeve.

Mësimi këtu është që, nëse i kalojmë ditët tona duke pritur për trëndafila përrallorë, mund të humbasim bukurinë dhe mrekullinë e luleve të imta mosmëharro që janë kudo rreth nesh.

Kjo nuk do të thotë se duhet të braktisim shpresën apo të kufizojmë synimet tona. Kurrë mos u ndalni së përpjekuri fort për më të mirën që keni brenda vetes. Kurrë mos u ndalni së shpresuari për të gjitha dëshirat e drejta të zemrës suaj. Por mos i mbyllni sytë e zemrat para bukurive të thjeshta dhe elegante të çasteve të

zakonshme të çdo dite që krijojnë një jetë të pasur e të jetuar mirë.

Njerëzit më të lumtur që njoh, nuk janë ata që gjejnë biletën e tyre të artë; janë ata që, ndërsa ndjekin synime të denja, zbulojnë dhe grumbullojnë si thesar bukurinë dhe ëmbëlsinë e çasteve të përditshme. Janë ata që, duke marrë nga një fije çdo ditë, endin një pëlthurë mirënjohjeje dhe mrekullie gjatë gjithë jetës së tyre. Këta janë ata që janë vërtet të lumtur.

Së katërti, mos harroni “përse-në” e ungjillit.

Nganjëherë, në rutinën e jetës sonë, pa dashje ne nuk vëmë re një aspekt jetësor të ungjillit të Jezu Krishtit, po ashtu si dikush mund të mos vërë re një lule mosmëharro të bukur e delikate. Në përpjekjet tona të zellshme për të përmbushur gjithë detyrat e detyrimet që kemi si anëtarë të Kishës, nganjëherë e mendojmë ungjillin si një listë të gjatë detyrash që duhet t'ia shtojmë listës tonë “për të bërë” që është tashmë e gjatë pamundësisht, si një bllok kohe që ne duhet ta fusim në ndonjëfarë mënyre në programet tona ditore të ngjeshura. Ne përqendrohemi tek ajo *çfarë* Zoti dëshiron që të bëjme ne dhe se *si* mund ta bëjme, por nganjëherë harrojmë *përse* [e bëjme].

Motrat e mia të dashura, ungjilli i Jezu Krishtit nuk është një detyrim; ai është një shteg, i shenjuar nga Ati ynë i dashur në Qiell, që çon tek lumturia dhe paqja në këtë jetë dhe tek lavdia e përmbushja e pashprehshme në jetën që do të vijë. Ungjilli është një dritë që përshkon vdekshmërinë dhe ndriçon udhën përpara nesh.

Ndërsa kuptojmë se pjesët “çfarë” dhe “si” të ungjillit janë të domosdoshme, zjarri i përjetshëm dhe madhështia e ungjillit buron nga “përse-ja”. Kur e kuptojmë se *përse* Ati ynë

Qiellor na ka dhënë këtë model për të jetuar, kur kujtojmë se *përse* u zotuar ta bëjmë atë një pjesë themelore të jetës sonë, ungjilli nuk bëhet më një barrë dhe, përkundrazi, bëhet një gëzim dhe një kënaqësi. Ai bëhet i çmuar dhe i ëmbël.

Le të mos ecim në shtegun e dishepullimit me sytë poshtë, duke menduar vetëm detyrat dhe detyrimet që janë para nesh. Le të mos ecim të pavetëdijshëm për bukurinë e peizazheve të lavdishme tokësore e shpirtërore që na rrethojnë.

Motra të dashura, kërkoni madhështinë, bukurinë dhe gëzimin emocional të “përse-së” së ungjillit të Jezu Krishtit.

Pjesët “çfarë” dhe “si” të bindjes shenjojnë udhën dhe na mbajnë në shtegun e saktë. “Përse-ja” e bindjes shenjtëron veprimet tona, duke shndërruar të rëndomtën në madhështore. Ajo i lartëson veprimet tona të vogla të bindjes në veprime të shenjta përkushtimi.

Së pesti, mos harroni se Zoti ju do.

Kur isha fëmijë dhe shihja lulet e vogla mosmëharro, nganjëherë u ndjeva pak si ato lule – i vogël dhe i parëndësishëm. Vrisja mendjen nëse do të harrohesha nga familja ime ose nga Ati im Qiellor.

Vite më vonë, mund të shoh pas tek ai djalë i vogël me butësi dhe dhe mbshuri. Dhe unë e di tani – mua nuk më harruan kurrë.

Dhe unë di diçka tjetër: si një Apostull i Mësuesit tonë, Jezu Krishtit, unë shpall me sigurinë dhe bindjen e zemrës sime – as ju!

Ju nuk ju kanë harruar.

Motra, kudo që të jeni, çfarëdo qofshin rrethanat tuaja, ju nuk ju kanë harruar. Pavarësisht sa të errëta të mund t'ju duken ditët tuaja, pavarësisht se sa të parëndësishme mund të ndiheni,



pavarësisht se sa në hije mund të mendoni se jeni, Ati juaj Qiellor nuk ju ka harruar. Në të vërtetë, Ai ju do me një dashuri të pafundme.

Thjesht mendoni për këtë: Juve ju njih dhe ju kujton qenia më madhështore, më e fuqishme dhe më e lavdishme në univers! Juve ju do Mbreti i hapësirës së pafund dhe i kohës së përhershme!

Ai që krijoi dhe i njih yjet, ju njih ju dhe emrin tuaj – ju jeni bijat e mbretërisë së Tij. Psalmisti shkroi:

“Kur mendoj qiejtë e tu, që janë vepër e gishtërinjve të tu, hënën dhe yjet që ti ke vendosur,

çfarë është njeriu, që ta mbash mend? . . .

Megjithatë ti e bërë pak më të ulët se Perëndia, dhe e kurorëzove me lavdi dhe me nder.”⁵

Perëndia ju do sepse ju jeni fëmijët e Tij. Ai ju do edhe pse nganjëherë mund të ndiheni të vetmuara apo bëni gabime.

Dashuria e Perëndisë dhe fuqia e ungjillit të rivendosur janë shëlbuese dhe shpëtuese. Nëse ju vetëm e lejoni dashurinë e Tij hyjnore në jetën tuaj, ajo mund të trajtojë çfarëdo plage, të shërojë çfarëdo lëndimi dhe të zbutë çfarëdo hidhërimi.

Motra të mia të dashura të Shoqatës së Ndihmës, ju jeni më afër qiellit se sa mund ta mendoni. Ju jeni destinuar për shumë më tepër se sa mund ta

përfytyroni. Vazhdoni të rriteni në besim dhe drejtësi personale. Pranojeni ungjillin e rivendosur të Jezu Krishtit si mënyrën tuaj të jetesës. Kijeni për zemër dhuratën e aktivitetit në këtë Kishë të shkëlqyer e të vërtetë. Mbajeni si thesar dhuratën e shërbimit në organizatën e bekuar të Shoqatës së Ndihmës. Vazhdoni të forconi shtëpitë dhe familjet. Vazhdoni të kërkoni e të ndihmoni të tjerët që kanë nevojë për ndihmën tuaj dhe të Zotit.

Motra, ka diçka frymëzuese dhe madhështore në lidhje me lulen e vogël mosmëharro. Shpresoj se do të jetë një simbol i gjërave të vogla që e bëjnë jetën tuaj të gëzueshme dhe të ëmbël. Ju lutem, mos harroni kurrë se duhet të jeni të duruara e të dhembshura me veten tuaj, se disa sakrifica janë më të mira se disa të tjera, se nuk ju duhet të prisni për një biletë të artë që të jeni të lumtura. Ju lutem mos harroni kurrë se “përse-ja” e ungjillit të Jezu Krishtit do t’ju frymëzojë e ngrejë moralisht. Dhe mos harroni kurrë se Ati juaj Qiellor ju njih, ju do dhe ju ka për zemër.

Faleminderit për atë që jeni. Faleminderit për veprimet e panumërta të dashurisë dhe shërbimit që ju u jepni kaq shumë njerëzve. Faleminderit për të gjithë atë që ende bëni për t’u sjellë gëzimin e ungjillit të Jezu Krishtit familjeve, Kishës, komuniteteve tuaja si dhe kombeve të botës.

Motra, ne ju duam. Është lutja dhe bekimi im që ju kurrë të mos harroni se jeni vërtetë bija të çmuara në mbretërinë e Perëndisë, në emrin e shenjtë të Shpëtimtarit tonë të dashur, Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Ethëri 12:27.
2. Shih 3 Nefi 12:48.
3. Roald Dahl, *Charlie and the Chocolate Factory* (1964), f. 55–56.
4. Nenet e Besimit 1:13.
5. Psalmeve 8:3–5.

Treguesi i Ngjarjeve në Konferencë

Lista vijuese e përvojave të përzgjedhura nga fjalimet e konferencës së përgjithshme mund të përdoret në studimin vetjak, mbrëmjen familjare dhe mësimdhënie tjetër. Numri i referohet faqes së parë të bisedës.

FOLËSI	NGJARJA
Plaku Riçard G. Skot	(6) Riçard G. Skot bën një regjistrim zanor të Librit të Mormonit për familjen e tij.
Plaku Hoze L. Alonso	(14) Prindërit e merakosur humbasin djalin e vogël në qytetin e Meksikos.
Presidenti Bojd K. Paker	(16) Bojd K. Paker merr bekimin e tij patriarkal.
Presidenti Diter F. Uhtdorf	(19) Diter F. Uhtdorf ndihmon për ndërtimin e një shtëpie mbledhjesh ndërkohë që merr pjesë në trajnimin për pilot të forcave ajrore. Një çift besnik ushtron një ndikim pozitiv mbi njerëzit që ka përreth.
Plaku Dejvid A. Bednar	(24) Të rinj të Priftërisë Aarone i japin mësim një klase të historisë familjare.
Plaku Nil L. Andersen	(28) Xhejms O. Mason dhe bashkëshortja e tij vendosin që të mos presin për të pasur fëmijë. Skot dhe Beki Dorius adoptojnë fëmijë pas 25 vitesh martesë.
Plaku Karl B. Kuk	(33) Tomas S. Monsoni e nxit Karl B. Kukun që të shohë lart. Motrat lëshojnë "barrat" në qiell në formën e tullumbaceve me helium.
Plaku LeGrand R. Kurtis i Riu	(35) Anëtarët më pak aktivë gjejnë shëlbim kur i ftojnë që të kthehen në kishë.
Plaku D. Tod Kristoferson	(38) Një i mbijetuar nga Doner Parti kujton mëngjesin kur pa Fermën e Xhonsonit.
Plaku W. Kristofer Uadell	(50) Misionari Havier Misiego takon burrin që pagëzoi babanë e tij.
Presidenti Henri B. Ajring	(56) Henri B. Ajring në moshë të re dhe peshkopi i tij vizitojnë një motër në lagjen e tyre. Gordon B. Hinkli dhe Henri B. Ajring shqyrtojnë një dorëshkrim natën vonë.
Presidenti Tomas S. Monson	(60) Tomas S. Monsoni mendon se ai është anëtari i vetëm i Kishës në kampin e trajnimit. Tomas S. Monsoni u flet për Kishën njerëzve në një autobus.
Presidenti Henri B. Ajring	(68) Henri B. Ajring flet në një universitet ku i kërkojnë të mos ndajë dëshminë e tij për Jezu Krishtin. Henri B. Ajring merr me vete të bijat e tij në vizitën tek një mikeshë që po vdes nga kanceri. Një burrë që po vdes, vishet me rrobat e së dielës për një bekim priftërie. Vite pasi largohet nga shtëpia, një burrë lexon Librin e Mormonit dhe fiton një dëshmi.
Plaku Ted R. Kelister	(74) Një e re i dëshmon shoqes së saj për vërtetësinë e Librit të Mormonit.
Presidenti Tomas S. Monson	(82) Tomas S. Monsoni mëson për fuqinë e lutjes pasi gjen pesë dollarëshin që mendonte se e kishte humbur. Tomas S. Monsoni ka përshtypjen që të njoftojë Piter Morekun për të folur në përkushtimin e Tempullit të Frankfurtit në Gjermani.
Plaku Rasëll M. Nelson	(86) Rusë të kthyer në besim vlerësojnë martesën e tyre në tempull.
Plaku Randall K. Benet	(98) Randall K. Benet shpërfill paralajmërimet për një rrymë të fortë oqeani.
Plaku J. Devn Kornish	(101) J. Devn Kornish gjen mrekullisht një çerek dollarëshi në përgjigje të lutjes.
Plaku Kuentin L. Kuk	(104) Alma Zon anulon rezervimin për tek anija <i>Titanik</i> . Irene Korbet vdes në anijen <i>Titanik</i> .
Silvia H. Ollred	(114) Një motër që vuan nga shumë sëmundje, ngushëllohet nga mësueset vizitore. Një burrë kthehet në besim pasi mësueset vizitore i shërbejnë familjes së tij.
Presidenti Diter F. Uhtdorf	(120) Një grua bëhet e hidhët sepse nuk është e martuar dhe nuk ka fëmijë.

Mësimet për Kohën Tonë

Mësimet e Priftërisë Melkizedeke dhe të Shoqatës së Ndhmës të dielën e katërt të muajit do t'u kushtohen "Mësimeve për Kohën Tonë". Secili mësim mund të përgatitet nga një ose më shumë biseda që janë dhënë në konferencën e përgjithshme më të fundit (shih tabelën më poshtë). Presidentët e kunjeve dhe të distrikteve mund të zgjedhin se cilat biseda duhet të përdoren, ose ata mund t'ia japin këtë përgjegjësi peshkopëve dhe presidentëve të degëve. Udhëheqësit duhet të theksojnë vlerën për vëllezërit e Priftërisë Melkizedeke dhe motrat e Shoqatës së Ndhmës që të studiojnë të njëjtat biseda në të njëjtën të diel.

Ata që marrin pjesë në mësimet e të dielave të katërta, nxiten të studiojnë dhe të sjellin në klasë botimin e revistës të konferencës së përgjithshme më të fundit.

Sugjerime për Përgatitjen e një Mësimi nga Bisedat

Lutuni që Shpirti i Shenjtë të jetë me ju kur studioni dhe jepni mësim

bisedën(at). Mund të tundoheni ta përgatitni mësimin duke përdorur materiale të tjera, por bisedat e konferencës janë materiali mësimor i miratuar. Detyra juaj është të ndihmoni të tjerët të mësojnë dhe të jetojnë ungjillin siç mësohet në konferencën e përgjithshme më të fundit të Kishës.

Rishiheni bisedën(at), duke kërkuar parime dhe doktrina që plotësojnë nevojat e anëtarëve të klasës. Gjithashtu kërkonin ndodhi, referenca shkrimi të shenjtë dhe deklarata nga biseda(t) që do t'ju ndihmojnë të jepni mësim mbi këto të vërteta.

Bëni një plan se si të jepni mësim mbi parimet dhe doktrinën. Plani juaj duhet të përfshijë çështje që ndihmojnë anëtarët e klasës:

- Të kërkojnë parime dhe doktrina në bisedë(at).
- Të mendojnë për domethënien e tyre.
- Të ndajnë së bashku kuptimet, idetë, përvojat dhe dëshmitë.
- Të zbatojnë këto parime dhe doktrina në jetën e tyre. ■

MUAJT KUR ZHVILLOHEN MËSIMET

Nëntor 2011–Prill 2012

Maj 2012–Tetor 2012

MATERIALE PËR MËSIMET E SË DIELËS SË KATËRT

Bisedat e botuara në numrat e nëntorit 2011 të *Liahonës**

Bisedat e botuara në numrat e majit 2012 të *Liahonës**

*Këto biseda janë të disponueshme në shumë gjuhë në faqen conference.lds.org.

Presidencat e Përgjithshme të Organizatave Ndhmëse


SHOQATA E NDIHMËS



Silvia H. Ollred
Këshilltare e Parë



Xhuli B. Bek
Presidente




Barbara Tompson
Këshilltare e Dytë


TË REJAT



Meri N. Kuk
Këshilltare e Parë




Elen S. Dalton
Presidente




En M. Dib
Këshilltare e Dytë

FILLORJA



Xhin A. Stivens
Këshilltare e Parë



Rozmari M. Uiksom
Presidente



Sheril A. Esplin
Këshilltare e Dytë

TË RINJTË



Leri M. Gibson
Këshilltar i Parë



Dejvid L. Bek
President



Adrián Ocoá
Këshilltar i Dytë

SHKOLLA E SË DIELËS



Dejvid M. Mek-Konki
Këshilltar i Parë



Rasëll T. Osguthorp
President



Methju O. Riçardson
Këshilltar i Dytë



Një paraqitje artistike tregon Tabernakullin e Provos, i cili u shkatërrua nga zjarri, të restauruar si tempullin e dytë në Provo të Jutas, SHBA.

Konferenca e Përgjithshme Gjysmëvjetrore e 181-të

Më shumë se 100.000 njerëz morën pjesë në pesë sesione të Konferencës së Përgjithshme Gjysmëvjetrore të 181-të të Kishës së Jezut Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme në Qendrën e Konferencave në Solt-Lejk-Siti të Jutas në SHBA, më 1 dhe 2 tetor. Miliona të tjerë e panë ose e dëgjuan nëpërmjet TV, radios, satelitit dhe transmetimeve me internet.

Gjatë sesionit të parë të shtunën, më 1 tetor, Presidenti Tomas S. Monson njoftoi vendndodhjen e gjashtë tempujve të rinj: Barrankila në Kolumbi; Durban në Afrikën e Jugut; Kinshasa në Republikën Demokratike të Kongos; Paris në Francë; Provo në Juta, SHBA; dhe Star Valej në Uajoming, SHBA.

Pas këtij njoftimi, Presidenti Monson ftoi anëtarët për të kontribuar në Fondin e Përgjithshëm të Kishës për Ndhimën Përkrahëse për Tempujt. “Ky fond siguron vetëm një vizitë për në tempull për ata që ndryshe nuk do të ishin në gjendje që të shkonin në tempull”, tha ai.

Të shtunën pasdite, Plaku Dejvid A. Bednar, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, njoftoi një sesion të ri të youth.lds.org – FamilySearch Youth and Family History [Kërkimit Familjar për të Rinjtë dhe Historisë së Familjes] (lds.org/familyhistoryyouth). Ky sesion

i ri ka për qëllim të ndihmojë të rinjtë që të zbulojnë historinë e familjes dhe t’u shërbejnë paraardhësve të tyre duke kërkuar në dokumentet e tyre. (Shih artikullin në faqen 128.)

Gjithashtu gjatë këtij sesioni, Plaku Klaudio R. M. Kosta u lirua [nga thirrja] nga Presidenca e Të Shtatëdhjetëve. Plaku Ted R. Kelister u mbështet në Presidencën e Të Shtatëdhjetëve (shih faqen 128 për biografinë e tij). Dymbëdhjetë nga Të Shtatëdhjetët dhe Të Shtatëdhjetët Zonalë u liruan ose plotësuan statusin e daljes në pension (shih faqen 23 për mbështetjet dhe lirimet [nga thirrja]).

Gjatë bisedës së tij të dielën në mëngjes, Presidenti Henri B. Ajring, Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë, kujtoi individët për thirrjen – e bërë gjatë konferencës së përgjithshme të prillit në fillim të këtij viti – për të gjithë anëtarët që të marrin pjesë në një ditë shërbimi gjatë 2011-ës (shih Henri B. Ajring, “Mundësi për të Bërë Mirë”, *Liahona*, maj 2011, f. 22).

Anëtarët përreth botës e dëgjuan konferencën në 93 gjuhë. Për informacion në lidhje me atë se kur do jenë në dispozicion në gjuhë të ndryshme variantet e konferencës në tekst, audio dhe video, vizitoni lds.org/general-conference/when-conference-materials-will-be-available. ■

Daughters in My Kingdom: A Historical Work for Today's LDS Woman [Bija në Mbretërinë Time: Një Punë Historike për Gratë e Sotme SHDM]

Nga Çells Nibergëll

Revistat e Kishës

Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society [Bija në Mbretërinë Time: Historia dhe Puna e Shoqatës së Ndhimës], një libër i ri i përgatitur nën drejtimin e Presidencës së Parë, përmban një dokument të trashëgimisë së Shoqatës së Ndhimës dhe grave të Kishës, tha Xhuli B. Bek, presidentja e përgjithshme e Shoqatës së Ndhimës, gjatë mbledhjes së përgjithshme të Shoqatës së Ndhimës në shtator 2011.

“Ai do t’i bashkojë motrat nëpër botë dhe do t’i ndihmojë ato të jetojnë në përputhje me qëllimet e Shoqatës së Ndhimës dhe modelet e privilegjet e të jetuarit si një pasuese”, tha ajo. “Ai është një dëshmi e rolit qendror të grave në planin e lumturisë së Atit tonë dhe ofron një standard të palëkundur të asaj se çfarë besojmë, çfarë bëjmë dhe çfarë do të mbrojmë” (faqja 113 e këtij botimi).

Motra Bek tha se libri siguron një bazë për identitetin e grave si bija të Perëndisë. Ndërsa njerëzit e studiojnë librin, tha ajo, ata do të jenë në gjendje të shohin se si Shoqata e Ndhimës do të veprojnë në jetën e çdo motre.

Si u Krijua Libri

Projekti filloi si një detyrë nga Presidenca e Parë. Suzan W. Taner,



ish-presidentja e përgjithshme e Të Rejave, u veçua për të shkruar librin. Motra Bek dhe këshilltaret e saj, Silvia H. Ollred dhe Barbara Tompson, u caktuan për të administruar projektin dhe për të punuar me Motrën Taner, redaktorët, faqosësit dhe të tjerët për të përcaktuar drejtimin e tij përmes shpirtit të zbulesës. Motra Bek tha: “Unë kurrë nuk kam punuar në ndonjë projekt që ka qenë kaq shumë i drejtuar nga Shpirti sa ky”.

Një pjesë e atij procesi përfshiu marrjen e vendimit se cila nga mijëra faqet e rrëfimit historik duhej të përfshihet në libër. Motra Bek, këshilltaret e saj dhe Motra Taner shqyrtuan procesverbalet nga mbledhjet e mëparshme të Shoqatës së Ndihmës në Navu dhe histori e rrëfime të tjera rreth Shoqatës së Ndihmës dhe grave të Kishës.

Motra Bek tha se përfundimi nuk është një histori tipike kronologjike, por një histori shpirtërore e grave të Kishës dhe Shoqatës së Ndihmës.

“Ne e studiojmë historinë tonë sepse ajo na ndihmon ne që të ndryshojmë”, tha Motra Bek në fjalimin e saj të mbledhjes së përgjithshme të Shoqatës së Ndihmës në shtator 2010. “Së fundi, vlera e historisë nuk është aq shumë te datat, kohët dhe vendet. Ajo është e vlefshme sepse na mëson neve parimet, qëllimet dhe modelet që ne duhet të ndjekim, ajo na ndihmon të dimë kush jemi e çfarë duhet të bëjmë dhe na bashkon në forcimin e shtëpive të Sionit e në ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë në tokë” (“Bija në Mbretërinë Time: Historia dhe Puna

e Shoqatës së Ndihmës,” *Liahona*, nëntor 2010, f. 115).

Ndërsa libri ndjek një linjë kohore, mësimet e tij janë paraqitur në kapituj që janë tematikë. Ai përdor histori dhe shembuj nga shkrimet e shenjta dhe kohët moderne, nga fjalët e profetëve dhe nga udhëheqëset e Shoqatës së Ndihmës për t'i dhënë mësim mesazhet e tij të rëndësishme.

Ndikimi i Librit

Motra Bek tha se nëpërmjet librit, motrat do të mësojnë se si t'i përmbushin qëllimet e Shoqatës së Ndihmës në jetën e tyre dhe si motëri pasuese e mbajtjes së besëlidhjes.

“Ato do të mësojnë se çfarë do të thotë të rrisësh besimin dhe drejtësinë vetjake, të forcosh familjen e shtëpinë dhe të kërkosh e ndihmohesh të tjerët që janë në nevojë”, tha Motra Bek në një intervistë për revistat e Kishës. “Ndërkohë që motrat arrijnë të kuptojnë rolin e tyre në Shoqatën e Ndihmës, ato mund të kuptojnë se sa ndikuese kanë qenë gratë në zhvillimin e Kishës, si në lashtësi, ashtu edhe në ditët e fundit dhe ato mund të dinë qëllimin e tyre dhe identitetin e tyre.”

Motra Bek beson se ata që e lexojnë librin do të mësojnë nëpërmjet shembullit dhe porosisë morale se si të dëgjojnë Frymën e Shenjtë dhe të marrin zbulesë personale. Ata gjithashtu, mund të forcohen dhe inkurajohen në jetën e tyre të përditshme dhe në sfidat e vështirësitë e tyre.

“Ka shumë shembuj force në libër – shumë forcë që mund ta marrim për shembull”, tha Motra Bek. “Kështu që në ditë të vështira, unë shpresoj se njerëzit do ta mbajnë librin e tyre pranë, do ta marrin dhe do të lexojnë një histori ose shembull që do t'i forcojë ata.”

Motra Bek tha gjithashtu se libri do të shkojë në shtëpitë e Kishës nëpërmjet duarve të motrave, por ajo beson se libri do të jetë një burim i rëndësishëm si për burrat ashtu edhe për gratë. Ai do t'i ndihmojë të rejtat të kuptojnë se si ato bëhen pjesë e një motërie të mrekullueshme në mbarë botën,

dhe ai mund t'i bashkojë bashkëshortët dhe bashkëshortet në punën e tyre të shenjtë për të udhëzuar familjen e tyre dhe për të shërbyer në Kishë.

Pas studimit të librit, Deil Kuk, presidenti i kunjit Bluf në Sajrakjus të Jutas, tha se ky do të jetë një burim i rëndësishëm për të ndihmuar jo vetëm gratë e Kishës për të kuptuar rolin e tyre si pasuese të Krishtit, por gjithashtu dhe burrat. “Ju e lexoni dhe e shihni se si ajo [Shoqata e Ndihmës] është e gërshtuar dhe e lidhur me priftërinë”, tha Presidenti Kuk. “Ajo më ka ndihmuar të kuptoj fuqinë tek bashkëshortja ime dhe [si] ta dua [më mirë] atë dhe ta ndihmoj e mbështes.”

Rreth Librit

Libri është një burim për studimin vetjak dhe për mësimdhënien në shtëpi, në Shoqatën e Ndihmës dhe në mjedise të tjera të Kishës. Ai po u dërgohet peshkopëve dhe presidentëve të degëve, të cilët do të punojnë me presidentet e Shoqatës së Ndihmës për të vendosur se si ta bëjnë shpërndarjen e librave një bekim për motrat në lagje dhe degë.

Librat priten të jenë në dispozicion në gati njëzet gjuhë nga fundi i janarit 2012. Shumë prej tyre janë tashmë të arritshme në internet, ku anëtarët mund të gjejnë video shoqëruese, të ndajnë citate dhe të lexojnë sugjerime për mënyrën se si t'i përdorin dhe ndajnë mesazhet në libër. Shkoni te lds.org/relief-society/daughters-in-my-kingdom. Klikoni në “**Additional Languages (PDF)**” në qendër të faqes poshtë “**Related Resources**”. Një listë e gjuhëve në dispozicion do të shfaqet në anën e djathtë të faqes tjetër. Faqja e internetit në fund do të përkthehet në disa gjuhë.

Një botim i librit me kapak kartoni është planifikuar në anglisht, portugalisht dhe spanjisht deri në fund të vitit dhe do të jetë i gatshëm përmes Shërbimeve të Shpërndarjes dhe store. lds.org. ■

Faqe e Re Interneti për të Ndhimuar Adoleshentët që të Fillojnë Historinë e Familjes

Sesioni i ri i FamilySearch Youth and Family History [Kërkimit Familjar për të Rinjtë dhe Historisë së Familjes] në youth.lds.org (lds.org/familyhistoryyouth) ka për qëllim të ndihmojë të rinjtë të zbulojnë historinë e familjes dhe t'u shërbejnë paraardhësve të tyre duke kërkuar në dokumentet e tyre.

Faqja e internetit pasqyron burimet që i mësojnë adoleshentët se si të fillojnë përdorimin e Kërkimit Familjar. Me pesë hapa të thjeshtë, të rinjtë u është mësuar se si të hulumtojnë pemën e tyre të familjes, si të bëjnë dokumentet e familjes dhe të përgatisin emrat për t'i marrë në tempull. Faqja gjithashtu, përfshin idetë se si klasat dhe kuorumet mund ta përdorin historinë familjare si një mjet për t'u shërbyer të tjerëve.

Sesioni i ri është aktualisht i disponueshëm në anglisht, portugalisht dhe spanjisht. Gjuhë të tjera do të mundësohen në muajt e ardhshëm. ■



Konkursi i Artit i Fton të Rinjtë për të Shkëlqyer

Muzeu i Historisë së Kishës i fton të rinjtë e moshës 13 deri në 18 vjeç për të marrë pjesë në Konkursin e tij të parë Ndërkombëtar të Artit për të Rinjtë.

Artistët duhet të krijojnë vepra që shprehin se çfarë do të thotë “ngrihuni e shkëlqeni” (shih DeB 115:4–6).

Vepra e artit duhet të jetë krijuar pas 1 janarit 2009. Konkurrentët duhet të jenë 13 vjeç, nga 1 janari 2012-ës dhe mund të paraqesin një vepër arti në internet nga 2 janari 2012-ës, deri në fund të afatit – të premten, 1 qershor 2012. Madhësia maksimale është 84 inç (213 cm) në përmasën më të gjatë. Të gjitha mjetet dhe stilet artistike janë të mirëpritura në konkurs.

Informacioni i paraqitjes do jetë në dispozicion në lds.org/youthartcomp.

Fituesve do t'u kërkohet të dërgojnë veprën e tyre origjinale në muze, për t'u paraqitur në ekspozitë nga data 16 nëntor 2012 deri më 17 qershor 2013. ■



Plaku Ted R. Kelister

i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve

Plaku Ted Riçards Kelister, i sapombështetur në Presidencën e Të Shtatëdhjetëve dhe anëtar i Kuorumit të Dytë të Të Shtatëdhjetëve, shpjegon se një nga qëllimet e Vëllezërve është të sjellin “rritjen e vërtetë” në Kishë. “Kjo përfshin shumë e më shumë njerëz, jo vetëm që të vijnë në mbledhjen e sakramentit, por gjithashtu dhe të marrin sakramentin, të marrin ordinancat që Kisha ofron dhe të mbajnë besëlidhjet e tyre”, tha ai.

Duke dashur të ndihmojë udhëheqësit vendorë të Kishës në atë përpjekje, Plaku Kelister është mirënjohës që Zoti i ka dhënë atij mundësinë për të shërbyer në shumë thirrje. “Për shkak se kam pasur të njëjtat përvoja si shumë njerëz, me të cilët jam duke punuar tani – presidentë kunjesh, peshkopë dhe presidentë të kuorumeve të pleqve – shpresoj se kjo më bën më të ndjeshëm dhe të vetëdijshëm se cilat janë nevojat e tyre”, shpjegoi ai.

Plaku Kelister ka shërbyer si një misionar me kohë të plotë në Misionin e Shteteve të Atlantikut Lindor, si president i kuorumit të pleqve, si president misioni i kunjit, si këshilltar i presidentit të kunjit, si peshkop, si president kunj, si përfaqësues krahinor, si i Shtatëdhjetë Zonal, si president i Misionit të Kanadasë, në Toronton Lindore (2005–2008), dhe po shërbente si President i Zonës së Paqësorit kur u thirr në Presidencën e Të Shtatëdhjetëve.

I lindur nga Rid dhe Norin Kelister në dhjetor të 1945-ës, në Glendeil të Kalifornisë, SHBA, Plaku Kelister u diplomua si kontabilist nga Universiteti “Brigam Jang” në 1968. Ai u diplomua në Fakultetin Juridik në Universitetin e Kalifornisë në Los Anxhelos në 1971. Në vitin 1972 fitoi një gradë shkencore në ligjin e taksave nga Universiteti i Nju-Jorkut. Nga 1972 deri në 2005 ai ushtroi profesionin e avokatit dhe ka shkruar libra rreth Shlyerjes dhe Braktisjes, dhe Rivendosjes.

Ai u martua me Kethrin Luis Saporiti në dhjetor 1968 në tempullin e Los Anxhelosit në Kaliforni. Ata kanë gjashtë fëmijë.

Plaku Kelister ka njohur dorën e Zotit në jetën e tij. “Dashuria e Shpëtimtarit është qaq e jashtëzakonshme sa që unë mendoj se Ai dhe Ati ynë në Qiell janë duke pritur me padurim për të na bekuar edhe për gjërat më të vogla që ne bëjmë, sepse ky është karakteri i Tyre.” ■



FOTOGRAFIA NGA MATTHEW REIER

Tempulli i San-Salvadorit në Salvador

Ky tempull mbresëlënës në Salvador u përkushtua më 21 gusht 2011, më i fundit nga 135 tempuj që funksionojnë në mbarë botën. Për tempujt, Presidenti Haurard W. Hanter (1907–1995) tha në fjalimin e tij në konferencën e përgjithshme të tetorit 1994: “Le të jemi një popull që e frekuentojmë tempullin. Frekuentojeni tempullin aq shpesh sa ta lejojnë rrethanat personale. Mbani një figurë tempulli në shtëpinë tuaj që fëmijët tuaj të mund ta shohin atë” (“Exceeding Great and Precious Promises”, Ensign, nëntor 1994, f. 8).



“Unë ndaj dëshminë time te ju se kjo punë është e vërtetë, se Shpëtimtari ynë jeton dhe se Ai udhëzon e drejton Kishën e Tij këtu mbi tokë”, tha Presidenti Tomas S. Monson gjatë sesionit përmbyllës të Konferencës së Përgjithshme Gjysmëvjetore të 181-të. “Unë po ju lë pohimin dhe dëshminë time se Perëndia Ati ynë i Përjetshëm jeton dhe na do. Ai është me të vërtetë Ati ynë dhe Ai është personal dhe i vërtetë. E dallofshim dhe e kuptofshim se sa afër nesh është i gatshëm të vijë Ai, sa larg është i gatshëm të shkojë Ai për të na ndihmuar, se sa shumë na do Ai dhe sa shumë bën Ai dhe është i gatshëm të bëjë për ne.”